MESNEVI

IV

Mevlana Xhelaleddin
Rumi

Bashkia Metropoliane e Konjas, Botimet Kulturore, Nr. 115

Koordinatori i përgjithshëm
Ercan Uslu

Botues
Mehmet Birekul

Korrektore
Flora Hoxha

Kapakët
Sadrettin Özçimi

Shtypur në
Sebat Ofset
+90.332.342 01 53

Konja, Maj / 2007

ISBN
978-9944-913-75-1 (kompleti)
978-9944-913-79-9 (vëll.4)

Përgatitur nga
Realizim i Shoqërisë Anonime Konya Kültür
+90.332. 352 81 11

www.mkm.gov.tr
www.konyakultur.com.tr

Mevlana Xhelaleddin Rumi

MESNEVI
IV

Përkthyes
Dr. Mithat Hoxha

Bashkia Metropoliane e Konjas

21 Ashiku ikën prej rojes dhe hyn në një kopësht të panjohur për të, e gjen të dashurën atje dhe, nga gëzimi, bën lutje për rojen dhe këndon ajetin: "Ndodhin gjëra të tilla që juve s'ju pëlqejnë aspak, mirëpo janë të dobishme e të bekuara për ju!"

24 Vaizi i cili sapo fillonte nga vazi, bënte lutje për mizorët, zemërgurët dhe të pabindurit në besim.

26 Dikush e pyet Isain (a.s.): "Në këtë botë, cila është gjëja më e vështirë e të vështirave?

27 Ashiku kërkon t'i bëjë të keqe, kurse e dashura i bërtet.

29 Sofiu që e zë në flagrancë gruan me një të huaj.

31 Duke përdorur dredhinë, gruaja i veshi të dashurit çarçaf dhe, siç ka thënë Zoti, "hilet tuaja janë shumë të mëdha", përdori pretekste të ndryshme për t'ia mbushur mendjen të shoqit.

32 Gruaja thotë se nuk është fjala për pajën, por për nderin dhe sofiu i thotë që këtë gjë ta mbajë të fshehtë.

33 Qëllimi pse thuhet se Zoti dëgjon e sheh.

34 Bota i përngjet vatrës së zjarrit, kurse takvaja, devocioni i përngjet hamamit!

35 Lëkurëpunuesi i cili, në tregun e shitësve të esencave parfumore, humb ndjenjat nga aromat e mira dhe bie në shtrat i sëmurë.

37 Vëllai i të sëmurit e mjekon të vëllanë fshehurazi me erë të dhjerash e bajgash.

39 Ashiku vendos të dredhojë, kërkon falje për fajin dhe lufton ta fshehë qëllimin; i dashuri e kupton këtë dredhi.

40 I dashuri e hedh poshtë justifikimin e ashikut dhe ia përplas dredhinë syve.

42 Një çift i thotë Aliut - Zoti ia lartësoftë fytyrën - kështu: "Po qe se i beson mbrojtjes së Zotit, hidhu poshtë nga kjo ndërtesë!"; përgjigjja që i jep çiftit emiri i muslimanëve.

44 Faltorja Aksa dhe bima çiçibanoz; Daudi (a.s.) vë si qëllim para Sulejmanit (a.s.) ta bëjë atë faltore.

45 Komenti i haditheve "Fjalë është vetëm kjo: Njerëzit janë vëllezër" dhe "Dijetarët janë si një njeri i vetëm"; veçanërisht uniteti i pejgamberëve Daud dhe Sulejman me pejgamberët e tjerë; mohimi i njërit do të quhet mosbesim ndaj të gjithë pejgamberëve. Shembja e njërës nga ato mijëra shtëpi, si shenjë uniteti, do të konsiderohej se nuk do të mbetej në këmbë asnjë mur, thënia e Zotit, "Ne nuk dallojmë asnjërin mes tyre"... Për njeriun e mençur, mjafton vetëm një shenjë, kurse kjo e kaloi shenjën!

49 Ndërtimi i faltores Aksa.

50 Hutbeja e parë e Osmanit (r.a.) si kalif: "Ai që jep këshillë me punë është më i mirë se ai që jep këshillë me fjalë!"

52 Filozofët thonë se njeriu është një botë e vogël, por të urtët e Zotit kanë thënë se njeriu është një botë e madhe, sepse dija e filozofëve ka të bëjë me trajtën e njeriut, kurse dija e të urtëve ka arritur në të vërtetën e njeriut.

53 Komenti i hadithit "Ummeti, bashkësia ime i përngjet gjemisë së Nuhut... Kush hyri në atë gjemi, shpëtoi, kush nuk hyri, u mbyt e shkoi!"

55 Belkizja i dërgon dhuratë Sulejmanit (a.s.) nga qyteti Sebe.

57 Kerametet dhe nuri i Sheh Abdullah Magribit - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën!

58 Sulejmani (a.s.) ia kthen prapë Belkizes përfaqësuesit së bashku me dhuratat që i kishte dërguar ajo dhe e fton Belkizen të heqë dorë nga adhurimi i diellit dhe t'i besojë Zotit.

59 Myshteriu i mësuar të hajë dhé ia vjedh fshehtas shitësit të artikujve të përzier argjilën e larjes së kokës që ai e përdorte si dërrhem, ndërsa po peshonte sheqer.

61 Sulejmani (a.s.) ua fiton zemrat përfaqësuesve, u bën komplimenta atyre, ua heq drojtjen në zemra dhe, meqë nuk ua kishte pranuar dhuratat, u kërkon falje dhe ua shpjegon shkaqet e mospranimit.

62 Dervishi i sheh shehlerët në ëndërr, u kërkon një rizk hallall pa u përpjekur dhe pa u penguar nga adhurimi; shehlerët e orientojnë dervishin dhe, me ndërhyrjen e tyre shpirtërore, frutat e tharta e të hidhura të malit i vijnë të ëmbla dervishit.

63 Dervishi thotë "t'ia jap këtë pará druvarit sepse unë fitova rizk me mrekullinë e shehlerëve", kurse druvari që e kupton qëllimin e dervishit, preket.

65 Me qëllim që Belkizja ta shfaqë besimin sa më parë, Sulejmani (a.s.) i urdhëron përfaqësuesit të shkojnë shpejt dhe i inkurajon ata.

65 Shkaku që Ibrahim Et'hemi - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën - emigron nga vendi dhe e braktis salltanetin e Horasanit.

67 Njeriu i etur ngjitet në arrë dhe e shkund dhe arrat bien në ujin e gropës që ai s'e kishte gjetur dot; në këtë mënyrë, njeriu e dëgjon zhurmën e ujit, kënaqet e gëzohet.

69 Sulejmani (a.s.) i dërgon fjalë Belkizes duke e kërcënuar që të mos ngulë këmbë në politeizëm dhe të mos vonohet për të besuar dhe për ta shprehur besimin.

71 Sulejmani (a.s.) i çon fjalë kështu Belkizes: "Kërkesa ime që ti të besosh është vetëm për pëlqim të Allahut; unë s'kam asnjë ambicje as për veten tënde, as për bukurinë tënde dhe as në mbretërinë dhe pasurinë tënde! Kur të të hapen sytë me dritën e Zotit, edhe ti ke për ta parë!"

72 Pjesa e mbetur e historisë së Ibrahim Et'hemit - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën!

73 Pjesa e mbetur e historisë së sebeasve. Sulejmani (a.s.) i fut në rrugë të drejtë Belkizen dhe popullin e saj. Zgjidhja e vështirësive fetare e ndjesore të secilit sipas gjendjes. Gjuajtja e çdo lloj zogu e shpendi prej zogut dhe shpendit të llojit të vet me anë të këngës së vet dhe gjërave që ha vetë.

74 Belkizja shpëton nga salltaneti, dehet me dëshirën e fortë të besimit dhe, kur largohet nga vendi i vet, lë çdo gjë me përjashtim të fronit.

77 Sulejmani (a.s.) gjen një zgjidhje për ta sjellë fronin e Belkizes nga Sebea.

78 Kur Halimja e pret Mustafain (a.s.) prej qumështi, e humb dhe kërkon ndihmë nga idhujt; idhujt dridhen dhe bien në sexhde dhe pastaj dëshmojnë për madhërinë e Mustafait (s.a.s.).

78 Plaku arab që e çon Halimen te idhujt për t'u kërkuar ndihmë.

82 Gjyshi i Mustafait, Abdylmuttalibi, dëgjon se Halimeja e ka humbur Muhammedin (a.s.), se po përsillet rreth qytetit duke e kërkuar dhe se në Qabe ka qarë e është ngashëryer, se i është lutur Zotit t'ia gjejë Muhammedin (a.s.).

85 Abdylmuttalibi lutet drejt Qabes me këto fjalë: "Më trego se ku ndodhet Muhammedi (a.s.) që ta gjej!" Nga brenda Qabes vjen një zë që i tregon vendin.

85 Pjesa e mbetur e historisë së ftesës së Belkizes për në mëshirën e Zotit.

86 Njeriu është sunduesi i botës, ai e kërkon botën me ambicje dhe, ndërsa shpirtërorët nga lloji i njeriut bërtisnin "që fisi i tyre t'ua dinte hallin", nuk kishin dijeni nga shteti.

90 Sulejmani (a.s.) e ndërton Faltoren Aksa në bazë të urtësive që i dinte Zoti, dhe e ndihmojnë hapur engjëjt dhe xhindët, shejtanët dhe njerëzit.

92 Mirësia e padishahut për poetin; veziri i quajtur Ebulhasan e shton atë mirësi.

93 Poeti vjen përsëri disa vjet më vonë me shpresën për të marrë të njëjtat të mira dhe padishahu, sipas zakonit, urdhëron t'i jepen një mijë dinarë; ndërkaq, veziri i ri i quajtur edhe ai Ebulhasan, thotë: "Kemi shumë shpenzime, thesari është i zbrazët, kurse unë e bëj të kënaqur atë me një të dhjetën e kësaj dhurate"!

98 Opinioni i keq i këtij veziri të ulët që donte ta prishte burrërinë e padishahut, i përngjet opinionit dhe masave të vezirit Haman që prishi aftësitë e Faraonit.

99 Divi ulet në postin e Sulejmanit (a.s.) dhe bën veprime e punë të ngjashme me veprimet dhe punët e Sulejmanit (a.s.); dallimi që duket dhe qëndron mes tyre; divi i vë vetes emrin Sulejmani i biri i Daudit.

101 Pas përfundimit të Faltores Aksa, Sulejmani (a.s.) shkon çdo ditë në faltore me qëllim për të bërë adhurim dhe për t'i orientuar ata që bënin adhurim dhe hynin në itikaf; në faltore mbijnë barëra dhe rrënjë.

102 Ndërsa në botë nuk kishte varr dhe nuk njihej hapja e varreve, Kabili e mësoi nga sorra ç'është varri dhe sesi hapet varri.

105 Në trëndafilishte, sofiu vë kokën mes gjunjëve dhe kridhet në vetëgjykim, kurse miqtë i thonë ta ngrerë kokën dhe ta sodisë lulishten, të sodisë lulet dhe zogjtë që janë vepër e mëshirës së Zotit.

106 Në një buxhak të Faltores Aksa mbin çiçibanoz dhe Sulejmani (a.s.) bisedon me atë bimë; Sulejmani shqetësohet kur bima ia thotë dinjitetin dhe emrin.

110 Eshtë e keqe për veten e tyre kur personat me natyrë të keqe bëhen zotërues dijeje, pasurie dhe pozite, sepse kjo është njëlloj sikur t'i japësh shpatë në dorë grabitësit dhe piratit.

112 Komenti i ajetit: "O ti i mbuluar..."

144 Thënia "Edhe mosdhënia e përgjigjes është përgjigje" e shtjellon thënien "Përgjigjja që i duhet dhënë kokëtrashit është heshtja!" Që të dyja tregohen me këtë histori.

114 Mustafai (a.s.) ka thënë: "Zoti i madh krijoi engjëjt dhe u dha arsye; krijoi kafshët dhe u dha epsh; krijoi njerëzit dhe u dha edhe arsye, edhe epsh. Kush prej tyre e ka arsyen mbi epshin, ai është më i lartë se engjëjt dhe kush prej tyre e ka epshin mbi arsyen, ai është më poshtë se kafshët!" Komenti i këtij hadithi.

117 Komenti i ajeteve: "Atyre që kanë sëmundje në zemra, Kur'ani ua shton fëlliqësinë e zemrave." Dhe: "Me shembujt në Kur'an, Zoti një shumicë e tërbon, kurse një shumicë tjetër e çon në rrugë të drejtë!"

117 Lufta mes arsyes dhe nefsit (egos, vetvetes), i përngjet luftës mes Mexhnunit dhe devesë së vet... Sevdaja e Mexhnunit është për Lejlanë, kurse sevdaja e devesë, për të voglin e saj. Kështu, Mexhnuni thoshte: "Dashuria e devesë sime është për atë që ka pas, kurse dashuria ime është për atë që kam para... Të dy jemi të dashuruar, por dashuritë tona janë të kundërta!"

119 Skllavi i shkruan padishahut duke iu ankuar për shpërblimin e pakët që merrte.

120 Hajduti ia vjedh çallmën një dijetari me çallmë të madhe. Dijetari i thërret hajdutit: "Hape çallmën, shihe ç'ke marrë, kuptoje dhe pastaj merre e shko!"

121 Bota u jep këshilla me gjuhën e gjendjes njerëzve të përkushtuar ndaj kësaj bote, njerëzve që shpresojnë besnikëri prej saj dhe njerëzve që e lakmojnë atë, duke u treguar për pabesinë e saj.

124 Arifi, dijetari shpirtëror, e ka ushqimin nga drita e Zotit. Ai ka thënë: "Unë shkoj mik te Zoti im dhe ai më ushqen e më jep ujë." Eshtë edhe hadithi që thotë: "Uria është gjella e Zotit. Me të i ringjall Zoti trupat e të drejtëve." Domethënë se në uri, njeriut i vjen gjella e Zotit.

126 Komenti i ajetit: "Musai ndjeu përbrenda një frikë... I thamë: Mos ki frikë, ti je më i lartë se ajo!"

128 Këmbëngulje që personi që ngre një çështje, të heqë dorë nga çështja dhe urdhërimi që të ndjekë pejgamberët.

129 Skllavi i shkruan padishahut për të kërkuar nafaka.

131 Lavdëruesi që bën lavdërime për ta mbrojtur nderin e vet, por që ndjehet se në ato lavdërime ka hall dhe dhimbje dhe që kuptohet se, për shkak të vjetërsisë së hirkës, ato falenderime janë fjalë të kota dhe gënjeshtra.

134 Mjekët e Zotit e kuptojnë sëmundjen e fesë dhe të zemrës nga fytyra e myridit dhe e të huajit, nga toni i zërit, nga ngjyra e syve. Jo vetëm kaq, ata kuptojnë edhe nga rruga e zemrës, sepse ata janë spiunë të zemrës... Kur të uleni me ta, të uleni me zemër të drejtë!

135 Zoti ua shenjtëroftë shpirtrat, Ebujezidi lajmëron vite më parë lindjen e Hasan Harkaniut, i thotë një e nga një shenjat mbi pamjen dhe karakterin e tij dhe historianët i shkruajnë ato për t'i shqyrtuar.

136 I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: "Unë e marr kundërmimin e Mëshiruesit nga drejtimi i Jemenit!"

138 Pakësimi i ushqimit të Zotit që i shkonte shpirtit dhe zemrës së sofiut.

140 Skllavi zemërohet keqas ngaqë nuk i vjen përgjigje nga padishahu letrës së vet.

140 Era fryn në të kundërt për shkak të një të mete të Sulejmanit (a.s.).

142 Shejh Ebulhasani (r.a.) dëgjon se Ebujezidi ka folur për të dhe për gjendjen e tij.

143 Pasi nuk i vjen përgjigje për letrën e parë, skllavi i shkruan padishahut një letër tjetër.

145 Një njeri takohet me një njeri tjetër dhe i kërkon këshillë, kurse ai i thotë se është armiku i tij, prandaj të kërkojë këshillë nga dikush tjetër.

146 Në një luftë, megjithëse në ushtri ndodheshin njerëz të moshuar dhe me përvojë lufte, i Dërguari i Allahut (a.s.) cakton si komandant një djalë të ri nga fisi Huzejl.

148 Dikush e kundërshton Pejgamberin pse bëri komandant të riun prej fisit Huzejl.

152 Mustafai (a.s.) i jep përgjigje kundërshtuesit.

153 Ebujezidi - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën - thotë për vete: "E deklaroj veten të pastër! Sa e lartë është fama dhe shfaqja ime!" Dervishët e kundërshtojnë. Bajaziti u jep përgjigje atyre jo me fjalë, por duke treguar të vërtetën.

156 Shkaku që ai llafazani, në prani të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), thotë fjalë oratorike dhe flet shumë.

157 Shkaku që i Dërguari i Allahut e vlerëson të riun e fisit Huzejl më lart se të moshuarit dhe personat me përvojë luftarake dhe e bën kryekomandant.

158 Shenjat e të mençurit të plotë me gjysmë të mençurin, e burrit të vërtetë me gjysmë burrin, si dhe të personit krenar që ishte i keq dhe s'kishte asnjë vlerë.

159 Liqeni; ata që gjuajnë peshq në liqen; tre peshqit, nga të cilët, njëri i mençur, tjetri gjysmë i mençur, kurse i treti krenar, kokëtrashë, i shkujdesur dhe i pavlerë; fundi i tyre.

160 Sekreti i këndimit të lutjes që këndon ai që merr abdest gjatë larjes së gjymtyrëve.

161 Dikush, gjatë pastrimit, pasi kryen nevojën, në vend që të këndojë lutjen përkatëse të këtij rasti, "O Zot, më bëj mua nga ata që pendohen dhe pastrohen", këndon lutjen "O Zot, bëmë të nuhas aromën e xhennetit", e cila bëhet kur i jepet ujë hundës duke marrë abdest. Një njeri i shquar që e dëgjon, nuk e duron dot.

162 Këshillat e zogut të zënë në lak: "Mos u pendo për kohën e ikur por dija vlerën kohës që jeton, përpiqu të përfitosh prej saj dhe mos e kalo kohën duke u penduar."

164 Peshku gjysmë i mençur mendon një zgjidhje për të shpëtuar dhe e tregon veten të ngordhur.

165 Nuk mund t'i besohet betimit të kokëtrashit i cili pendohet pasi ka pësuar një të keqe. "Sikur të ktheheshin prapë në botë, ata do të fillonin përsëri t'i bënin ato gjëra për të cilat qenë ndaluar t'i bënin. Ata janë gënjeshtarë!" Zbardhja e parë e agimit është e pabesë.

166 Fantazia është e kundërta e arsyes, e cila lufton me të. I ngjet asaj, por nuk është ajo. Pyetje-përgjigjet mes Musait (a.s.) të arsyeshëm dhe Faraonit fantazist.

168 Ndërtimi është te shembja; bashkimi është te shpërndarja; rregullimi është te thyerja; qëllimi është te paqëllimi; qenia është te mosqenia. Çdo gjë i ngjet kësaj. Edhe të kundërtët dhe të ngjashmit e tjerë janë po si këta.

169 Musai i jep përgjigje Faraonit që qoftë i mallkuar!

171 Çdo ndjim i njeriut ndjen (përcepton) gjëra të tjera dhe është i painformuar për përceptimet e ndjimeve të tjera. Po kështu, edhe çdo usta zanatçi është i paformuar në zanatin e një ustai tjetër, nuk e njeh atë zanat. Ndërkaq, fakti që një ndjim nuk di gjë për detyrën e ndjimeve të tjera, nuk është argument për mosqenien e ndjimeve të tjera. Kështu, persa i përket përbërjes dhe gjendjes, çdo ndjim e mohon detyrën e ndjimeve të tjera dhe çdo zanatçi e mohon artin e zanatçinjve të tjerë. Themi e mohon, por me këtë nuk duam të themi se nuk e di ekzistencën e atij ndjimi ose atij arti.

175 Sulmimi i banorëve të kësaj bote kundër banorëve të asaj bote, sulmi gjer te brezat që janë kufiri i botës së fshehtë, rënia në shkujdesje e padije për shkak të qenies së tyre në pusi... Fundja, edhe gaziu, po të mos shkojë në luftë, qafirët hyjnë në vendin musliman dhe grabisin.

177 Trupi i njeriut të krijuar prej dheu, i ngjet hekurit prej minerali të mirë, ka kapacitet për t'u bërë pasqyrë; te ai, edhe në këtë botë duken xhenneti, xhehennemi, etj., dhe duken hapur e drejt, jo me rrugën e imagjinatës!

178 Musai (a.s.) ia tregon Faraonit të fshehtat si dhe, duke i dhënë lajm nga bota e fshehtë, ia tregon se ç'ëndrra ka parë, me qëllim që Faraoni të besojë se Zoti di gjithçka ose, të paktën, të dyshojë për këtë.

179 Porta e pendesës është e hapur.

179 Musai (a.s.) i thotë Faraonit: "Prano një këshillë prej meje dhe, si shpërblim, fito katër virtyte!"

180 Si shpërblim për besimin, Musai (a.s.) ia tregon Faraonit katër virtytet.

181 Komenti i hadithit të shenjtë: "Unë isha një thesar i fshehtë dhe desha të njihesha!"

183 Duke u mashtruar nga zgjuarsia e tij e bashkëlindur dhe mendimet, njeriu nuk e kërkon diturinë e fshehtë që është dituria e pejgamberëve.

184 Hadithi: "Popullit folini jo sa ju mban mendja juaj, por sa mban mendja e tij, në mënyrë që të mos i thonë gënjeni Zotit dhe pejgamberit të tij!

184 "Kush më lajmëron se ka dalë Saferi, do t'i jap lajmin e mirë të xhennetit!"

185 Faraoni këshillohet me Asijen në lidhje me besimin ndaj Musait (a.s.).

187 Skifteri i padishahut dhe gruaja plakë.

189 Gruaja që i kishte shkarë fëmija mbi ulluk dhe i kishte rënë në rrezik, shkon te Aliu (k.s.) për t'i kërkuar zgjidhje.

192 Faraoni këshillohet me vezirin e vet Haman në lidhje me besimin ndaj Musait (a.s.)

193 Poshtërsia e fjalëve të Hamanit - Zoti e mallkoftë!

195 Musai (a.s.) e pret shpresën se Faraoni i ndodhur nën ndikimin e fjalëve të Hamanit, do të besojë!

196 Feudalët arabë i drejtohen Mustafait (a.s.) me propozimin për ta ndarë mes tyre vendin dhe shtetin në mënyrë që të mos mbetet grindje dhe rrëmujë. Mustafa (a.s.) u përgjigjet: "Unë jam i ngarkuar me detyrë për ta drejtuar shtetin". Të dy palët hynë në bast.

198 Kush e njeh fuqinë e Zotit, nuk pyet se ku janë xhenneti me xhehennemin!

199 Përgjigje Dehriut, materialistit, që e mohon ekzistencën e Zotit dhe thotë se bota nuk ka fillim.

202 Komenti i ajetit "Qiejt dhe tokën dhe ato që ndodhen mes tyre i krijova me të drejtë", pra, jo vetëm që t'i shihni ju, por i krijova për kuptimin që nuk e shihni ju dhe për një urtësi të përjetshme!

205 Zoti i dërgon Musait (a.s.) mesazhin: "O Musa, unë, Zoti krijues, të dua ty!"

206 Padishahu zemërohet me nedimin, shokun e bisedës; dikush ndërhyn dhe i lutet padishahut ta falë; padishahu e pranon ndërhyrjen, kurse nedimi zemërohet me personin që ndërhyn dhe e qorton për ndërhyrjen.

208 Xhebraili (a.s.) e pyet Halilin nëse kishte ndonjë nevojë. Halili i përgjigjet: "Kam, por jo prej teje!"

210 Musai e pyet Zotin: "Pse i krijove njerëzit dhe pastaj i shkatërron ata?" Përgjigjja e Zotit.

212 Fryma shtazore dhe arsyeja e pjesshme i përngjasin dhallit të imagjinatës dhe fantazisë, kurse fryma e përjetshme i përngjet gjalpit që ndodhet i fshehur në këtë dhallë.

213 Një shembull tjetër mbi këtë.

216 Historia e shehzadesë, birit të padishahut, që i tregohet padishahllëku i vërtetë dhe ajeti "Atë ditë njeriu ikën nga vëllai, nëna dhe babai". Padishahllëku ose sundimi mbi këtë grumbull dheu është i personave me natyrë fëminore; kësaj ata i thonë "ta marrësh kalanë"; njëri nga fëmijët del më i fortë se të tjerët, ngjitet mbi grumbullin e dheut dhe thotë: "Kalaja është imja!" Fëmijët e tjerë e kanë zili sepse toka është pranvera e fëmijëve. Pasi shehzadeja shpëtoi nga vartësia e ngjyrave, tha: "Unë këtyre dherave me ngjyra u them "tokë e poshtër". Nuk i them flori, atllas dhe mëndafsh i zi. Unë shpëtova nga ky mëndafsh i zi dhe u hoqa mënjanë. Sipas ajetit "Ne i dhamë atij urtësi qysh kur ishte fëmijë", orientimi hynor mund të bëhet në çdo kohë pa pasur nevojë për kalimin e viteve. Përballë fuqisë së Zotit i cili e zbaton në çast dëshirën e tij, askush nuk mund të pretendojë diçka!

218 Duke pasur frikë se mos i ndërpritet soji, padishahu i merr të birit një vajzë.

219 Pjesëtaret e haremit e kundërshtojnë zgjedhjen nga padishahu të vajzës së një zahidi të varfër për të birin dhe turpërohen nga kjo krushqi.

221 Padishahut i pranohet lutja për shpëtimin e të birit nga magjistarja e djallëzuar.

223 Shehzadeja është njeriu, përfaqësuesi i Zotit mbi tokë, kurse i ati, zëvendësi i Zotit, Ademi, të cilit i bënë sexhde engjëjt. Plaka e djallëzuar është kjo botë; ajo e ndau me magji të birin nga i ati. Pejgamberët dhe velinjtë, të urtët, janë ai mjeku që i gjeti shpëtim kësaj.

226 Historia e zahidit të varfër dhe me familje të madhe i cili, në një vit zije, ndërsa populli vdiste nga uria, tregohej i gëzuar dhe i hareshëm. Njerëzit i thanë: "Nuk është koha për gëzim, por për të vajtur në qindra ngushëllime!" Kurse ai iu përgjigj: "Ç'më duhet mua?"

227 E gjithë bota është trajtë e arsyes së përgjithshme. Po të veprosh në kundërshtim me arsyen e përgjithshme, po të krijosh shqetësime, bota ta shton ty shqetësimin; po kështu, po të prishesh shumë herë me tët atë, kur ta shohësh atë, dëshpërohesh, nuk do t'ia shohësh fytyrën, kurse më parë ai ishte drita e syve të tu, qetësia jote!

228 Fëmijët e Uzejrit (a.s.) e pyesin atë për gjendjen e të atit dhe ai u thotë "e pashë". Disa e njohën dhe i humbën ndjenjat, kurse disa të tjerë që s'e njohën, thanë: "Ky na dha neve myzhde, ç'është kjo humbje ndjenjash?"

230 Komenti i hadithit: "Unë çdo ditë i shfaq shtatëdhjetë herë pendesë Zotit".

231 Arsyeja e pjesshme sheh gjërat gjer në varr... Në gjërat e tjera imiton pejgamberët dhe velinjtë, të urtët.

233 Ajeti "O ju që keni besuar, mos flisni dhe mos vendosni para se të flasin dhe vendosin Allahu dhe i Dërguari!" Meqë s'je pejgamber, bëhu nga ummeti, bashkësia e tij; meqë s'je mbret, bëhu nënshtetas!

235 Mushka e pyet devenë: "Unë rrëzohem shpesh në rrugë, kurse ti, rrallë; pse ndodh kjo?" Përgjigjja e devesë.

237 Mushka e miraton përgjigjen e devesë dhe e pohon epërsinë e saj, kërkon ndihmë prej saj dhe mbështetet me zemër të pastër te ajo; deveja i shfaq konsideratë mushkës, e udhëzon dhe e ndihmon prindërisht dhe mbretërisht.

238 Kiptiu i lutet një burri nga fiset izraelite: "Për hatër të vëllazërisë dhe miqësisë, mbush nga Nili një shtambë ujë me qëllim për vete, ma vër në buzë dhe të pi, sepse kur ju izraelitët i mbushni enët për veten tuaj, uji kthjellohet, kurse kur i mbushim ne, kiptinjtë, turbullohet!"

242 Kiptiu kërkon nga izraeliti të lutet për të për të mirë dhe izraeliti bën lutje për kiptiun për të mirë; lutja e tij pranohet nga Zoti, më bujari i bujarëve dhe më mëshiruesi i mëshiruesve.

245 Gruaja e keqe i thotë të shoqit: "Ato fantazma të duken ty nga maja e drurit të dardhës, sepse, nga maja e dardhës, të tilla gjëra i bien njeriut në sy! Zbrit poshtë dhe ato fantazma ikin!" Po të na thoshte dikush se ajo që ka parë burri, s'ka qenë fantazmë, do t'i jepnim këtë përgjigje: "Ky është shembull, jo çështje. Kaq shembull është i mjaftueshëm. Po të mos ngjitej në drurin e dardhës, nuk do të shihte as fantazmë, as gjë tjetër!"

247 Pema e shtrembër drejtohet dhe e tregon Zotin... "Rrënjët i ka në tokë, kurse degët e gjethet, në qiell!" Pjesa e mbetur e historisë së Musait.

251 Gjendjet dhe mjediset që ndërroi njeriu qysh nga fillimi.

253 Njerëzit e xhehennemit janë të uritur. Ata i luten Zotit: "O Zot, na i shto furnizimet tona dhe na i dërgo menjëherë se nuk na mbeti më durim!"

256 Dhulkarnejni shkon në Malin e Përrallave dhe i thotë: "O Mali i Përrallave, na fol për madhështinë e Zotit!" Mali i Përrallave i përgjigjet: "Madhështia e tij s'tregohet me fjalë... Përballë asaj madhështie, kuptimet asgjësohen!" Dhulkarnejni i lutet: "Të paktën na fol për atë që mban mend dhe për artet e Zotit të cilat mund të thuhen lehtë!"

257 Një milingonë që po ecte mbi letër, pa kalemin që po shkruante e vizatonte dhe filloi ta lavdëronte. Një milingonë tjetër me sy më të mprehtë i tha se ajo e shihte se mjeshtëria ishte te gishtat, prandaj t'i lavdëronte gishtat. Kurse një milingonë tjetër që shihte më mirë se të dyja, u tha: "Unë lavdëroj krahun sepse gishtat janë pjesë të krahut!" Etj.

259 Xhebraili (a.s.) ia tregoi veten Mustafait (s.a.s.) në trajtën e vërtetë. Atëherë, kur u duk njëra prej shtatëqind flatrave, ajo e zuri tërë horizontin dhe dielli u mbulua me të gjitha rrezet.

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut Mëshirues e Shpërblyes!

Ky është emgrimi i katërt në konakun më të bukur e me dobinë më të madhe! Ashtu siç gëzohen kopshtet kur bubullon qielli, ashtu siç e pranojnë sytë gjumin e ëmbël, ashtu gëzohen e mbushen me hare zemrat e arifëve, e njerëzve të pajisur me kulturën shpirtërore, kur shohin këtë. Prehja e shpirtrave dhe shërimi i zemrave në këtë emigrim të katërt janë. Ky emigrim është pikërisht ashtu siç e duan dhe e kërkojnë njerëzit e sinqertë dhe principialë në besim, siç e dëshirojnë dhe e lypin udhëtarët. Është dritë për sytë dhe hare për shpirtrat. Është më i bukuri e më i miri frut për vjelësit. Më e këndshmja e më e larta e dëshirave dhe kërkesave. E tërheq dhe e çon të sëmurin te mjeku. E merr dhe e arrin dashnorin te e dashura. Lavdi Zotit, ky emigrim i katërt është më e madhja e mirësive, më e përsosura e gjërave që dëshirohen. E rinovon kohën e afërsisë, e lehtëson vështirësinë e atyre që heqin keq. Kush ka mbetur larg nga Zoti, këtë sheh; po ta lexojë, ia shton shpjegimin. E shton edhe gëzimin dhe falenderimin e personit që ka arritur bekueshmërinë. A nuk stolisen gratë në shtëpi? Ja, edhe në zemrën e personit që e lexon këtë, shfaqet një gëzim dhe hare më e madhe se gëzimi i shkaktuar nga stolitë dhe margaritarët që varin në gjoks ato zonja shtëpie! Ky është shpërblim për njerëzit e dijes dhe adhurimit. Ky emigrimi i katërt i ngjet hënës së re të porsalindur. Është si fati i ikur e i rikthyer përsëri. Ua shton një pas një shpresat e atyre që shpresojnë, duke shkuar para atyre që adhurojnë, ua përgatit

vendet në konak dhe gjërat e nevojshme. U jep vrull sërishmi shpresave të shuara. E përhap dhe e shtron sërish lutjen e ngutshme por të shuar të udhëtarit. Ky vëllim i katërt i ngjet diellit që lind mes reve të shpërndara; është dritë për shokët tanë... thesar për ata që kanë ardhur nga mesi ynë! O Zot, për të falenderuar, kërkojmë sukses, sepse falenderimi është kusht për dhuntinë që ndodhet në dorë dhe më e shumta e dhuntisë me anë të falenderimit arrihet. Bëhet vetëm ajo që dëshiron Zoti!

Njëra nga gjërat që më dëshpëron mua është edhe kjo: Unë po flija.

Moti ishte i bukur e i freskët dhe unë isha zhytur e harruar në atë freski.

Në lis kishte qëndruar një pëllumb ngjyrë hiri, kurse unë vazhdoja të qëndroja i kredhur në dalldi gjersa më bëri zë pëllumbi.

Këndonte bukur e bukur dhe qante.

Eh, sikur, para se të filloja atë vajtim, unë të kisha nisur të vajtoja nga ashku...

Po të vihesha të klithja e të vajtoja nga dashuria për zotërinjtë, nuk do të pendohesha, do të gjeja ngushëllim...

Por ç'e do? Ai nisi të qajë e të vajtojë para meje dhe më bëri edhe mua të qaj.

Po, vajtimi i tij më bëri edhe mua të vajtoj dhe thashë: Virtyti është i atij që prin në këtë punë!

Zoti i mëshiroftë edhe ata që kanë shkuar, edhe ata që do të vijnë! Edhe ata që qëndrojnë në fjalë, edhe ata që ua përngjasin veten këtyre! Me mirësinë, bujarinë dhe favorin e tij të madh, Zoti i mëshiroftë të gjithë! S'ka dyshim se ai është më i dobishmi i të kërkuarve, më i larti i të shpresuarve! "Zoti është mbrojtësi më i dobishëm dhe më mëshiruesi i mëshiruesve!" Është më i dobishmi i të afërmve, i trashëgimtarëve dhe i atyre që bëjnë një të mirë si shpërblim për dicka! Ai është furnizuesi dhe ushqyesi i atyre që lërojnë arën dhe hedhin farën pa e lënë faljen! Zoti e mëshiroftë të dërguarin e Tij, Muhammedin, dhe brezin e tij të lartë! Zoti u faltë mëshirën e Tij të gjithë profetëve dhe njerëzve të sheriatit! Amin, ashtu qoftë!

MESNEWI
IV

O dritë e të vërtetës Husameddin, ti je një burrë i tillë që, me dritën tënde, Mesnevia ia kaloi edhe hënës, u bë më e ndritshme se hëna!

O ti nga i cili shpresohet favor dhe bujari, ku po e tërheq këtë Mesnevi ndihma jote e lartë? Zoti e di!

Ia ke lidhur qafën kësaj Mesnevie dhe po e tërheq drejt vendit që di ti.

Mesnevia po ikën me vrap... kurse tërheqësi është i fshehtë, por i fshehtë nga indiferenti që s'ka sy për të parë.

Ti je bërë pretekst në fillim për shkrimin e Mesnevisë... po të shtohet e të zgjatet, prapë ti je që e shton, që e zgjat!

Meqë ti do kështu, edhe Zoti kështu do. Zoti realizon dëshirën e njerëzve të devotshëm!

Fillimisht ti ia dhe qenien Zotit dhe, si përgjigje, Zoti ta dha qenien e vet ty.

Mesnevia të falenderon ty mijëra herë. Ngre duart dhe bën lutje...

Zoti pa se me gjuhën dhe dorën e Mesnevisë ti je falenderuar dhe bëri të mira, favore, e shumoi bujarinë.

Sepse Zoti ka premtuar se do të shumojë dhuntinë e falenderuesit. Kështu, shpërblimi i sexhdes është afrimi me Zotin.

Zoti ynë tha: "Bëj sexhde dhe afrohu!" Sexhdeja e trupave është shkak për afrimin e shpirtrave tanë te Zoti.

Nëse Mesnevia shtohet e zgjatet, për këtë shkak shtohet, për këtë shkak zgjatet. Jo për t'u dukur shumë si sasi dhe e madhe!

Ashtu siç çubukut të rrushit i pëlqen pranvera, ashtu siç është njësuar ai me pranverën, ashtu jemi mësuar edhe ne me ty, ashtu na pëlqen ti... Po deshe, urdhëro, hiqe dhe ta çojmë tutje!

O durim, urdhri i sekretit është çelësi i ekzistencës, pra, tërhiqe dhe çoje këtë karvan mirë e bukur gjer në haxh!

Haxhi është vizita e shtëpisë së Zotit, kurse vizita e të zotit të shtëpisë është burrëri.

Husameddin. ti je një diell, prandaj të thashë dritë... Këto dy fjalë, Husam (shpatë e mprehtë) dhe Zija (dritë), janë veti të tua!

Këto, husam dhe zija janë një; nuk ka dyshim se shpata e diellit është prej drite.

Drita e hënës quhet nur, bukuri, kurse drita e diellit quhet zija, dritë. Lexoje Kur'anin dhe shih!

I dashur babë, Kur'ani i tha diellit zija, kurse hënës, nur! Pa vështroje dhe shihe!

Dielli është më i lartë se hëna. Në këto kushte, dije se edhe drita (zija) është në gradë më lart se bukuria (nur)!

Askush nuk e pa me dritën e hënës rrugën ku duhej shkuar dhe, kur lindi dielli, rruga doli në shesh dhe u pa!

Dielli i tregoi mirë gjërat që do të shiteshin e bliheshin, prandaj pazaret u ngritën ditën!

Me qëllim që akçeja kallpe të dallohet qartë nga akçeja e vërtetë, që askush të mos mashtrojë e mashtrohet,

Drita e diellit ra mbi tokë mirë e mirë dhe u bë mëshirë ndaj botëve për ata që bënin tregti!

Mirëpo kjo është një gjë që s'u pëlqen aspak kallpazanëve dhe u vjen shumë rëndë, sepse drita e diellit ua prish punën, akçet kallpe duken, dallohen dhe nuk shkojnë!

Akçeja kallpe është armik i jetës së sarrafit. A bëhet për të varfërin armik tjetërkush veç qenit!

Pejgamberët luftojnë me armiqtë, kurse engjëjt luten: "O Zot, ti mbroje!"

Këtë kandil shumë të ndritshëm të Zotit mbaje larg nga fryrja e vjedhësve, nga fryma e tyre!

Vjedhësi dhe kallpazani janë armiq të dritës dhe bukurisë. O Zot që i shkon në ndihmë thirrjes, na arri në ndihmë!

Husameddin, shpërndaji dritë këtij defterit të katërt! Sepse edhe dielli lind nga qielli i katërt dhe e mbyt botën në dritë!

Edhe ti, me këtë defterin e katërt shpërndaju dritë botëve si dielli dhe të shkëlqejë nëpër shtete e qytete, çdo anë ta mbysë në dritë!

Ky libër është përrallë për atë që i thotë përrallë. Por ai që e sheh vetveten në këtë libër, që e kupton vetveten me këtë libër, është burrë!

Mesnevija është uji i lumit Nil.. Kiptive u duket gjak, por për fisin e Musait s'është gjak, por ujë!

Armiku i kësaj fjale tani po i duket kështu syrit tim: i rënë në xhehennem me kokë poshtë!

O Dritë e të Vërtetës, ti e pe hallin e tij... Zoti të tregoi ty përgjigjen që ua dha punëve të tij!

Syri yt që e sheh botën e fshehtë, është mjeshtër porsi bota e fshehtë. Ky shikim, kjo mirësi mos mbettë mangut nga kjo botë!

Të ka hije po ta ta mbarosh këtu këtë histori që është vetë gjendja jonë.

Ata që s'janë burra, lëri për hatër të atyre që janë burra; dhe mbaroje historinë, jepi fund kësaj historie!

Po qe se historia në fjalë nuk është plotësuar në vëllimin e tretë, ja ku është vëllimi i katërt! Atë vëre në rregull këtu dhe përfundoje!

Ashiku ikën prej rojes dhe hyn në një kopësht të panjohur për të,
e gjen të dashurën atje dhe, nga gëzimi, bën lutje për rojen
dhe këndon ajetin: "Ndodhin gjëra të tilla
që juve s'ju pëlqejnë aspak,
mirëpo janë të dobishme e të bekuara për ju!"

Tregonim se ai djaloshi u frikësua nga doja dhe e ngau kalin për në një kopësht.

Ndërkaq, bukuroshja me të cilën djaloshi pati rënë në dashuri, dhe pati vuajtur e qe djegur me këtë dhimbje për tetë vjet me radhë, na u ndodhkësh mu në atë kopësht!

Ashiku, djaloshi i dashuruar me pasion pas vajzës, nuk gjente dot mundësinë për t'ia parë as hijen! Por dëgjonte për vetitë e saj siç dëgjonte për zogur Feniks!

Sidoqë të jetë, ai e kishte parë aksidentalisht një herë atë, që vranë nga ai vështrim dhe pastaj ia pati dhënë zemrën e pati mbaruar!

Pastaj, sado që qe përpjekur, ajo e dashur me sjellje të ashpra nuk i pati dalë, kurrsesi s'ia pati treguar veten!

As lutja s'kishte bërë punë, as dhënia e mallit dhe pasurisë. Ajo e dashur si fidan e kishte syrin të ngopur, nuk kishte lakmi për ndonjë gjë!

Në çdo mjeshtëri dhe art, Zoti bën që në çdo gjë të kërkuar e të dëshiruar më parë të prekin buzët e ashikut, ta shijojnë ato buzë

Pastaj, pasi ashikët, me atë shije dhe kënaqësi, vihen të kërkojnë dëshirat e tyre, çdo ditë u nxjerr para një kurth, ua lidh këmbët!

Dhe po hynë të hetojnë e të kërkojnë, e mbyll derën "që në fillim të sjellin paranë e kurorës"!

Edhe ashikët me atë shpresë vërtiten e vrapojnë, çdo çast bien në lutje, çdo çast kapen nga mungesa e shpresës.

Çdokush ka një shpresë se ka për të shtënë në dorë diçka. Më në fund, vjen një ditë që atij i hapin dhe një derë.

Ia hapin, por menjëherë e mbyllin prapë atë derë. Dhe personi që i falet asaj dere, që lidh shpresën tek ajo, bëhet me shpresë, bëhet zjarr me atë shpresë dhe i futet punës!

Edhe atij të riut, me të hyrë këndshëm në kopësht, papritmas këmba iu fundos në thesar!

Zoti e bër shkak rojen, Nga frika e rojes hyri natën në kopësht duke vrapuar, u strehua aty

Dhe pa se e dashura e cila e kishte rrëzuar unazën në lumin që kalonte nëpër kopësht, po e kërkonte unazën me një fener në dorë.

Atë çast, nga gëzimi, duke e falenderuar Zotin, filloi të lutej për mbarësi për rojen:

"U frikësova nga roja dhe ika, hyra në dëm, por, o Zot, lësho në kokën e tij ar dhe argjend sa njëzetfishi i dëmit!

Shpëtoje atë nga qëllimet e njerëzve të këqinj dhe gëzoje atë siç jam gëzuar unë!

Dhe bëje atë të lumtur edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Dhe shpëtoje atë nga të këqijat dhe qenëritë!

O Zot, ç'është e vërteta, është zakon i atij njeriu të keq që vazhdimisht kërkon të keqen për popullin (por prapë ti mbroje atë).

Njeriu i keq, sapo dëgjonte një lajm se padishahu i kishte gjetur muslimanët fajtorë, gëzohej e fryhej...

Por po të dëgjonte se padishahu u tregua i mëshirshëm dhe, me bujarinë e tij, ua hoqi muslimanëve dënimin,

Mërzitej, i ngushtohej shpirti dhe binte në zi. Te personi i keq ka sa e sa gjëra të tjera të këqija e të ulta!

Por ashiku vazhdonte të lutej për mirë për rojen, sepse për shkak të tij kishte fituar rehatinë!

Roja ishte helm për të gjithë, kurse për atë ishte kundërhelm. Roja ishte bërë shkak që ai të takohej me të dashurën.

E sheh, pra, se në këtë botë nuk ka gjë absolutisht të keqe. E keqja është si ta shohësh. Pastaj dije edhe këtë se,

Në këtë botë nuk ka asnjë helm ose sheqer që për dikë të jetë këmbë, kurse për tjetrin, këpucë!

Po, dikujt i bëhet këmbë, tjetrit kular në qafë. Për dikë është helm, për tjetrin, i ëmbël si sheqer!

Helmi i gjarpërit është jetë për gjarpërin, kurse për njeriun, vdekje!

Për qeniet e detit, deti është si kopësht e vreshtë, kurse për ata që jetojnë në tokë, është mal me gurë, vdekje!

O i zoti i punës, këtë raport kape te njëshi dhe çoje duke e numëruar gjer te mijëshi!

Sipas dikujt, Zejdi është shejtan, kurse sipas dikujt tjetër, sulltan!

I dyti thotë se Zejdi është një person shumë i drejtë, shumë i ndershëm e shumë i lartë. I pari thotë se Zejdi është një qafir që duhet vrarë!

Zejdi është po ai njeri, mirëpo i tillë është për të, fund e krye mundim dhe humbje!

Po qe se kërkon që ai të duket sheqer edhe sipas teje, shihe me sytë e atyre që e duan!

Atë bukuroshe mos e shih me syrin tënd... Të dëshiruarin shihe me sytë e atyre që e dëshirojnë!

Sytë e tu mbylli. Në vend të syve të tu, merr hua sytë e atyre që e duan atë.

Madje, merr një sy e një vështrim hua nga ai vetë dhe shihe në fytyrë me syrin e vet!

Shih dhe bëhu i sigurt pa u mërzitur, pa u neveritur. Ja, pra, Pejgamberi i madh tha kështu për këtë çështje: "Kush ia jep veten Zotit, Zoti ia jep veten atij!"

Zoti tha: "Atëherë unë bëhem syri i tij që i sheh, dora e tij që i prek, zemra e tij që i ndjen dhe, në këtë mënyrë, ai shpëton nga pafatësia!"

Sido që të bëhet, a nuk t'u bë kallauz ty, a nuk të çoi te e dashura? Ja, pra, është njeri i mirë, është mik!

Vaizi i cili sapo fillonte nga vazi, bënte lutje për mizorët, zemërgurët dhe të pabindurit në besim.

Ishte një vaiz, predikues... Sapo ngjitej në minber, në vendin e posaçëm në xhami nga predikonte, fillonte me lutje për grabitësit dhe piratët.

Ngrinte duart për lutje dhe thoshte: "O Zot, mëshiroji të këqinjtë, shtijakeqët, ngatërrestarët, të pabindurit!

Tregohu i mëshirshëm me të gjithë ata që tallen me mirëbërësit, me të gjitha zemrat mohuese, me ata që ndodhen nëpër kisha!"

Nuk lutej fare për njerëzit e pastër, nuk bënte lutje veçse për njerëzit e këqinj!

I thanë: "S'kemi parë kurrë ndonjë zakon të tillë! Të lutesh për mirë për fajtorët, mëkatarët dhe të mbrapshtët nuk është as njerëzore, as ndonjë virtyt!"

Kurse ai ua ktheu: "Unë kam parë të mira prej tyre! Prandaj e bëra zakon të lutem për ta!

Aq të këqija më bënë, më munduan në atë gradë, që, më në fund, më shpëtuan nga e keqja dhe më bënë të arrij te e mira!

Sa herë që orentohesha drejt kësaj bote, më mundoninmë bënin të vuaj, më hiqnin dru!

Prandaj ikja në drejtim të anës së mirë. Ata ujq më sillnin mua në rrugë të drejtë!

Ata u bënë shkak për të mirën time. O njeri me mend në kokë, unë e kam detyrim jete të lutem për ta!"

Robi i qahet Zotit për vuajtjet dhe dhimbjet dhe i bën qindra ankesa për mundimet që heq.

Dhe Zoti i thotë: "A e sheh, pra, më në fund, hallet dhe mundimet të sollën ty në atë gjendje që të më lutesh, të drejtuan ty!

Ankohu për ata që të pengojnë në rrugën tënde dhe të nxjerrin prej saj, që të largojnë dhe përzënë prej portës sonë!"

Në të vërtetë, çdo dushman është ilaçi yt, të jep dobi, ta fiton zemrën!

Sepse ti ikën prej tij, mbështetesh te ata ku do të gjesh vetminë për vete, kërkon ndihmë nga favori i Zotit!

Kurse miqtë e tu janë, në të vërtetë, armiqtë e tu; ata të largojnë nga vendi i Zotit, ta zënë kohën, të preokupojnë.

Është një kafshë që i thonë baldosë, vjedull. Me të grënë dajak, shëndoshet dhe majmet!

Sapo t'i biesh me shkop, përmirësohet. Shkopi i bën mirë, e shëndosh, e majm!

Ja, pra, edhe shpirti i besimtarit është me të vërtetë një baldosë; edhe ai, me mundime e vështirësi, fuqizohet, majmet!

Prandaj pejgamberët kanë pësuar mundime e vështirësi.... Mundimet që kanë hequr ata ka qenë mbi mundimin e hequr nga të gjithë njerëzit e botës!

Sepse edhe shpirtin e kishin më të madh e më epror se të gjithë shpirtrat; prandaj, ngatërresat dhe të këqijat që u ranë atyre mbi krye nuk i ranë asnjë grupi tjetër njerëzor!

Lëkura pëson ngatërresa me anë të ilaçeve, kurse lëkura e Taifit merr një gjendje dhe pamje të bukur.

Ndryshe, po qe se lëkura e Taifit nuk do të lyhej me ilaçe të hidhura e të forta, do të kundërmonte ndyrë dhe rëndë.

Edhe njeriun quaje lëkurë të pastaxhionuar; merr lagështirë, bëhet e shëmtuar dhe kundërmon rëndë!

Ti jepja me të tepërt atij ilaçet e hidhura e të forta që të pastrohet, të zbukurohet, të shëndoshet!

Po s'pate fuqi për këtë, po të dha Zoti, pa kërkesën dhe dëshirën tënde, një mundim, duro dhe pranoje me pëlqim!

Sepse belaja që të vjen nga miku, ju pastron. Dija e Zotit është eprore ndaj masave tuaja parandaluese e mbrojtëse!

Po qe se një njeri sheh dëfrim në bela, belaja ëmbëlsohet. Kur i sëmuri e sheh se po shërohet, ilaçi fillon t'i vijë i këndshëm!

Megjithëse i mundur, sheh se po fiton dhe thotë: "O njerëz të besueshëm në fjalë e punë, vrismëni mua!"

Edhe ky njeri i keq i bëri dobi tjetërkujt, por për vete u bë i papranuar.

Mëshira e ardhur prej besimit, u muar prej tij. Urrejtja që është atribut i shejtanit, i ra atij, u përplas me të!

U bë shtrati ku furia dhe urrejtja u shtrinë e morën formë. Dije se urrejtja është themeli i mbrapshtisë, mëkatit dhe mohimit!

Dikush e pyet Isain (a.s.): "Në këtë botë, cila është gjëja më e vështirë e të vështirave?

Një njeri i mençur e pyeti Isain: "Në botë, ç'gjë është më e thepisur, më e vështirë se çdo gjë tjetër?"

Isa i tha: "O shpirt, gjëja më e thepisur e më e vështirë është ndëshkimi i Zotit, sepse nga ai ndëshkim, xhehennemi, madje, dridhet si uji!"

Njeriu e pyeti sërish: "Mirë, po si mund të gjejmë shpëtim nga ndëshkimi i Zotit?" Isai i dha këtë përgjigje: "Kur të zemërohesh, të mos i nënshtrohesh zemërimit!"

Njeriu i keq është miniera e këtij zemërimi. Zemërimi i shëmtuar i tij e kalon edhe zemërimin e kafshëve të egra e shqyese!

Ai njeri pa takt, ç'mëshirë mund të shpresojë prej Zotit përveç çlirimit prej zemërimit?

Ç'është e vërteta, është e pamundur që të mos ketë në botë të tillë. Edhe këta janë të nevojshëm në këtë botë. Por ta thuash këtë fjalë, do të thotë t'i hedhësh plotësisht ata në mrapshti!

Në këtë botë s'ka shpëtim: edhe ujë gjendet, edhe shurrë; mirëpo shurra s'është ujë i pastër e i kulluar!

Ashiku kërkon t'i bëjë të keqe, kurse e dashura i bërtet.

Ai njeri kokëtrashë, me ta parë të dashurën vetëm për vetëm, aty për aty u nis ta përqafojë e ta puthë!

Bukuroshja i bërtiti me të madhe: "Mos bëj paturpësi, nuk ka nevojë për sjellje pa edukatë, mblidhi mendtë në kokë!"

Ashiku i tha: "Këtu është qetësi, nuk ka njeri... Uji mu në mes dhe unë, një njeri i etur!

Këtu s'lëviz kush veç erës. Kush është ai që do të na bëhej pengesë të hapeshim e t'ia lëshonim sipas qejfit?"

E dashura i tha: "Ah, ti i marrë! Ti paske qenë budalla! Siç duket, nuk ke dëgjuar gjë nga të mençurit!

Po pe se fryn era, dije se këtu është dikush që e vë në lëvizje atë, e bën të fryjë!

Siç dëshiron arti i Zotit, punë është ta prekësh erën, ta bësh atë të fryjë!

Edhe era e pjesshme dhe e parëndësishme që është nën urdhrin tonë, po s'e tunde elpazenë, nuk fryn.

O njeri kokëtrashë, po s'qemë unë dhe ti elpaze, as era më e pjesshme nuk fryn!

Edhe fryma që del nga buzët, varet nga urdhri i trupit dhe i shpirtit, me urdhrin e tyre vihet në lëvizje.

Herë me atë frymë e lavdëron ti këndi, i çon dikujt lajm, herë qorton dikë, vepron kundër tij, e shan!

Shihe këtë dhe mësoje edhe gjendjen e erërave të tjera. Të mençurit te pjesa shohin të tërën.

Zoti e bën erën herë erë behari, herë dimrit e zhvesh atë nga kjo bukuri.

Për fisin e Adit e kthen në ciklon, kurse për pejgamberin Hud, të njëjtën erë e bën të fryjë me aromë të mirë.

Një erë e shndërron në erë të rxehtë e helmuese, kurse ardhjen e flladit të mëngjesit e bën të bekuar.

Edhe ty të dha një lloj flladi frymëmarrjeje me qëllim që çdo erë ta krahasosh me të.

S'bëhet fjalë pa erë favori dhe persekutimi.... Për një pjesë njerëzish, fjala është mjaltë, kurse për një pjesë tjetër, helm.

Elpazeja tundet për t'u freskuar por mizat dhe *mushkonjat i godet, i plagos dhe i vret!*

Atëherë, pse elpazeja e vlerësimit dhe vendimit të Zotit të mos jetë plot me ndihma dhe shqetësime?

Meqë edhe era që shkakton frymëmarrja ose era e shkaktuar nga elpazeja, madje, fryjnë ose për ta vënë diçka në rregull, ose për ta prishur...

Atëherë, si mund të ndodhë që erërat e veriut e të jugut, të lindjes e perëndimit, të mos kenë të bëjnë me favorin dhe mirësinë?

Sa të shohësh një dorë grurë, mendo hambarin, shih hambarin dhe kupto se po ai grurë është edhe në hambar!

Edhe të gjitha erërat që shkëputen e vijnë nga yjësia qiellore e erës, si fryjnë po të mos jetë elpazeja e atij që i këput ato erëra?

Në kohën e lëmit e të shirjes, a s'kërkojnë bujqit erë nga Zoti?

Po të vonohet era, i sheh të gjithë se si fillojnë t'i luten Zotit.

Kështu është edhe koha e lindjes. Po të mos vijnë gazrat e lindjes dhe të prerat e lindjes, dëgjon zëra të shqetësuar dhe ndihmë nga Zoti!

Po të mos e dinë njerëzit se erën e dërgon Zoti, a ka më kuptim lutja?

Edhe ata që hipin në anijen me vela, luten që të ketë erë, i luten Zotit t'u lëshojë erë të mbarë!

Edhe nëse dhimbja e dhëmbit shkaktohet nga ajri, i lutesh Zotit me përgjërim dhe bindje të plotë ta qetësojë atë erë.

Edhe ushtarët luten me përgjërim:"Zoti ynë që na i plotëson qëllimet, na jep një erë të mbarë fitoreje!"

Me vonimin e lindjes së shtatzënës, të afërmit e saj kërkojnë nuska nga çdo njeri i shenjtë.

Të gjithë e dinë mjaft mirë se erën e dërgon Zoti i Gjithësisë!

Fundja, çdo person që di, e di me mendje se gjëja që lëviz e ka atë që e vë në lëvizje.

Edhe pse ti s'e sheh me sy atë, sheh rrjedhojat e veprimit të tij; ato shihi dhe kupto!

Edhe trupi lëviz dhe vepron me anë të shpirtit, por ti shpirtin s'e sheh dot. S'e sheh, por shih lëvizjen e trupit dhe kuptoje shpirtin!

Ashiku tha: "Edhe nëse jam i trashë përsa i përket respektimit të etikës, në besnikëri dhe kërkesë jam i mençur, i kuptueshëm!"

Dashnori tha: "Po qe se ky veprim që duket është respektim i etikës, për më tej ti e di më mirë!"

* Po qe se etika është kjo, ato shprehi dhe vese të groposura, ende të padukshme, patjetër do të jenë më keq se kjo... Këtë e kemi kuptuar dhe njohur mirë!

* Ç'të ketë kulluar nga kjo shtambë, nuk ka dyshim se edhe këtej e tutje e njëjta gjë dhe në të njëjtëm mënyrë do të vazhdojë të kullojë!

Sofiu që e zë në flagrancë gruan me një të huaj.

Një ditë, një sofi u kthye në shtëpi.... Shtëpia kishte një derë dhe gruaja ndodhej brenda me një këpucar.

Gruaja e tij u ishte nënshtruar hileve të nefsit, ishte marrë vesh me këpucarin dhe ishte takuar me të në dhomë.

Kur sofiu trokiti fort në derë në kohë të sillës, që të dy u hutuan. S'kishte as mundësi për ndonjë hile, as rrugë për të ikur!

Sofiu nuk e kishte patur zakon gjer atë ditë ta linte dyqanin në atë orë e të kthehej në shtëpi!

Ai kishte pas parë disa shenja te e shoqja, kishte rënë në dyshim, prandaj dhe atë ditë kishte ardhur në shtëpi pa kohë.

Kurse e shoqja ishte krejt e sigurt se ai kurrë s'kishte për ta lënë punën në atë kohë e të kthehej në shtëpi!

Por, gjithsesi, kjo ide e saj nuk doli e drejtë... Zoti i mbulon fajet, por edhe i ndëshkon!

Po të bësh keq, frikësohu, mos rri i sigurt, sepse e keqja që bëre është një farë dhe Zoti patjetër bën që ajo të mbijë.

E mbulon dhe e fsheh disa herë se mos pendohesh dhe ndjen turp.

Në kohën e kalifatit të tij, burri i madh i muslimanëve, kalifi Omer, ia dorëzoi një vjedhës xhelatit.

Vjedhësi i thirri: "O zotëri i këtij vendi, mos ma merr jetën, ky është faji im i parë!"

Omeri i tha: "Zoti na ruajttë, Zoti nuk e jep dënimin menjëherë, qysh me rastin e parë të fajit!

Për ta nxjerrë në pah mirësinë dhe favorin e tij, e mbulon shumë herë me radhë dhe vetëm pastaj, për ta treguar drejtësinë e tij, e ndëshkon!"

Në këtë mënyrë, dëshiron që këto dy atribute të tij të dalin në shesh, që favori i tij të jetë përgëzues, kurse persekutimi i tij të jetë frikësues!"

Gruaja e kishte bërë disa herë atë punë të keqe, por e kishte hedhur lehtë. Tashmë kjo punë i dukej e lehtë.

Mendja këmbëlehtë nuk e dinte se shtamba s'kishte për të ardhur nga lumi çdo herë shëndoshë e mirë, pa u thyer!

Por kësaj here, kazaja dhe kaderi e kishin zënë gruan aq ngushtë, sa ç'zë vdekja papritmas hipokritin!

As udhë kishte, as bashkudhëtar, as dhe mundësi shpëtimi... Edhe hipokritit engjëlli i shpirtrave vjen e ia zgjat dorën për t'ia marrë shpirtin pikërisht kur ai ndodhet në një të tillë gjendje!

Edhe gruaja, në atë dhomë mundimi e pësoi së bashku me mikun e vet duke u tretur e ngrirë në vend!

Sofiu thoshte me zemër: "Hë, more qafirë, hë... Ju urrej me gjithë shpirt, por po duroj.

Kësaj radhe po bëj sikur s'mora vesh gjë në mënyrë që të mos e dëgjojnë të tjerët zërin e kësaj çange!

Edhe burri në rrugën e së Vërtetës, kështu ushqen fshehtas urrejtje për ju... Si sëmundja e hidropsisë, e shfaq ngadalë dhe pak nga pak urrejtjen e tij.

Njeriu i zënë nga sëmundja e hidropsisë, vazhdon të ngrijë si akull çast pas çasti, por çdo çast e pandeh veten më mirë!

A nuk e gjuajnë çakallin duke e kërkuar me fjalët "more, po ku është ky çakalli?", "këtu çakall s'paska!". Çakalli gënjehet nga këto fjalë dhe, kështu, e kapin!

Ndërkaq, në shtëpinë e gruas nuk kishte ndonjë vend për t'u fshehur, ndonjë të ngritur, ndonjë të futur, të çarë, ndonjë kalim për t'u ngjitur lart!

S'kishte as ndonjë furrë ku mund ta fshihte dashnorin, as ndonjë thes që t'ia lëshonte para si perde!

E brendshmja e shtëpisë ishte krejt e rrafshtë si sheshi i grumbullimit pas ringjalljes në ditën e kiametit; as një gropë, as një majë, as ndonjë vend për të ikur!

Duke e përshkruar ditën e kiametit, Zoti ka thënë kështu për sheshin e grumbullimit: "Atje s'mund të shohësh as ndonjë gropë e as ndonjë të ngritur!"

Duke përdorur dredhinë, gruaja i veshi të dashurit çarçaf
dhe, siç ka thënë Zoti, "hilet tuaja janë shumë të mëdha",
përdori pretekste të ndryshme
për t'ia mbushur mendjen të shoqit.

Gruaja ia hodhi menjëherë çarçafin sipër të dashurit dhe, duke i dhënë atij trajtë femre, e hapi derën.

I demaskuar plotësisht brenda çarçafit, burri rrinte duke u dukur si deveja ngjitur në shkallë!

Gruaja i tha kështu të shoqit për dashnorin: "Eshtë gruaja e njërit prej të mëdhenjve të qytetit... Ka mall, ka pushtet, është shumë i pasur!

E mbylla portën që ndonjë i huaj të mos hynte si injorant!"

Sofiu i tha: "Shumë mirë! Thuaji ç'shërbim kërkon që t'ia bëj me gjithë dëshirë!"

Gruaja i tha: "Kërkon të bëjë krushqi me ne... Grua e mirë, po se ç'ka brenda, Zoti e di!..

Ka një djalë që s'e ka shokun në qytet... I bukur, i marrëvesh, i shkathët dhe jeton mirë!"

Sofiu i tha: "Mirë, po ne jemi të varfër, kurse familja e kësaj gruaje janë njerëz me mall e pasuri!

Si mund të barazohen me ne? Një kanat i portës prej dërrase, tjetri prej fildishi! Punë është kjo?

Në kurorë, çifti duhet të jenë të barabartë e të përshtatshëm për njëri-tjetrin, ndryshe, puna prishet, mbarësi s'ka, nuk përshkohen dot!"

Gruaja thotë se nuk është fjala për pajën, por për nderin dhe sofiu i thotë që këtë gjë ta mbajë të fshehtë.

Gruaja i tha sofiut: "Edhe unë ia thashë këtë pengesë, por ajo më tha se "unë nuk jam nga ato që kërkojnë pajë e më the e të thashë...

Ne jemi ngopur me me mall e flori, jemi mërzitur... Nuk jemi si të tjerët, ambiciozë, nuk kemi mendim për të mbledhur mall dhe para!

Gjëja që kërkojmë ne është vetëm që vajza të jetë e mbyllur, e pastër dhe e ndershme. Fundja, me këto arrihet shpëtimi në të dy botët!"

Sofiu përsëri e theksoi pengesën e varfërisë dhe foli për këtë duke e përsëritur me qëllim që të mbahej e fshehtë.

Gruaja i tha: "Edhe unë ia përsërita dhe ja shpjegova qartë se s'kemi pajë.

Por bindja e saj është më e shëndoshë se mali... Nuk ka ankesë për qindra mungesa!

Dhe thotë vazhdimisht se gjëja që do ajo është nderi, se gjëja që kërkon prej nesh është ndershmëria!"

Sofiu i tha: "Fundja pajën, mallin, na e pa; i pa të gjitha ç'kemi hapur e fshehur!

Ja shtëpia jonë e ngushtë, kemi një vend që mund të nxërë vetëm një njeri... Aq e ngushtë, sa as një gjilpërë s'mund të fshehësh!

Sa për pastërtinë, mbulesën, devocionin, nderin, ajo këto i di!

Mbulesën dhe nderin tonë ajo i di dhe i sheh më mirë se ne fund e krye, fillim e mbarim!

Fundja, është sheshit se vajza jonë nuk ka pajë, gjellëtor, shërbyes. Sa për atë që është e mirë dhe e ndershme, i di fort mirë!

Nuk është kusht që babai të thotë se e ka vajzën të ndershme... Se si është ajo, është sheshit si drita e diellit!"

Edhe gabimi yt, o mik, doli sheshit, u demaskove e u turpërove... Të paktën, fol pak! Prandaj e tregova këtë histori!

O ti që ngul këmbë në çështjen tënde, ja, e tillë është mënyra sesi i kupton ti gjërat, se si nxjerr përfundim!

Edhe ti je tradhtar si gruaja e sofiut, ke ngritur kurthin e hiles në të keqe!

Në këtë mënyrë, ti rri duke i treguar pastërtinë çdo personi të pistë që s'i nxihet fytyra! Nga vetja turpërohesh, por nga Zoti s'turpërohesh!

Qëllimi pse thuhet se Zoti dëgjon e sheh.

Zoti e sheh çdo gjë dhe e quajti veten "shikues" me qëllim që ky shikimi i tij të të frikësojë ty vazhdimisht!

Dhe që t'i mbyllësh buzët ndaj fjalëve të këqija, e përshkroi veten si "dëgjues".

Dhe e emërtoi veten si "njohës" me qëllim që të kesh frikë dhe të mos mendosh ndonjë intrigë.

Por këta nuk janë emra që i janë vënë Zotit siç mund t'i vihet, për shembull, një emër një zezaku!

Emri i Zotit formohet si fjalë e prejardhur nga cilësia, nga atributi i tij. Cilësitë dhe atributet e Zotit janë të përhershme, të pafillimshme.

Përndryshe, do të ishte tallje si t'i vihej shurdhit emri "veshmprehtë" ose qorrit, emri "syshqiponjë"!

Emri që vihet për njohje, s'ka të bëjë me cilësitë e njeriut që i vihet.

Ndërkaq, fëmijës së porsalindur mund t'ia vënë emrin haxhi ose gazi ngaqë në familje ose në fis është një haxhi ose gazi.

Por po qe se fëmijës i vihen për ta lavdëruar dhe këto cilësi nuk gjenden te ai, atëherë lavdërimi nuk është me vend.

Ose është tallje me personin, ose ai që e bën këtë lavdërim, është i marrë! Kurse Zoti s'ka të bëjë me thëniet e njerëzve të padrejtë e mizorë!

Unë e kam ditur që pa u takuar me ty: ti e ke fytyrën të bukur, por ke vese të këqija!

Unë pa të parë e kam ditur se je njeri kryeneç, këmbëngulës në të keqe, i mësuar për të bërë të keqe!

Edhe nëse më skuqet syri dhe shoh pak, e di se më ka kapur ajo sëmundje!

Ti më pe mua si një qengj të vetmuar pa çoban dhe pandehe se s'kam vëzhgues, se s'kam roje.

Ashikët shohin atje ku duhet parë, prandaj dëshpërohen, qajnë dhe rënkojnë.

Dhe atë drerin e pandehin pa çoban, atë robin, me çmim të lirë!

Më në fund, është një shigjetë shikimi që thotë "vëzhguesi, kujdestari, roja i tij jam unë... shihe pak", dhe ngulet në zemër!

A mos jam unë më poshtë se një qengj apo një kec që të mos kem pas vëzhguesin, kujdestarin dhe rojen time?

Kam një roje të tillë që i ka hije salltaneti! Ai e di se ç'fllad më lëshon mua!

I ngrohtë apo i ftohtë është ai fllad? Ai Zot që di, nuk është indiferent, as dhe i humbur. E di, o njeri i keq, e di!

Por nefsi, egoja që i përket epshit, është shurdh, është qorr ndaj Zotit. Edhe unë e pashë nga larg verbërinë tënde!

Prandaj ka tetë vjet që s'kam pyetur fare për ty... Sepse të pashë se je shumëfish i paditur!

Pse ta pyes "si je" burrin që punon te vatra e zjarrit e hammamit? Si do të jetë? Kokëposhtë, ja, ashtu!

Bota i përngjet vatrës së zjarrit, kurse takvaja, devocioni i përngjet hamamit!

Epshi dhe pasioni për këtë botë i përngjasin vatrës së zjarrit që i thonë kylhan, "shtëpia e hirit"! Kurse hamami i takvasë ose devocionit ndriçohen me të!

Ndërkaq, në vatrën e zjarrit, të devotshmit e kalojnë me dëfrim e kënaqësi. Sepse ata kanë hyrë në hamam, janë fërkuar dhe janë pastruar.

Kurse të pasurit u përngjajnë atyre që bartin bajga të thara për t'i ngrohur ata të hamamit.

Zoti u ka dhënë atyre ambicje me qëllim që hamami të ngrohet e avullohet.

Lëre vatrën e zjarrin dhe shko në hamam. Lënia apo braktisja e vatrës së zjarrit është vetë hyrja në hamam.

Kurse ai që mbetet në vatrën e zjarrit, që e duron epshin material të kësaj bote, që heq dorë nga bota, është në nivelin e shërbyesit.

Ai që ndodhet në hamam, kuptohet nga fytyra, nga pastërtia dhe bukuria e fytyrës.

Edhe ata që ndodhen në vatrën e zjarrit, dallohen nga tymi, pluhuri dhe bloza në fytyra dhe rroba!

Po s'ia pe fytyrën, kija kujdes kundërmimin. Kundërmimi është si shkopi për qorrin!

Po s'ia kuptove edhe kundërmimin, nga fjala e re kuptoja të fshehtën e vjetër!

Babai i arit, zjarrmëtari, thotë: Sot gjer në mbrëmje kam bartur plot njëzet kosha me bajga!

Po si ky, edhe ambicja jote i përngjet zjarrit në këtë botë. Çdo flakë e tij ka hapur qindra gojë!

Ç'është e vërteta, bajga i jep flakë zjarrit, e fuqizon, por sipas mendjes, ky flori është jashtëqitje, është bajgë që s'të jep kënaqësi!

Dielli që është zjarr, e bën bajgën e njomë të vlefshme për t'u hedhur në zjarr.

Ja, pikërisht si kjo, është prapë dielli që e shndërron atë gur në ar me qëllim që zjarrmëtari i ambicjes të qëllohet me qindra shkëndija, të marrë flakë!

Ai që thotë mblodha pasur, ç'kërkon të thotë? Kërkon të thotë "solla kaq e aq jashtëqitje, kaq e aq bajga!"

Kjo fjalë është një fjalë që e shton turpërimin, por zjarrmëtarët, ata që punojnë në vatrën e zjarrit të hamamit, krenohen mes tyre me këtë!

Dhe i thonë njëri-tjetrit: Ti solle gjer në mbrëmje gjashtë kosha bajga, kurse unë, pa u munduar aspak, solla plot njëzet kosha!

Po t'i japësh atij që ka lindur si zjarrmëtar dhe nuk di ç'do të thotë pastërti, të marrë erë parfumi, i bën keq, e sëmur!

Lëkurëpunuesi i cili, në tregun e shitësve të esencave parfumore, humb ndjenjat nga aromat e mira dhe bie në shtrat i sëmurë.

Dikush, me të shkuar në tregun e shitësve të esencave parfumore, i humbi ndjenjat dhe u shemb përdhé.

Aromat e mira të ardhura nga dyqanet e bimëve dhe vajrave aromatike e bënë t'i merreshin mendtë dhe të shembet përtokë.

Ai njeri i paditur, në mes të ditës e në mes të rrugës, u shemb si kufomë dhe mbeti ashtu.

Menjëherë iu mblodhën njerëz përreth. Çdokush, duke thënë "la havle...", kërkonte shpëtim për hallin e tij.

Dikush ia kontrollonte zemrën me dorë, tjetri e spërkaste në fytyrë me ujë trëndafili.

Ai nuk e dinte se të keqen e kishte pikërisht prej ujit të trëndafilit!

Dikush ia fërkonte pulsin e duarve dhe kokën, një tjetër sillte argjilë të lagur me kashtë që të nxehej.

Dikush e tymoste me një tymosëse, kurse një tjetër ia zhvishte një pjesë të rrobave dhe e lehtësonte

Dikush ia kontrollonte pulsin për të parë se si i rrihte, kurse tjetri e nuhaste në gojë.

Ai donte të kuptonte nëse i sëmuri kishte pirë verë apo drogë, apo kishte gëlltitur opium. Populli nuk e kishte kuptuar dot se pse ishte mpakur, dhe kishte mbetur i hutuar.

Menjëherë ia lajmëruan të afërmit duke u thënë se njeriu i tyre kishte mbetur i alivanosur në aksh vend.

Ndërkaq, askush s'e dinte pse i kishte rënë të fikët!

I sëmuri kishte një vëlla trupmadh, të fuqishëm, të mësuar dhe të kuptueshëm i cili erdhi menjëherë duke vrapuar.

Kishte marrë me vete pak të dhjerë qeni, e çau grumbullin e njerëzve dhe, duke bërtitur, arriti te koka e të vëllait.

Unë e di pse është sëmurur, tha ai. Po të identifikohet sëmundja, po t'i gjendet shkaku, mjekimi është i lehtë.

Po s'u dit shkaku, mjekimi vështirësohet. Cili ilaç do t'i bëjë mirë? Njëqind lloje mundësish ka.

Por po u dit shkaku, puna lehtësohet Njohja e shkaqeve e mënjanon paditurinë.

I ardhuri po thoshte me vete se të vëllait i kishte hyrë e dhjera e qenit gjer në damarë, gjer në palcë.

Për ta fituar bukën e gojës, çdo ditë kishte punuar gjer në mbrëmje në pisllëk, ishte zhytur në kanalet e zeza.

Edhe Galinusi i madh kështu kishte thënë: Jepi të sëmurit atë me të cilën është mësuar!

Heq keq nga gjërat e kundërta me të cilat është mësuar, prandaj edhe ilaçin e sëmundjes së tij kërkoje në gjërat e mësuara.

Insektet që janë mësuar në pisllëqe, mpaken nga uji i trëndafilit.

Ilaçi i këtij njeriu është prapë pisllëku i qenit. Sepse me atë është mësuar!

Këndoje ajetin "pisat janë të pisave" dhe kuptoje fillimin dhe fundin e kësaj fjale!

Këshilluesit thonë se njeriu i pistë duhet mjekuar me ujë trëndafili me qëllim që atij t'i hapet një portë, të shërohet!

Por o persona të besueshëm, gjërat e pastra nuk janë të denja për njerëzit e pistë!

Ata janë shtrembëruar me erën e bukur të mesazhit hyjnor, janë prapësuar dhe kanë filluar të bërtasin se u kanë bërë keq, se u kanë ndjellur prapësi!

Ata kanë thënë: "Kjo fjalë ne na jep mundim, nga kjo fjalë ne sëmuremi. Predikimi juaj s'është i mirë, s'na bën mirë ne!

Po qe se nuk heshtni, por nisni sërish nga këshillat, menjëherë do t'ju gjuajmë me gurë dhe do t'ju vrasim!

Ne jemi shëndoshur e majmur me lojëra, me gjëra të kota e të marra. Ne s'jemi mësuar aspak me këshilla!

Ushqimi ynë është gënjeshtra, fjala e pabazë, janë fjalët e përbëra prej marrëzirash. Fjalët që na thoni ju, na e prishin stomakun!

Me këto fjalë ju na e shtoni sëmundjen qindra herë. Në vend të ilaçit, mendjes na i jepni opium!"

Vëllai i të sëmurit e mjekon të vëllanë fshehurazi me erë të dhjerash e bajgash.

Për të mos e parë kush ilaçin që do ta përgatiste për të vëllanë, vëllai i shëndoshë e largoi popullin.

Sikur do t'i thoshte gjëra të fshehta, e afroi gojën te veshi i të sëmurit, kurse pisllëkun ia vuri në hundë.

Të dhjerën e qenit e kishte lyer në dorë. Ilaçin e trurit të pistë në këtë pisllëk e kishte parë.

Sapo e nuhati pëllëmbën e lyer, i mpakuri nisi të lëvizë e të dridhet. Njerëzit menduan se kjo ishte një magji me shumë rëndësi!

Sipas njerëzve, vëllai e kishte kënduar magjinë dhe ia kishte fryrë të sëmurit në vesh. Ai që dukej si i vdekur i vërtetë, ishte shëruar si me magji!

Kështu ndodh me njerëzit e këqinj. Lidhja seksuale e jashtëligjshme rregullohet me vështrime, me shenja sysh dhe vetullash.

Kush s'është mësuar me këshilla të mira, me siguri që është mësuar me erëra të këqija.

Meqë mushrikët, politeistët kanë lindur qysh në pafillim në pisllëk, Zoti i ka quajtur nexhis, të fëlliqur.

Ujku i lindur mes pisllëkut, përjetësisht nuk heq dorë nga vesi i vet, nuk sheh nga erërat e mira!

Atij s'i ka bërë mirë shpërndarësi i dritës dhe bukurisë. Ai përbëhet krejtësisht prej trupit, ai është, si lëvozhga, pa tul, pa zemër!

Po qe se ka pjesë nga shpërndarja e dritës së Zotit, po qe se e ka prekur kjo dritë, edhe sikur të bjerë në pisllëk, ashtu siç ka ndodhur në Egjipt, nga veza e groposur në atë pisllëk del në shesh një zog!

Por ky zog i dalë në shesh, nuk është nga lloji i pulës së pistë të ushqyer në shtëpi, por zog dijeje dhe kuptimi.

Edhe ti i ngjet atij që s'ka pjesë nga ajo dritë, sepse je duke e futur hundër në pisllëk!

Qysh kur jam ndarë, fytyra të është zverdhur, por ti je një gjethe e verdhë, një frut i pabërë.

Poçja u nxi, u bë sterrë nga zjarri, mori ngjyrë bloze, por mishi, ngaqë është i fortë, ashtu ka mbetur, nuk ka zjerë fare!

Të zjeva ty plot tetë vjet me zjarrin e ndarjes, por papjekuria jote, dyfytyrësia jote nuk janë pakësuar asnjë herrime!

Ti je një rrush aguridhe që ke mbetur ashtu, i ngrirë, nga sëmundja. Ndërsa rrushi u poq e u bë rrush i thatë, ti je akoma i papjekur!"

Ashiku vendos të dredhojë, kërkon falje për fajin dhe lufton ta fshehë qëllimin; i dashuri e kupton këtë dredhi.

Ashiku i tha: "Mos ma merr për keq, por të provova nëse je do të më ndjekësh mua, apo je i ndershëm.

Unë e dija se ti je i ndershëm edhe pa të provuar, po a i ngjet dëgjimi shikimit me sy?

Ti je një diell, emri dhe fama jote janë bërë të njohura, janë përhapur në botë! Ç'të keqe ka nëse e vura diellin në një provë të tillë?

Ti je unë; unë çdo ditë e provoj veten nëse jam në dobi a në dëm!

Dushmanët i vunë në provë edhe pejgamberët; i provuan dhe prej tyre u shfaqën mrekulli.

Syrin e provova ma dritë; o i dashur që qofsh larg syrit të keq!

Kjo botë i përngjet një gërmadhe, kurse ti je një thesar. Mos u prek ndaj meje nëse të kërkova në thesar!

Të provova paturpësisht... Në këtë mënyrë, edhe dushmanëve t'ua themi gjithmonë:

Kur gjuha ime të të kujtojë ty, edhe syri të jetë dëshmitar që po të sheh!

Nëse ke rrahur rrugën e respektit, o i dashur fytyrëhënë, ja, pra qefini në qafën time, shpata në dorë... Të erdha para!

I kësaj dore jam unë, jo i një dore tjetër... Të lutem, premi ti duar e këmbë dhe mos lejo të m'i presë dikush tjetër!

Thekson ndarjen... Bëj si të duash, vetëm se mos më ndaj prej teje, mos ma bëj këtë!"

Tani morëm rrugë për në vendin e fjalës... Por koha kaloi, s'ka mundësi për të thënë diçka!

E thamë fytyrën e jashtme të punës, fytyra e brendshme mbeti e mbuluar. Në qofshim gjallë, s'do të mbesë kështu, edhe atë do ta themi gjithsesi!

I dashuri e hedh poshtë justifikimin e ashikut dhe ia përplas dredhinë syve.

I dashuri hapi gojën dhe iu përgjigj kështu: "Sipas nesh, gjendja jote është e ndritshme si dita, por, sipas teje, është si nata!

Pse i sjell, i përhap e i derdh këto hile të zeza para personave që shohin në ditën e drejtësisë?

Hilet dhe sajimet e tua që ke në zemër, demaskohen të gjitha para nesh, të gjitha rrimë e i shohim si dita.

Po qe se na vjen keq për atë robin tonë dhe ia mbulojmë fajin, ti pse tregohesh dyfytyrësh dhe e kalon masën?

Mëso prej tët eti! Me të bërë faj, Ademi menjëherë shkoi te vendi ku hiqen këpucët.

E pa të gatshëm e vëzhgues Zotin që i di ato sekrete të fshehta dhe duke qëndruar mbi dy këmbët, u vu të lutet që t'i falej faji.

Kaloi dhe u ul në mes të hirit të vuajtjes, nuk u hodh nga dega në degë duke zënë pretekst.

Dhe tha: "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes tonë!" Sepse para e pas vetes pa engjëjt e ndëshkimit.

Pa engjëjt e ndëshkimit të fshehtë si shpirti; shkopi në dorën e secilit zgjatej gjer në qiell!

Eja në vete... Bëhu milingonë para Sulejmanit që ky shkop të mos të bëjë copë-copë!

Mos qëndro për asnjë çast tjetërkund veç vendqëndrimit të drejtësisë. Askush nuk kujdeset për njeriun si syri i vet!

Edhe pse qorri merr vazhdimisht këshilla, prapëseprapë çdo çast rrëshqet e fëlliqet!

O Adem, ti ke sy, nuk je qorr... Por kur të vijë kazaja, syri bëhet qorr!

Duhen jetë të tëra që njeriu që ka sy të bjerë në gropë rastësisht.

Mirëpo kjo kaza është bashkudhëtare e qorrit. Sepse rrëzimi është natyra e saj, vesi i saj!

Qorri bie në pisllëk dhe nuk e di nëse ajo erë e keqe i vjen nga vetja, apo i është ngjitur ndonjë pisllëk.

Sikur dikush ta spërkasë me erëra të mira, ai kujton se e ka nga vetja, jo nga favori i dashamirësit.

Shkurt, o person syçelë, këta dy sy janë për të qindra nëna, qindra baballarë!

Sidomos syri i zemrës! Ai është shtatëdhjetë herë më i fuqishëm e më i çmuar se sytë e ballit! Me dhuntinë e tij punojnë këta dy sy!

Turp të kenë piratët që janë ulur e i kanë bërë qindra nyje gjuhës sime!

Ai që i ka këmbët të lidhura, si mund të shkojë revan? Kjo është një lidhje e rëndë, mos më bëj fajtor!

O zemër, kjo fjalë po vjen copa-copa. Kjo fjalë është margaritar, kurse përpjekja e Zotit, gur mulliri!

Edhe sikur të jetë i vogël dhe i thyer, margaritari bëhet përçues për syrin e sëmurë.

O margaritar, mos të të vijë keq se u thyeve... Duke u thyer, do të shkëlqesh, do të bëhesh krejt dritë!

Kështu, ajo, copë-copë do të thuhet. Por Zoti është i pasur, në fund e sjell atë në gjendje të rregullt!

Gruri nuk humbi pse u thye, pse u zvogëlua! U bë miell, bukë dhe hyri në dyqan!

O ashik, edhe faji yt u qartësua... Tashmë lëre ujin dhe vajin dhe bëhu copë-copë!

Kjo është e posaçme për fëmijët e barkut të Ademit. Ata thonë: "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes sonë!"

Edhe ti paraqite nevojën tënde dhe mos tento të sjellësh argumente si Iblisi i pafytyrë i mallkuar!

Por në qoftë se pafytyrësia ia pati mbuluar fajin Iblisit, edhe ti bëj kryeneçësi, tregohu i pafytyrë, mbahu në këtë rrugë, përplasi këmbët përtokë!

Ebu Xhehli kërkoi nga Pejgamberi mrekulli si urrejtësi Oguz Turku.

Por Besniku i Zotit, Ebu Bekri, nuk kërkoi mrekulli; ai tha për Pejgamberin: "Fundja, ky njeri me këtë fytyrë nuk thotë gjë tjetër veçse të vërtetën!"

Ku ti, ku unë që, duke rënë në egoizmin e dikujt si ti, e vë në provë një të dashur!

Një çifut i thotë Aliut - Zoti ia lartësoftë fytyrën - kështu: "Po qe se i beson mbrojtjes së Zotit, hidhu poshtë nga kjo ndërtesë!"; përgjigjja që i jep çifutit emiri i muslimanëve.

Një kryeneç që s'dinte ta madhëronte Zotin, i tha një ditë Murtezait:

"Mirë, ja tek ndodhesh në çatinë e një ndërtese të lartë... O ti më mend në kokë, e di se Zoti ka për të të mbrojtur, apo jo?"

Murtezai i tha: "Po, ai është mbrojtës, kujdestar... Ai na e mbron qenien tonë, ai kujdeset për ne qysh nga fëmijëria e gjersa të bëhemi burra!"

Çifuti i tha: "Mirë, pra! Meqë qenka kështu, hidhe veten poshtë duke i besuar plotësisht mbrojtjes së Zotit!

Hidhu poshtë që edhe unë ta kuptoj mirë se ti beson, ta shoh me provë besimin tënd të mirë!"

Emiri i muslimanëve i tha atij: "Hesht, zhduku që këtu që për shkak të këtij guximi të mos të bjerë shpirtit ndonjë fatkeqësi!!"

A i ka hije robit ta vërë në provë Zotin?

O kokëtrashë, o budalla, ku e ka atë të drejtë robi që ta bëjë këtë paturpësi duke e vënë në provë Zotin?

Vënia në provë i ka hije Zotit. Ai i provon robtë e vet çdo çast e vazhdimisht!

Dhe me këtë provë na i tregon hapur bindjet tona që i fshehim përbrenda!

A mos vallë me gabimin, me fajin që bëri, Ademi e vuri në provë Zotin?

A mos vallë i tha: "Sovrani im, butësia jote gjer ku shkon? Atë desha të shoh!" Te kush ka një guxim të tillë?

Mendja jote është hutuar, ti je turbulluar shumë... Justifikimi yt është më i keq se mëkati yt!

Të vësh në provë atë që ka ngritur kubenë qiellorë, ë? Po ku e di ti këtë gjë?

O ti që nuk e di se ç'është mirë e ç'është keq, ti provoje veten, jo të tjerët!

Po e vure në provë veten, ke për të hequr dorë nga vënia në provë e të tjerëve!

Po e njohe copën e sheqerit, e di edhe se ajo është e denjë për vendin ku bëhet dhe shitet sheqeri.

Pa bërë provë, dije se Zoti nuk të dërgon sheqer ty pa kohë e pa vend!

A ndodh që njeriu i mençur ta hedhë margaritarin e çmuar në nevojtore, në pellgun e shurrës?

Gjykatësi i mirëkuptueshëm, madje, nuk e dërgon grurin në depon e kashtës!

Po qe se myridi ngrihet ta vërë në provë shehun që prin, që është udhërrëfyes, është gomar!

Po tentove ta vësh në provë atë në rrugën e fesë, o ti që s'ke haber nga e vërteta, ti vetë vihesh në provë!

Guximi yt, padija jote mbeten lakuriq dhe përhapen në të gjithë botën, ndryshe si do të kuptohet, si do të dalë në shesh me këtë provim?

O trimi im, po qe se ngrihet një thërrime dhe tenton ta peshojë malin, peshorja i bëhet copë-copë.

Edhe ata, sipas mendjes së tyre, ngrenë një peshore dhe kërkojnë ta peshojnë me të njeriun e Zotit!

Mirëpo atë s'e nxë as peshorja e mendjes... Edhe peshorja e mendjes thyhet e copëtohet!

Ta vësh në provë atë, është sikur ta urdhërosh atë sipas urdhrit të tij! Kurrë mos tento ta vësh nën urdhër një sovran të tillë!

A mund ta vënë në provë piktorët një piktor të tillë, a mund ta urdhërojnë një piktor të tillë?

Po qe se te piktori shfaqet një provë, po qe se piktori do të zotëronte një njohuri provuese, a nuk është po ai piktor që e vizaton atë?

Tashmë, në krahasim me figurat në dijen e atij piktori, ç'është figura e vizatuar nga ky piktor?

Po të erdhi një lëkundje provimi, dije se ai është një fat i keq për ty... Të ka rënë në kokë, të ka goditur në zverk!

Atëherë kthehu shpejt te Zoti dhe bjer në sexhde...

Dhe lage vendin e sexhdes me lot! Dhe thuaj: "O Zot, shpëtomë nga kjo lëkundje e ky dyshim!"

Po ta dëshirosh provën, do të thotë se pikërisht atëherë tempulli i fesë është plot me çiçibanoz!

Faltorja Aksa dhe bima çiçibanoz; Daudi (a.s.) vë si qëllim para Sulejmanit (a.s.) ta bëjë atë faltore.

Daudi vuri si qëllim në mënyrë të vendosur ta ngrinte faltoren Aksa me gurë.

Zoti i komunikoi: "Hiq dorë nga kjo punë... Ti nuk mund ta bësh këtë faltore!

O njeri i zgjedhur, Ne nuk e kemi vendosur që këtë faltore ta bësh ti!"

Daudi i tha: "O Zot që i di të fshehtat, cili është faji im? Përse më thua mos e bëj faltoren?"

Zoti i tha: "Je pa faj, nuk ke ndonjë faj, mirëpo ke hyrë në gjakra! Gjaqet e të pafajshmëve i ke marrë në qafë!

Njerëz të panumërt dhanë shpirt nga zëri yt, njerëz të panumërt u bënë gjah i zërit tënd!

Zëri yt ka hyrë shumë në gjak, melodité e tua të bukura zemërpërvëluese kanë vrarë shumë njerëz!"

Daudi i tha: "Kam qenë i munduri yt, i dehuri pas teje... Dorën e kisha të lidhur nga fuqia jote!"

A s'i vjen keq sovranit për të mundurin? I mundur, a nuk do të thotë asgjë?

Zoti urdhëroi: "Ky i mundur është një asgjë i tillë që, në krahasim me ekzistencën, nuk është asgjësuar në dukje, kuptojeni mirë këtë!

Ky lloj i asgjësuar ka kapërcyer vetveten dhe është bërë më i miri, më i madhi i atyre që ekzistojnë.

Në krahasim me atributet e Zotit, ai s'është, por, në të vërtetë, në mosqenie ka për të një qenie.

Të gjithë shpirtrat janë nën masën e tij, të gjitha kufomat janë nën urdhrin e tij.

Ai që ka rënë i mundur, i nënshtruar ndaj favorit tonë, nuk do të thotë se ka mbetur pa vullnet, pa mundësi zgjedhjeje dhe i dobët; në dashurinë tonë, ai është bërë zotërues i mundësisë për të zgjedhur!

Fundja, ky është edhe fundi i vullnetit dhe mundësisë së zgjedhjes, domethënë, është asgjësimi i vullnetit dhe zgjedhjes konceptuale të njeriut në këtë pozitë.

Fundja, po qe se ai, më në fund, nuk do të shkatërrohej nga ajo ekzistencë konceptuale, nuk do të merrte dot kënaqësi e shije nga asnjë vullnet dhe mundësi zgjedhjeje!

Qoftë sikur në këtë botë të jetë një kafshatë që do të hahet apo ndonjë pije që do të pihet, shija e saj vjen pas ndërprerjes prej shijimit. Njeriu nuk merr kënaqësi nga gjërat që ha e pi pa e humbur kënaqësinë prej tyre. Po s'u ndërpre nga kënaqësitë lëndore, nuk mund t'i gjejë kënaqësitë shpirtërore!

Ai që heq dorë nga kënaqësia, në të vërtetë, vjen në gjendje që të mos interesohet për të gjitha kënaqësitë, por, në të vërtetë, ai vetë kthehet në kënaqësi, nuk ndahet fare nga kënaqësia!

Komenti i hadithëve "Fjalë është vetëm kjo: Njerëzit janë vëllezër" dhe "Dijetarët janë si një njeri i vetëm"; veçanërisht uniteti i pejgamberëve Daud dhe Sulejman me pejgamberët e tjerë; mohimi i njërit do të quhet mosbesim ndaj të gjithë pejgamberëve. Shembja e njërës nga ato mijëra shtëpi, si shenjë uniteti, do të konsiderohej se nuk do të mbetej në këmbë asnjë mur, thënia e Zotit, "Ne nuk dallojmë asnjërin mes tyre"... Për njeriun e mençur, mjafton vetëm një shenjë, kurse kjo e kaloi shenjën!

Kjo punë nuk do të bëhet me shtrëngimin tënd, me fuqinë tënde, por atë faltore do ta bëjë biri yt!

O i urtë, e bëra e tij është edhe e bëra jote. Qysh prej një kohe të pafillim, besimtarët janë e njëjta e njëri-tjetrit, ata janë një!

Besimtarët janë të numërueshëm, janë shumë, por besimi është një. Trupat e tyre janë shumë, por shpirtrat e tyre janë një.

Te njeriu, përveç kuptimit dhe shpirtit të kaut dhe gomarit ka një mendje tjetër, një shpirt tjetër.

Edhe personi që arrin të bëhet i afërmi i Zotit, përveç mendjes dhe shpirtit që ka çdo njeri, ka një mendje dhe një shpirt të veçantë.

Në shpirtrat shtazorë nuk ka bashkim dhe njësim... Ti mos e kërko këtë njësim dhe bashkim në shpirtin e erës!

Nëse ky shpirt shtazor ha bukë, barku i shpirtit njerëzor s'ngopet; nëse ky mban barrë, ai nuk vuan!

Madje, me vdekjen e tij, ky shpirt shtazor gëzohet, kurse po pa që shpirti njerëzor ka fituar diçka, vdes nga smira!

Shpirtrat e ujqve dhe qenve janë veç e veç. Një janë shpirtrat e luanëve të Zotit i cili është një!

E thashë në numrin shumës sepse ai shpirt i vetëm, në raport me trupin, bëhet njëqind!

Edhe drita e vetme e diellit të vetëm në qiell, pasi hyn nëpër shtëpi, shumohet në qindra drita.

Por po t'i heqësh muret, drita e të gjithave bëhet një!

Po të mos jenë themelet e shtëpive, besimtarët kthehen një një njeri të vetëm dhe kjo e fshehtë del në shesh.

Nga kjo fjalë shfaqen ndryshime, lindin vështirësi, sepse kjo punë nuk i ngjet të vërtetës; ky është një shembull.

Mes luanit dhe një njeriu trim ka ndryshime të pafundme.

O njeri që ke mirëkuptim, kur sillet shembull, luhet me ngjasimet mes gjërave.

Në këtë botë nuk ka një trajtë që të ta sjell si shembull të njëjtën e saj.

Për ta shpëtuar mendjen nga hutimi, përsëri po hedh dorë mbi një shembull të sajuar.

Natën, në shtëpi vënë një kandil ose një qiri dhe me dritën e tij shpëtojnë nga errësira, apo jo!

Ai kandil i ngjason këtij trupi, kurse drita e tij, shpirtit. Kandili ka nevojë për fitil e gjëra të tjera.

Kandili me gjashtë fitila i këtyre ndjenjave, në përgjithësi mbështetet në gjumë, në të ngrënë e në të pirë... Këto janë themeli i atij kandili.

Pa ngrënë e pa pirë, pa rënë e pa fjetur nuk jeton dot as një kohë gjysmë frymëmarrjeje, madje. Por as me të ngrënë e me të fjetur nuk jeton dot!

Po të mos ketë fitil dhe vaj, s'ka vazhdim; por edhe me fitil dhe vaj nuk ka besë.

Sepse drita e tij që varet nga shkaqet, që s'formohet dot pa shkaqe, rri duke e kërkuar vdekjen. Si mund të jetojë kur dita e ndritshme është vdekja e tij!

As të gjitha ndjenjat e njeriut nuk kanë vazhdimësi, sepse ditën e ringjalljes ato do të jenë asgjësuar.

Por drita e ndjenjave dhe e shpirtit të etërve tanë, krejt si bari, mbijnë herë pas here, nuk janë tharë.

Vetëm nën dritën e diellit, ndriçimi i yjeve dhe drita e hënës shuhen, nuk shihen!

Ashtu siç ndodh që djegia, dhimbja dhe mundimi që shkaktohen nga kafshimi i pleshtit shuhen pas kafshimit të gjarprit!

Ashtu siç ndodh që njeriu i zhveshur hidhet në ujë për të shpëtuar nga kafshimi i grenzave!

Ndërkaq, grenzat vërtiten mbi kokë të tij dhe sapo ta nxjerrë kokën, nuk e falin, por menjëherë e kafshojnë!

Përmendja e Zotit është ujë, kurse përmendja e kësaj gruaje apo atij burri të ditës është grenzë!

Zhytu në ujin e përmendjes së Zotit, mbaje frymën, duro dhe shpëto nga mendimet e vjetra, dyshimet dhe lëkundjet!

Pastaj ti mbështillesh nga maja e kokës te thoi me natyrën e atij uji të pastër e të kulluar.

Dhe vjen në një gjendje të tillë që, ashtu si grenza druhet e ikën nga uji, edhe ti ashtu druhesh e ikën!

Pastaj, po deshe, largohu prej ujit sepse e ke përvetësuar natyrën e tij dhe, në të vërtetë, quhesh se nuk je ndarë prej tij!

Edhe personat që kanë ikur nga kjo botë nuk janë asgjësuar por janë veshur me atributet e Zotit

Atributet e tyre, përballë atributeve të Zotit, janë kthyer në yje përballë diellit.

O kryeneç, po deshe provë për këtë, këndo në Kur'an: "Të gjithë ata ndodhen në praninë tonë!"

Ata për të cilët thuhet "ndodhen në praninë tonë", nuk asgjësohen; përqëndrohu në këtë që ta kuptosh mirë vazhdimësinë e shpirtrave!

Shpirti i privuar nga vazhdimësia, ndodhet në mundim, kurse shpirti i bashkuar me Zotin ndodhet në botën e përhershmërisë i shpëtuar nga mbulesat dhe pengesat.

Ja, pra, t'i thashë ç'desha të të them për kandilin e ndjenjave shtazore, për të vërtetën e këtij kandili. Mblidhe mendjen dhe mos përfytyro ndonjë identifikim mes ndjenjës shtazore dhe shpirtit!

Shpejt, çoje shpirtin tënd te shpirtrat e bekuar të udhëtarëve!

Edhe sikur të kesh njëqind kandilë, n'daç të shuhen, n'daç të digjen, janë secili veç e veç, nuk mund të bëhen një!

Ja, për këtë arsye shokët tanë janë vazhdimisht në luftë, kurse askush s'ka dëgjuar që pejgamberët të luftojnë me njëri-tjetrin!

Sepse dritërat e pejgamberëve janë diell, kurse drita jonë ndjesore, është kandil dhe qiri!

Njëri shuhet, tjetri mbetet gjer kur të gdhijë... Njëri digjet e shkrihet, tjetri shkëlqen pa pushim.

Shpirti shtazor ringjallet me ushqim dhe çdo e mirë vdes me gjënë e keqe.

Por në qoftë se ky kandil u shua, pse shtëpia e komshiut të mbetet në errësirë?

Drita e asaj shtëpie vazhdon të qëndrojë edhe në mungesë të dritës së kësaj shtëpie... Pra, drita e ndjenjës së çdo shtëpie është veç e veç.

Ky është shembulli i shpirtit shtazor, jo i shpirtit hyjnor!

Kur lind drita e hënës natën, bie në çdo dritare, e ndriçon gjithkahjen!

Ti quaji një dritat e atyre qindra shtëpive të ndriçuara nga hëna, sepse sapo të perëndojë hëna, në asnjë shtëpi s'mbetet dritë!

Kur dielli ndodhet në kupë të qiellit, bëhet mik në çdo shtëpi.

Por kur dielli i shpirtit perëndon, drita e të gjitha shtëpive humbet, shuhet!

Kjo fjalë është shembull për dritën, jo identitet i dritës. Edhe ty ta tregon rrugën, edhe rrugën e armikut e rreh!

Ai njeri i keq thur rrjeta si të merimangës.

Me pështymën e vet shtrin perde, por syrin e vet të kuptimit e bën qorr.

Po e kapi kalin për zverku, ia arrin qëllimit, por po ia kapi këmbën, e ha shkelmin!

Mos iu afro kalit të prapë... Bëje mendjen dhe fenë kallauz për vete, bëj si të thonë ato!

Kurrsesi mos e nënvleftëso këtë vendosmëri dhe mos e pandeh pa rëndësi. Në këtë rrugë duhet durim, duhen përballuar vështirësitë që kanë për t'u hequr!

Ndërtimi i faltores Aksa.

Sulejmani nisi ndërtimin e saj ndërtese të pastër si Qabja, të shquar si Minaja.

Gjatë ndërtimit, u përball me vështirësi, sepse ajo s'ishte një ndërtesë e rastit, si të tjerat, dhe e pavlerë!

Çdo gur që pritej nga mali për ndërtim, thoshte qartë: "Në fillim më dërgoni mua!"

Ashtu si uji dhe dheu me të cilat u mbrujt Ademi, nga çdo qerpiç i asaj ndërtese shpërthente dritë e bukuri!

Guri vinte pa hamall. Ajo derë e ato mure ishin si të gjalla!

Zoti thotë gjithmonë se muret e xhennetit nuk janë si këto dyer, pa shpirt e të shëmtuara.

Porta e trupit është e zgjuar si muri i trupit. Edhe shtëpia e xhennetit është e gjallë, sepse ai vend i përket sovranit të sovranëve!

Edhe pema bisedon me njeriun e xhennetit, i thotë fjalë atij, edhe fruti, edhe ujërat që rrjedhin!

Sepse xhennetin nuk e kanë bërë me vegla... Ai është ngrehinë prej adhurimesh, prej qëllimesh!

Kjo strukturë është e bërë prej ujit të vdekur, prej dheut të vdekur, kurse ajo strukturë është ngritur me adhurime të gjalla.

Kjo i përngjet origjinës së vet, është plot rrëmujë. Edhe ajo i përngjet diturisë dhe adhurimit që i ka për origjinë.

Edhe froni i atjeshëm, edhe pallati, edhe kurora, edhe rroba i bën pyetje banorit të xhennetit, i jep përgjigje!

Pajisja e saj është bërë pa pajisës... Ajo shtëpi është fshirë dhe pastruar pa fshesë!

Shihe shtëpinë e zemrës! Sapo të pluhuroset me ankth, fshihet e pastrohet pa fshesar, me anë të pendesës!

Froni i atij vendbanimi ecën dhe shkon pa e bartur dhe çuar kush. Edhe rrethi trokitës i derës ua thotë këngëve me zë të bukur dhe u bie veglave muzikore, edhe dera!

Edhe në zemër është gjallëria e xhennetit që është shtëpi e përjetshmërisë. Por ç'e do që nuk më vjen në gjuhë, nuk e them dot!

Çdo mëngjes, kur Sulejmani hynte në faltore për ta këshilluar dhe orientuar popullin,

Jepte këshilla herë me fjalë, herë me këngë, herë me vegla muzikore, herë me veprime, domethënë, me ruku ose duke falur namaz.

Këshilla me veprime e tërheq më shumë popullin. Sepse këtë këshillë e dëgjojnë me veshët e zemrës edhe shurdhët!

Pastaj, kjo lloj këshille ngjet më pak me urdhrin, kështu, ndikon mjaft mirë mbi popullin!

Hutbeja e parë e Osmanit (r.a.) si kalif: "Ai që jep këshillë me punë është më i mirë se ai që jep këshillë me fjalë!"

Sapo u bë kalif, Osmani menjëherë vrapoi dhe u ngjit në minber, në vendin e predikimit.

Minberi i Pejgamberit të lartë kishte tri shkallare. Kur u ngjit Ebu Bekri në minber, u ul në shkallaren e dytë.

Edhe Omeri, në kohën e vet, në shenjë respekti për Islamin dhe fenë, kur u ngjit në minber, u ul në shkallaren më të ulët.

Kur erdhi koha e Omerit, ai u ngjit në shkallën më të sipërme, aty u ul ai rob me fat.

Një llafazan e pyeti: "Dy kalifët e parë nuk u ulën në vendin e Pejgamberit.

Si u bë që ti tenton të bëhesh më i lartë se ata? Kurse nga grada ti je më poshtë se ta!"

Osmani i tha: "Po të ulesha në shkallaren e fundit, do të më përngjasonin me Omerin.

Po të ulesha në shkallaren e dytë, mund të thonin se i përngjaj Ebu Bekrit, jam shembulli i tij.

Dhe kjo shkallare është pozita e Mustafait... Dhe dihet se nuk ka mundësi për t'i përngjarë atij sovrani!"

Pastaj, në vend që të mbante predikim, ai kalif i mëshirshëm ndenji i heshtur gjer afër kohës së iqindisë.

Ndërkaq, askush nuk kishte fuqi t'i thoshte që të fliste ose të ngrihej e të ikte nga faltorja.

Edhe mbi parësinë kishte rënë një impresionim i madh, dhe mbi njerëzit e thjeshtë! Faltorja ishte mbushur e tëra me dritë dhe bukuri!

Ata që i kishin të hapur sytë e zemrës, e shihnin atë dritë... Jo vetëm ata, edhe qorrave, madje, u ishte ngritur zemra peshë me atë dritë!

Syri i qorrit e ndjen lindjen e diellit nga ngrohtësia që lëshon ai!

Kjo ngrohtësi e kjo nxehtësi ia hap sytë gjithkujt që ndjen me qëllim që të shihet e vërteta.

Dhe në ngrohtësinë e tij ka një shqetësim... Dielli i vërtetë, me ngrohtësinë dhe nxehtësinë e tij, e hap zemrën dhe i jep asaj gjerësi dhe lehtësi!

Sapo që qorri të ngrohet me dritën e Zotit të pafillim, nga kënaqësia thotë se iu hapën sytë dhe po sheh!

Kjo është një dehje e bukur, e plotë dhe e këndshme. Vetëm se për hapjen e syve të zemrës është një rrugë që duhet kapërcyer.

Kjo është pjesa që përfiton qorri nga dielli... Por Zoti e di se ç'është më e drejtë! Ndoshta ai ka edhe qindra përfitime të tjera si ky!

A mos vallë është në gjendje Ebu Ali Sinai ta përshkruajë gjendjen e personit që e sheh atë dritë?

Edhe sikur të jetë njëqind herë e fuqishme, kush është kjo gjuhë që tenton ta lëvizë me dorën e saj perden e pamjes?

Mjerë për të nëse e prek me dorë perden... Shpata e Zotit ia pret dorën aty për aty!

Madje, çdo të thotë dorë? E pret, e këput edhe kokën që bën paturpësi nga mosdija!

Nuk e thashë këtë vetëm sa për ta thënë! Se, ku dora e tij, ku ai!

Si thonë? Po ta kishte tezja atë veglën, do të bëhej dajë! Edhe kjo fjalë, si ajo!

Edhe sikur të them se për syrin e pastruar prej fjalës ka rrugë qindramijëravjeçare gjer te e vërteta që thuhet, përcillet dhe shihet me sy, pak kam thënë!

Por eja në vete dhe mos e prit shpresën nga drita e qiellit! Po deshi Zoti, ajo dritë arrin tek ti në një çast!

Për shembull, yjet kanë qindra ndikime mbi metalet. Fuqia e Zotit ua çon atë çdo çast.

Dielli i cili është një yll në qiell, i fshin errësirat. Kurse drita e Zotit është e pranishme vazhdimisht në atributet e Zotit!

O ti që kërkon ndihmë, ndikimi i diellit arriti në tokë nga qielli që është një rrugë pesëqindvjeçare!

Gjer në Saturn ka një rrugë mëse treqind mijë e pesëqindvjeçare, por ndikimi i tij duket çdo çast!

Po të dojë Zoti, ashtu si hija që zhduket me të lindur dielli, e zhduk edhe ndikimin e tij... Ç'vlerë mund të ketë hija para diellit?

Shpirtrat e pastër si yjet, u japin frymëzim yjeve në qiell, i ndihmojnë ata!

Në pamje, yjet janë shkak për ekzistencën dhe shëndetin tonë, por, në të vërtetë, bota jonë e brendshme është shkak për stabilitetin dhe ekzistencën e qiellit!

Filozofët thonë se njeriu është një botë e vogël,
por të urtët e Zotit kanë thënë se njeriu është një botë e madhe,
sepse dija e filozofëve ka të bëjë me trajtën e njeriut,
kurse dija e të urtëve ka arritur në të vërtetën e njeriut.

Në pamje, ti je një botë e vogël, por në të vërtetë, bota më e madhe ti je!

Në pamje, dega është origjina e frutit, por, në të vërtetë, dega është bërë e qenë për frutin!

A do të mbillte pemë kopshtari po të mos kishte prirje për të marrë fruta, po të mos kishte shpresë se prej pemës do të merrte fruta?

Në këto kushte, në pamje, fruti ka lindur nga pema, por, në të vërtetë, pema ka gjetur ekzistencë nga fruti.

Prandaj Mustafai tha: "Ademi dhe të gjithë pejgamberët janë pas meje dhe nën flamurin tim!"

Prandaj ai zotërues i shprehive të larta ka thënë: "Unë jam ai që kam ardhur i fundit, por, në fakt, jam ai që shkon para dhe që e kupton pjellën e parë!"

Si trajtë, unë kam lindur nga Ademi, por, në të vërtetë, jam stërgjyshi i tij!

Engjëjt mua më bënë sexhde... Ademi eci pas meje dhe doli mbi shtatë kat qiell!

Në të vërtetë, im atë ka lindur nga unë, pema gjeti ekzistencë nga fruti!

Mendimi i parë u shfaq së fundi në botën e punës; sidomos mendimi cilësor!

Shkurt, brenda një çasti vijnë shumë karvane dhe në qiell shkojnë shumë karvane!

Kjo rrugë nuk i vjen e gjatë këtij karvani... A i vjen e gjerë fusha personit të lartë?

Zemra shkon çdo çast në Qabe. Edhe unë, me favorin e Zotit, vishem me natyrën e zemrës!

Kjo gjatësi e shkurtësi janë sipas trupit... Atje ku ndodhet Zoti, a bëhet fjalë për gjatësi e shkurtësi?

Sapo Zoti ta bëjë ekzistent trupin fizik, ky ecën pa parë për largësi!

O trim, lëri llafet e tepërta! Tani ka qindra shpresa, prandaj menjëherë shih të hedhësh hapin!

Sapo t'i mbyllësh sytë, e sheh veten të hipur në gjemi dhe fle. Megjithëkëtë, je duke marrë rrugë!

Komenti i hadithit
"Ummeti, bashkësia ime i përngjet gjemisë së Nuhut...
Kush hyri në atë gjemi, shpëtoi,
kush nuk hyri, u mbyt e shkoi!"

Prandaj, Pejgamberi ka thënë: "Unë jam si gjemi e kohës së përmbytjes;

Unë dhe shokët e mi i ngjajmë gjemisë së Nuhut. Kush hedh dorën në këtë gjemi, kush hip në këtë gjemi, shpëton!"

Kur të jesh bashkë me shehun, je larg nga të këqijat; je në gjemi dhe po ecën natë e ditë.

Je strehuar te shpirti që fal shpirtra... Ke hyrë në gjemi dhe po fle; megjithëkëtë, je duke marrë udhë!

Mos u ndaj nga Pejgamberi i kohës dhe mos i beso shumë aftësisë tënde, dëshirës tënde!

Edhe sikur të jesh luan! A po merr udhë pa kallauz? E sheh edhe vetë se je i humbur! Prandaj, fluturo me flatrat e shehut dhe merre ndihmën e ushtarëve të shehut!

Vjen një kohë që valët e favorit të tij të bëhen flatra ty; vjen një kohë që zjarri i persekutimit të merr me vete!

Mos e quaj shumë persekutimin e tij si të kundërtën e favorit të tij, por shihe unitetin e të dyve përsa i përket efektit!

Një herë, të bleron ty si tokën, një herë, të mbush e të fryn me atmosferën e të dashurit tënd!

Arifi i jep trupit të vet cilësinë e trupit të ngurtë e të pajetë dhe atje bën të mbijnë trëndafila e lule të tjera!

Por këto i sheh ai e jo të tjerët. Asgjë tjetër veç botës së brendshme të pastër nuk mund ta marrë aromën e xhennetit!

Pastroje zemrën nga mohimi i të dashurit dhe atje të mbijnë gonxhet e trëndafilishtes së tij!

Pastroje zemrën dhe, ashtu siç mori Muhammedi nga Jemeni aromën e Mëshirës, edhe ti gjeje aromën e përjetshmërisë së të dashurit tim!

Po të qëndrosh në radhët e atyre që bëjnë miraxh, mosqenia të ngre të në qiej si Burak.

Ky nuk është miraxh që i përket tokës dhe që mund të të ngrejë gjer në hënë, por i përngjet miraxhi që e kthen kallamin në sheqer!

Ky miraxh nuk është një miraxh si ngjitja e kësaj dite në qiell, por i përngjet arritjes së fëmijës në barkun e nënës në gradën e dijes dhe kulturës shpirtërore!

Ç'burak (ç'kalë shale) është kali i mosqenies... Nëse je asgjësuar, të çon ty në pozitën e qenies dhe ekzistencës! Malet dhe detet mund të të prekin vetëm thonjtë e këmbëve, aq i shpejtë është: botën e ndijimeve e lë menjëherë pas!

Fute këmbën në gjemi dhe, si shpirti që shkon te i dashuri i shpirtit, vazhdo të ecësh atje ku po rri!

Dhe shko pa duar e këmbë gjer te Zoti që s'ka fillim... Ashtu siç vrapojnë shpirtrat pa këmbë e duar nga mosqenia në botën e qenies!

Po qe se ai që dëgjon nuk do të ishte në gjumin e indiferentizmit, po qe se do të të ndodhej hapur veshi i zemrës, do ta grisje perden e krahasimit të rremë!

O qiell, hidh margaritarë mbi fjalët e tij... O botë, turpërohu nga bota e tij!

Po hodhe dhe shpërndave margaritarë, margaritarët e tu shumohen njëqindfish, trupi yt i ngurtë sheh dhe bëhet për t'u dashuruar.

Ato margaritarë që hodhe, do të thotë se i hodhe për vete, sepse çdo lloj kapitali të shtohet njëqindfish!

Belkizja i dërgon dhuratë Sulejmanit (a.s.) nga qyteti Sebe.

Dhurata e Belkizes ishte dyzet barrë mushke qerpiç flori!

Ata që i sollën dhuratat, kur hynë në sarajin e Sulejmanit, panë se vendi ishte shtruar krejtësisht me flori të pastër!

Dhe bënë plot dyzet konaqe rrugë mbi flori! Tashmë, në syte e tyre, floriri nuk dukej i rëndësishëm as sa uji!

Dhe thanë shumë herë mes vedi: "T'i çojmë prapë florinjtë ku i morëm! Ç'punë të pabërë që po bëjmë ne!

Eshtë kokëtrashësi të çosh flori si dhuratë atje ku edhe dheu është flori i pastër!"

O ti që i çon Zotit mend si dhuratë, ajo mendje është atje më e ulët se dheu në rrugë!

Ngaqë e kuptuan se dhurata e tyre nuk do të merrej në konsideratë, turpërimi i shtynte pas e më pas!

Pastaj thanë: "Në daç të pëlqehet, në daç, jo! Ç'na duhet neve? Ne jemi shërbëtorë që zbatojmë urdhrat!

Le të jetë flori apo dhé! Ne jemi të detyruar ta çojmë në vend, jemi të detyruar ta zbatojmë urdhrin e urdhëruesit!

Po të na thonë kthejeni prapë, bëjmë siç na urdhërojnë dhe e kthejmë dhuratën atje ku e morëm!"

Kur Sulejmani i pa sjellësit e dhuratës dhe dhuratën që kishin sjellë, filloi të qeshë. Dhe u tha: "A mos ju kërkova lëng unë juve?

Unë nuk ju thashë të më sillni dhurata, por të bëheni të denjë për dhurata!

Mua më vijnë nga bota e fshehtë dhurata të pashoqe, të tilla, që njeriu as që e çon nëpër mend t'i kërkojë!

Ju i faleni diellit, një ylli që e kthen mineralin nën tokë në flori! Kthejeni fytyrën nga krijuesi i atij ylli!"

I faleni diellit në qiell duke e poshtëruar shpirtin tuaj që ka vlerë të lartë!

Me urdhër të Zotit, dielli është gjellëtori ynë, pra, është kokëtrashësi t'i thuash atij zot!

Ç'do të bësh kur të zihet dielli? Si do t'ia heqësh nxirjen?

A nuk e kthen fytyrën përsëri nga Zoti dhe i lutesh t'ia heqë nxirjen e t'i japë përsëri dritë?

Ku është dielli që t'i lutesh nëse në mes të natës ngrihet dikush të të vrasë?

Dhe shumica e ngjarjeve ndodhin natën, kurse Zoti që i falesh natën nuk është sheshit!

Po qe se i drejtohesh Zotit me drejtësinë e zemrës, shpëton nga yjet dhe bëhesh i afërt i Zotit!

Sapo të bëhesh i afërt, unë e hap gojën dhe t'i them të fshehtat... Në këtë mënyrë, ti sheh një diell në mes të natës!

Lindje tjetër e tij nga shpirti i pastër... Edhe në moslindjen e tij nuk mund të ketë ndryshim mes natës dhe ditës!

Ditë i thonë kohës kur lind ai. Por kur lind dhe shkëlqen natën, nuk mbetet natë në mes!

Ky diell që duket, para atij dielli duket siç duket molekula para diellit!

Kur syri i këtij dielli që ndriçon botën, e sheh atë diell, hutohet e verbohet!

Dhe ti e sheh këtë diell sa një molekulë përballë bukurisë së Arshit, përballë dritës së pakufishme të Arshit!

Kur syrit i vjen një fuqi nga Zoti, ti e sheh diellin e dukshëm të varfër e të pavlerë!

Zoti është një kimist i tillë që, me një ndikim të tij, tymi është kthyer në diell!

Ka një eliksir të padukshëm, të tillë që errësirën e ka shndërruar në diell!

Eshtë një artist i çuditshëm që, me një art të tij, i ka dhënë Saturnit kaq shumë veçori!

Tashmë bashkoji yjet e tjerë të zemrës me margaritarët e shpirtit dhe krahasoji me të!

Syri i ballit është i shtënë pas diellit; kërko një sy hyjnor, gjej një sy hyjnor

Dhe përballë shikimit të tij, dritërat e diellit që shpërndajnë vetëtima, të nënshtrohen!

Ai vështrim i përket bukurisë, kurse ky vështrim, flakës... Përballë bukurisë, zjarri duket krejtësisht i zi!

Kerametet dhe nuri i Sheh Abdullah Magribit - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën!

Sheh Abdullah Magribi thotë: "Ka gjashtëdhjetë vjet që unë s'kam parë ç'është nata!

Brenda këtyre gjashtëdhjetë vjetëve, as ditë, as natë... Për asnjë shkak nuk rashë në errësirë!"

Edhe sofitë e kanë miratuar drejtësinë e fjalës së shehut dhe kanë thënë: "Ne shkonim pas tij gjatë netëve!"

Ne ecnim në shkretëtirat e mbushura me gjemba dhe gropa, kurse ai ecte para nesh si hënë e plotë!

Dhe, në kohën e natës, pa e kthyer kokën pas, na thoshte: "Kujdes, para keni një gropë, bëni majtas!"

Kurse një çast më pas, na bënte zë: "Shkoni djathtas, poshtë këmbëve kemi gjemba!"

Kur bëhej ditë, ne ia puthnim këmbët dhe shihnim se këmbët i kishte si këmbë nuseje!

S'kishte as shenja dheu, as shenja balte; as gjembat e kishin shpuar, as gurët e kishin plagosur!

Zoti ia kishte bërë perëndimin, lindje, e kishte shndërruar perëndimin për të në lindje që shpërndan dritë!

Drita e këtij dielli të prapë është një at i sheshit të ashkut, që është ai që e ruan edhe ditën e parësisë së popullit, edhe ditën e të tjerëve!

Si nuk i ruan ajo dritë që është shfaqësi i mijra diejve!

Ti vazhdo të ecësh i sigurt me dritën e tij dhe shih të marrësh udhë mes kuçedrave dhe akrepëve!

Ajo dritë e pastër vazhdon të ecë para teje; e kap dhe e copëton çdo grabitqar rruge!

Kuptoje drejt ajetin "Zoti nuk ka për ta turpëruar Pejgamberin e vet në ditën e kiametit!" Dhe lexoje ajetin "Bukuria dritësore e besimtarëve ecën para dhe në të djathtë të tyre dhe ua ndriçon rrugën!"

Ajo dritë shumohet në kiamet, por atë dritë të Zotit duhet ta kërkojmë edhe këtu!

Sepse Zoti e di më mirë se si t'i përgjigjet gjësë së kërkuar, por i fal dritë shpirti edhe resë, edhe errësirës!

Sulejmani (a.s.) ia kthen prapë Belkizes përfaqësuesit së bashku me dhuratat që i kishte dërguar ajo dhe e fton Belkizen të heqë dorë nga adhurimi i diellit dhe t'i besojë Zotit.

Pejgamberi Sulejman u tha të dërguarve: "O të dërguar që keni turp, kthehuni pas! Floriri t'ju mbetet juve, mua më sillni zemër, më sillni zemër!

Merrni edhe këta florinjtë e mi dhe shtojuani atyre tuajve... Kuptojeni verbërinë tuaj dhe ato florinj futjani mushkës në organin femëror!

Organi femëror i mushkës është i denjë t'i vihet dry i artë... Kurse floriri i ashikut është fytyra e tij krejt e verdhë!

Ajo fytyrë është vendi ku hedh vështrimin Zoti, kurse floririn metalik e vështron dielli.

Metali është vendvështrimi i dritës së diellit; fytyra e ashikut është vendvështrimi i Zotit, zotëruesit të të vërtetave!

Tani erdhët e më ratë më qafë edhe mua, jeni robi im, megjithatë, frikësohuni se mos ju zë, bëjeni mburojë shpirtin tuaj!

Zogu i shtënë pas thërrimes ndodhet mbi çati dhe, megjithëse i ka flatrat të lira, ai ka rënë, tashmë, në kurth!

Meqë ia ka dhënë mendjen dhe zemrën thërrimes, dije se është zënë në lak ende pa u zënë!

A nuk po rri duke parë nga thërrimja? Ato vështrime quaji nyjë të lidhur këmbëve!

O thërrime, ti tani po sheh si e si të më vjedhësh mua, por ki durim se, në të vërtetë, unë jam ai që po të vjedh ty!

Më në fund, kur ai vështrim do të tërheqë ty tek unë, do ta kuptosh se unë nuk jam i panjoftuar për ty!

Myshteriu i mësuar të hajë dhé ia vjedh fshehtas shitësit të artikujve të përzier argjilën e larjes së kokës që ai e përdorte si dërhem, ndërsa po peshonte sheqer.

Dikush që e kishte bërë zakon të hante dhé, shkoi te një shitës i artikujve të përzier për të marrë sheqer kokërr.

Në peshoren e atij shitësi hileqar dhe zemërkeq, në vend të dërhemëve dhe gurëve të tjerë të peshimit, kishte dhé.

Ai i tha myshteriut: "Guri i peshimit i peshores sime është dheu. Po të kesh qëllim për të marrë sheqer, prit që të gjej dërhemë!"

Myshteriu i tha: "Kam një punë me rëndësi, prandaj më duhet të marr sheqer menjëherë... Nuk ka dëm se ç'lloj guri peshimi ke!"

Dhe me vete thoshte: "Ç'është guri për personin që e ka bërë zakon të hajë dhé? Dheu është më i mirë se floriri!

Si puna e asaj gruas kallauze që i thoshte atij djalit se i kishte gjetur një nuse shumë të bukur.

Shumë të bukur dhe, përveç kësaj, ajo vajzë e ndershme është vajzë hallvaxhiu

Dhe kjo është më e mirë për burrin që ka për të marrë, se vajza e hallvaxhiut është më e yndyrshme, më e ëmbël!

Edhe ti, s'ke gurë peshimi dhe, në vend të tyre, përdor dhé; fort mirë! Dheu është fruti që ma do zemra!"

Në pjatën e gurëve, shitësi një copë dheu në vend të gurit të peshimit.

Kurse në pjatën tjetër vuri sheqer kokërr.

Për ta ndarë copën e madhe të sheqerit në copëra më të vogla, u vu të gjejë veglën e duhur duke e lënë aty të vetëm myshteriun.

Por shitësi njërin sy e mbante te myshteriu i cili, meqë e kishte bërë zakon të hante dhé, nuk duroi dot dhe, me lëvizje gjysmë të fshehta, nisi të këpuste copa nga plisi dhe t'i hante.

Por edhe frikësohej se mos shitësi kthehet papritmas dhe e vë ré.

Shitësi e pa. E pa, por e tregonte veten sikur ishte shumë i zënë, kurse me vete thoshte: "O surratverdhë, hë, vidh edhe pak!

Ti po më vjedh dheun, prandaj mua s'më bën gjë. Ti sikur po këput copëra nga mishi yt e po i ha!

Je duke ndenjur me frikë prej meje, por kjo, për shkak të gomarllëkut tënd, kurse unë po frikësohem se ke për të ngrënë pak!

Jam i zënë, por nuk jam as kokëtrashë sa të të jap tepër sheqer nga kallami im!

Por prit të shohësh se kush është kokëtrashë dhe i pakuptuar kur ta shohësh sheqerin që ke për të marrë!"

Zogu vazhdon ta vështrojë thërrimen, por edhe thërrimja vazhdon t'ia presë nga larg rrugën zogut!

A nuk ta ka ënda përdhunimin me sy? Mirëpo, në fund të fundit, a nuk do të thotë kjo se je duke e ngrënë veten?

Ky vështrim nga larg është si shigjetë dhe helm... Dashuria të shtohet gjithnjë e më shumë, kurse durimi të pakësohet!

Malli dhe pasuria e kësaj bote janë si kurthi apo laku për zogjtë e dobët. Kurse pasuria e ahiretit, jetës së pasme, është kurthi apo laku i zogjve të lartë e të fortë!

Madje, pasuria e jetës së pasme është një kurth aq i thellë, sa kap zogjtë më të lartë!

Unë jam Sulejman, nuk e dua pasurinë tuaj. Lëre kërkimin e pasurisë suaj, unë ju mbroj juve nga gjërat që ju shkatërrojnë!

Tani ju jeni robtë e mallit dhe pasurisë materiale. Personi që ka mall e pasuri është ai që ka shpëtuar nga shkatërrimi, ai që nuk është rob i mallit dhe pasurisë!

Mirëpo, o ti që je rob i kësaj bote, përkundrazi, ia vure emrin vetes urdhërues i kësaj bote!

Në të vërtetë, ti je rob i kësaj bote dhe shpirti yt ka rënë në burgun e kësaj bote. Megjithëkëtë, gjer kur do të vazhdosh t'i thuash vetes zotërues i kësaj bote?

Sulejmani (a.s.) ua fiton zemrat përfaqësuesve,
u bën komplimenta atyre,
ua heq drojtjen në zemra dhe,
meqë nuk ua kishte pranuar dhuratat,
u kërkon falje
dhe ua shpjegon shkaqet e mospranimit.

"O të dërguar! Unë po ju kthej tani si të dërguarit e mi! Mospranimi nga unë i këtyre dhuratave është, për ju, më mirë sesa t'i kisha pranuar!

Kur të arrini te Belkizja, tregojini për gjërat e çuditshme që patë, përshkruajani fushën prej floriri!

Përshkruajani që ta kuptojë se unë nuk lakmoj flori, se kam shtënë në dorë flori nga krijuesi i floririt!

Ai Zot është një Zot i tillë që, po të dëshirojë, e shndërron gjithë faqen e tokës, nga kreu në fund, në flori dhe margaritarë të paçmueshëm.

O ti që zgjedh floririn, që e do atë, prandaj, në ditën e ringjalljes dhe llogaridhënies, Zoti do ta krijojë këtë tokë prej argjendi.

Ne nuk interesohemi as për flori! Artet tona janë të shumta; ne e kthejmë gjithë faqen e tokës në flori!

Hiqni dorë nga pasuria e kësaj bote edhe sikur të jetë pasuria e Sebesë. Ka shumë e shumë pasuri përveç ujit dhe dheut!

Gjëja që ti i thua fron, është kurth i bërë prej dërrase. Vendin ku je vendosur e ke pandehur për kryevend, por ke mbetur mu në derë!

Ti akoma nuk urdhëron dot mjekrën tënde, si ngrihesh, atëherë, të urdhërosh, të mbretërosh mbi të mirin e të keqin?

Mjekra të thinjet edhe pse nuk do ti; o shpresëhumbur, ki turp nga mjekra jote!

Në të vërtetë, ai Zot është pronar malli e pasurie; atij që i bindet, i fal jo më kaq sa kjo tokë, por qindra pasuri të tjera!

Një sexhde para Zotit të vjen ty më e këndshme se dyqind pushtete dhe mbretërime!

Unë nuk dua as mall, as pasuri, as pushtet, as mbretërim! Mua falma pushtetin e asaj sexhdeje, më mjafton!

Mbretërit e kësaj bote, për shkak të të këqijave të veta, as aromën nuk ia kanë marrë verës së adhurimit të Zotit!

Ndryshe, edhe ata, si Et'hemi, menjëherë do të entuziazmoheshin, do të deheshin e do ta shkatërronin salltanetin e kësaj bote!

Por Zoti ua ka mbyllur sytë dhe gojët me qëllim që kjo botë të qëndrojë në këmbë e të rregullohet!

Në këtë mënyrë, atyre iu vjen e ëmbël froni dhe kurora dhe thonë të marrin haraç nga njerëzit e botës...

Kështu, merr e merr haraç, grumbullon flori si rërë, por, megjithatë, ti vdes e ngordh, kurse florinjtë mbeten pas teje!

Malli e pasuria, pushteti dhe floriri nuk i bëhen bashkudhëtar shpirtit! Ti jep flori dhe blij syrmé për fuqizimin e shikimit!

Ngjyeji sytë me syrmé dhe shih se kjo botë është një gropë e ngushtë dhe kape litarin!

Dhe, kur të dalësh e të ngjitesh në ballkon, ata që të shohin, të thonë: "Sihariq, ja një skllav për ne!"

Në gropë, syri bën reflektime dhe njeriut i shfaqen fantazma, më e keqja e të cilave është kjo: guri duket si flori!

Edhe fëmijët e periudhës së lojës nxehen... A nuk u duken copat e gurëve dhe dheut, flori dhe pasuri?

Kurse të urtët e Zotit janë bërë kimistë dhe atyre u duken të pavlera edhe metalet, madje!

Dervishi i sheh shehlerët në ëndërr,
u kërkon një rizk hallall pa u përpjekur
dhe pa u penguar nga adhurimi;
shehlerët e orientojnë dervishin dhe,
me ndërhyrjen e tyre shpirtërore,
frutat e tharta e të hidhura të malit
i vijnë të ëmbla dervishit.

Një dervish tregoi: "Unë pashë në ëndërr të urtët e Hizrit.

Dhe u thashë atyre: "Nga mund ta fitoj rizkun hallall dhe pa asnjë mundim?"

Dhe ata më çuan në male e pyje. Në pyje shtrydhën fruta.

Dhe më thanë: "Me anë të shërbimit tonë, Zoti i bëri këto të ëmbla për ty!

Haji menjëherë se këto janë hallall dhe pa numërim. Në të njëjtën kohë, janë rizk i fituar pa përpjekje, pa dhimbje koke, pa barrë, pa vrapuar poshtë e përpjetë!"

I hëngra ato dhe në fjalë më erdhi një begati e një efekt që fjalët e mia filluan t'i lënë mendjet të mahnitura!

Zoti im - thashë - kjo është një provë. Ti më bëre një të mirë të fshehtë nga të gjithë njerëzit!

Erdha në një gjendje që të mos them dot asnjë fjalë. Zemra m'u kënaq dhe, nga kënaqësia, u çava si shegë!

Thashë se edhe sikur në xhennet të mos ketë kënaqësi si kjo,

Nuk dua dhunti tjetër! Nuk e le këtë për të ngrënë arra dhe sheqer!

Nga fitimi më kishin mbetur në dorë nja dy kokrra që i qepa në astarin e xhybes!

Dervishi thotë "t'ia jap këtë pará druvarit
sepse unë fitova rizk me mrekullinë e shehlerëve",
kurse druvari që e kupton qëllimin e dervishit,
preket.

Një dervish tjetër merrej me druvarí. Ai u kthye nga pylli i lodhur e i dërrmuar.

Kur e pashë atë, thashë me vete: "Tashmë unë s'kam punë me rizkun. Pas kësaj, unë s'do të vuaj për rizk!

Frutat e këqinj më vijnë mua të mira e të këndshme. Unë u bëra i merituar i një rizku të veçantë.

Meqë shpëtova nga halli i grykës, kam disa kokrra, le t'ia jap këtij!

T'ia fal këtij druvari që edhe ai të shpëtojë nga halli i grykës për nja dy ditë!"

Druvari e paskej kuptuar atë që ndjente përbrenda, sepse veshi i qe ndriçuar me dritën e Zotit!

Sipas tij, çdo mendim ishte si një kandil brenda në qelq. I shihte të gjitha!

Ajo që u ndjeka përbrenda, nuk u fshehka prej tij. Ai ishte bërë urdhër për të gjitha të ndjerat e zemrave!

Ai burrë që ishte për t'u habitur me të fshehtën e tij, fliste me vete përballë këtij mendimit tim:

"Kështu mendon për sovranët, ë? Po të të mos japin ata rizk, si do të furnizohesh dhe ushqehesh ti?"

Nuk e kuptoja ç'thoshte, por qortimi i tij i reflektohej mirë zemrës sime.

Ndërkaq, më erdhi para me madhështi prej luani dhe e lëshoi përtokë barrën e druve.

Dhe tha: "Po të ketë rob të tu të vërtetë me lutje të bekuara dhe me shenja të shquara,

Të lutem që, për hir të tyre, favori yt të tregojë një art dhe, tani për tani, kjo barrë me dru të kthehet në barrë me flori!"

Sapo e tha këtë, pashë se drutë u bënë flori që shkëlqente mbi tokë si zjarr!

Dhe, me ta parë këtë, më ra të fikët dhe qëndrova ashtu mjaft kohë. Kur më kaloi hutimi dhe erdha në vete,

Ai tha: "O Zot, po qe se ata të mëdhenjtë janë persona të zellshëm dhe që ikin nga fama dhe popullariteti,

Për hir të tyre, përsëri bëje këtë flori dru, sille në gjendjen e mëparshme!

Pas këtyre fjalëve, ato degë prej floriri u bënë menjëherë dru. Me ta parë punën e atij burri, edhe mendja u deh dhe e humbi veten, edhe vështrimi!

Pastaj ai i ngarkoi sërish drutë dhe vazhdoi rrugën. Duke shpejtuar, më kaloi para dhe shkoi në qytet!

Desha t'i shkoj pas atij sovrani dhe t'ia pyes hallet e t'ia dëgjoj fjalën,

Por më pengoi impresionimi prej tij, nuk shkova dot. Nuk ka rrugë për personat e ulët që të arrijnë te burrat e vërtetë!

Po qe se dikush gjen rrugë me mish e me shpirt, kjo bëhet me mëshirën dhe tërheqjen e tyre!

Prandaj dije se arritja e atij suksesi është pasuri. Po qe se gjen bisedën e një burri të drejtë, këtë quaje rast të favorshëm!

Dhe mos i ngjaj kokëtrashit i cili, megjithëse ndodhet pranë sovranit, megjithëse ka arritur të jetë pranë sovranit, e sheh të pavlefshme këtë aferësi dhe nuk e kthen rrugën!

Po t'i japin ndonjë copë të mirë nga mishi i deles së kurbanit, kokëtrashi thotë: "Më duket se kjo është tul kau!"

O shpifës, ajo nuk është tul kau, por të duket ashtu nga gomarllëku yt!

Kjo është një mirësi sovrani e dhënë pa shpërblim. Është një e mirë e posaçme e dhënë si rrjedhojë e kësaj mëshire!

Me qëllim që Belkizja ta shfaqë besimin sa më parë, Sulejmani (a.s.) i urdhëron përfaqësuesit të shkojnë shpejt dhe i inkurajon ata.

Pejgamberi Sulejman, në vend që të luftonte, i tërhoqi te vetja njerëzit dhe ushtarët e Belkizes.

O të bekuar - u tha - ejani shpejt, sepse deti i bujarisë nisi të dallgëzojë.

Dallgët e tij të shkumëzuara hedhin çdo çast në breg qindra margaritarë të padëmtuar!

O ju që e keni gjetur udhën, thashë sala për ju. Ridvani e hapi mu tani portën e xhennetit!

Sulejmani u tha: "O të dërguar, shkoni, arrini te Belkizja dhe bindeni për këtë fe!

Dhe i thoni: "Të gjithë ejani këtu dhe shpejt, se, nuk ka dyshim që Zoti po ju thërret në vendin e shpëtimit!"

O ti që kërkon lumturi, eja shpejt këtu! Kjo kohë është kohë begatie, koha kur janë hapur dyert!

O ti që nuk lyp, edhe ti eja... Edhe ti eja që të kesh të drejtën për të kërkuar nga ky i dashur i besës!

Shkaku që Ibrahim Et'hemi - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën - emigron nga vendi dhe e braktis salltanetin e Horasanit.

Ashtu si Et'hemi, edhe ti braktise menjëherë pushtetin dhe salltanetin dhe arri në një salltanet të përjetshëm!

Natën, Ibrahim Et'hemi flinte në fronin e vet, kurse vëzhguesit dhe rojet bënin zhurmë dhe rrëmujë në çati.

Sovrani s'deshte që rojet t'i përzenin vjedhësit dhe njerëzit e këqinj.

Sepse e dinte dhe e kishte zemrën të sigurt se ishte vetë ishte njeri i drejtë dhe se nuk kishte për t'i ardhur asnjë e keqe!

Eshtë drejtësia që i ruan dhe i mbron qëllimet dhe dëshirat, jo rojet që netëve shëtisin në çati me shkopinj në duar!

Por qëllimi që ndiqte sovrani duke dëgjuar zërin e rebabit, asaj violinës antike me tre tela, ishte, si ata që digjen nga dëshira për Zotin, të përfytyronte fjalën e Zotit t'i drejtohej.

Zërat e zurnasë dhe daulles i ngjajnë sadopak zërit të Bririt që do të bjerë në ditën e kiametit dhe ringjalljes.

Të urtët kanë thënë se këto tinguj muzikorë i kanë marrë nga rrotullimi i qiejve.

Këto këngë dhe melodi të ekzekutuara nga populli me vegla dhe të kënduara me zë, janë marrë që të gjitha nga lëvizja e qiellit.

Besimtarët thonë se, nën efektin e xhennetit, të gjithë zërat e këqinj e të shëmtuar bëhen të bukur.

Të gjithë ne kemi qenë pjesë të Ademit. Ato zëra dhe melodi i dëgjuam në xhennet!

Ç'është e vërteta, uji dhe dheu na futën një dyshim, por, prapë, ato melodi na kujtohen pak.

Por si do t'i japin notat këto melodi pasi të jenë përzjerë me dheun e së keqes?

Pasi të jenë përzjerë me ujë, shurrë dhe pisllëk, prishen, natyra e tyre bëhet e hidhur dhe e ashpër.

Edhe në kufomën e njeriut ka pak ujë. Edhe sikur ti ta quash shurrë atë, përsëri e shuan zjarrin! Apo jo?

Edhe sikur të jetë i fëlliqur, uji ka natyrë të përjetshme. Me anë të asaj natyre e shuan zjarrin e vojtjes.

Ja, prandaj dëgjimi i zërave të bukur është ushqim për ashikët, të pasionuarit pas Zotit! Sepse në dëgjimin e muzikës së bukur ka qetësim zemre dhe kënaqësi bashkimi me Zotin.

Përfytyrimet e njeriut fuqizohen, madje, marrin trajta të ndryshme nga ato zëra dhe melodi të bukura!

Ashtu siç fuqizohet zjarri i atij që hedh në të lëvozhga arrash, edhe zjarri i ashkut gjen forcë në zërat e bukur!

Njeriu i etur ngjitet në arrë dhe e shkund dhe arrat bien në ujin e gropës që ai s'e kishte gjetur dot; në këtë mënyrë, njeriu e dëgjon zhurmën e ujit, kënaqet e gëzohet.

Uji ndodhej në një vend shumë të thellë. Dikush që ishte etur, kishte hipur në një dru arre që ndodhej në anën e sipërme të ujit, dhe po e shkundte.

Kur binin arrat nga pema në ujë, dëgjonte zërin e ujit dhe sodiste flluckat e ujit që formoheshin.

Një burrë i mençur që e pa këtë skenë, i tha: "O trim, këto arra të etin më shumë!

Në ujë bien shumë arra, por uji është thellë, larg teje!

Gjersa të zbresësh ti poshtë me mundime, uji do t'i çojë ato më larg!"

Njeriu i tha: "Qëllimi për të cilin po e shkund pemën nuk është të mbledh arra. Mos vështro pamjen, por kuptoma mirë qëllimin!

Qëllimi im është të dëgjoj zërin e ujit dhe të shoh flluckat që formohen mbi ujë!"

Në këtë botë, ç'punë tjetër ka i eturi përveç se të përsillet vazhdimisht rreth hauzit?

Si tavafi i haxhiut përreth Qabes, edhe ai përsillet rreth ujit të lumit duke ia vënë veshin zërit të ujit!

Ja, pra, o dritë e popullit, Husameddin, si qëllimi i të eturit, edhe qëllimi im me Mesnevinë je ti!

Mesnevia është krejtësisht e jotja edhe me gjërat thelbësore, edhe me ato dytësore. Këtë ti e ke pranuar!

Sovranët e pranojnë edhe të mirën, edhe të keqen. Pasi ta pranojnë një gjë, nuk e kundërshtojnë më.

Meqë mbolle një fidan, ujite. Meqë e ke zgjidhur, mos e lidh nyjë!

Synimi që ndjek unë me fjalët e Mesnevisë, është e fshehta jote; synimi për ta thënë atë si vjershë, është zëri yt!

Për mua, zëri yt është zëri i Zotit... Ashiku, mos qoftë e thënë, nuk ndahet nga i dashuri.

Mes shpirti të njeriut dhe Zotit të njeriut ka një afrim, një njësim të drejtpërdrejtë, të pakrahasueshëm.

E kam fjalën për njeriun e vërtetë! Njerëz janë të afërtit e Zotit që është shpirti i shpirtrave, jo të tjerët!

Po ku është njeriu? Ti s'e ke parë kokën e njeriut, ti je bisht!

Ti e ke lexuar ajetin që thotë se "në dukje, ti je ai që e hodhe atë dhé, por, në të vërtetë, ishte Zoti yt", por je trup, ke mbetur te pjesët!

O kokëtrashë, siç bëri Belkizja, braktise vendin tënd trupor për Pejgamberin Sulejman!

Them "lahavle" jo nga fjalët e mia, por nga dyshimet e njeriut me mendim të keq!

Sepse, përballë fjalëve të mia, ai po bie në fantazira, po thur fantazira për shkak të dyshimeve në zemër dhe mohimeve të lindura nga dyshimi.

Po them "lahavle", pra, nuk ka zgjidhje kjo punë, sepse në zemrën tënde ka mendime dhe fjalë që janë e kundërta e fjalëve të mia!

Fjalët e mia më ngecën në grykë dhe unë po hesht. Eja, thuaje ti atë që është e denjë për ty!

Ndërsa një fyelltar po i binte fyellit me zë të bukur, nga ana e poshtme doli një pordhë!

Duke e kapur fyellin menjëherë nga ana e poshtme, fyelltari i tha: "Pa të të shohim! Po i fryve më mirë se unë, fryji!"

O musliman, po pyete e kërkove të dish se ç'është edukata, dije se edukata është të tregosh durim ndaj paturpësisë së çdo të paturpi.

Po pe dikë që ankohet për dikë tjetër se ka natyrë dhe shprehi të këqija,

Dije se ky ankues ka shprehi të këqija, sepse flet për të këqijat e atij me shprehi të këqija!

Sepse njeriu me shprehi të mira është ai që i duron ata që kanë shprehi dhe natyra të këqija, që nuk flet për anët e këqija të tyre!

Por po qe se shehu flet për të këqijat e dikujt, kjo bëhet me urdhër të Zotit, jo për zemërim dhe pasion!

Ankesa e tij nuk është ankesë, është përpjekje për përmirësimin e tjetrit. Ajo ankesë i përngjet ankesës së pejgamberëve.

Dije se padurimi i pejgamberëve është me urdhër të Zotit, përndryshe, butësia e tyre i duron gjërat e këqija.

Ata e nënshtruan natyrën e vet duke e duruar të keqen. Tashmë, po të shfaqet ndonjë mosdurim prej tyre, nuk është prej tyre, por prej Zotit.

O Sulejman, mes trumcakut dhe skifterit veshu me butësinë e Zotit dhe merru vesh me të gjithë zogjtë dhe shpendët!

O ti që butësia jote nënshtron qindra Belkize, o ti që thua "Zoti im, tregoja rrugën e drejtë popullit tim se s'dinë!"

Sulejmani (a.s.) i dërgon fjalë Belkizes duke e kërcënuar që të mos ngulë këmbë në politeizëm dhe të mos vonohet për të besuar dhe për ta shprehur besimin.

Belkize, eja në vete, mblidhi mendtë në kokë, ndryshe, e pëson keq! Ushtarët e tu kthehen kundër teje, të bëhen armiq!

Perdexhiu ta gris perden... Shpirti yt bën armiqësi kundër shpirtit tënd!

Të gjitha molekulat në tokë e në qiell, në kohën e provës janë ushtarë të Zotit

A e pe dheun se ç'i bëri popullit të Adit? A e pe ujin se ç'bëri në tufan?

Ç'punë i hapi Faraonit ai deti i urrejtjes! Ç'gjëra i tregoi Karunit kjo tokë!

Ç'i bënë elefantit zogjtë Ebabil! Si ia hëngri mushkonja kokën Nemrudit!

Kur Daudi e ngriti me dorë shkëmbin dhe ua hodhi armiqve, shkëmbi u nda në plot gjashtëqind copë dhe ushtria pësoi disfatë!

Luti u hodhi armiqve breshëri gurësh dhe, më në fund, ata i thithën dallgët e ujit të zi!

Po të nis e të tregoj për ndihmën e mençur të gjërave jo të gjalla për pejgamberët,

Mesnevia bëhet aq e madhe, sa dyzet deve, madje, s'e tërheqin dot!

Dora dëshmon në dëm të qafirit, bëhet ushtar i Zotit, i nënshtrohet urdhrit të Zotit!

O ti që, në punë, jep mësim në të kundërt të Zotit, ki frikë! Edhe ti je ndërmjet ushtarëve të Zotit.

Atij i është nënshtruar edhe pjesa e pjesës, e cila edhe ajo është ushtar i Zotit, por që, tani, për shkak të dyfytyrësisë, të duket e bindur ty!

Po t'i thotë Zoti syrit "shtrëngoje atë", dhimbja e syrit t'i gërryen rrënjët ty!

Po t'i thotë dhëmbit "jepi një ndëshkim atij", sheh se dhëmbi nis të ta tërheqë veshin!

Hape librin e mjekësisë dhe lexo pjesën mbi sëmundjet dhe shih se ç'bëjnë ushtarët e Zotit!

Meqë ai është shpirti i shpirtit të çdo gjëje, a mos është e lehtë t'i hyhet armiqësisë me shpirtin e shpirtit?

Belkize, lëri mënjanë ushtarët xhindë dhe shejtanë, sepse ata i nënshtrohen me gjithë shpirt urdhrit tim, me urdhrin tim çajnë radhë!

Belkize, në fillim lëre salltanetin, sepse, po më gjete mua, gjithë malli, pasuria dhe pushteti bëhen të tutë!

Kur të vish tek unë, do ta kuptosh se, pa mua, paske qenë vetëm një pikturë!

Le të jetë pikturë sovrani apo të pasuri! A është pikturë? Domethënë, është gjë pa shpirt!

Ajo është stolisur për të tjerë... E ka hapur më kot gojën dhe syrin!

Ti ia ke hyrë luftës me vetveten. Nuk i ke njohur e kuptuar dot të tjerët si veten tënde!

Në ç'fytyrë që të rastisësh, rri e thua "kjo jam unë", mirëpo, vallahi, ajo s'je ti!

Edhe sikur pak kohë të largohesh nga populli, të mbetesh vetëm, do të fundosesh gjer në grykë në ankth e dyshim.

Mirëpo si mund të jesh ti ajo? Ti je ai njeriu i vetëm, je e bukura e vetvetes, e dashura e vetvetes, e dehura e vetvetes!

Je zogu i vetvetes, gjahu i vetvetes, kurthi i vetvetes... Kreu i vendit i vetvetes, dyshemeja e vetvetes, çatia e vetvetes!

Thelb i thonë asaj gjëje që ekziston në vetvete, kurse gjëja që ekziston në sajë të saj, që është rrjedhimi i saj, është shenjë.

Në se edhe ti je bijë e Ademit, bëhu si ai, të gjithë pasardhësit shihi në vetvete!

Ç'ka në shtambë që të mos jetë në lumë. Ç'ka në shtëpi që të mos gjendet në qytet!

Kjo botë është një shtambë, kurse zemra i përngjet ujit të lumit. Kjo botë është një dhomë, kurse zemra, një qytet i mbushur me gjëra të papara e të çuditshme!

Sulejmani (a.s.) i çon fjalë kështu Belkizes:
"Kërkesa ime që ti të besosh
është vetëm për pëlqim të Allahut;
unë s'kam asnjë ambicje as për veten tënde,
as për bukurinë tënde
dhe as në mbretërinë dhe pasurinë tënde!
Kur të të hapen sytë me dritën e Zotit,
edhe ti ke për ta parë!"

Eja menjëherë! Unë jam një i dërguar që po të fton ty. Si vdekja, jam vrasës i epshit, jo rob i tij!

Madje, edhe sikur të kesh epsh, jam urdhërues i epshit. Unë nuk bëhem rob i epshit pasi t'ia shoh fytyrën një bukurie!

Origjina e origjinës sonë janë, si Halili dhe të gjithë pejgamberët, personat që thyejnë idhujt!

O rob, edhe sikur të hyjmë në tempullin e idhujve, ne nuk u bëjmë sexhde idhujve, idhujt na bëjnë sexhde neve!

Edhe Ahmedi hyri atje ku ndodheshin idhujt, edhe Ebuxhehli. Por mes sjelljes dhe veprimeve të tyre ka ndryshim të madh!

Po të hyjë ky në tempullin e idhujve, para tij idhujt vënë ballin në tokë, i bëjnë sexhde. Po të hyjë ai, ai vetë u bën sexhde idhujve siç u kanë bërë bashkësitë e ndryshme!

Edhe kjo botë epshi është një tempull idhujsh. Eshtë fole edhe për pejgamberët, edhe për qafirët!

Por epshi është rob i njerëzve të pastër. Floririn e pastër nuk e djeg zjarri!

Qafirët janë kallpë, kurse njerëzit e pastër i ngjajnë floririt. Që të dy palët ndodhen brenda kësaj pote!

Po të hyjë gjëja kallpe në potë, menjëherë nxihet. Po të hyjë floriri, menjëherë dallohet se është flori.

Floriri hap krahët e hidhet në potë; mes zjarrit, buzëqesh me një pamje të bukur!

Trupi ynë në këtë botë na e mbulon fytyrën. Ne jemi si deti i mbuluar me kashtë!

Sovranin e fesë mos e shih si dhé, o i paditur! Edhe shejtani i mallkuar me këtë vështrim e pati parë Ademin!

Thuajmë mua, a mund të zihet dielli me baltë?

Edhe sikur t'i hedhësh dhé e pluhur dritës, përsëri e ngre kryet dhe shkëlqen!

E ç'është kashta që ta mbulojë fytyrën e ujit? E ç'është dheu që të mund ta mbyllë diellin?

Ngrihu, o Belkize dhe, me sjellje prej sovrani, si Et'hemi, shpërndaje tymin e këtij salltaneti dy-tri ditësh!

Pjesa e mbetur e historisë së Ibrahim Et'hemit - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën!

Një natë, kur ai sovran me emër e famë po rrinte në fron, në çati u dëgjua një lëvizje, një zhurmë.

Në çati të sarajit hidheshin hapa të fortë. Me vete mendoi se kush guxonte ta bënte këtë.

Nga dritarja e sarajit bëri zë: "Kush është? S'mund të jetë njeri, duhet të jetë perri!"

Një grup njerëzish të panjohur e ulën kokën nga çatia dhe thanë: "Kemi humbje dhe po i kërkojmë tani natën!"

Ibrahim Et'hemi i pyeti: "Ç'po kërkoni?" Ata iu përgjigjën: "Devetë!" Ai u tha: "Kush ka parë të kërkohen devetë në çati?"

Ata i thanë: "Në është kështu, si e kërkon, si shpreson ti ta gjesh Zotin duke ndenjur në fron e duke sunduar?"

Ja, pra, ndodhi kjo dhe, pas kësaj, askush s'e pa më Ibrahim Et'hemin. Humbi nga sytë e njerëzve si perri!

Vetë ndodhej para syve të popullit, por kuptimi i tij ndodhej i fshehur. Ç'sheh populli tjetër veç mjekrës dhe hirkës?

Humbi edhe nga sytë e vetë, edhe nga sytë e njerëzve. Pikërisht atëherë u bë i famshëm në botë si feniksi!

Shpirti i cilit zog që shkon në malin e përrallave, bota për atë flet!

Edhe kur kjo dritë e lindjes ra mbi Sebenë, edhe mbi Belkizen, edhe mbi njerëzit e atjeshëm u ndje një tronditje.

Të gjithë shpirtrat e vdekur u ringjallën, përplasën flatrat. Të vdekurit ngritën kokat nga varret!

Dhe nisën t'i japin sihariq njëri-tjetrit: "Pa shih! Nga qielli po vjen një zë!"

Kush e dëgjoji atë zë, mori formë, u mbush... Degët dhe gjethet e zemrave u gjelbëruan!

Ajo frymë e ardhur nga Sulejmani, si të kishte rënë Briri, i çliroi të vdekurit nga varri.

O dëgjues, faktin Zoti e di më mirë, kjo kohë kaloi... Pas kësaj, bekimi le të bjerë mbi ty!

Pjesa e mbetur e historisë së sebeasve. Sulejmani (a.s.) i fut në rrugë të drejtë Belkizen dhe popullin e saj. Zgjidhja e vështirësive fetare e ndjesore të secilit sipas gjendjes. Gjuajtja e çdo lloj zogu e shpendi prej zogut dhe shpendit të llojit të vet me anë të këngës së vet dhe gjërave që ha vetë.

Po e them historinë e sebeasve si me një dëshirë të madhe, sepse flladi i mëngjesit erdhi e fryu mbi lulishte.

Trupat gjetën ditët e bashkimit. Fëmijët u takuan me nënat dhe baballarët nga e kanë origjinën.

Ummeti ose bashkësia e ashkut, dashurisë pasionante për Zotin, e cila është e fshehur ndër bashkësitë e tjera, i ngjan bujarisë së qarkuar nga urrejtja.

Poshtërimi i shpirtrave është për shkak të trupave. Lartësimi i trupave është pasojë e shpirtrave.

O ashikë, vera e pastër dhe e kthjellët është e juaja, ju ofrohet juve... Ju jeni të përjetshëm, përjetshmëria është juaja!

O ju që s'keni vuajtje ashku ndër zemra, ngrihuni, bëhuni ashikë... Ja, kundërmimi i Jusufit po vjen, nuhateni menjëherë, merreni atë kundërmim!

O gjuhë e zogjve e Sulejmanit, eja! Zëri i cilit zog të vijë, sipas tij thur melodi!

Zoti ua ka dërguar zërin zogjve... Melodinë e çdo zogu ty ta ka mësuar!

Zogut imponues foli me gjuhë imponuese. Atij krahëthyerit foli për durimin!

Zogun që bën durim, shihe me sy të mirë, fale. Feniksit lexoja cilësitë e malit të përrallavë!

Pëllumbit thuaji të ruhet nga skifteri. Skifterit shpjegoja butësinë, thuaji të tërhiqet pa djegur shpirt. Lakuriqin e natës të mbetur pa shpresë bëje shok me dritën, njihe me dritën!

Thëllënzës që lufton, mësoja paqen. Gjelave tregojua shenjat e kohës së mëngjesit!

Nga papagalli e gjer te sorra, të gjithë zogjve, tregojua, kështu, rrugën... Zoti e di më mirë ç'është e drejtë!

Belkizja shpëton nga salltaneti,
dehet me dëshirën e fortë të besimit dhe,
kur largohet nga vendi i vet,
lë çdo gjë me përjashtim të fronit.

Sapo u fishkëlleu zogjve të Sebeas, Sulejmani i bëri të gjithë zogjtë t'i binden si skllevër.

Përveç atyre pa shpirt e pa krahë ose, si peshqit, shurdhmemecë në origjinë!

Jo, e thashë gabim! Edhe shurdhit, nëqoftëse i nënshtrohet mesazhit të Zotit, Zoti i fal ndjijime e ndjenja!

Belkizja u përgatit me zemër e shpirt për të shkuar te Sulejmani. Ajo iu hap kohëve të shkuara.

Ashtu siç e braktisin ashikët emër e famë, ashtu dhe ajo e braktisi mallin dhe pasurinë.

Në sytë e saj, skllavet dhe shërbëtoret nazemadhe nisën të duken si qepë e kalbur.

Për shkak të dashurisë, vreshtat, pallatet, lumenjtë i dukeshin si kuaj.

Kur dashuria nxehet dhe rrjedh, të gjitha bukuritë i duken syrit të shëmtuara.

Zelli i dashurisë, edhe smeraldin, madje, e tregon në sy të njeriut të pavlerë sa preshin... Ja, ky është kuptimi i "La"-së!

O ti që kërkon vend për t'u strehuar, kjo është "La ilahe il'la Hu" (Nuk ka zot tjetër veç Atij). Edhe hëna të duket ty si poçe e nxirë!

Edhe Belkizja nuk i jepte vlerë asnjë malli, asnjë thesari, asnjë gjëje të çmuar. Vetëm nga froni nuk kishte hequr dot dorë!

Sulejmani e kuptoi se ç'kishte në zemër Belkizja, sepse mes dy zemrave të tyre qe formuar një rrugë!

Ai që dëgjon zërat e milingonave, sigurisht që e dëgjon edhe thirrjen e atyre që ndodhen larg.

Ai që e shpreh të fshehtën "një milingonë tha që...", e di edhe të fshehtën e kësaj bote të vjetër.

Ai pa që larg se Belkizja e cila ia kishte dorëzuar edhe veten, i vinte vështirë të ndahej vetëm nga froni!

Po ta them shkakun e kësaj, po të ngrihem të tregoj se pse ishte kaq e shtënë pas fronit, fjala do të zgjatet.

Belkizja s'ishte e të njëjtit lloj me fronin, por edhe kalemi s'është i të njëjtit lloj me qatipin, megjithatë, është shok i ngushtë, është bashkudhëtar me të!

Edhe veglat e çdo arti janë, kështu, pa shpirt, por janë të afërtit e artistit të gjallë!

Po të mos kishte lagështirë në syrin e mirëkuptimit, këtë shkak do ta tregoja më hapur.

Froni ishte i stërmadh, prandaj s'kishte mundësi të bartej.

Ishte bërë me një art shumë të hollë dhe pjesët ishin lidhur aq fort me njëra-tjetrën, sa nuk mund të ndaheshin, prandaj nuk mund të çohej kund se thyhej.

Sulejmani tha: Më në fund, do të ftohet edhe nga froni, edhe nga kurora!

Po qe se zemra arrin në botën e unitetit dhe shfaqet në atë botë, përballë bukurisë së unitetit s'mbetet gjë nga bukuria e trupit!

Pasi të dalë margaritari nga fundi i detit, shkumën dhe plehërishtet e detit i sheh pa vlerë!

Pasi të lindë dielli që shpërndan dritë, kush dëshiron të zërë vend në bisht të akrepit?

Pavarësisht nga të gjitha këto, froni i saj duhet sjellë.

Duhet sjellë që, kur të takohet, të mos dëshpërohet; dëshira fëminore t'i jetë plotësuar!

Për ne, ai fron është një gjë e thjeshtë, por, për të, shumë i çmuar! Ç'të bëjmë, në sofrën e hyrive le të ndodhet edhe shejtani!

Gjithashtu, ashtu siç i qenë bërë pësim Ejazit më pas hirka me opingat, edhe asaj i bëhet pësim froni!

Sheh nga froni dhe e kupton se pas ç'gjëje është shtënë, nga ku gjer ku ka ardhur, nga ç'gjendje në ç'gjendje është futur!

A nuk na i mban Zoti vazhdimisht para syve dheun, spermën dhe copën e mishit?

O qëllimkeq, shih... Si ishe e si të bëra! Tani ke neveri prej tyre, apo jo?

Ato kohë ti ishe i dashuruar pas dheut, spermës dhe copës së mishit. Ato kohë e mohoje këtë bujari dhe mirësi!

Në fillim, kur ishe në gjendje dheu, mohoje se kishe për t'u bërë me mendje dhe shpirt. Kjo bujari dhe mirësi është për të ta shuar atë mohim.

Faktiqëubëreigjallëështënjëprovëepakundërshtueshme përballë mohimit tënd të mëparshëm... Kjo sëmundje t'u bë më keq se shërimi!

A ka mundësi dheu ta bëjë këtë punë? A bën armiqësi sperma, a bie në mohim?

Ato kohë ishe pa zemër e pa shpirt, prandaj e mohoje edhe mendimin, edhe mohimin!

Kur ishte trup jo i gjallë, e mohoje se kishe për t'u bërë njeri, kurse tani ngul këmbë në mohimin e ringjalljes!

Puna jote është kështu. Vjen një njeri në derë të dikujt dhe troket duke e përplasur fort hallkën metalike, kurse i zoti i shtëpisë thërret nga brenda: "I zoti i shtëpisë s'është këtu!"

I ardhuri e kupton nga këto fjalë se i zoti i shtëpisë është brenda, por dorën s'e heq nga hallka.

Edhe mohimi yt tregon se Zoti ka krijuar dhe ringjallur qindra shpirtra nga bota e trupave të ngurtë e pa jetë.

Nga uji dhe dheu, e gjer sa u bë njeriu me zemër e shpirt, sa e sa cilësi fitoi!

Ja, pra, uji dhe dheu, domethënë, njeriu, mohojnë, por, në të vërtetë, e pohojnë, vetëm se, po ashtu si ai njeriu, duke bërtitur: "I zoti i shtëpisë nuk ndodhet brenda!"

Këtë mund ta shtjelloj në njëqind mënyra, por mendja e njeriut rrëshqet nga fjalët e holla, prandaj po heq dorë!

Sulejmani (a.s.) gjen një zgjidhje për ta sjellë fronin e Belkizes nga Sebea.

Një demon tha: "Unë e sjell fronin para se të ngrihesh ti nga vendi!"

Kurse Asafi, ministri i Sulejmanit, tha: "Me fuqinë e Emrit të Madh të Zotit, unë e sjell këtu fronin brenda çastit!"

Demoni ishte mjeshtër në magji, por ai fron erdhi me frymën e Asafit.

Froni i Belkizes u shfaq menjëherë para Sulejmanit, por me përpjekjen e Asafit, jo me hilen e demonëve!

Sulejmani e falenderoi Zotin. Ai vazhdoi: "Edhe këtë dhunti e pashë me favorin e Zotit të botëve, edhe qindra të tjerë si ky!"

Pastaj pa nga froni dhe tha: "Po, ti mund t'i gënjesh kokëtrashët, o dru!

Sa e sa kokëtrashë bien në sexhde para drurit dhe gurit të gdhendur e të zbukuruar!"

As adhuruesi ka dijeni për shpirtin, as i adhuruari... Vetëm se kanë parë një lëvizje dhe shenjë të vogël nga shpirti, vetëm kaq!

Kur është shtangur nga habia, ka parë se guri ka folur dhe ka bërë me shenja dhe atëherë është shtangur plotësisht nga habia.

Ai njeri i keq nuk e ka lëvizur tavllën e adhurimit në vend, prandaj luanin prej guri e ka pandehur luan të vërtetë!

Luani i vërtetë ka treguar bujari dhe menjëherë ka hedhur një kockë para qenit...

Dhe ka thënë se ai qen nuk është qen i vërtetë, por hedhja e kockës nga ne është një favor i përgjithshëm!

Kur Halimja e pret Mustafain (a.s.) prej qumështi, e humb dhe kërkon ndihmë nga idhujt; idhujt dridhen dhe bien në sexhde dhe pastaj dëshmojnë për madhërinë e Mustafait (s.a.s.).

Të ta tregoj ty historinë e fshehtë të Halimes dhe të të ikë shqetësimi nga zemra!

Pasi e preu Mustafanë prej qumështi, e kapi për dore, e mori në gji

Dhe, duke e mbrojtur prej të mirit e të keqit, shkoi në Mekë për t'ia dorëzuar të atit atë sovran të sovranëve!

Duke pasur frikë se mos e humbë atë amanet, shkoi në Qabe dhe hyri në Hatim.

Ndërkaq, nga sipër po vinte një zë që thoshte: "O Hatim, për ty sot lindi një diell shumë i madh...

O Hatim, sot mbi ty ranë qindramijëra dritëra nga dielli i bujarisë...

O Hatim, sot për ty ndriti fati se të erdhi sovrani i sovranëve...

Nuk ka dyshim se do të bëhesh nga e para konaku i shpirtrave që i përkasin botës së lartë...

Shpirtrat e pastër do të vinë tek ti nga çdo anë turma-turma, sërë-sërë, të dehur nga dëshira dhe kënaqësia!"

Halimeja u habit nga ky zë. S'kishte njeri as para, as pas!

Nga të gjashtë anët s'kishte kush... Por ai zë që iu bëfshin shpirtrat kurban, vinte pa u ndalur.

Atëherë Halimeja e la Mustafain përtokë për të hetuar se nga vinte ai zë i bukur, kush fliste ashtu!

Dhe i shëtiti sytë nga të gjitha anët për të parë se ku ishte ai sovran që zbulonte të fshehta, që thoshte gjëra të fshehta.

Dhe thoshte: "O Zot, ky zë i lartë më vjen nga e djathta dhe e majta, por kush është ai që flet?"

Kur s'pa asnjeri, u habit, iu pre shpresa dhe e kuptoi se s'do ta gjente dot atë që fliste. Dhe dridhej si dega e shelgut!

Pastaj u kthye andej ku e kishte lënë atë fëmijë me mend në kokë... Por, ç'të shohë? Mustafai nuk ishte aty ku e kishte lënë!

U hutua krejt! Vendi sikur iu nxi nga mjerimi!

Dhe nisi të vraponte nga të gjitha anët duke thirrur se kush ia kishte marrë margaritarin.

Mekasit i thanë se s'dinin gjë, madje se s'kishin parë ndonjë fëmijë në atë vend!

Halimeja filloi të qante e të klithte në atë mënyrë, që, duke e parë, edhe të tjerët nisën të qanin!

E rrihte gjoksin dhe qante aq dhimbshëm, sa nisën të qanin edhe yjet që e vështronin!

Plaku arab që e çon Halimen te idhujt për t'u kërkuar ndihmë.

Në këtë mes, u shfaq një plak që vinte duke trokitur me shkopin përtokë. Ai i tha: "O Halime, ç'të ra mbi kokë?

Pse qan kështu, pse po i copëton zemrat?"

Halimeja i tha: "Unë jam mëndesha e besueshme e Ahmedit. E solla atë për t'ia dorëzuar të atit.

Por, kur erdha në Hatim, në vesh nisën të më vinin zëra nga lart.

Kur i dëgjova ato zëra që vinin nga qielli, e lashë fëmijën aty...

Desha ta shihja se kush i thoshte ato fjalë, sepse ai zë ishte shumë i bukur e i ëmbël.

As nuk pashë njeri përreth, as zëri nuk u pre për asnjë çast.

Mbeta e hutuar dhe, duke shkuar andej-këndej nga hutimi, pashë se fëmija nuk ndodhej më atje ku e kisha lënë! E mjera unë!"

Plaku i tha: "Mos u shqetëso, mos u dëshpëro! Unë do të të tregoj një njeri të shquar!

Ai do të të thotë se ç'u bë fëmija, ku shkoi, ku ndodhet tani!"

Halimeja i tha: "T'u bëftë shpirti kurban, o plak fytyrëdritë dhe fjalëmbël!

Eja, tregoma menjëherë atë njeri të shquar që të marr vesh për gjendjen e fëmijës!"

Dhe plaku e çoi Halimen pranë Uzza-s. Dhe i tha: "Ky idhull ka përvojë për lajmërimin e të humburve.

Kur ne i kemi shkuar dhe i kemi bërë fli, mijëra humbje na i ka gjetur!"

Plaku ra në gjunjë para idhullit dhe i tha: "O shkaku i qenies së arabëve, o det bujarie!

O Uzza! Ti na bëre gjithato favore dhe ne shpëtuam nga kurthet!

Për shkak të favoreve, ke të drejta mbi arabët. Arabit i është bërë e detyrueshme të të përulet ty!

Kjo Halimeja nga fisi Sad erdhi e u strehua nën hijen tënde duke shpresuar se do t'i gjesh shpëtim.

Asaj i paska humbur një fëmijë i vogël. E paska emrin Muhammed!"

Sapo që arabi përmendi emrin Muhammed, të gjithë idhujt ranë menjëherë në gjunjë duke vënë ballin përtokë!

Dhe thanë: "O plak, ç'është kjo mënyrë e kërkimit të Muhammedit? Për shkak të tij ne kemi për t'u poshtëruar!

Për shkak të tij kanë për të na zënë me gurë, kanë për të na shtrirë përtokë! Ne kemi për t'i humbur të gjitha vlerat tona!

Fantazitë që panë herëpashere ambiciozët prej nesh në kohën pa pegamber,

Kur të vijë koha e tij, do të shuhen... Kur të duket uji, tejemmumi nuk do të vlejë më!

O plak, largohu prej nesh dhe mos i fryj zjarrit të provës, mos na digj ne me zilinë e Ahmedit!

Për hir të Zotit, largohu, o plak! Largohu që zjarri i paracaktimit hyjnor të të mos djegë edhe ty bashkë me ne!

A nuk e di se kjo do të thotë t'ia shkelësh bishtin kuçedrës? A nuk e di se ç'lajm sjell kjo nga pas?

Nga ky lajm ngrihet peshë edhe zemra e detit, edhe zemra e tokës! Nga ky lajm, shtatë kat qiell, madje, dridhen si ndër ethe!"

Pasi i dëgjoi këto fjalë nga idhujt prej guri, ai plak i parë e i pësuar e hodhi shkopin përtokë.

Dhe nisi të dridhej. Ishte trembur nga ato fjalë. Dhëmbët i kërcisnin në gojë.

Dridhej si njeriu lakuriq në mes të dimrit dhe thoshte: "Mjerë për ne, u shkatërruam!"

Duke e parë gjendjen e plakut, Halimeja u hutua krejt dhe harroi se ç'duhej të bënte.

Ajo tha: "O plak, edhe unë jam në hall, por tani e humba krejt!

Vjen një çast që era më flet, vjen një çast që gurët më japin mësim!

Era më thotë fjalë, guri dhe mali ma mësojnë të vërtetën e gjërave!

Ndërkaq, qeniet e botës së fshehtë, engjëjt me flatra të gjelbra të qiellit ma rrëmbejnë fëmijën!

Kujt t'i qahem? Kujt t'i ankohem? U ktheva tani drejt qindra zemrave të dashuruara!

Zelli i atij fëmije nuk më lë t'i them sekretet e botës së fshehtë, ma mbyll gojën. Vetëm kaq po them: Fëmija më humbi!

Po të them gjë tjetër, njerëzit më pandehin për të marrë, më lidhin me zinxhirë!"

Plaku i tha: "O Halime, gëzohu! Bjer në sexhden e falenderimit, mos e çjerr fytyrën!

Mos u dëshpëro! Ai nuk humbet, ndoshta gjithë bota humbet në të!

Çdo çast, para dhe pas tij ka qindramijëra vëzhgues e roje që e ruajnë atë!

A nuk e pe? Ata idhuj të aftë, me ta dëgjuar emrin e fëmijës, u përgjunjën dhe vunë ballin në tokë!

Kjo kohë është një kohë e çuditshme mbi tokë. Unë u plaka e shkova, por gjë të tillë nuk pashë!

Si klithën gurët nga ky lajm? Nuk e di se ç'do t'u ndodhë fajtorëve!

Gurit ne i themi zot, por ai s'ka faj pse ne e bëjmë zot... As ti s'je e detyruar t'i falesh atij!

Dhe, nëse, megjithatë, frikësohet, mendo se ç'ka për t'i ndodhur!

Gjyshi i Mustafait, Abdylmuttalibi, dëgjon se Halimeja e ka humbur Muhammedin (a.s.), se po përsillet rreth qytetit duke e kërkuar dhe se në Qabe ka qarë e është ngashëryer, se i është lutur Zotit t'ia gjejë Muhammedin (a.s.).

Kur gjyshi i Mustafait dëgjoi për gjendjen e Halimes, se kishte qarë mes njerëzve,

Se kishte klithur sa për t'u dëgjuar gjer larg,

E kuptoi si qëndronte puna dhe filloi t'i binte gjoksit me grushte e të qante!

Kështu, duke u qarë e ankuar, arriti në derën e Qabes dhe tha: "O Zot që i di edhe të fshehtat e natës, edhe punët e ditës!

Nuk shoh ndonjë aftësi në veten time që të barazohem me ty!

Nuk shoh ndonjë të drejtë në veten time që të bëhem i pranueshëm në këtë derë të bekuar!

As në kokë kam ndonjë vlerë, as në sexhden time... As ndonjë fat i lumtur më buzëqesh në qarjen time!

Vetëm në fytyrën e margaritarit të vetëm të pashoq kam parë shenjat e favorit tënd, o bujari, Zoti im!

Ai është yni, por nuk na ngjet neve... Ne jemi bakër, kurse ai është kimí.

Gjërat e çuditshme që kam parë tek ai, nuk i kam parë as te miku, as te armiku!

Vlerave dhe virtyteve që ke dhuruar te ky fëmijë, një tjetër nuk mund t'ua gjejë as shenjën edhe sikur njëqind vjet të përpiqet!

I kam parë mirë favoret e tua tek ai dhe e kuptova se ai është margaritari i vetëm i detit tënd!

Ja, dhe unë po e sjell tek ti atë si ndërmjetës dhe po të lutem që, për hir të tij, të më tregosh se në ç'gjendje ndodhet ai, o Zot që e di gjendjen e secilit!"

Nga brenda Qabes erdhi menjëherë një zë: "Tani do të të shfaqet ty!

Ai ka marrë pjesë nga ne me qindra të mira... Qindra grupe engjëjsh po e ruajnë atë.

Dukjen e tij do t'ia bëjmë të njohur botës, kurse botën e tij të brendshme do ta fshehim nga të gjithë!

Uji dhe dheu janë mineral floriri, kurse ne jemi argjendar dhe herë e bëjmë gish atë, herë unazë!

Herë e bëjmë rrip shpate, herë lak në qafë të luanit!

Herë e bëjmë bronz që zbukuron fronin, herë e vëmë kurorë në kokë të sovranëve që kërkojnë pushtet!

Ne kemi dashurira pasionante me këtë tokë, sepse ajo ushtë ulur në gradën e pëlqimit.

Herë prej tij nxjerrim një sovran të tillë, herë atë sovran e bëjmë të dashuruar me pasion pas një sovrani tjetër!

Nga ajo tokë krijojmë qindramijëra të dashuruar e qindramijëra të dashur. Që të gjithë janë tek klithin e rënkojnë, që të gjithë diçka kërkojnë!

Kjo, pra, është puna jonë për verbërinë e atij që nuk është i prirur me zemër ndaj punës sonë!

Kësmetin e vëmë para atyre që s'kanë ushqim. Prandaj i japim tokës këto vlera!

Sepse toka duket e zezë dhe me pluhur, por brenda ka cilësi të bukura!

Pamja e jashtme e saj është në luftë me pamjen e brendshme. Faqja e brendshme është si margaritar, e jashtmja i ngjet gurit.

E jashtmja thotë: "Ne jemi vetëm kjo që jemi". E brendshmja thotë: "Ki kujdes, shihe mirë punën para dhe pas"!

E jashtmja mohon: "Brenda s'kemi asgjë..." E brendshmja thotë: "Prit të të tregojmë të vërtetën tonë!"

E jashtmja me të brendshmen janë në luftë. Dhe, meqë e brendshmja tregon durim ndaj të jashtmes, meriton ndihmën e Zotit!

Ja, pra, ne rregullojmë trajta nga kjo tokë fytyrëthartë dhe e nxjerrim në shesh buzëqeshjen e saj të fshehtë.

Sepse e jashtmja e tokës përbëhet nga vuajtja dhe qarja, kurse brenda ka qindramijëra buzëqeshje!

Ne i nxjerrim të fshehtat në dukje, kjo është puna jonë. Këto gjëra të fshehta i nxjerrim vazhdimisht nga pusia.

Vjedhësi vjen nga mohimi, hesht, nuk thotë gjë, por roja e shtrëngon dhe ia nxjerr vjedhjen në dukje!

Edhe në këto dhera ka vjedhur shumë e shumë të mira. Dhe ai e bën ta pohojë dhe i shkakton ngatërresa të shumta!

Ai ka shumë fëmijë të çuditshëm. Por Ahmedi është më i lartë se të gjithë!

Toka dhe qielli qeshin dhe gëzohen se nga një çift si yni ka lindur një sovran i vetëm.

Qielli po çahet nga gëzimi. Toka po shndërrohet në stolisëse ngaqë është e lirë!

O tokë e bukur, meqë faqja jote e jashtme është në luftë me të brendshmen,

Kush lufton me vetveten për hir të Zotit, më në fund e gjen të vërtetën, bëhet armiku i ngjyrës dhe aromës (pamjes së jashtme)!

Nuk ka perëndim për diellin e shpirtit të atij, errësira e të cilit hyn në luftë me dritën e vet!

Ndër këmbë të personit që ua hyn provave, që përpiqet për hir tonë, bie edhe qielli!

E jashtmja jote qan për shkak të errësirave, por faqja jote e brendshme është trëndafilishte në trëndafilishte!

Ajo, si sofitë fytyrëthartë, ka për qëllim të përzihet dhe afrohet me persona që shuajnë dritë.

Arifët surratthartë i ngjanë iriqit. Ata bëjnë qejf në rrënjë të gjembave të fortë!

Lulishtja është e fshehtë, kurse gjembat përreth saj janë sheshit... Pra, thonë: "O vjedhës armik, largohu nga kjo portë!"

O iriq, e ke bërë gjembin roje për vete dhe e ke tërhequr kokën brenda hirkës si sofitë!

Dëshiron që askush prej këtyre personave me fytyrë trëndafili, por me shprehi gjembi, të mos prekë as më të voglën kënaqësi tënden!

Fëmija yt është fëmijë, por të dy botët janë foshnjat e tij, për të janë krijuar!

Me të e ringjallim ne botën, e bëjmë qiellin rob dhe skllav në shërbim të tij!"

Abdylmuttalibi tha: "Tani ku është, o ti që i di të fshehtat, tregoma rrugën që do të më çojë tek ai!"

Abdylmuttalibi lutet drejt Qabes me këto fjalë: "Më trego se ku ndodhet Muhammedi (a.s.) që ta gjej!" Nga brenda Qabes vjen një zë që i tregon vendin.

Nga brenda Qabes, Abdylmuttalibit i erdhi një zë: "O njeri me mend që kërkon fëmijën,

E ke në filan luginë, nën filan pemë!" Sapo e dëgjoi këtë zë ai fatmirë, menjëherë u nis.

Kurse pas i shkonin të parët e kurejshve. Sepse ati i Pejgamberit ishte nga të mëdhenjtë e kurejshve.

Të gjithë të parët gjer te Pejgamberi ishin personat më të shquar edhe në kuvend, edhe në luftë!

Ky soj ishte soji i tij në dukje. Sovranët e mëdhenj kishin rrjedhur prej sovranit të tij.

Kurse i brendshmi ishte i pastër nga soji e sorollopi. Nga peshku, te ylli i quajtur "Alfa Virgo", nuk kishte askush të ngjashëm a të njëjtë me të në lloj.

Askush nuk e kërkon se nga kush lindi drita e të Vërtetës, si mori formë. Ç'nevojë ka për ta pyetur dhe kërkuar prejardhjen e krijimeve të Zotit?

Edhe pelerina më e thjeshtë e dhënë nga Zoti si shpërblim për mirësitë, është më e ndritshme, më e lartë se drita e diellit!

Pjesa e mbetur e historisë së ftesës së Belkizes për në mëshirën e Zotit.

Ngrihu, o Belkize, dhe shihe pushtetin dhe salltanetin dhe mblidh margaritarë në bregun e detit të Zotit!

Motrat e tua rrinë në qiejt e lartë. Ti pse vazhdon të sundosh mbi një gjë të ndyrë?

A e di se ç'u ka dhënë ai sovrani motrave të tua nga bakshishet e larta e të shumta?

Mirëpo ti i bie me gëzim daulles: "Unë jam sovrani dhe i pari i vatrës së hirit!"

Njeriu është sunduesi i botës,
ai e kërkon botën me ambicje dhe,
ndërsa shpirtërorët nga lloji i njeriut bërtisnin
"që fisi i tyre t'ua dinte hallin",
nuk kishin dijeni nga shteti.

A nuk ndodhi që një qen pa në gropë lypësin qorr dhe e sulmoi dhe ia grisi hirkën?

Këtë e thamë, por po e themi edhe një herë tjetër për ta përforcuar.

Qorri tha: "Miqtë e tu tani po kërkojnë gjah në male...

Të afërmit e tu po gjuajnë në mal gomarë të egër, kurse ti zë qorrë në mes të fshatit!"

O sheh që ikën nga gjërat e larta, lëre këtë dredhi! Ti i ngjet ujit të hidhur që ka mbledhur në krye disa qorrë!

Dhe thua: "Këta janë si dervishë të mi, kurse unë jam ujë i hidhur. Pinë prej meje dhe bëhen qorra, ja, kështu!"

Uji yt vjen i ëmbël nga deti hyjnor, pra, mos ua bëj kurth ujin e keq këtyre qorrave!

Ngrihu dhe shihi luanët e Zotit që gjuajnë gomarë të egër! Pse ti, si një qen, gjuan qorra me dredhi?

Thashë se ata gjuajnë gomarë të egër... Po ç'është gomari i egër? Ata nuk gjuajnë tjetër veç të dashurit! Që të gjithë janë luanë, gjuetarë luanësh, të dehur të dritës hyjnore!

Duke e soditur gjahun dhe gjuetinë e sovranit, që të gjithë e kanë lënë rënien në gjah, të mahnitur, kanë dhënë shpirt!

Ashtu siç marrin gjuetarët në duar zogj apo shpendë të ngordhur për të gjuajtur zogj apo shpendë të të njëjtit lloj, ashtu dhe i dashuri i ka marrë ata në duar.

Ai zog është në gjendje të pavullnetshme mes bashkimit dhe veçimit. A nuk e ke lexuar hadithin që thotë se "zemra është mes dy gishtave të Zotit"?

Po qe se ai që është gjuajtur nga ai zog i vdekur, vështron me kujdes, sheh se është gjuajtur nga sovrani.

Ai që i del para këtij zogu të vdekur, kurrë nuk mund ta gjejë dorën e gjuetarit!

Zogu i vdekur thotë: "Mos ma vër re fëlliqësinë, por dashurinë e sovranit për mua. Vër re dhe shih se si kujdeset për kufomën time!

Unë nuk jam i fëlliqur... Mua më vrau sovrani; trajta ime i ngjau të vdekurit.

Më parë fluturoja me flatrat e mia, kurse tani, lëvizja ime është në dorë të sovranit.

Lëvizja ime e përkohshme dhe vdekëtare më doli nga lëkura e iku, kurse lëvizja ime e tanishme është e amshueshme, sepse është prej tij!

Atë që bën lëvizje të shtrembra në krahasim me lëvizjen time, edhe po të jetë feniks, e shkatërroj, e bëj të qajë, e bëj të rënkojë, e vras!

Nëse je i gjallë, mblidhi mendtë në kokë dhe mos më shih të vdekur; nëse je rob i Zotit, shihmë se jam në dorë të sovranit tim!

Me bujarinë e tij, Isai ngjalli të vdekurin; kurse unë jam në dorë të krijuesit të Isait.

A mund të mbetem i vdekur sa të jem në dorë të Zotit? Kjo s'ka mundësi edhe sikur të jem në dorë të Isait!

Jam Isa, por ai që gjen shpirt nga fryma ime, nuk vdes edhe një herë tjetër, mbetet i gjallë përjetësisht.

Ai që u ringjall me frymën e Isait, vdiq përsëri... Por lum ai që i ka dhënë shpirt këtij Isai!

Unë jam shkopi në dorën e Musait tim... Musai im është i fshehtë, kurse unë dukem dhe qëndroj para tij.

U bëhem muslimanëve urë mbi det, pastaj bëhem kuçedër për Faraonin!

O bir, mos e shih të vetmuar këtë shkop. Ai s'i bën dot këto punë po të mos jetë në dorë të Zotit!

Edhe vala e përmbytjes u bë shkop... Në atë gjendje të mjerueshme, ajo i përfshiu ata që adhuronin magjistarët!

Po u ngrita t'i numëroj shkopinjtë e Zotit, i gëlltis hilet e atyre që i përkasën këtij Faraoni!

Por lëri ta kullosin edhe ca ditë këtë bar të hidhur e të ëmbël!

Nga do të ushqehej xhehennemi po të mos ishte mbështetja e Faraonit dhe po të mos ishte ai kryesues e prijës?

O kasap, në fillim majme bagëtinë, pastaj there, sepse qentë në xhehennem janë pa ushqim!

Po të mos ishin armiqtë në këtë botë, zemërimi mes njerëzve do të tulatej e do të shuhej.

Zemërimi është ai që i thua xhehennem. Duhet armiqësia që të jetojë. Ndryshe, mëshira do ta shuante!

Atëherë do të mbetej favori pa të këqija e pa vuajtje dhe, në këto kushte, si do të dilte në pah bujaria e sovranitetit?

Mohuesit nuk ua vunë veshin fjalëve të këshilluesve, shembujve të sjellë prej tyre, qeshën me mjekrat e tyre!

Po deshe, edhe ti qesh... Por, o i ndyrë, gjer kur do të jetosh, gjer kur?

O ju që dashuroni, filloni të luteni, gëzohuni, lutuni në këtë derë se kjo derë do të hapet sot!

Në kopësht ka nga një brazdë për secilën nga perimet, si qepa, hudhra, etj.

Secila ndodhet së bashku me llojin e vet, në brazdën e vet dhe qëndron atje për t'u ushqyer nga toka dhe lagështia me qëllim që të rritet e të piqet!

Ti je brazdë shafrani, bëhu shafran! Mos u afro e mos u përzje me perimet e tjera!

O shafran, merre ushqimin nga uji, bëhu shafran dhe hyr në zerde!

Mos hyr në brazdën e karrotave e mos e hap gojën për t'u bërë i të njëjtës natyrë, i të njëjtave shprehi me to!

Ti je vendosur në një brazdë, ato, në një brazdë tjetër, sepse "toka e Zotit është shumë e gjerë"!

Kjo faqe e tokës është aq e gjerë, sa edhe devetë dhe perritë e nisura për udhëtim, humbin aty!

Në atë det, në atë fushë, në ato male nuk dalin dot në rrugë as imagjinata dhe fantazia, se humbasin e shkojnë!

Kjo fushë, në fushën e asaj toke mbetet si një qime në detin pa anë e pa fund!

Atje ka ujëra aq të qeta, sa rrjedhja e tyre është e fshehtë. Që të gjitha janë më të freskëta, më të këndshme se ujëvarat!

Rrjedhin në vetvete dhe fshehtazi si shpirtra; ato kanë këmbë që rrjedhin e shkojnë!

Dëgjuesit fjetën, preje shkurt fjalën, o predikues! Lëre, mos shkruaj shkrim mbi ujë!

Ngrihu, o Belkize, tregu i marrë-dhënies u nxeh! Ik nga këta koprracë që s'u del gjë dore!

Ngrihu, o Belkize, ngrihu tani me vullnetin dhe dëshirën tënde pra se të vijë e t'ia behë vdekja!

Se, pastaj, vdekja ta heq veshin në atë mënyrë që, si një hajdute, del në skenë duke u zvarritur dhe dorëzohesh!

Gjer kur do të vazhdosh të vjedhësh potkonj nga këta gomerë? Nëse do të vjedhësh diçka, të paktën eja dhe vidh gurë të çmuar!

Motrat e tua shtinë në dorë pasurinë e përjetësisë, kurse ti mbete në këtë vendbanim në zi!

Ç'lumturi për atë që u hodh nga ky vend e doli, sepse më në fund, vdekja e shemb dhe e bën gërmadhë këtë vendbanim!

Ngrihu dhe eja, o Belkize, dhe qoftë edhe një herë të vetme shihe vendbanimin e sovranëve të fesë!

Në dukje, ata ngasin devetë me këngë mes miqve, por, në botën e brendshme, janë ulur në trëndafilishte ku dëfrehen e kënaqen!

Kopshti shkon pas tyre ku të shkojnë ata, por kjo është e fshehur nga njerëzit!

Frutat luten: "Na vilni, na mblidhni!.." Uji jetëdhënës lutet: "Pini prej meje!.."

Eja dhe përsillu pa flatra nëpër qiell, si dielli, si hëna e plotë, si hëna e re!..

Sa të fillosh të ecësh, do të ecësh si shpirt, pa këmbë... Do të hash qindra gjellë pa ia hyrë mundimit për t'i përtypur!

As krokodili i shqetësimit përplaset në gjeminë tënde, as keqësohesh nga vdekja!

Bëhesh edhe sovran, edhe ushtar, edhe fron... Edhe meriton një fat të mirë, edhe bëhesh vetë fat i mirë!

Por ç'dobi do të kishe nga fati i mirë në dukje, nga mbretërimi në dukje? Këto janë të tjetërkujt, prandaj vjen një ditë që ndërrojnë!

Dhe, atëherë, ti bie në gjendje nevojëtarie si të varfërit! O njeri i zgjedhur, bëhu fat, bëhu pushtet!

O burrë shpirtëror, po të bëhesh vetë fat i mirë, si mund të ndodhë ta humbësh atë?

O njeri me shprehi të mira, po të bëhesh vetë mall e pasuri për veten tënde, si mund të ndodhë që t'i humbësh ato? A është e mundur kjo?

Sulejmani (a.s.) e ndërton Faltoren Aksa në bazë të urtësive që i dinte Zoti, dhe e ndihmojnë hapur engjëjt dhe xhindët, shejtanët dhe njerëzit.

O Sulejman, ndërtoje faltoren Aksa se populli i Belkizes erdhi për namaz!

Me të filluar Sulejmani ngritjen e faltores, xhindët dhe njerëzit, të gjithë iu futën punës.

Një pjesë iu fut punës me dëshirë dhe pasion, kurse një pjesë tjetër, pa dëshirë. Krejt siç ndodh në zbatimin e urdhrave të Zotit nga njerëzit, në adhurimet e tyre!

Edhe njerëzit u ngjajnë xhindëve. Epshi është zinxhir që i tërheq ata në dyqan, shitblerje, prodhim dhe ushqim!

Ky zinxhir është i përbërë prej frikës dhe hutimit. Mos e pandeh popullin pa zinxhirë dhe të lirë!

Një pjesë e tërheq në fitim, në gjah. Një pjesë tjetër e zvarrit për në miniera, për në detra!

I shtyn ata në të mirë e në të keqe. Zoti ka thënë: "Në qafë të tyre ka një litar të thurur prej fijesh...

U hodhëm atyre në qafë një litar... Atë litar e thurëm dhe e bëmë prej shprehive dhe veseve të tyre...

Nuk ka asnjë njeri të ndyrë e të keq ose të pastër e të mirë që të mos e ketë të varur në qafë librin e punëve!"

Ambicja jote për punë të keqe i ngjan zjarrit... Qymyri zbukurohet me ngjyrën e zjarrit.

E zeza e qymyrit fshihet te zjarri. Kur shuhet zjarri, e zeza del në shesh!

Qymyri u bë zjarr, u duk në formë zjarri nga ambicja jote... Por kur të kalon ambicja, qymyri mbetet i zi, në gjendje të keqe!

Atëherë, dukja e qymyrit si zjarr nuk ishte rrjedhojë e bukurisë së punës, por e zjarrit të ambicjes!

Ambicja kishte stolisur forcën dhe punën tënde. Me të të ikur ambicja, forca dhe puna jote mbetën sterrë të zeza!

Njeriu kokëtrashë e pandeh të bërë e të mirë barin e thartë të stolisur nga shejtani,

Por sapo ta provojë, e kupton se ç'është, i mpihen dhëmbët!

Për shkak të dëshirës, laku duket si kafshatë. Në fakt, ajo është diçka e pangrënshme, por reflektimi i shejtanit të dëshirës e tregon të mirë atë.

Ambicjen kërkoje në punët e fesë dhe në dobi, bëhu i pangopur në punët e fesë dhe në bamirësitë! Vetë këto punë janë të mira e të bukura. Edhe sikur të të kalojë ambicja, duken të mira e të bukura!

Punët e mira e të dobishme, bamirësitë janë të mira e të hijshme në thelb, nuk duken të bukura me anë të reflektimit të diçkaje tjetër. Në këto punë, edhe sikur shkëlqimi i ambicjes të kalojë, hijeshia dhe shkëlqimi i të mirës mbeten.

Kurse sapo të kalojë shkëlqimi i ambicjes në punët e interesave të kësaj bote, do të thotë se nxehtësia dhe shkëlqimi i zjarrit kanë kaluar dhe ka mbetur qymyri... Ja, kështu!

Edhe fëmijët ambicja i mashtron dhe, nga kënaqësia, e bëjnë shkopin si kalë, i përveshin rrobat dhe ia shalojnë!

Por kur u kalon ambicja, fëmijëve u vjen për të qeshur!

Dhe thonë duke buzëqeshur me vete: "Ç'bëra unë? Nga ambicja, uthulla m'u duk mjaltë!.."

Edhe në bëmat e pejgamberëve s'ka pasur ambicje. Prandaj shkëlqenin nga koka në këmbët, u shtohej shkëlqimi!

Njerëzit e mëdhenj ngritën shumë faltore, por asnjëra prej tyre s'e pati emrin "Faltorja Aksa"!

Lartësia sublime e Qabes që shtohet çdo çast, është rrjedhojë e principialitetit dhe sinqeritetit të Ibrahimit.

Vlerat dhe virtytet e asaj faltoreje nuk janë rrjedhojë e gurit dhe baltës së saj, sepse tek ndërtuesi i saj nuk kishte ambicje dhe luftë!

As librat e tyre u ngjasin librave të të tjerëve, as faltoret e tyre, faltoreve të të tjerëve, as dhënie-marrjet, mallrat dhe pasuritë, dhënie-marrjeve, mallrave dhe pasurive të të tjerëve!

As edukata e tyre është si edukata e të tjerëve, as zemërimi i tyre si zemërimi i të tjerëve. Edhe gjumin e kanë ndryshe, edhe krahasimin, edhe fjalët!

Secili ka një bukuri dhe dritë tjetër... Zogu i zemrës u fluturon, por u fluturon me flatra të tjera!

Kur zemra e kujton gjendjen e tyre, dridhet... Punët e tyre janë kible, pikë orientuese për punët tona!

Vezët e zogjve të tyre janë prej floriri. Shpirtrat e tyre shohin në mesnatë kohën e zbardhjes!

Sado që ta them me gjithë zemër mirësinë e atij fisi, e kam thënë mangët, i kam lavdëruar mangët ata!

O ju të mëdhenj, bëni faltore Aksa, sepse Sulejmani erdhi përsëri!

Po të ketë nga ata që u dalin para këtyre divave, këtyre perrive, të gjithë engjëjt i kapin e i lidhin!

Po qe se divi ia hyn qoftë edhe për një çast dredhisë dhe mashtrimit dhe ecën shtrembër, menjëherë i bie mbi kokë një kamxhik si vetëtimë!

Edhe ti ngjaji Sulejmanit, në mënyrë që divat të të ndihmojnë në ndërtim, të të presin gurë!

Bëhu si Sulejmani pa lëkundje, dyshime e dredhi, në mënyrë që xhindët dhe divat t'i nënshtrohen edhe urdhrit tënd!

Kjo zemër është vula jote... Mblidhi mendtë në kokë, në mënyrë që divi të mos ta gjuajë vulën!

Po ta gjuajti, po ta shtiu në dorë, atëherë bëhet fund e krye Sulejman për ty... Ruhu nga divi me vulë!

Zemra, cilësia prej Sulejmani nuk është diçka kalimtare. Ti ke aftësi të bësh Sulejmanllëk edhe në dukje dhe kjo aftësi ndodhet edhe brenda teje!

Ndodh që edhe divi të bëjë Sulejmanllëk, por si mund të endë atllas çdo endës?

I luan duart, por sa ndryshim ka mes të dyve!

Mirësia e padishahut për poetin; veziri i quajtur Ebulhasan e shton atë mirësi.

Një poet shkroi një poezi me shpresë për të marrë nga padishahu veshje, pozitë, mirësi, dhe ia dërgoi.

Padishahu ishte bujar; ai urdhëroi që poetit t'i jepeshin një mijë florinj të kuq dhe dhurata të tjera.

Veziri i tha: "Kaq është shumë pak. Të paktën jepi dhjetë mijë florinj dhe lëre të shkojë!

Madje, edhe dhjetë mijë florinj janë pak për një padishah si ti që, në mirëbërësi, i ngjan detit!"

Veziri i tregoi ngjarje mbi mirësitë e padishahëve të shkuar të cilët i jepnin poetit një të dhjetën e lëmit, foli për urtësitë e tyre.

Dhe padishahu i dha poetit dhjetë mijë florinj bashkë me rroba të çmuara duke e shndërruar zemrën e poetit në vend falenderimi dhe lavdërimi!

Më pas, poeti hetoi se me përpjekjet e kujt ndodhi kjo, se kush ia bëri të ditur padishahut aftësinë e tij si poet!

I thanë: "A e njeh vezirin që e ka emrin Hasan dhe shprehitë Hasen (të bukura)? Ja, ai u bë shkaktar për këtë!"

Kur e dëgjoi këtë, poeti e lavdëroi shumë vezirin, shkroi një kaside të gjatë me këtë temë, shkoi në shtëpinë e vezirit dhe ia paraqiti.

Në kaside nuk kishte asnjë lavdërim për padishahun sepse vetë dhuratat vazhdonin ta lavdëronin atë pa gojë e pa buzë!

Poeti vjen përsëri disa vjet më vonë
me shpresën për të marrë të njëjtat të mira
dhe padishahu, sipas zakonit, urdhëron t'i jepen
një mijë dinarë; ndërkaq, veziri i ri i quajtur edhe ai
Ebulhasan, thotë:
"Kemi shumë shpenzime, thesari është i zbrazët,
kurse unë e bëj të kënaqur atë
me një të dhjetën e kësaj dhurate"!

Pas disa vjetësh, poeti ra përsëri në varfëri, u bë nevojëtar. Me shpresën për t'u furnizuar, për të marrë para për ushqime,

Tha: "Eshtë më mirë që, në kohë ngushtice, të kërkosh gjënë e provuar, t'i drejtohesh asaj...

Të shkoj te porta që e kam provuar për bujari dhe mirësi dhe t'ia paraqes nevojën..."

Duke e shpjeguar kuptimin e fjalës "Allah", Sibevejhi ka thënë: "Populli mbështetet te Ai në kohë nevoje...

Nevojat tona t'i paraqesim ty, tek ti mbështetemi! Kërkesat i lusim prej teje dhe i gjejmë tek ti!"

Me mijëra njerëz të mençur, në kohë mjerimi dhe nevoje, qajnë e rënkojnë së bashku para atij Zoti të vetëm!

Nuk ka asnjë mendjengushtë e të marrë që t'ia paraqesë dobësinë një dorështrënguari!

Po qe se të mençurit nuk do ta shihnin mijëra herë plotësimin e nevojave të tyre, a do të shkonin me gjithë dëshirë në atë tempull?

Madje as të gjithë peshqit mes dallgëve të detit, të gjithë zogjtë që fluturojnë në lartësi...

Elefanti, ujku, luani i gjuajtur, kuçedra e madhe, milingona, gjarpri...

Madje, dheu, uji, era dhe çdo shkëndijë, prej tij e marrin atë që dëshirojnë edhe dimrit, edhe verës!

Kjo faqe e qiellit i lutet atij çdo çast që të mos e ulë poshtë, të mos e poshtërojë...

Dhe i thotë: "Shtylla ime është mbrojtja jote... Të gjithë qiejt janë mbledhur e hapur në dorën tënde të djathtë..."

Toka i lutet: "Ti je që më ke ngarkuar mua mbi ujë; mos ma merr qëndrueshmërinë prej dore!"

Të gjithë i kanë mbushur qeset me dhuntinë e tij, të gjithë e kanë mësuar prej tij të japin nevojëtari!

Çdo pejgamber ka sjellë prej tij ferman: "Kërkoni ndihmë prej tij në durim dhe namaz"!

Ejani në vete, prej tij kërkoni, jo prej dikujt tjetër. Ujin në det kërkojeni, jo në përroin e tharë!

Edhe gjënë e kërkuar prej dikujt tjetër ai e jep. Eshtë prapë Allahu që ia fal bujarinë dorës së atij personi që priret ndaj teje!

E mbyt në florinj edhe atë që shmanget t'i bindet; po ta bëjë Karuni, t'i bindesh atij e të kthesh fytyrën nga ai, çfarë nuk bën?

Poeti e ktheu fytyrën edhe një herë tjetër nga ai padishahu mirëbërës me dëshirën për të marrë dhuratë.

Ç'do të ishte dhurata e poetit? Një vjershë e re... Atë ia çon mirëbërësit, ia paraqet dhe, pothuaj, e lë peng!

Mirëbërësit, me bujari të madhe, grumbullojnë flori dhe presin poetët.

Sipas tyre, një vjershë është më e mirë se njëqind topa basme... Sidomos po të jetë vjersha e një poeti që zhytet në det dhe nxjerr nga fundi i tij margaritarë!

Njeriu në fillim është i uritur për bukë, sepse buka dhe uji janë shtylla e jetës.

E merr shpirtin në pëllëmbë dhe me shpresë e me qindra mashtrime lufton për ta fituar bukën.

Por kur arrin diçka të pakët dhe s'i mbetet nevojë për të punuar, atëherë jepet me pasion pas popullaritetit, emrit dhe famës dhe lavdërimit të poetëve.

Dëshiron që ata t'ia lavdërojnë origjinën dhe pasardhësit, të ngrenë katedra për të treguar për favoret dhe mirësitë e tij!

Në këtë mënyrë, favori, mirësia, dhuratat e tij prej floriri të kundërmojnë si parfum mes fjalëve!

Zoti na e krijoi shprehinë tonë në përshtatje me shprehinë e tij, sipas trajtës së tij; edhe cilësia jonë është një shembull nga cilësia e tij.

Edhe Zoti krijues kërkon ta felenderojnë dhe lavdërojnë. Prandaj edhe shprehia e njeriut është e tillë; edhe ai kërkon ta lavdërojnë.

Sidomos njeriu i Zotit, epror në vlera dhe virtyte, është i mbushur me atë fllad si calik i shëndoshë!

Por nëse njeriu nuk është i denjë për atë lavdërim, nuk e meriton atë lavdërim, flladi i rremë nuk bën dobi... E plas dhe e shqyen calikun!

Këtë krahasim nuk po e bëj nga vetja, o shok; në i paç mendtë në kokë dhe në qofsh i aftë për të kuptuar, mos e dëgjo me shpërfillje!

Këtë e tha Pejgamberi pasi dëgjoi satirat e drejtuara kundër tij dhe thënien e politeistëve: "Pse i pëlqejnë lavdërimet Ahmedit, pse mbetet i kënaqur nga lavdërimet?"

Poeti e mori poezinë që shkroi për padishahun si falenderim për mirësinë e parë të tij dhe ia paraqiti.

Mirëbërësit vdiqën, mirësitë u mbetën. Ç'lumturi për atë person që ngau këtë gomar!

Edhe mizorët vdiqën e shkuan, por padrejtësitë dhe mizoritë u mbetën... Mjerë për atë shpirt që bëri keq!

Pejgamberi ka thënë: "Ç'lumturi për atë njeri që vetë iku nga kjo botë, por nga ai mbeti një punë e mirë!"

Mirëbërësi vdiq, por mirësia e tij s'vdiq! Para Zotit, feja dhe mirësia nuk janë gjë e vogël dhe pa vlerë!

Mjerë për atë njeri që vetë vdiq duke lënë pas mohimin dhe të keqen! Kurrë mos pandeh se vdiq dhe shpëtoi!

Lëre tani këtë! Poeti ndodhet në rrugë, është borxhli dhe ka nevojë shumë për para!

Poeti ia çoi dhe ia paraqiti padishahut poezinë që e shkroi me shpresën për të merituar sërish mirësinë e mëparshme.

Poeti ia paraqiti padishahut atë poezi të bukur e të hijshme, të mbushur plot perla, me shpresën e mirësive dhe dhuratave të para.

Ishte zakon i padishahut të jepte dhurata dhe, sipas këtij zakoni, tha që t4i jepeshin një mijë florinj.

Por këtë radhë nuk ishte më ai veziri i mëparshëm i cili kishte mërguar në botën tjetër!

Në vend të ishte bërë vezir dikush tjetër. Ky tjetri ishte shumë i pamëshirshëm, shumë dorështrënguar!

Ai tha: "Padishahu im! Kemi shpenzime! Nuk është i denjë një poet për t'i bërë një dhuratë kaq të madhe!

Unë e lë të kënaqur atë poet me çerekun e një të dhjetës së kësaj shume!"

Ata që ndodheshin të pranishëm aty, thanë: "Ai pati marrë më parë dhjetë mijë florinj nga padishahu.

Pasi të ketë ngrënë sheqer, si do ta përtypë kallamin e sheqerit? Si do të bëhet si lypës para padishahut?"

Veziri tha: "Unë e shtrëngoj në atë mënyrë, që, më në fund, të mërzitet nga pritja...

Sikur edhe të marr e t'i jap dhé, e rrëmben sikur t'i kisha dhënë fletë trëndafili!

Lërmani mua këtë. Unë jam mjeshtër në këtë punë! Edhe sikur zjarr të bjerë, unë di ta shuaj!

Edhe sikur të fluturojë nga ylli i Plejadës për në pallat, me të më parë mua, zbutet!"

Padishahu i tha: "Mirë... Bëj ç'të duash! Vetëm gëzoje atë sepse bën fjalë për mirësinë tonë!"

Veziri tha: "Ti lërmi mua edhe atë, edhe dyqind vetë të tjerë që presin me shpresë!"

Dhe veziri e bëri poetin të presë. Iku dimri dhe erdhi pranvera!

Prit e prit, poeti u plak. Iu ndrydh zemra nga vuajtja e kësaj pritjeje!

Dhe i tha vetes: "T'u bëfsha kurban! Po të mos ketë florinj, të paktën shaj dhe ma shpëto jetën!"

Kjo pritje më vdiq; të paktën shko dhe të më shpëtojë shpirti nga mbetja peng!"

Më në fund, veziri i dha poetit aq sa pati thënë, vetëm njëzet e pesë florinj! Poeti ra në mendime të thella!

Dhe tha me vete: "Dhurata e parë jo vetëm ishte peshin, por edhe aq e madhe! Kurse kjo edhe u hap vonë, edhe kur u hap, e pashë se ishin një tufë gjemba!"

Poetit i thanë: "Ai veziri bujar iku nga kjo botë, Zoti e mëshiroftë!

Për shkak të tij, mirësitë qenë shtuar kat më kat. Në kohën e tij bëheshin shumë pak gabime në mirëbërësi!

Tani ai shkoi duke marrë me vete edhe mirësinë. Më saktë, s'vdiq ai, por bujaria dhe mirësia!

Ai vezir i mençur e bujar iku dhe në vend të tij mbiu ky vezir që ua rrjep lëkurën të varfërve!

Merri këto dhe ik që sonte prej këtu, ndryshe ky inatçi të kap dhe t'i merr prej dore edhe ato që t'i ka dhënë!

Ti nuk di gjë për përpjekjet tona! Ne bëmë qindra hile pa e morëm këtë dhuratë prej tij!"

Poeti iu kthye atyre dhe i pyeti: "O mirëbërësit e mi, nga erdhi ky vezir i keq?

Më thoni, si e ka emrin ky vezir që zhvesh njerëzit?" Ata i thanë: "E quajnë Hasan!"

Atëherë, poeti tha: "O Zot i madh! Edhe atë e quanin Hasan, edhe këtë! Turp e për faqe të zezë! Si ndodh që të dy të kenë të njëjtin emër?

E quanin Hasan... Por me një shkrimin e tij, qindra njerëz bujarë mund të bëheshin vezirë dhe ndihmës së padishahut!

Edhe ky e paska emrin Hasan! Por nga mjekra e shëmtuar e këtij Hasani mund të thurësh qindra rripa!

Po t'ia vërë veshin fjalës së një veziri të tillë, padishahu e turpëron edhe veten, edhe shtetin!"

Opinioni i keq i këtij veziri të ulët që donte ta prishte burrërinë e padishahut, i përngjet opinionit dhe masave të vezirit Haman që prishi aftësitë e Faraonit.

Duke ia dëgjuar fjalët Musait, sa herë u zbut Faraoni, u nënshtrua!

Fjalët e Musait ishin të tilla që po ta dëgjonte guri bukurinë e tyre të pashoqe, do të pikonte qumësht!

Por kur takohej dhe këshillohej me të veziri i tij, Haman, i mbushur plot me vesin e urrejtjes, i thoshte:

"Gjer tani ishe sovran! A mos tani u mashtrove nga dikush që vesh pelerinë të grisur dhe u bëre rob?"

Kjo fjalë i vinte Faraonit si gur i hedhur nga katapulta dhe ia thyente pallatin e tij prej qelqi!

Atë që përpiqej dhe arrinte Bashkëbiseduesi i Zotit, Musai, për njëqind ditë, ai e shembte brenda një çasti!

Edhe mendja jote është vezir dhe e mposhtur nga dëshirat dhe pasionet. Edhe trupi yt rri e ta pret rrugën për tek Zoti!

Po të të japë këshillë një këshillues i Zotit, ia heq ndikimin asaj këshille me një dredhi!

Dhe të thotë: "Kjo nuk është fjalë me vend, pra, eja në vete dhe mos e humb atdheun, vatrën e shtëpinë! Puna nuk është ashtu, pra, eja në vete dhe mos u marros!"

Mjerë për atë padishah që ka një vezir të tillë! Vendi i të dyve është xhehennemi që ushqen urrejtje!

Dhe ç'lumturi për atë padishah që, po të bjerë në vështirësi, ka një vezir si Asafi që e mban për dore!

Pasi padishahu i drejtë të bëhet shok me Asafin, emri i bëhet "dritë mbi dritë"!

Po qe se padishahu bëhet Sulejman dhe veziri i tij, Asaf, bëhet dritë mbi dritë, qelibar mbi qelibar!

Por po qe se padishahu bëhet faraon dhe veziri i tij, Haman, që të dy nuk ikin dot nga fati i keq, por i zë e keqja e i shkatërron!

Dhe bien në errësira mbi errësira dhe as arsyeja u bëhet mik, as ditën e kiametit shpëtojnë nga fati i lig!

Unë nuk kam parë tek të këqinjtë gjë tjetër veç së keqes... Nëse ti ke parë, thuaj dhe jepu të fala me shëndet!

Padishahu i ngjet shpirtit dhe veziri, mendjes. Mendja ngatërrestare e çon shpirtin në të këqija!

Kur engjëlli i mendjes të bëhet Harut, u mëson magji qindra personave të këqinj!

Arsyen e Pjesshme mos e bëj vezir për vete; Arsyen e Përgjithshme bëje vezir, sundimtari im!

Mos i bëj vezir dëshirat dhe pasionet, në mënyrë që shpirti yt i pastër të mos mbetet pa namaz e pa lutje!

Sepse dëshirat dhe pasionet janë të mbushura me ambicje dhe e shohin në ç'gjendje ndodhesh. Kurse arsyeja e mendjes është arsyeja e ditës së fesë!

Sytë e mendjes e të arsyes vëzhgojnë fundin e punës. Mendja vuan e mundohet nga gjembat vetëm për një trëndafil!

Por ai trëndafil është një trëndafil i tillë që as vyshket, as derdhet në vjeshtë. Qoftë larg prej tij hunda e kujtdo që nuk nuhat dot aromë!

Divi ulet në postin e Sulejmanit (a.s.) dhe bën veprime e punë të ngjashme me veprimet dhe punët e Sulejmanit (a.s.); dallimi që duket dhe qëndron mes tyre; divi i vë vetes emrin Sulejmani i biri i Daudit.

Nëse ke mendje, bëhu mik me një mendje tjetër dhe këshillohu me të!

Me dy mendje shpëton nga shumë ngatërresa e kokëçarje dhe e vë këmbën gjer në majë të qiejve!

Divi i ngjiti vetes emrin Sulejman, futi në dorë pushtet dhe e vuri vendin nën sundim.

Ai e kishte parë si vepronte Sulejmani, pra, vepronte si ai, megjithëkëtë, cilësia e tij prej divi i shfaqej nga bota e brendshme në fytyrë dhe dukej qartë se ishte div!

Populli thoshte se tek ky Sulejman nuk ishte ajo pastërti dhe hijeshi dhe se mes dy Sulejmanëve kishte dallime.

I pari i ngjante zgjimit, kurse ky ishte si një gjumë i thellë. Mes të dyve kishte një ndryshim të madh si mes Hesenit të parë e të dytë!

Kurse divi thoshte: "Zoti ka krijuar në trajtën time një div të bukur.

Ai ia ka dhënë trajtën time një divi, prandaj kurrsesi të mos ju mashtrojë ai!

Po qe se del në shesh dhe pretendon si unë se është Sulejman, kurrsesi mos i jepni vlerë tratës së tij!"

Divi ua thoshte atyre këto fjalë me hile, por në zemrën e njerëzve të mirë dukej e kundërta e kësaj.

Nuk bëhet lojë me njeriun që e dallon të mirën nga e keqja, sidomos kur kjo aftësi dalluese dhe mendja e tij e shihnin dhe e tregonin të fshehtën!

Asnjë magji, asnjë mashtrim dhe djallëzi nuk mund të varë perde para zemrës së njerëzve të zgjedhur!

Ata thoshin me vete: "Ah ti, fjalështrembër, ti ecën në të kundërt...

Duke ecur e duke ecur kështu, përsëmbrapthi, ke për të shkuar gjer në fund të xhehennemit!

Sulejmani mbeti i varfër, por hëna e plotë vazhdoi të ndriçojë në ballin e tij!

Fundi i fundit, ti ke rrëmbyer një unazë, por prapë je si një xhehennem që ka ngrirë si mesi i dimrit!

Po ne, ku jemi? Ku është sexhdeja para madhështisë dhe rrënjës? Jo vetëm që s'vëmë kokën në tokë para gjërave të tilla, por s'vëmë as thoin e egërsirës!

Për më tepër, po të harrojmë e ta vëmë ballin në tokë, vjen një kthetër, na e shtyn kokën tutje dhe na bëhet pengesë!

Mos iu gjunjëzoni këtij njeriu të poshtër, ejani në vete! Mos i bëni sexhde këtij njeriu të pavlerë!"

Unë do të ngrihesha ta tregoja këtë histori që i jep jetë jetës, por po të mos ishte përpjekja e Zotit!

Kënaqu me kaq, pranoje këtë dhe një herë tjetër të ta tregoj!

Divi ia ngjiti vetes emrin pejgamberi Sulejman, por vetëm për të gënjyer fëmijët!

Lëre trajtën dhe emrin e të pandershmit! Ik nga emri e llagapi dhe vrapo pas kuptimit!

Dhe pyet për gjendjen dhe punët e tij dhe kërkoje atë në gjendjen dhe punën e tij!

Pas përfundimit të Faltores Aksa,
Sulejmani (a.s.) shkon çdo ditë në faltore
me qëllim për të bërë adhurim
dhe për t'i orientuar ata që bënin adhurim
dhe hynin në itikaf;
në faltore mbijnë barëra dhe rrënjë.

Çdo mëngjes, Sulejmani shkonte në faltoren Aksa dhe i falej Zotit me sinqeritet të plotë!

Çdo ditë shihte se në faltore kishte mbirë një bar i ri dhe e pyeste se si e kishte emrin,

Se ç'lloj ilaçi ishte, si i thoshin, kujt i bënte dëm e kujt, dobi.

Çdo bar bëhej me gojë, ia tregonte emrin dhe veprimin dhe i thoshte: "Për këtë jam jetë, e për atë, helm; helmi im për këtë është sheqer për atë. Emri im në tabelën e fatit është kështu..."

Mjekët e mësonin emrin e atij bari nga Sulejmani, përvetësonin njohuri dhe bënin siç u thoshte ai.

Në këtë mënyrë, hartuan libra të mjekësisë dhe i shpëtuan trupat nga sëmundjet.

Këto njohuri astrologjike dhe mjekësore janë mesazhet hyjnore që u vijnë pejgamberëve. Ndryshe, ç'punë do të kishte me këtë anë mendja dhe ndjenja?

Mendja e Pjesshme nuk është mendje që mund të nxjerrë konkluzion nga çdo gjë. Ajo vetëm sa e pranon shkencën nga shkencëtari, është nevojtare për të mësuar prej tij!

Kjo mendje ka aftësi për të mësuar dhe kuptuar, por atë e mëson ai që zotëron mesazhin hyjnor!

Nuk ka dyshim se të gjitha artet dalin në shesh në fillim nga mesazhi hyjnor, pastaj mendja shton diçka mbi to.

Bëj kujdes dhe shih! Mendja jonë, a mund ta mësojë ndonjë art pa pasur mjeshtër?

Ajo e pjesëton qimen në dyzet pjesë, por asnjë art dhe mjeshtëri nuk e fiton dot pa mjeshtër!

Po qe se dija e artit dhe mjeshtërive do të ekzistonte me këtë mendje, artet dhe mjeshtëritë do të dilnin në shesh pa artist dhe mjeshtër!

Ndërsa në botë nuk kishte varr
dhe nuk njihej hapja e varreve,
Kabili e mësoi nga sorra ç'është varri
dhe sesi hapet varri.

Gërrmimi i varrit, mjeshtëria më e thjeshtë. S'është diçka që do të duhej të lindte nga mendimi i thellë dhe rregulli!

Por po qe se te Kabili do të kishte kaq arsye, a do ta bartte Habilin me vete?

A do të thoshte "ç'do ta bëj këtë të vdekur të përzjerë me gjak dhe dhé, si ta zhduk?"

Ndërkaq, pa një sorrë që kishte marrë në gojë një sorrë të ngordhur e po vinte.

Sorra zbriti në tokë dhe, për t'ia mësuar Kabilit hapjen e varrit, filloi ta gërrmonte tokën...

Hapi shpejt e shpejt një gropë dhe e futi atje sorrën e ngordhur.

Pastaj e mbuloi me dhé. Kështu e kishte mësuar këtë gjë sorra me anë të frymëzimit hyjnor.

Kur e pa këtë, Kabili e shau mendjen e vet. Ai tha me vete: "Edhe një sorrë qenka më e mençme se unë!"

Zoti e quajti Mendjen e Përgjithshme "sheh në mazgallë", kurse Mendja e Pjesshme rri duke parë nga të gjitha anët.

Drita e njerëzve të vërtetë është mendja që sheh në mazgallë, kurse mendja e sorrës ishte mjeshtre për t'u hapur varr të vdekurve!

Sorra e çon, më në fund, në varr shpirtin që vrapon pas saj!

Eja në vete dhe mos vrapo pas sorrës nefsit i cili i ngjet sorrës! Sepse ai të çon në varr, jo në kopësht e vreshtë!

Po qe se do të ecësh, shko pas feniksit të zemrës dhe arri te mali i përrallave, te faltorja Aksa e zemrës!

Me sevdanë tënde, në faltoren tënde Aksa mbin një bar i ri, një rrënjë e re për çdo çast!

Si Sulejmani, edhe ti shihi me vëmendje ato. Vëzhgoji ato dhe mos i shkel me këmbë!

Sepse gjendjen e kësaj toke ta mësojnë ty barërat llojelloje!

A ka mbirë kallam sheqeri, apo kallam i thjeshtë? Çdo bar i mbirë të njofton për gjendjen dhe mundësitë e tokës ku ka mbirë!

Edhe nga zemra mbijnë ide, edhe bimësia e zemrës janë idetë. Këto ide të tregojnë ty të fshehtat e zemrës.

Po të gjej në kuvend burrë që të më bëjë të flas, bëj të mbijnë qindramijëra trëndafilë si të isha dhé pjellor.

Por, duke thënë fjalë, të jetë një pezevenk që vret vetet, idetë e zemrës ikin si hajdutë.

Çdo njeri ndodhet në atë anë nga e tërheq veprimi i vet. Tërheqja e njeriut të drejtë nuk i ngjan tërheqjes së gënjeshtarit.

Ti herë ecën si mëkatar, herë si njeri që e ka gjetur rrugën e drejtë. As litari që të heq zvarrë ty është në shesh, as njeriu që të tërheq!

Ti i ngjet një deveje qorre. Litari i lidhur pas qafe të tërheq për diku, por ti mos shih litarin, por njeriun!

Po t'i shihje tërheqësin dhe litarin, kjo botë nuk do të bëhej për ty vend gënjimi.

A do të bëhej qafiri (mohuesi) maskara në dorë të Shejtanit të fuqishëm po të shihte se ai shkon pas qenit?

A do të vraponte pas tij si një i pandershëm? Menjëherë do ta hiqte këmbën dhe do të shpëtonte!

Po ta dinte lopa se ç'do t'i bënin kasapët, a do të ecte, a do të shkonte në dyqan pas tyre?

Ose, a do të hante krunde nga dora e tyre? Ose, a do të gënjehej nga fytyra e qeshur e tyre, a do t'u jepte qumësht atyre?

Për më tepër, po ta dinte se pse hante bar dhe ushqehej, a do të mund ta treste atë bar?

Prandaj, shtylla e kësaj bote është mosnjohja, indiferentizmi. Dhe e gjithë jeta përbëhet nga vrapimi dhe dajaku!

Një herë vrapo, pastaj ha dajak! Në këtë vend gërmadhë nuk ka gjë tjetër veç vdekjes duke vrapuar pas atij që ka pushtet!

Ti vë dorë në një punë dhe merresh seriozisht me të. Në atë çast, e meta dhe mangësia në atë punë janë të mbuluara për ty.

Meqë Zoti i ka mbuluar ato për ty, ti i futesh asaj pune me shpirt e me zemër!

Edhe e meta e idesë që ti e mbron me zjarr, është e fshehur prej teje.

Po qe se mangësia dhe e meta e asaj ideje do të ishte e njohur për ty, ti do të ikje prej saj. Dhe do të thoshe: "Sikur të isha larg nga kjo ide sa ç'janë larg perëndimi me lindjen!"

Më në fund, ti mërzitesh prej saj dhe pendohesh, apo jo! Po të ndodhte kjo më parë, a do të vrapoje pas saj?

Prandaj Zoti e ka fshehur që më parë të metën e asaj pune në mënyrë që ta kryejmë në përputhje me kazanë dhe kaderin.

Dhe kur kazaja dhe kaderi ta shfaqin vendimin e vet, sytë hapen dhe ia beh pendimi!

Ndërkaq, ky pendim është një kaza dhe kader më vete. Prandaj lëre këtë pendim dhe falju Zotit!

Po qe se do ta bësh zakon pendimin, gjatë gjithë kohës nuk bën tjetër veçse të pendohesh dhe, pastaj, të pendohesh më shumë për këtë pendim!

Dhe gjysma e jetës të kalon në pendim, kurse gjysma e tjetrës të shkatërrohet e të shkon kot në pendim!

Braktise këtë ide dhe këtë pendim dhe kërko një gjendje më të mirë, një mik më të mirë dhe një punë më të mirë!

Po s'pate një punë më të mirë në dorë, ç'të duhet pendimi? Ç'le pa bërë që pendohesh?

Po ta dish, e di se rruga e drejtë është adhurimi i Zotit. Por po s'e dite, si do ta dish se një gjë është e keqe?

Po s'e dite të mirën, nuk mund ta dish të keqen... O trim, e kundërta mund të shihet me të kundërtën!

Meqë je i dobët e i paaftë për ta braktisur këtë ide, atëherë je i dobët e i paaftë edhe për të mos bërë mëkat!

Dhe kur të jesh i dobët e i paaftë, pse duhet të pendohesh? Kërkoje ta mësosh se me vlerësimin e kujt është kjo dobësi dhe paaftësi!

Pa pasur një vlerësues në këtë botë, askush nuk do ta shihte dobësinë dhe as do të ndodhte një gjë e tillë! Kështu ta dish këtë!

Kështu, pra, ti je i panjoftuar për të metën e çdo dëshire për realizimin e së cilës përpiqesh! E meta e saj është e mbuluar për ty!

Po qe se e meta dhe mangësia e dëshirës tënde do të bëhej e dukshme ty, zemra do të të largohej menjëherë nga hetimi i saj!

Po qe se e meta dhe mangësia e asaj pune do të ishte e qartë për ty, askush nuk do të çonte dot te ajo punë edhe sikur të të tërhiqte zvarrë!

A nuk ka punë që ta kesh urryer? Pse e ke urryer? Sepse i ka dalë në shesh e meta dhe mangësia!

O Zot fjalëbukur që i njeh të fshehtat, mos e fshih prej nesh të metën dhe mangësinë e punëve!

Edhe punët e mira mos na i trego të këqija, në mënyrë që të kapemi pas tyre, që përpjekja të mos na shkojë kot, që zelli të mos na ftohet!

Sulejmani i lartë, siç e kishte zakon, shkonte në faltore në muzg.

Çdo ditë, siç e kishte zakon, kërkonte dhe shihte se ç'bimë e ç'rrënjë tjetër kishte mbirë.

Zemra ia shihte dhe njihte fshehtas me syrin e vet ato bimë dhe rrënjë të mbajtura fshehur nga populli.

Në trëndafilishte, sofiu vë kokën mes gjunjëve
dhe kridhet në vetëgjykim,
kurse miqtë i thonë ta ngrerë kokën
dhe ta sodisë lulishten,
të sodisë lulet dhe zogjtë
që janë vepër e mëshirës së Zotit.

Një sofi kishte hyrë në një vreshtë për t'u gëzuar dhe prehur dhe, siç e kanë zakon sofitë, e kishte vënë kokën mes gjunjëve

Dhe ishte kredhur në thellësitë e ekzistencës. Ndërkaq, një llafazan e zgjoi nga gjumi

Dhe i tha: "Pse po fle, or ti? Ngrije kokën dhe vështroji bistakët e rrushit, këto pemë e bimë, vepra të Zotit!

Dhe dëgjoje urdhrin e Zotit i cili ka thënë: "Shihni veprat e mëshirës së Zotit!" Pra, ktheje fytyrën nga veprat e mëshirës së Zotit e sodit!"

Sofiu tha: "O i dëshiruar, vepra e Zotit është zemra, kurse ato jashtë janë vetëm vepra e veprës së Zotit!

Vreshtat, kopshtet, gjelbërimet janë në zemër, kurse ato jashtë u ngjajnë reflektimeve që bien mbi ujëvarë!

Vreshta që duket është një vreshtë imagjinare e reflektuar në ujë që lodron mbi të për shkak të sipërfaqes pasqyrore dhe tejdukshmërisë së ujit!

Vreshtat, kopshtet dhe frutat janë në zemër. Reflektimi i hijeshisë së tyre ka rënë mbi këtë ujë e mbi këtë tokë!

Po të mos ishte reflektimi i asaj selvisë së gëzimit, Zoti nuk do t'i thoshte kësaj bote vend i zhgënjimit.

Zhgënjimi është ky: Kjo fantazi është prodhuar nga reflektimi i zemrave dhe shpirtrave të njerëzve të lartësuar në nivel shpirtëror.

Të gjithë të zhgënjyerit kanë ardhur në këtë reflektim duke e pandehur për xhennet.

Kurse ata ikin nga vreshtat dhe kopshtet e vërtetë dhe mbeten duke u zbavitur me një fantazi!

Por kur ky gjumë indiferentizmi e mosnjohjeje t'u dalë e të zgjohen, e shohin të vërtetën, mirëpo atëherë s'bën më dobi!

Pastaj mbi varre ndehet një klithmë e një vajtim dhe ky zhgënjim zgjatet kështu gjer në kiamet!

Lumë për atë njeri që vdes ende pa vdekur, domethënë, që nuhat një aromë nga origjinali i këtij rrushi!

Në një buxhak të Faltores Aksa mbin çiçibanoz dhe Sulejmani (a.s.) bisedon me atë bimë; Sulejmani shqetësohet kur bima ia thotë dinjitetin dhe emrin.

Ndërkaq, Sulejmani vuri re se në një buxhak kishte mbirë një bimë e re që i ngjante kallirit.

Ishte një bimë e paparë, jeshile dhe e njomë fare. Ngjyra jeshile e saj t'i merrte sytë!

Sulejmani menjëherë e përshëndeti atë bimë dhe ajo iu përgjigj. Sulejmani u shtang nga bukuria e asaj bime!

Dhe i tha: "Si e ke emrin? Thuaje, të shohim, pa gjuhë e pa buzë!" Bima iu përgjigj: "O sovran i botës, mua më thonë çiçibanoz!"

Sulejmani e pyeti: "Ç'veçori ke ti?" Bima iu përgjigj: "Vendi ku mbij unë shembet, bëhet gërmadhë!

Unë jam çiçibanoz... Vendi ku mbij unë shkatërrohet; unë jam shkatërruesja e këtij uji dhe e këtij dheu!"

Sulejmani e kuptoi menjëherë se i kishte ardhur vdekja, se ishte dukur koha e mërgimit të tij!

Ai tha: "Sa të jem gjallë unë, s'ka dyshim se kjo faltore nuk shembet nga fatkeqësitë natyrore!

Si mund të ndodhë që, sa kur të jem gjallë unë, faltorja Aksa të shembet e të shkatërrohet?

Prandaj, nuk ka dyshim se faltorja ime do të shembet pas vdekjes sime!"

Faltorja si vendsexhdeje i trupit është zemra. Kurse miku i keq është çiçibanozi që mbin në çdo vend të faltores!

Kur tek ti të shfaqet dashuria për mikun e keq, mblidhe veten, ik prej tij, takohu pak e fol pak me të!

Dhe shkule atë me rrënjë, sepse, po mbiu dhe të lëshojë shtat, atëherë është ai që të shkul ty nga rrënjët dhe të shkatërron edhe ty, edhe faltoren tënde!

O ashik, shtrembëria është për ty si çiçibanoz. Ku po shkon e po zvarrisesh drejt shtrembërisë si fëmijët?

Dije fajtor veten, fajtor shihe! Mos ki frikë, në mënyrë që ai mjeshtër mësimdhënieje të mos ta vjedhë mësimin prej teje!

T'i thuash injorantit të të japë mësim, të zotërosh këtë maturi, është më mirë se të synosh për nder dhe dinjitet!

O fëmijë fytyrëdritë, mësoje nga yt atë të thuash: "Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes sonë!"

Ai as pretekste gjeti, as u ngrit të dredhojë, as flamurin e mashtrimit s'e ngriti lart.

Por Iblisi hyri në bast dhe i tha: "Fytyrën e ke të kuqe, ti më zverdhe mua...

Ngjyra është ngjyra që më dhe ti; ti je që më ke ngjyrosur mua. Edhe origjina e fajit tim je ti, edhe fatkeqësia që pësova, edhe mali që ngjita!

Eja në vete dhe lexoje "Zoti im, për shkak se më tërboi mua, ..." Lexoje dhe mos u bëj determinist, mos tento të endësh një copë nga e prapa!

Gjer kur do të ngjitesh në drurin e determinizmit duke e lënë vullnetin mënjanë?

Si Iblisi dhe soji e sorollopi i tij, je në debat dhe grindje me Zotin...

I përvesh rrobat e ashtu vrapon drejt kundërshtimit. A mund të bëhesh determinist me kaq kënaqësi e dëshirë?

Kush shkon drejt së keqes me kaq dëshirë? Kush vrapon drejt rrugës së shtrembër dhe mëkatit duke vallëzuar kështu?

Po të të japin këshilla të tjerët dhe të të thonë të mirën e asaj pune, ndoshta do të hyje në luftë me njëzet burra për këtë çështje, do të këmbëngulje para njëzet burrave!

Dhe do të thoje: "Kjo është e drejta... Rruga është kjo dhe e tillë; kush mund të më qortojë mua veç atij që s'është burrë?"

A flet kështu njeriu determinist? A lufton kështu personi që s'ka rrugë?

Ti ke vullnet për ato që t'i do nefsi, por tek gjëja që ta do mendja je i detyruar, je determinist, ë?

Kush është me fat e di se pretendimi për zgjuarsi është i Iblisit, djallit, kurse ashku, i Ademit!

Mendja dhe zgjuarsia i ngjajnë trapit të lundrimit, por pak vetë shpëtojnë nga lundrimi me trap në det; vjen dita që të mbytesh.

Lëre trapin, hiq dorë nga mendjemadhësia dhe urrejtja! Ky s'është lumë, por det, det!

Dhe është një det pa anë e pa breg që s'ka vend për strehim, që i rrëmben shtatë dete e i vërtit si fije kashte!

Ashku, pasioni hyjnor, i ngjan gjemisë për ata që përparojnë. Eshtë e rrallë që ai që hipën në gjemi, të pësojë fatkeqësi; në të shumtën e rasteve, shpëton!

Shiti mendjen dhe zgjuarsinë dhe merr mahnitjen... Mendja dhe zgjuarsia janë pandehje, kurse mahnitja është vështrim!

Bëje kurban mendjen para Mustafait dhe thuaj: "Hasbijallah, Allahu më mjafton mua!"

Mos u largo nga gjemia si Kenani. Edhe atij, krenarinë ia patën dhënë mendja dhe zgjuarsia, ato e patën gënjyer!

Ai tha: "Unë ngjitem mbi majën e një mali dhe shpëtoj, pse t'i jem mirënjohës Nuhut?"

O i pamend! si ndodh që të mos e durosh dot mirënjohjen ndaj tij? Edhe Zoti, madje, e duron mirënjohjen ndaj tij!

Si mund të ndodhë që shpirti të mos na jetë mirënjohës ndaj tij? Edhe Zoti, madje, e falenderon atë dhe i është mirënjohës ndaj tij!

O njeri krenar! Mirënjohjen ndaj tij edhe Zoti e duron!

Eh, sikur ai të mos dinte not, t'i ishte mirënjohës Nuhut dhe të ngutej për të hipur në gjemi!

Eh, sikur të ishte, si fëmijët, injorant për dredhira dhe, si fëmijët, t'ia hidhte duart s'ëmës, të kapej fort pas saj!

Ose të ishte i mbushur pak me dijeni hyjnore dhe zemra e tij ta rrëmbente dijen hyjnore nga një i urtë!

Ndërsa ekziston një dritë e tillë, e hap librin para dhe shpirti yt që prehet me anë të mesazhit hyjnor, të qorton ty!

Dije se përballë fjalës së njeriut më të shquar të kohës, dija e përcjellë i ngjan bërjes së tejemmumit ndërsa ka ujë!

Bëje veten si abdall, bëj sipas tij dhe ec... Vetëm me këtë abdallësi mund të shpëtosh!

Prandaj im atë, padishahu i njerëzve, ka thënë se "shumica e njerëzve të xhennetit janë abdallë"!

Mendja dhe zgjuarsia të japin ty mendjemadhësi dhe krenari. Bëhu abdall dhe zemra të të mbetet e drejtë!

Kjo që po e quaj abdallëk nuk është kokëtrashësia e njeriut dyfish maskara para popullit... Ky abdallëk është abdallëku i njeriut që është admiruesi i tij!

Ata që ia panë fytyrën Jusufit duke harruar veten e tyre dhe që, prandaj, prenë gishtërinjtë... Ja, ata janë abdallë!

Bëje kurban mendjen për dashuri të mikut! Të gjitha mendjet janë të kthyera në atë anë, tek Ai!

Të mençurit i kanë dërguar mendjet në atë anë, vetëm kokëtrashi që s'ka të dashur ka mbetur në këtë anë!

Kur të të ikë mendja prej kreje nga mahnitja, çdo fije floku bëhet një kokë, një mendje!

Në atë anë nuk ka mundim për mendjen, trurin, mendimin, sepse atje çdo fushë e çdo kopësht prodhon tru dhe mendje!

Nëse kalon nga kjo fushë e shkon në fushën e asaj ane, dëgjon fjalime... Po erdhe në vreshtat dhe kopshtet e atyshme, fidani i hurmës tënde ujitet e gjelbërohet!

Braktisi pallatin, shkëlqimin, emrin dhe famën e kësaj rruge... Gjersa kallauzi të të mos lëvizë, mos lëviz as ti!

Kush lëviz pa kokë, bëhet bisht. Lëvizja e njeriut të tillë i ngjet lëvizjes së akrepit.

Shkon shtrembër, netëve nuk sheh, është i shëmtuar, i helmuar... Gjithë përpjekja dhe puna e tij është t'i kafshojë e t'i fryjë trupat e pastër!

Shtypja kokën atij! Ky është vesi i tij, ky është gjithmonë morali i tij. Ai nuk heq dorë nga ky ves!

Prandaj, gjëja më e mirë është t'i shtypet koka. Në këtë mënyrë, edhe thërrimja e shpirtit shpëton nga ai trup!

Merre armën nga dora e të marrit dhe drejtësia e paqja të mbeten të kënaqur me ty!

Por nëse ke armë në dorë, por s'ke mend, lidhi duart, ndryshe, bëjnë qindra dëme!

Eshtë e keqe për veten e tyre kur personat me natyrë të keqe
bëhen zotërues dijeje, pasurie dhe pozite,
sepse kjo është njëlloj
sikur t'i japësh shpatë në dorë grabitësit dhe piratit.

T'i mësosh dije dhe shkencë njeriut me natyrë të keqe, është njëlloj sikur t'i japësh armë në dorë grabitësit që të pret rrugën!

T'i japësh shpatë në dorë zezakut të dehur është më mirë se ta bësh atë që s'është njeri, të mësojë njohuri përmendësh!

Dija, malli, pasuria, pozita dhe sundimi janë mjete intrige në dorë të personave me natyrë të keqe.

Lufta u është bërë detyrim besimtarëve me qëllim që t'ua heqin të çmendurve shpatat nga duart.

Shpirti i tij është i çmenduri, kurse trupi i tij, shpata që ka në duar. Merrja shpatën nga dora atij me vese dhe shprehi të këqija!

Të keqen e bërë nga posti që fusin në dorë të padituri, nuk ua bëjnë dot të paditurve qindra luanë të bërë bashkë!

Sepse, ndërsa e meta e tyre është e fshehtë, me anë të postit gjen shesh, e nxjerr gjarprin nga vrima dhe përhapet ngado.

Sapo injoranti të bëhet një sundimtar që zbaton vendime të këqija, e gjithë hapësira mbushet me gjarpërinj dhe akrepë!

Sapo që në dorë të atij që s'është njeri, kalon pasuri dhe post, është vetë ai që dëshiron turpërimin e vetes para se të dëshirojë turpërimin e të tjerëve!

Sepse ai, ose bëhet dorështrënguar dhe jep pak, ose bëhet dorëlirë dhe bën mirësira të pavend!

E vendos mbretin në kutinë e ushtarit... Kur kokëtrashi bën një të mirë, e mira e tij kësaj i përngjet!

Po qe se sundimi (urdhërimi) kalon në dorë të njeriut të mbrapshtë, ai e pandeh këtë si post, mirëpo, në të vërtetë, ka rënë në gropë!

Rrugën s'e di dhe ngrihet të bëhet kallauz... Shpirti i tij i keq i vë zjarrin botës!

Po qe se fëmija i rrugës së papasjes ia hyn prijësisë, ata që i shkojnë pas përballohen me lugatin e fatit të keq!

Të thotë "eja të ta tregoj hënën", mirëpo ai njeri i paqenë nuk e ka parë fare hënën!

Kur s'e ka parë kurrë në jetë as reflektimin e hënës në ujë, si mund të ta tregojë, ore torrollak?

Kokëtrashët u bënë krye, kurse të mençurit e fshehën kokën nën qilim!

Komenti i ajetit: "O ti i mbuluar..."

Prandaj Pejgamberit iu tha: "O ti i mbuluar me qilim që frikësohesh dhe ikën, dil nga qilimi!"

Mos e fut kokën nën qilim, mos e mbulo fytyrën, sepse bota është një trup i shastitur, kurse ti je mendje për këtë botë!

Eja në vete dhe mos u fshih e mos u largo prej atyre që janë ngritur për këtë çështje, sepse tek ti ka drifëra të qiriut të mesazhit hyjnor!

Eja në vete dhe ngrihu natën, sepse, o Pejgamber, qiriu natër rri në këmbë!

Pa dritën tënde, edhe dita e ndritshme është natë... Pa u mbështetur tek ti, edhe luani bëhet lepur!

O Mustafa, bëj punën e kapitenit në këtë det drite, sepse ti je Nuhu i dytë!

Të mençurit kanë nevojë për udhërrëfyes, sidomos po qe se rruga është rrugë detare!

Ngrihu dhe dhe shihe karvanin që i është prerë rruga! Në të gjitha anët shih lugetër që janë bërë kapitenë!

Ti je Hizri i kësaj kohe, ti je që i shkon në ndihmë çdo gjemie! Mos e bëj zakon të ecësh i vetëm si Shpirti i Zotit!

Ti je si drita në qiell para kësaj bashkësie, ti i ngjet diellit. Mos tento të fshihesh prej tyre, të stolisësh vetminë!

S'është koha për t'u tërhequr në vetmi... Eja te bashkësia! O Pejgamber, rruga e drejtë, orientimi në rrugën e drejtë i ngjasin malit të përrallave, kurse ti je i Zgjedhuri, zogu i mbarësisë!

Hëna e plotë ecën netëve nëpër qiell. Ajo nuk e lë ecjen pse lehin qentë!

Qortuesit u ngjajnë qenve që lehin ndaj hënës tënde të plotë!

Këta qenë janë të shurdhër ndaj urdhrit "heshtni, dëgjoni!"... Nga kokëtrashësia, ata vazhdojnë të lehin pa pushim ndaj hënës tënde të plotë!

O shërim, mos e braktis të sëmurin... Mos u zemëro ndaj shurdhit dhe pastaj ta lësh shkopin e qorrit!

Ti ke thënë: "Ai që e sheh qorrin në rrugë dhe e kap për dore, merr qindra shpërblime prej Zotit, fiton qindra mirësi!

Kush e kap për dore dyzet hapa një të keq, i falen mëkatet dhe e gjen rrugën e drejtë!"

Atëherë, kapi për dore dhe drejtoji në rrugë të drejtë qorrat në këtë botë të lëkundshme!

Kjo është puna e udhërrëfyesit të udhës së drejtë dhe ti je udhërrëfyesi i udhës së drejtë, je gëzimi i pesimizmit të kohës së fundit!

O imami i të devotshmëve, çoji gjer te pozita e njohjes faktike ata që janë dhënë pas iluzioneve!

Unë i bie në zverk atij që mendon ndonjë dredhi ose mashtrim kundër teje, pra, mos u shqetëso, por ec para i gëzuar!

Atij ia shtoj verbërinë... Ai e pandeh sheqer, kurse unë i jap helm!

Mendjet ndriçohen e shkëlqejnë me dritën time! Dredhitë mësohen nga dredhia ime!

Ç'është në këtë botë çadra e zezë e turkmenit në krahasim me këmbët e elefantit?

O Pejgamberi im i madh, ç'është qiriu i tij ndaj stuhisë time?

Ngrihu menjëherë me zërin e frikshëm të bririt që mijra të vdekur të ngrihen prej dheu!

Ti je Israfili i kohës, pra, ngrihu drejt dhe shpërthe një kiamet para kiametit!

Po të të thotë ndokush se ku është kiameti, tregoje veten dhe thuaji se ti je kiameti!

O njeri që ke rënë në mundime dhe bën pyetje, bëj kujdes dhe shih se qindra botë po këputen nga ky kiamet!

Po të mos ketë njerëz të lutjes dhe adhurimit, përgjigjja që duhet t4i jepet kokëtrashit duhet të jetë heshtja!

O sovrani im! Po të mos na pranohet lutja, Zoti i përgjigjet nga qielli me heshtje kërkesës sonë!

Erdhi koha e të vjelave, por, sa keq që dita na iku për shkak të fatit tonë të keq!

Dita është e ngushtë, kurse kjo fjalë është aq e gjerë, sa një jetë e tërë i vjen e ngushtë asaj!

T'ia hysh lojës me heshta në këtë gropë të ngushtë, i turpëron lojtarët e saj!

Koha është e ngushtë, por, o bir, mirëkuptimi i popullit është njëqind herë më i ngushtë se koha!

Meqë përgjigjja që i duhet dhënë kokëtrashit është heshtja, pse vazhdon ta zgjasësh fjalën?

Nga lartësia sublime e mëshirës së vet dhe dallgëzimit të detit të tij të bujarisë, Zoti po i lëshon ujë çdo vendi të thatë!

Thënia "Edhe mosdhënia e përgjigjes është përgjigje" e shtjellon thënien "Përgjigjja që i duhet dhënë kokëtrashit është heshtja!" Që të dyja tregohen me këtë histori.

Një sundimtar kishte një skllav të cilit i kishte vdekur mendja, kurse epshin e kishte të gjallë.

I linte shërbimet e holla të sundimtarit, zhytej në mendime të këqija, por pandehte se vepronte mirë!

Sundimtari dha urdhër t'i pakësohej ushqimi dhe, po të ankohej, t'i fshihej emri nga shërbyesit.

Skllavi e kishte mendjen të pakët, kurse ambicjen, të shumtë. Kur e pa ushqimin të pakët, u zemërua, u nxeh dhe u prapësua.

Po të kishte mend, do të vërente rreth vetes, do të mendohej, do ta peshonte punën, do ta kuptonte gabimin dhe, kështu, do të bënte që ta falnin.

Po qe se gomari me një këmbë të lidhur për shkak të gomarllëkut të vet, prapësohet, ia lidhin të dyja këmbët!

Dhe po qe se gomari të thotë se lidhja e njërës këmbë i mjafton, mos ia vër veshin sepse për shkak të gomarllëkut të vet i janë lidhur të dyja këmbët!

Mustafai (a.s.) ka thënë: "Zoti i madh krijoi engjëjt dhe u dha arsye; krijoi kafshët dhe u dha epsh; krijoi njerëzit dhe u dha edhe arsye, edhe epsh. Kush prej tyre e ka arsyen mbi epshin, ai është më i lartë se engjëjt dhe kush prej tyre e ka epshin mbi arsyen, ai është më poshtë se kafshët!" Komenti i këtij hadithi.

Ka ardhur me hadith: Zoti i krijoi krijesat në tre lloje.

Një pjesë, të përbërë krejtësisht prej arsyes, dijes dhe bujarisë. Këta janë engjëjt të cilët s'dinë gjë tjetër veç sexhdes!

Në natyrën e tyre s'ka dëshira dhe ambicje. Ata janë dritë absolute dhe janë ngjallur me ashkun, dashurinë pasionante për Zotin!

Një pjesë tjetër janë të paditur. Si kafshë që janë, hanë bar dhe majmen.

Ata nuk shohin gjë tjetër veç stallës dhe barit. S'dinë gjë as për të keqen, as për të mirën, as për të lartën!

Grupi i tretë janë të bijtë e Ademit, njerëzit. Nga natyra e tyre krijimore, njerëzit janë gjysmëengjëj e gjysmëgomerë!

Gjysma prej gomari, priret për nga e ulta, kurse gjysma prej engjëlli priret për nga arsyeja.

Dy grupet e parë s'kuptojnë nga konflikti dhe lufta, ata janë të kënaqur e të qetë. Por grupi i tretë, domethënë, njerëzit, në të kundërt me dy grupet e parë, janë të shqetësuar e të vuajtur.

Edhe vetë njerëzit janë ndarë në tre nëngrupe si rrjedhojë e vënies në provë. Që të gjithë kanë trajtë njeriu, por dallohen në tre lloje:

Njëri lloj është dhënë pas Zotit i cili është qenie absolute; këta e kanë humbur veten. Si Isai, këta janë futur në grupin e engjëjve.

Në trajtë janë njerëz, por, në të vërtetë, janë xhebrailë. Kanë shpëtuar nga zemërimi, dëshirat dhe pasionet, si dhe thashethemet.

Kanë shpëtuar edhe nga përkorësia, edhe nga asketizmi, edhe nga lufta... Sikur të mos kenë lindur nga njeriu!

Lloji i dytë janë ata që janë futur te gomerët. Këta janë bërë vetë zemërimi, janë shndërruar kokë e këmbë në epsh!

Tek këta, cilësia prej xhebraili, prej engjëlli, ka ikur, sepse ajo shtëpi ishte e ngushtë, ajo cilësi, e madhe, kështu që nuk e nxuri dhe iku!

Njeriu pa shpirt, vdes, kurse njeriu, te shpirti i të cilit s'është kjo cilësi, bëhet gomar!

Sepse shpirti pa këtë cilësi është i pavlerë, i ulët. Këtë fjalë e ka thënë sofiu, është e drejtë!

Ai dëshiron më shumë se kafshët, u hyn punëve të holla në këtë botë.

Dredhia dhe djallëzia e thurur prej tij nuk shfaqet te ndonjë kafshë tjetër!

Ai end rroba me fije ari, nxjerr margaritarë nga fundi i detit...

Ai i njeh pikat më të imta të gjeometrisë ose përvetëson njohuritë e astronomisë, mjekësisë dhe filozofisë!

Sepse ai ka lidhje vetëm me këtë botë. Ai s'ka rrugë për t'u ngjitur në qiellin e shtatë!

Të gjitha këto njohuri vlejnë për të ndërtuar stallë dhe stalla është mbështetje për ekzistencën e kaut dhe devesë!

Emrin e këtyre njohurive që u vlejnë kafshëve për të jetuar ca ditë, këta kokëtrashë e quajtën simbole, gjëra të holla!

Dijen mbi rrugën e Zotit, mbi ndalesën te Zoti, e dinë vetëm njerëzit e zemrës ose zemra e njeriut të zemrës!

Ja, me këtë sintezë e krijoi Zoti njeriun i cili është një kafshë e hijshme, dhe e shoqëroi me njohuri!

Atij lloji i tha "si kafshë"... Sepse ç'lidhje ka gjendja zgjuar me gjendjen në gjumë?

Në shpirtin kafshëror gjendet vetëm gjumë... Te ky lloj njerëzish ka ndjenja të kundërta.

Por sapo të vijë zgjimi dhe të mos mbetet më gjumë shtazor, e kupton se ndjenjën e ka të kundërt e të mbrapshtë!

Siç ndodh që, njeriu i cili është zhytur në gjumë, kur zgjohet, sheh të kundërtën e atyre që ka parë në ëndërr!

Shkurt, ai njeri i ulët ndodhet në botën e ulët. Lëre atë dhe thuaj: "Unë nuk i dua ata që perëndojnë!"

Komenti i ajeteve: "Atyre që kanë sëmundje në zemra,
Kur'ani ua shton fëlliqësinë e zemrave."
Dhe: "Me shembujt në Kur'an, Zoti një shumicë e tërbon,
kurse një shumicë tjetër e çon në rrugë të drejtë!"

Sepse tek njeriu i cili ka shpirt shtazor, ekzistonte aftësia për t'i ndërruar shprehitë, për të hyrë në luftë me nefsin, egon e vet dhe për të shpëtuar nga vulgariteti, por ai e shuajti këtë aftësi!

Kurse te kafshët nuk ka aftësi... Manësia dhe defekti te kafshët është krejt i hapur.

Sapo që nga njeriu të ikë kjo aftësi udhëzuese, çfarëdo që të hajë, mbetet tru gomari!

Po të hajë frutin beladur, një ilaç, ky, që e shton aftësinë mendore, i kthehet në opium që ia shton dobësinë e zemrës dhe pamençurinë!

Kurse një lloj tjetër i njerëzve është në luftë. Është gjysmë kafshë dhe, përsa i përket gjetjes së rrugës së drejtë, gjysmë njeri!

Këta janë natë e ditë në konflikt e në luftë... Fundi i tyre, domethënë njerëzillëku i tyre lufton pa pushim me kreun, domethënë, me shtazërinë e tyre!

Lufta mes arsyes dhe nefsit (egos, vetvetes),
i përngjet luftës mes Mexhnunit dhe devesë së vet...
Sevdaja e Mexhnunit është për Lejlanë, kurse sevdaja e devesë,
për të voglin e saj. Kështu, Mexhnuni thoshte:
"Dashuria e devesë sime është për atë që ka pas,
kurse dashuria ime është për atë që kam para...
Të dy jemi të dashuruar, por dashuritë tona janë të kundërta!"

Kjo i ngjet Mexhnunit dhe devesë së tij. Ai lufton të shkojë para, kjo, për të shkuar pas!

Sevdaja e Mexhnunit, të takohet me Lejlanë që ndodhet para, kurse sevdaja e devesë, të kthehet pas për të shkuar te i vogli i saj!

Sikur edhe një çast të përhumbej Mexhnuni, deveja kthehej menjëherë pas.

Ngaqë ishte i mbushur krejtësisht me pasion dhe sevda, ishte e pamundur që Mexhnuni të mos përhumbej.

Ishte arsyeja që kujdesej për të, mirëpo ai e kishte lënë arsyen në sevdanë për Lejlanë!

Sa për devenë, ajo ishte e shkathët dhe ruante rastin.... Sapo ta ndjente kapistrën të lëshuar,

E kuptonte se Mexhnuni ishte përhumbur, kishte ikur nga kjo botë! Atëherë, menjëherë kthehej pas dhe fillonte të shkonte andej nga ndodhej i vogli i saj!

Atëherë, Mexhnuni vinte në vete dhe e kuptonte se ishte kthyer shumë pas vendit ku ndodhej më parë!

Kështu udhëtuan për tri ditë. Mexhnunit i dukej se kishte vite në këtë pavendosmëri!

Më në fund i tha devesë: "O deve, që të dy jemi të dashuruar, por të kundërt me njëri-tjetrin... S'jemi të denjë për shoqërimin e njëri-tjetrit!

Edhe dashuria jote s'më përshtatet mua, edhe kapistra jote duhet të çlirohet prej teje!"

Të dy këta shokë ia prisnin rrugën njëri-tjetrit. Shpirti që nuk zbret poshtë trupit e nuk ndahet prej tij, e ngatërron rrugën!

Edhe shpirti yt, pas ndarjes nga arshi, ka rënë në varfëri. Kurse trupi, me dashurinë për gjemba, të është kthyer në deve!

Shpirti hap flatrat për në lartësi. Trupi mbahet fort me thonj pas toke!

"O deve që ke vdekur me ashkun për vatanin, sa të jesh me mua, shpirti ka për të më mbetur larg Lejlasë!

Pothuaj siç pati mbetur fisi i Musait me vite në shkretëtirë, edhe unë me ty rashë në këtë gjendje! Dhe më iku jeta...

Kjo rrugë për të arritur në bashkim, përbëhet prej dy ditësh. Mirëpo, me dredhinë tënde, unë mbeta plot gjashtëdhjetë vjet në këtë rrugë dyditëshe!

Rruga është afër, por unë mbeta vonë. U mërzita keq, më në fund, nga ky shalim!"

Pas këtyre fjalëve, u hodh nga deveja duke thënë: "Pse të vazhdoj të digjem nga kjo vuajtje? Fundja, jam djegur!"

Ajo fushë e gjerë i erdhi shumë e ngushtë dhe e hodhi veten në një gurishte!

Dhe e hodhi ashtu që trupi i atij trimi u shtyp e u dërrmua!

E hodhi veten ashtu për toke, sa, pa dashur, iu thye edhe këmba!

E lidhi këmbën dhe tha: "Bëhem top dhe bie e rrokullisem para caktimit të Tij!"

Ja, prandaj i urti fjalëbukur e ka mallkuar kalorësin që nuk zbret prej trupit!

A mund të bëhet pasioni ndaj Zotit më pak i vlerë se pasioni për Lejlanë? Sigurisht që është më e drejtë, më me vend t'i bëhesh top Atij!

Bëhu top dhe shtrihu në anën e pasionit hyjnor dhe rrokullisu me shkopin e atij pasioni!

Sepse, pas zbritjes nga shala, ky udhëtim bëhet me tërheqjen e Zotit, kurse ecja jonë e mëparshme bëhej me anë të devesë!

Kjo lloj ecjeje është krejt e veçantë nga ecjet e tjera. Kjo vajtje nuk bëhet as me përpjekjet e xhindëve, as me përpjekjet e njerëzve!

Kjo heqje mënjanë dhe vajtje nuk është heqje dhe vajtje e thjeshtë dhe e zakonshme. Këtë e solli në sheshin e favorit Ahmedi! Mbeçi me shëndet!

Skllavi i shkruan padishahut duke iu ankuar për shpërblimin e pakët që merrte.

Prije fjalën shkurt dhe trego për skllavin që i shkroi dhe i dërgoi letër padishahut!

Skllavi i shkroi dhe i dërgoi padishahut të përkëdhelur një letër të mbushur plot me luftë, pretendime dhe urrejtje.

Kallëpi yt, kurmi yt është letër, pra, mbaje parasysh nëse është i denjë për padishahun apo jo? kuptoje një herë, pastaj dërgoje!

Shko në një skaj, hape letrën dhe lexoje dhe shih nëse fjalët brenda janë fjalë të denja për padishahun!

Po s'qe e denjë, grise atë letër dhe shkruaj një tjetër!

Por mos e pandeh të lehtë hapjen e letrës së trupit. Ndryshe, çdo njeri do ta shihte qartë të fshehtën e zemrës!

Sa e vështirë, sa e përpjetë është hapja e kësaj letre! Kjo është punë burrash, jo punë çiliminjsh!

Të gjithë ne jemi të kënaqur me përmbajtjen tonë, sepse jemi përlyer me dëshira dhe pasione!

Mirëpo përmbajtja është një kurth për njerëzit që ta shohin dhe ashtu ta pandehin tekstin!

Hape letrën dhe mos e kthe fytyrën mënjanë prej saj sepse Zoti e di më mirë se si është e drejta!

Përmbajtja e letrës i përngjet pohimit me gojë. Por ti vëre në provë tekstin e letrës së zemrës!

Dhe shihe, a përputhet me pohimin tënd? Këtë shihe në mënyrë që puna jote të mos kthehet në punë të hipokritëve dhe hezitantëve!

Po u nise të ngarkosh e të shpiesh një thes të rëndë, vështrimi përtej tij nuk ta lahtëson barrën!

Shih në thelbin e gjërave... Shih ç'ka në thes, të ëmbël a të hidhur, dhe barte nëse e vlen!

Ndryshe, zbrazi gurët që ka në thes dhe shpëtoje veten nga kjo punë e kotë dhe nga kjo barrë e turpshme!

Dhe mbushe thesin me gjëra që mund t'u çohen mbretërve e sovranëve!

Hajduti ia vjedh çallmën një dijetari me çallmë të madhe.
Dijetari i thërret hajdutit:
"Hape çallmën, shihe ç'ke marrë,
kuptoje dhe pastaj merre e shko!"

Një dijetar kishte mbledhur copa bezeje dhe i kishte futur brenda çallmës duke i ngjeshur mirë e mirë!

Në këtë mënyrë, ai donte të dukej i madh, populli t'i jepte rëndësi dhe, kur të shkonte në faltore, ta vinin në krye të vendit!

Ai, pra, e kishte zmadhuar çallmën me copëra të marra nga rrobat.

Ana e jashtme e çallmës u ngjante plaçkave të xhennetit, kurse e brendshmja ishte, si zemra e hipokritit, e turpshme dhe e shëmtuar!

Copa bezeje, leshi e lëkure... Të gjitha ishin groposur brenda asaj çallme!

Një mëngjes, ndërsa po shkonte në medrese me këtë madhështi për të fituar diçka,

Një hajdut po priste në një rrugicë me qëllime të mbrapshta për të bërë diçka.

Kur dijetari u fut në rrugicë, ia rroku menjëherë çallmën dhe nisi të ikte me vrap!

Dijetari i bërtiti nga pas: "O bir, zgjidhe çallmën dhe pastaj merre!

Je duke fluturuar me katër krahë, por pa hape dhuratën e shihe!

Hape, zgjidhe, pastaj merre me vete e të qoftë falë!"

Pa e lënë vrapin, hajduti e zgjidhi çallmën dhe në rrugë u derdhën qindra copëra bezeje!

Dhe nga ajo çallmë e paqenë që s'vlente për gjë, në dorën e hajdutit mbeti vetëm një arshin beze e saktë!

Duke e përplasur përtokë atë që i kishte mbetur në dorë, tha: "O burrë i poshtër, me këtë dredhi ma çove mundin kot!"

Bota u jep këshilla me gjuhën e gjendjes
njerëzve të përkushtuar ndaj kësaj bote,
njerëzve që shpresojnë besnikëri prej saj
dhe njerëzve që e lakmojnë atë,
duke u treguar për pabesinë e saj.

Dijetari tha: "Të pengova nga rruga me dredhi, por edhe punën me rrugë këshille ta tregova!"

Ja, kështu është edhe kjo botë. Hapet e zgjerohet mirë e bukur, por edhe pabesinë e thotë me zë të lartë!

Në këtë botë bërjeje e zhbërjeje ajo bën mashtrim dhe, me këtë rast, edhe këshilla prishet!

Bërja thotë: "Gjurma ime është e bekuar, eja pas meje! Kurse zhbërja thotë: "Shko, unë s'jam asgjë!"

O ti që, duke u mahnitur pas bukurisë së pranverës, kafshon buzët, shih fytyrën e verdhë të vjeshtës dhe ftohtësinë e stinës së saj!

E sheh të bukur fytyrën e diellit të ditës, por mendo edhe vdekjen në kohën e perëndimit të tij!

Je duke e soditur me kënaqësi nënën e plotë nga ky çardak, por pa shih edhe mallin e tij në fund të muajit!

Me bukurinë e tij, një djalë bëhet zotëri për popullin... Bëhet, por nesër turbullohet dhe turpërohet para popullit!

Nëse ty të ka rrëmbyer trupi i bukurosheve trupargjendta, shih edhe trupin që, në pleqëri, kthehet në arë pambuku!

O ti sheh dhe ha gjellë të dhjamura e të ëmbla si mjaltë, shko në nevojtore e shih ç'ka mbetur prej tyre!

Ç'punë ka me pisllëkun ajo bukuria jote, ku është në pjatat ai vështrimi yt i këndshëm, ajo kënaqësi e ndjerë prej teje, ajo shije!

Ajo të thotë: "Ajo ishte kafshata, kurse unë, laku! Pasi re në lak ti, kafshata u fsheh!

Ç'gishtërinj ka që i kanë zili edhe mjeshtrat, por, më në fund, ato gishta dridhen duke bërë punë!

Sytë e bukur e të perënduar si shpirt, më në fund bëhen që të mos shohin dhe prej tyre nis të pikojë ujë!

Trimi që ecën si luan në radhët e luanëve, më në fund bie i mundur nga një mi!

Artistin apo personin me aftësi e shkathtësi shihe në fund! Plaku kthehet në gomar, turbullohet dhe merr fund!

Kaçurrelat e zeza parfumkundërmonjëse që i turbullojnë mendjet, në fund kthehen në bisht të shëmtuar gomari të thinjur!

Në fillim sodite mirë bërjen e një gjëje duke u hapur e zbukuruar, në fund sodite zhbërjen dhe demaskimin e saj për të ardhur keq!

Gjëja që ta tregoi në fillim hapur kurthin e saj, në fund ua shkuli mustaqet dhe mjekrën atyre që qenë shtënë pas saj!

Dhe mos thuaj se bota të mashtroi me anë të dredhive, ndryshe, mendja ime sigurisht që do të kishte ikur nga kurthi i saj!

Vështroje dhe shihe se ç'zinxhir është, në të vërtetë, gjerdani i artë!

Kështu, numëroji dhe derdhi të gjitha pjesët e gjithësisë dhe shihi të gjitha në fillim e në fund!

Kush e sheh më shumë fundin, është më i bekuar, por kush e sheh stallën, ai është më i përzënë, më i syrgjynosur!

Shihja çdo gëje fytyrën të bukur e të ndritshme si hëna, por, pasi t'ia kesh parë fillimin, soditja edhe fundin!

Soditja dhe mos u bëj Iblis i verbër. Ai sheh mangët ngaqë është i mangët; njëra anë i sheh, kurse ana tjetër s'i sheh!

I pa dheun Ademit, por s'ia pa fenë. E pa këtë botë, por nuk ia pa përmbajtjen shpirtërore që sheh botën tjetër!

O trim, epërsia e meshkujve mbi femrat nuk është te forca, fuqia, fitimi, malli e pasuria.

Po të ishte ashtu, luani dhe elefanti, meqë janë më të fuqishëm se njeriu, do të ishin eprorë ndaj tij, o qorr!

O ti që sheh vetëm këtë çast, epërsia e meshkujve ndaj femrave është se meshkujt e shohin fundin më shumë se femrat!

Po qe se mashkulli s'e sheh dot fundin e punës, në krahasim me të tjerët që e shohin fundin e punës konsiderohet i mangët si femrat!

Nga gjithësia vijnë dy zëra të kundërt... Ta shohim, për kë ke aftësi ti!

Njëri zë është jetë për njerëzit e mirë, kurse zëri tjetër, dredhi për njerëzit e këqinj!

Njëri zë thotë: "O njeri i bukur dhe i pasionuar pas meje, unë jam lule gjembi... Lulja derdhet, unë mbetem; unë jam degë gjembi!"

Kurse lulja e tij thotë: "O shitës trëndafilash, eja në këtë anë... Mos u përpiq të vish pranë nesh me zërin e gjembit!"

Kur ta kesh pranuar njërin nga këto zëra, tjetrin as e dëgjon dot. Sepse personi që dashuron, bëhet i shurdhër ndaj fjalëve të personave të kundërt me të dashurën!

Njëri nga ato zëra të thotë: "Ja ku jam unë, jam gati!" Kurse zëri tjetër të thotë: "Shihma fundin!"

Zhbërja e botës të thotë: "Gjendja ime e tanishme është hile, pusí! Fundin shihma duke parë anën e përparme timen që i përngjet një pasqyre!"

Po hyre në njërin nga këto thasë, atëherë bëhesh i kundërt i tjetrit, nuk je më i denjë për të!

Ç'lumturi për atë që e dëgjoi qysh në fillim këtë zë që e dëgjojnë mendjet e burrave të vërtetë!

Cili zë që ta gjejë bosh shtëpinë e zemrës, ai vjen dhe e zë... Atëherë, të zotit të shtëpisë, të tjerët i duken ose të shtrembër, ose të pakuptueshëm!

Po qe se shtamba e re e thith shurrën, uji s'e pastron dot më fëlliqësinë prej saj!

Në gjithësi, çdo gjë tërheq diçka, edhe magneti... Edhe sikur të jesh hekur, edhe sikur të jesh fije kashte, gjithsesi ke për të rënë në një kurth!

Po të jesh hekur, të zë magneti, po të jesh fije kashte, kapesh nga qelibari, shkon te ai!

Kush s'është mik me njerëz të mirë, sigurisht zë vend pranë të këqinjve, bëhet komshi me ta!

Musai është shumë i keq për kiptinjtë, por edhe Hamani është, për izraelitët, si djall i zënë me gurë!

Zemra e Hamanit tërheq kiptiun, kurse zemra e Musait dëshiron izraelitët!

Stomaki i gomarit tërheq kashtën, stomaku i njeriut, grurin dhe ujin!

Po s'e njohe dikë për shkak të errësirës, shih kush e ka bërë imam, kush i është vënë pas dhe e kupton kush është!

Arifi, dijetari shpirtëror, e ka ushqimin nga drita e Zotit.
Ai ka thënë: "Unë shkoj mik te Zoti im
dhe ai më ushqen e më jep ujë."
Është edhe hadithi që thotë: "Uria është gjella e Zotit.
Me të i ringjall Zoti trupat e të drejtëve."
Domethënë se në uri, njeriut i vjen gjella e Zotit.

Çdo foshnjë shkon pas s'ëmës. Me këtë kuptohet edhe gjinia.

Njeriut i vjen qumështi nga gjiri, kurse qumështi i gomarit rrjedh nga gjysma e poshtme e trupit.

Drejtësia është shpërndarëse, ajo i përpjesëton gjërat që duhen përpjesëtuar. Por është e habitshme që në këtë nuk ka as shtrëngim, as padrejtësi!

Po të kishte shtrëngim, a do të kishte pendesë? Po të kishte padrejtësi, a do të kishte mbrojtje të Zotit?

Dita kaloi, mësimi na mbeti për nesër. A mos e nxë dita të fshehtën tonë?

O ti që u beson mashtrimeve të njeriut të keq, që ia quan fjalët të drejta,

Ti ke bërë një kube nga flluckat e ujit, por një çadër të tillë që i ka penjët shumë të pafuqishëm,

Që i ngjan rrufesë së hiles. Udhëtarët nuk kanë mundësi ta shohin udhën me dritën e saj!

As në këtë botë nuk ka gjë, as në banorët e kësaj bote! Që të dy palët kanë të njëjtën zemër në pabesi!

I biri i botës, i pabesë si vetë bota! E kthen fytyrën nga ti, por ajo s'është fytyrë, por shpinë!

Por të merituarit e asaj bote, në mënyrë të përjetshme si ajo botë, u qëndrojnë besnikë betimeve në mirësi dhe bujari!

A mos ke parë që dy pejgamberë të jenë të kundërt me njëri-tjetrin, të rrëmbejnë mrekullitë e njëri-tjetrit?

A vyshket dhe a prishet fryti i asaj bote? Gëzimi i arsyes nuk dëshpërohet!

Nefsi, vetvetja, nuk rri në fjalë, prandaj është një gjë që duhet ngordhur! Edhe vetë është e poshtër, edhe vendi i orientimit të saj!

Fundja, kjo turmë të poshtrish është e denjë për nefsin, siç janë varri dhe qefini të denjë për të vdekurin!

Eshtë i zgjuar, njeh gjërat e holla... I njeh, por a s'është bota vendi i orientimit të tij? Atëherë, dije të vdekur atë!

Uji i mesazhit hyjnor iu bë provë këtij të vdekuri dhe ai doli prej toke i gjallë!

Por pa të ardhur mesazhi hyjnor, ti kurrsesi mos u mashtro nga e kuqja e fytyrës tënde jetë gjatë, mos u kreno!

Kërko një zë e një popullaritet që të mos bjerë nga vështrimi, kërko një shkëlqim të një dielli që s'perëndon!

Ato aftësi të holla, ato thashetheme i ngjajnë fisit të Faraonit me vdekjen në lumin e Nilit!

Shkëlqimi, veshjet dhe magjitë e tyre e tërheqin popullin prej qafe me shtrëngim,

Por që të gjithë diji si magjistarë të magjistarëve! Kurse vdekja është ai shkopi i ardhur si kuçedër!

Të gjitha magjitë i bëri një kafshatë dhe i gëlltiti! Siç e lëpin dhe e gëlltit mëngjesi një botë nate!

Por me atë gëlltitje, drita e mëngjesit nuk u shtua; siç qe në fillim, ashtu mbeti!

Shumica, teprica janë te vepra, jo te personi. Personi s'ka as shtim, as pakësim!

Zoti nuk u shtua pse e krijoi botën! Fundja, ai nuk është sot ndërsa s'ka qenë dje!

Por me krijimin e njerëzve, vepra u shtua. Vetëm se mes këtyre dy shtimeve ka ndryshime të mëdha!

Shtimi i veprës është shfaqja e tij. Në këtë mënyrë i dalin në pah dhe i duken artet dhe puna!

Sa për shtimin e personit, kjo është provë se ai person që shtohet është i varur nga shkaqet dhe i krijuar pas!

Komenti i ajetit: "Musai ndjeu përbrenda një frikë... I thamë: Mos ki frikë, ti je më i lartë se ajo!"

Musai tha: "Edhe magjia e huton njeriun! Ç'të bëj unë? Populli s'e ndan dot magjinë nga mrekullia!"

Zoti i tha: "Unë e shfaq atë dallueshmëri tek ta, e bëj mendjen që nuk e dallon dot të drejtën e të shtrembrën, të shohë e të kuptojë!

Ata shkumbëzuan si det, por mos ki frikë, o Musa, ti do të dalësh fitimtar!"

Në kohën e vet, magjia ishte një gjë për t'u lavdëruar, por me t'u bërë shkopi kuçedër, të gjitha magjitë u bënë menjëherë diçka për t'u pasur turp!

Çdokush përpiqet për bukuri dhe hijeshi, por gur prove për hijeshitë është vdekja!

Edhe magja kaloi e iku, edhe mrekullia e Musait. Që të dyve u ranë legenët nga çatia e qenies!

Nga zëri i legenit të magjisë mbeti vetëm mallkim, kurse nga zëri i legenit të fesë, vetëm lartësi sublime!

Gur prove nuk ka as te mashkulli, as te femra; ai ka mbetur i fshehur. O zemër, eja tashmë, futu në radhë dhe fol se është pikërisht koha!

Tani është pikërisht koha e fjalës, sepse gur prove nuk ka në shesh, pra të mbajnë lart dhe ti shëtit nga dora në dorë, o zemër!

Zemra krenohet çdo çast dhe i thotë floririt: "Unë jam gjithmonë si ti, o flori! Kur kam qenë poshtë teje?"

Edhe floriri i thotë: "Po, o shok porte! Por guri i provës po vjen, pra, përgatitu!"

Vdekja e trupit është dhuratë për njerëzit e të fshehtës... Ç'dëm i vjen floririt të pastër nga gërshëra?

Po qe se zemra do të shihte fundin, në vend që të nxihej më pas, nxihej më parë

Dhe, duke u nxirë më parë, do të mbetej larg hipokrizisë dhe të keqes!

Po qe se mendja e saj do të kërkonte përbërjen prej virtyti dhe mirësie, do të bëhej eprore ndaj dredhisë së saj!

Dhe kur zemra t'i thyhej, do ta kuptonte veten dhe do ta shihte para vetes Zotin që i rregullon thyerjet!

Kur përpjekësi e sheh fundin, shndërrohet në një gjendje të thyer e të dërrmuar dhe menjëherë kapet, lidhet, mbahet fort dhe e kapërcen aty për aty thyerjen!

Mirësia e Zotit i shtyn drejt eliksirit bakërat, por ai i lari me flori mbetet i mangët prej kësaj!

O ti i larë me flori, mos u nis të përpiqesh më kot, sepse nuk do të kesh gjithmonë myshterinj të tillë qorra, shihe këtë!

Drita e ringjalljes ua hap sytë. A nuk ua lidhje sytë ti? Ja, prandaj demaskohesh ti!

Ti që sheh fundin e punës, shihi personat që vuajnë zilinë e zemrave dhe syve!

Shihi edhe personat që shohin të sotmen! Këta janë persona me botë të brendshme të kalbur. Janë ndarë e larguar nga origjina!

Sipas atyre që shohin të sotmen, prandaj, sipas atyre që mbeten në padije dhe dyshim, zbardhja e parë e ditës me zbardhjen e vërtetë janë e njëjta gjë.

Zbardhja e parë ka fshirë mijëra karvane me erën e saj shkatërrimtare!

Nuk ka asnjë monedhë në botë që të mos i mashtrojë ata dëshiruesit... Mjerë për shpirtin e atij që s'ka gur peshimi e gërshërë!

Këmbëngulje që personi që ngre një çështje, të heqë dorë nga çështja dhe urdhërimi që të ndjekë pejgamberët.

Ebu Musejleme tha: "Edhe unë jam Ahmed... Fenë e Ahmedit do ta godas me anë të mashtrimit dhe do ta thyej!"

Thuaji Ebu Musejlemes: "Mos u mbaj më të madh, mos u ngrefos shumë duke parë anën e parme të punës, por shihja fundin!"

Mos iu fut prijësisë me ambicjen për të mbledhur njerëz mbi kokë! Bëj sipas kallauzit, shko pas tij që ai të të ndrijë para si qiri e ti ta shohësh udhën!

Qiriu ta tregon synimin si hënë dhe të thotë se në këtë anë ka ushqim ose ky këtu është kurth!

Po të kesh dritë në dorë, edhe sikur të duash, edhe sikur të mos duash, i sheh dhe i dallon gjurmët e skifterit me të sorrës nga njëra-tjetra!

Por po s'pate qiri, kjo s'është e mundur. Sepse këto sorra janë hileqare, ato kanë mësuar zërin e skifterëve!

Edhe po e mësoi trimi zërin e papagallit, ku është zëri i papagallit, lajmi i Sebesë?

Dije se zëri aksidental është nga zëri origjinal. kurorat e padishahëve janë të marra nga kurorat e papagallëve!

Fjalët e dervishëve me fjalimet e arifëve janë marrë nëpër gojë nga këta të paturpshëm!

Shkatërrimi i popujve të vjetër është shkaktuar gjithmonë ngaqë e kanë pandehur gurin e fortë për dru zjarri!

Ata e kishin aftësinë dalluese për ta kuptuar atë dhe për ta nxjerrë në shesh, por ambicja dhe lakmia e bëjnë njerin qorr dhe shurdh!

Verbëria e qorrave nuk është larg mëshirës, për ta ka dhembshuri. Por për verbërinë e lakmisë nuk ka justifikim!

Për njeriun e kryqëzuar nga padishahu ka dhembshuri, por ai që mbërthehet në kryqin e smirës nuk falet!

O peshk, shihe fundin e punës, jo grepin! Por grykësia jote ta mbylli syrin që sheh fundin e punës sate!

Shihe fillimin dhe fundin me të dy sytë! eja në vete e mos u bëj me një sy të vetëm si Iblisi!

Me një sy të vetëm i thonë atij që sheh vetëm gjendjen ku ndodhet... Si kafshët, ai nuk di për gjë tjetër!

Ndëshkimi i kaut me qorrim të plotë është ndëshkimi duke ia nxjerrë vetëm njërin sy... Sepse tek ai nuk ka dinjitet!

Dy sytë e kaut janë gjysma e vlerës, sepse ti mund ta detyrosh atë ta kryejë atë veprim që ai do ta bënte vetë me dy sy!

Por nëse ia nxjerr njeriut njërin sy, duhet t'ia japësh gjysmën e vlerës!

Sepse syri i njeriut mundet ta bëjë vetë një punë pa ndihmën e dikujt tjetër!

Ngaqë syri i gomarit nuk e sheh fundin, edhe sikur gomari t'i ketë të dy sytë, është njëlloj si ta kishte vetëm njërin!

Kjo fjalë nuk mbaron. Me lakminë për bukë, ai mendjelehti u vu t'i shkruajë letër padishahut.

Skllavi i shkruan padishahut për të kërkuar nafaka.

Para se ta shkruante letrën, shkoi te përgjegjësi i kuzhinës dhe i tha: "O njeriu shpirtngushtë në kuzhinën e padishahut bujar!

Të më pritet kaq shumë gjë nga nafakaja ime, është larg shpirtgjerësisë së padishahut!"

Përgjegjësi i kuzhinës i tha: "Ashtu është parë e domosdoshme, prandaj ta ka prerë, as për koprraci, as për shpirtngushtësi!"

Skllavi i tha: "Jo... Vallahi, kjo fjalë, ky urdhër s'janë prej padishahut! Pranë padishahut, edhe floriri i vjetër është, pothuaj, si dhé!"

Përgjegjësi i kuzhinës i solli shumë lloj argumente, por, nga ambicja, ai i hodhi poshtë të gjitha!

Kur në kohën e sillës ushqimi i erdhi pak, u ankua gjatë, tha fjalë të këqija, por s'pati asnjë dobi!

Tha: "Ju e bëni këtë me qëllim!" Përgjegjësi i kuzhinës i tha: "Jo, ne jemi shërbëtorë që zbatojmë urdhrat!"

Mos e pandeh këtë prej të dytit, kjo është nga i pari. Mos e gjej shumë me faj harkun, është krahu që e hedh shigjetën!

Ajeti "kur qëllove, nuk qëllove ti" është një dedikim, pra, mos i gjej shumë mëkat Pejgamberit, se kjo punë është nga Zoti!

O njeri me sy të turbulluar, uji turbullohet te burimi! Hapi mirë sytë dhe shihe fillimin e punës!

I zemëruar e i nxehur, skllavi u tërhoq në një skaj dhe shkroj një letër ku ia bënte të ditur padishahut zemërimin e vet.

Në letër e lavdëroi padishahun... Ia shpoi margaritarët bujarisë së tij!

I shkroi: "O ti me dorën më bujare se deti dhe reja në dhënien e nevojës nevojtarit!

Reja jep, por duke qarë, kurse dora jote shtron sofra të tëra duke buzëqeshur!"

Forma dhe pamja e letrës ishin lavdërim, por në ato lavdërime ndihej kundërmimi i zemërimit!

Edhe puna jote është krejt si e tija, e errët dhe e shëmtuar, sepse ti je larg dritës së krijimit!

Puna e personave të ulët është e cunguar. Si fruti i njomë, ajo prishet shpejt dhe kalbet!

Prandaj cungohet dhe prishet shkëlqimi dhe përparimi i botës, sepse ajo është botë bërjeje dhe zhbërjeje!

Po qe se te lavdëruesi ka urrejtje, lavdërimet e lindura nga natyra e tij nuk i vijnë të këndshme njeriut!

O zemër, pastrohu nga urrejtja dhe fëlliqësia, pastaj lexoje me shkathtësi suren "Hamd"!

Me gojë lavdëron e falenderon, por zemra ta kundërshton këtë! Lavdërimi dhe falenderimi në gjuhën tënde është ose djallëzi, ose magji!

Ja, prandaj Zoti tha: "Unë nuk shoh anën e jashtme, por të brendshmen!"

Lavdëruesi që bën lavdërime për ta mbrojtur nderin e vet,
por që ndjehet se në ato lavdërime ka hall dhe dhimbje
dhe që kuptohet se, për shkak të vjetërsisë së hirkës,
ato falenderime janë fjalë të kota dhe gënjeshtra.

Dikush ia behu nga Iraku me një hirkë, pelerinë të vjetër. Miqtë e pyetën për largimin.

Ai u tha: "E drejtë, u ndava, por udhëtimi më erdhi shumë i mbarë!

Kalifi më dha dhjetë palë rroba. Lavdëruar qoftë qindra herë!"

E lavdëroi gjatë kalifin, i bëri falenderime e urime. Më në fund, falenderimi e kaloi masën.

I thanë: "Gjendja jote e keqe dëshmon për plagët e tua!

Trupin të zhveshur, kokën si kungull, zemrën të djegur... A mos i vodhe kund këto falenderime, apo i mësove prej ndokujt?

Ku janë shenjat e falenderimit dhe madhërimit të sundimtarit që po lavdëron? Ato duhej të të dukeshin te kjo kokë e padenjë, te këmbët!

Gjuha ta lavdëron atë sovran, por të shtatë gjymtyrët të ankohen pa pushim!

Po e lavdëron atë sovran bujarie, atë mbret zemërmadhësie, por si shpërblim të tyre duhet të kishe në këmbë këpucë e në shalët, shallvare!"

Ai u tha: "Unë i shpërndava të gjitha që m'i dha; sundimtari nuk la gjë mangët në mirësi!

Të gjitha dhuratat i mora, por të gjitha ua shpërndava jetimëve dhe të varfërve!

Dhashë mall dhe, si shpërblim, mora një jetë të gjatë, sepse unë jam shumë punëmirë!"

Pas kësaj, i thanë: "Nëse ai mall i bekuar ka ikur, ç'është ky tym, kjo nxehtësi brenda teje?

Brenda ke qindra pisllëqe si gjemba. A mund të jetë vuajtja shenjë lumturie?

Nëse ato gjëra të shkuara për të cilat po flet janë të vërteta, ku është shenja e pasionit, e kënaqësisë së dhurimit?

Ta zëmë se malli humbi e shkoi, prirja ku është? Nëse kaloi rrebeshi, ku është vendi?

Ta zëmë se në fillim atë syrin që u jepte shpirtrave shpirt, e kishe të zi, por bukuria i iku. Por pse tani e ke syrin qiell?"

O fytyrëthartë, ku është shenja e pastërtisë? Prej teje vjen era e llafeve të shtrembra, pra, hesht!

Në zemër bëhen qindra shenja të dhurimit të mallit, duken qindra shenja të punës së mirë!

Zemrës së personit që e fal dhe e shpërndan mallin, i vijnë qindra gjallëri në vend të atij malli!

Të mbillen farëra të pastra në arën e Zotit dhe pastaj të mos japin prodhim! S'është e mundur!

Po të mos japin prodhim edhe kopshtet e Zotit, a mund të thuhet atëherë se vendi i Zotit është i gjerë? Thuaj!

As ky vend papasjeje nuk rri pa dhënë prodhim. Atëherë, si ndodh që vendi shumë i gjerë i Zotit të mos japë prodhim?

Edhe ky vend, madje, ka mundësi të panumërta për të dhënë prodhim; farës më të ulët i jep njëqindfish!

Je duke falenderuar, por ku është shenja e këtyre falenderimeve? Këto shenja nuk i ke as jashtë, as brenda!

Lavdërimi dhe falenderimi i arifit ndaj Zotit është me vend, sepse dëshmitari i tyre janë duart dhe këmbët!

Lavdërimi dhe falenderimi e nxjerrin arifin nga pusi i trupit fizik të errët, e shpëtojnë nga burgu i kësaj bote!

Atllasi i devocionit të hedhur shpinës me dritën e afërsisë hyjnore janë shenja të lavdërimit dhe falenderimit.

Arifi ka shpëtuar nga kjo botë e përkohshme dhe ka zënë vendbanim në trëndafilishtet, anës ujëvarave!

Vendi ku rri, pozita dhe detyra që i janë dhënë ndodhen mbi ndenjësen e së fshehtës së ndihmës së lartë!

Ai vend është një pozitë e tillë drejtësie, që të gjithë të drejtit kanë zënë vend atje duke u dalluar nga fytyrat e gëzuara e të hijshme!

Lavdërimi dhe falenderimi i tyre është si lavdërimi dhe falenderimi i trëndafilishtes për pranverën. Ka qindra shenja dhe qindra vepra!

Burim për ardhjen e pranverës, fidanë, barëra... Ajo trëndafilishte, ato lule ngjyra-ngjyra janë dëshmitarë!

E bukura ka mijëra dëshimtarë në të gjitha anët. Si gjërat që dëshmojnë për formimin e margaritarit në midhjen e sedeftë!

Mirëpo nga fryma jote vjen kundërmimi i të fshehtës së keqe. O llafazan, halli yt duket e të shkëlqen në kokë e në fytyrë!

Në sheshin e kësaj bote ka njerëz të aftë që kuptojnë nga kundërmimi. Pra, mos tento të bësh lojëra të tilla!

Dhe mos fol për miskun... Nga goja po të vjen kundërmim qepe, pra, mos e nxirr sheshit të fshehtën tënde!

Ti thua vazhdimisht se ke ngrënë ëmbëlsirë trëndafili, por kundërmimi i hudhrës që të vjen prej frymës të thotë të mos shesësh dokrra!

Zemra i ngjet një shtëpie të madhe e të gjerë. Shtëpia e zemrës ka komshinj të fshehtë!

Ata vëzhgojnë nga dritarja, nga vrima e murit, dhe i kuptojnë të fshehtat!

Ata e shohin gjithçka nga një plasë, nga një vrimë që i zoti i shtëpisë nuk e ka vënë re fare, që s'di gjë për të!

Sikur ta lexoje Kur'anin... Shejtani me fisin e vet e nuhatin fshehtas gjendjen e njerëzve!

E kuptojnë të fshehtën e njeriut nga një rrugë që njeriu s'e di. Kjo rrugë nuk është rrugë që ndjehet me ndjenjë ose që mësohet me ndonjë gjë tjetër!

Mos tento të bësh hile mes atyre që shohin... Ndërsa guri i provës është në mes, mos ua hyr llafeve, o kallpazan!

Guri i provës ka aftësi për ta njohur edhe origjinalen, edhe kallpen. Zoti e ka bërë atë urdhërues të trupit dhe zemrës!

Edhe shejtanët me ato gjëra të ulta e të këqija e dinë të fshehtën tonë, mendimin tonë, rrugën nga ecim...

Edhe ata, madje, e kanë një rrugë vjedhjeje për në zemrën tonë. Për shkak të hajdutërisë së tyre po përmbysemi ne!

Çdo çast na shkaktojnë humbje të mëdha. Kanë plasa dhe vrima nga na vëzhgojnë...

E pse, tashmë, shpirtrat e ndriçuar të kësaj bote të mos kenë dijeni për gjendjet e fshehta?

A mos shpirtrat që kanë ngritur çadër në qiell, janë më poshtë se shejtanët në hyrjen në trupin e njeriut?

Shejtani niset të ngjitet në qiell si hajdutëri, por përzihet prej atje me lëng djegës.

Siç i derdhen trutë në luftë qafirit të keq me heshtë, ashtu dhe ai bie kokëposhtë nga qielli!

Kështu i hedhin shejtanët kokëposhtë nga qielli shpirtrat e pëlqyer nga zemrat meqë i kanë zili!

Atëherë, nëse s'je i gjymtuar, i çalë, i verbër e shurdh, mos pandeh për të keq kundër shpirtrave të lartë...

Ki turp, fol pak me vete, mos hiq shpirt se ka shumë spiunë që e vëzhgojnë trupin dhe i kuptojnë të fshehtat!

Mjekët e Zotit e kuptojnë sëmundjen e fesë dhe të zemrës
nga fytyra e myridit dhe e të huajit,
nga toni i zërit, nga ngjyra e syve.
Jo vetëm kaq, ata kuptojnë edhe nga rruga e zemrës,
sepse ata janë spiunë të zemrës... Kur të uleni me ta,
të uleni me zemër të drejtë!

Këta mjekë të trupit janë mjaft të ditur. Sëmundjet e tua i dinë më mirë se ti!

Ta vërejnë urinën dhe ta kuptojnë gjendjen. Por ti nuk mund ta njohësh, nuk mund ta përcaktosh sëmundjen në atë formë!

Pastaj, nga pulsi, nga ngjyra e fytyrës, nga gjaku e nuhasin çdo sëmundje.

Po mjekët e Zotit në këtë botë, si nuk ta kuptojnë dot gjendjen pa ua thënë ti?

Edhe nga pulsi, edhe nga syri, edhe nga ngjyra e fytyrës kuptojnë dhe gjejnë menjëherë qindra sëmundje tek ti!

Mjekët e trupit sapo e kanë mësuar mjekësinë... Për ta përcaktuar sëmundjen, ata kanë nevojë për urinën, etj.

Kurse njerëzit e lartësuar shpirtërisht, mjekët e Zotit, sapo t'ia dëgjojnë emrin nga larg, hyjnë gjer në thellësi të qenies!

Madje, i shohin gjendjet e tua të viteve të mëparshëm ende pa lindur ti!

Zoti ua shenjtëroftë shpirtrat, Ebujezidi lajmëron vite më parë
lindjen e Hasan Harkaniut, i thotë një e nga një shenjat
mbi pamjen dhe karakterin e tij
dhe historianët i shkruajnë ato për t'i shqyrtuar.

A nuk e ke dëgjuar se si Bajazidi e pati parë qysh më parë gjendjen e Ebulhasanit?

Një ditë, ndërsa ai mbret devocioni po kalonte nëpër fushë me dervishët e tij,

Papritmas, nga Harkani në rrethinat e Rejit, i erdhi një kundërmim.

Atje lëshoi një klithmë të dëshiruar dhe nuhati erën.

Nuhati me dëshirë të madhe; shpirti pothuaj po i shijonte një verë prej ere.

Në faqen e jashtme të shtambës të mbushur me ujë të akullt, derdhen ujëra si djersë.

Kjo ndodh nga nxehtësia e mjedisit dhe jo se uji i shtambës rrjedh nga brenda jashtë.

Era që sillte kundërmimin, e sillte si ujë. Ja, pra, si ajo, edhe Bajazitit i kishte ardhur si verë e vërtetë!

Kur te Bajaziti u dukën shenja dehjeje, një myrid i shkoi dhe e pyeti:

"Ç'është kjo gjendja jote e këndshme jashtë pesë shqisave dhe gjashtë anëve?

Fytyra jote herë skuqet, herë zverdhet, herë zbardhet; ç'është kjo gjendje, kjo myzhde?

Je duke nuhatur, por në dukje nuk ka trëndafil.

Pa dyshim, kjo është nga bota e fshehtë, nga trëndafilishtja ku çelin trëndafilat e vërtetë!

O njeri që e njeh veten, që ke synime dhe qëllime prej njeriu të ditur, çdo çast ty të vjen nga bota e fshehtë një lajm, një letër,

Çdo çast, si Jakubit, edhe ty të arrin një aromë shërimi nga Jusufi!

Na derdh neve një pikë nga ajo shtambë. Na përshkruaj edhe neve një aromë nga ajo trëndafilishte!

Ne nuk jemi mësuar me këtë, o njeri i lartë e i bukur. Buzët tona janë të thata ndërsa ti e pi vetë këtë verë!

O burrë i shkathët, o njeri që e shëtit qiellin nga të gjitha anët, na jep edhe neve një gllënjkë nga vera që pi ti!

Në këtë kohë ti je zotëria i kuvendit, jo tjetërkush..., pra shihna edhe ne!

A pihet kjo verë fshehtas nga ne? Vera patjetër e demaskon njeriun, e bën rezil!

Edhe nëse ia fsheh aromën, ç'do t'i bësh sytë e dehur?

Fundja, në këtë botë, kjo aromë nuk është e tillë që të mund të fshihet as nën qindramijëra mbulesa!

Me atë aromë të mprehtë u mbushën fusha e shkretëtira... Po ç'është fusha? Ajo aromë i kaloi nëntë qiejt, madje!

Mos ia mbulo me baltë kokën shtambës ku ndodhet kjo verë! Fundja, kjo është një verë aq në shesh, sa nuk ka mundësi të mbulohet!

O rrëfyes i të fshehtave që e njeh të fshehtën, ki mirësinë e na e thuaj se kush të ka gjuajtur ty!"

Bajazidi tha: "Mua më erdhi një aromë për t'u çuditur... Si aroma që i erdhi Pejgamberit nga Jemeni!

Muhammedi ka thënë: "Me dorën e flladit të agimit, mua më vjen nga Jemeni aroma e Zotit!"

Siç i erdhi shpirtit të Vises aroma e Ramiut, edhe nga Uvejsi vjen aromë e Zotit!

Nga Uvejsi, nga fisi Karen erdhi një aromë e çuditshme dhe Pejgamberin e dehu, e mbushi me hare!

Uvejsi kishte kapërcyer veten dhe, ndërsa i përkiste tokës, ishte bërë qenie qiellore!

Ishte përzier me barin halile e me sheqer, ishte brumosur me të ëmbël dhe s'i kishte mbetur shije e hidhur!

Me barin halile e kishte humbur krejtësisht qenien... Ishte vetëm në formë halile, por shije s'i kishte mbetur!"

Kjo fjalë s'mbaron! Ti thuaj se ç'tregoi ai njeri nga mesazhi i botës së fshehtë! Atë tregona ti!

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë:
"Unë e marr kundërmimin e Mëshiruesit nga drejtimi i Jemenit!"

Bajazidi tha: "Nga kjo anë po vjen aroma e një miku... Nga ky fshat po vjen një sovran!

Pas shumë e shumë vitesh do të lindë një sovran që do ta ngrerë çadrën në qiej!

Fytyra do t'i marrë ngjyrën e trëndafilit nën efektin e trëndafilishteve të Zotit! Në pozitë dhe detyrë do të jetë mbi mua!"

I thanë: "Si e ka emrin?" Ai tha: "Bajazid, Ebulhasan..." Ia përshkroi pamjen dhe harkun e vetullës!

Tregoi një për një për shtatin, ngjyrën, trajtën, flokët dhe fytyrën.

Ia përshkroi shprehitë e brendshme, cilësitë shpitërore e morale, shpirtin, rrugën, vendin, pasurinë.

Forma e trupit është e përkohshme si trupi, pra, mos ia jep zemrën asaj, sepse brenda një çasti vjen e shkon!

Natyrisht, edhe forma dhe gjendja e shpirtit janë të përkohshme, prandaj kërko formën dhe cilësinë e atij shpirti që është në qiell!

Trupi i tij është si qiriu mbi tokë, kurse drita dhe bukuria e tij, mbi tavanin e shtatë qiejve!

Dritat e diellit janë në dhomë, por dielli është në qiellin e katërt.

Formën e trëndafilit e sheh nën hundën me rrugë të holla, por aroma e trëndafilit ka zënë çdo vend, gjer në tavan në kokës!

Njeriu që fle sheh se në Aden ka pësuar një aksident, kurse reflektimi i kësaj në trup duket në formë djerse.

Këmisha pati mbetur peng në Egjipt në dorën e një koprraci, por vendi i Kenanit që mbushur me aromën e asaj këmishe!

Kur historianët e dëgjuan këtë, e shkruan kohën e përcaktuar nga Bajazidi. Kalemat prej kallami që pothuaj i ngjanin hellit, i stolisën me qebap.

Kohët kaluan dhe, kur erdhi dita, lindi ai sovran që luajti shahun e fatit!

Pas vdekjes së Bajazidit kaluan vite dhe erdhi në botë Ebulhasani.

Ç'të kishte thënë ai sovran për shprehitë e mirësisë dhe zilisë së Ebulhasanit, dolën në shesh po ashtu!

Sepse është Levhi Mahfudh, Tabela e Kujtesës, që i shkonte para. Ajo tabelë është e mbrojtur nga gabimi!

Kjo nuk është as astrologji, as ëndërr. Zoti e di më mirë se ç'është e drejtë, apo jo? Është mesazh i Zotit!

Për ta fshehur nga populli, sofitë e kanë quajtur këtë mesazh zemre.

Në daç ti, supozoje atë mesazh zemre, se, fundja, zemra është vendvështrimi i Zotit. Nëse zemra është e njohur për të, si mund të bëjë gabim?

O besimtar, ti sheh me dritën e Zotit, pra, je i siguruar nga gabimi, nga gënjimi!

Pakësimi i ushqimit të Zotit që i shkonte shpirtit dhe zemrës së sofiut.

Kur sofiu dëshpërohej për papasjen, papasja i bëhej dado dhe ushqim.

Sepse xhenneti është formuar prej gjërave që s'të pëlqejnë... Mëshira është pjesa që përfitojnë viktimat zemërthyera.

Personi që mbahet më të madh dhe u thyen kokën të tjerëve me këtë, nuk përfiton as nga mëshira e Zotit, as nga mëshira e njerëzve!

Kjo fjalë s'ka fund... Po, ai trim u shkatërrua nga pakica e sasisë së bukës dhe ushqimeve që i binin në pjesë!

Ç'lumturi për atë sofi që i pakësohet rizku, furnizimi me ushqime. Medaljoni i bëhet margaritar, vetë shndërrohet në det!

Ai që e ndjen atë nafaka të posaçme të Zotit, arrin afërsinë e Zotit, fiton nafakanë e botës së fshehtë.

Por shpirti i personit të mangët në nafakanë shpirtërore, nis të dridhet për shkak të asaj mungese.

Dhe e kupton se ka bërë një gabim, për pasojë, lulishtja e jaseminëve të tij është prishur.

Ja, pra, edhe ai njeriu, për shkak të prodhimit të pakët, i shkroi letër të zotit të lëmit.

Letrën e tij ia dërguan atij padishahut të drejtë e të lartë, i cili e lexoi, por nuk i dha përgjigje.

Ai tha: "Halli i tij është vetëm ushqim, jo gjë tjetër... Përgjigjja më e mirë që i duhet dhënë kokëtrashit është heshtja!"

Tek ai nuk ka fare hall ndarjeje apo bashkimi; është lidhur pas gjërave të dyta, origjinën nuk e kërkon fare.

Ai është i pagdhendur; është kapur pas qenies, ka vdekur e shkuar... Por kjo s'i bën as përshtypje, sepse e ka hallin te gjërat materiale.

Zëre se qiejt dhe toka janë një mollë; një mollë e bërë në pemën e fuqisë së Zotit!

Ti i ngjet krimbit brenda mollës, nuk ke dijeni as për pemën, as për kopshtarin!

Në mollë është edhe një krimb tjetër, por shpirti i tij është flamurtar në botën e jashtme!

Lëvizja e tij e çan mollën... Molla nuk e pengon dot lëvizjen e tij!

Lëvizja e tij i gris perdet. Pamjen e ka krimb, por, në të vërtetë, është kuçedër!

Zjarri i parë i dalë nga hekuri hedh hap dalngadalë jashtë.

Më parë e kishte dadon pambuk, por, në fund, rrezatimet e tij ngjiten gjer në eter!

Njeriu në fillim është nevojtar për gjumë dhe bukë, por, më në fund, bëhet më i lartë edhe se engjëjt!

Nën mbrojtjen e pambukut dhe squfurit, flaka dhe drita ngjiten gjer te Arusha e Madhe!

E ndriçojnë gjithësinë e errët. Edhe shufrën prej hekuri e shpojnë me gjilpërë dhe e kalojnë.

Edhe zjarri është material, por nuk është as prej shpirti, as prej botës shpirtërore!

Trupi material nuk ka pjesë nga ajo lartësi sublime. Trupi material është si një pikë përballë detit të shpirtit!

Trupi material shtohet me anë të shpirtit, shumohet nga dita në ditë. Por po iku shpirti, shihe trupin se në ç'gjendje vjen!

Efekti i trupit material nuk shkon më tej se nja dy arshin, kurse i shpirtit, ngjitet gjer në qiej e përsillet!

O njeri i mirë, në përfytyrimin e shpirtit, Bagdadi dhe Samarkandi janë vetëm gjysmë hapi larg!

Syri juaj është një copë dhjami i rëndë dy dërhem, kurse drita e shpirtit e përfshin çdo anë gjer në qiej!

Drita e shpirtit e sheh çdo gjë edhe në gjumë, pa sy. Kurse syri pa këtë dritë mbetet gërmadhë e mbaron!

Shpirti yt nuk ka punë me mjekrën dhe mustaqet e tua, por pa shpirtin, trupi është i fëlliqur, i ulët!

Ky trup është shkak për paraqitjen madhështore të shpirtit shtazor. Ti shko më parë dhe shihe shpirtin njerëzor!

Kalo edhe nga njeriu, edhe nga thashethemet dhe arri në bregun ku mbështetet dhe rri shpirti i Xhebrailit!

Pastaj, shpirti i Ahmedit të kafshojë buzën përballë teje, Xhebraili të frikësohet prej teje, të mbetet pas!

Dhe të të thotë: "Edhe sikur të të afrohem sa një hark, digjem menjëherë!"

Skllavi zemërohet keqas ngaqë nuk i vjen përgjigje nga padishahu letrës së vet.

Kjo fushë nuk ka as krye, as fund... Ndërkaq, skllavi rri i mërzitur ngaqë nuk i ka ardhur përgjigje për letrën!

Ai thotë me vete: "Ç'gjë e çuditshme, pse s'më shkroi padishahu përgjigje? Apo mos dërguesi i letrës bëri ndonjë tradhti!

A mos e fshehu letrën dhe nuk ia dha padishahut? A mos qe ndonjë hipokrit që të fut ujët nën rrogoz?

Por unë do të shkruaj një letër tjetër për provë dhe do të gjej një dërgues tjetër të aftë e me edukatë!"

Nga injoranca, ai i bënte me faj padishahun, përgjegjësin e kuzhinës dhe dërguesin e letrës.

Dhe nuk e kërkonte të metën tek vetja se mos kishte vepruar shtrembër në rrugën e fesë!

Era fryn në të kundërt për shkak të një të mete të Sulejmanit (a.s.).

Era fryu në të kundërt të fronit të Sulejmanit. Sulejmani i tha: "O erë, mos fry në të kundërt!"

Edhe era i tha: "O Sulejman, mos vepro në të kundërt! Nëse vepron në të kundërt, mos u zemëro me mua po të fryj në të kundërt!"

Zoti e krijoi këtë peshore që ne të marrim mësim dhe të bëhemi të matur.

Po vure ti dërhem mangët, edhe unë peshoj mangët. Po më trajtove drejt ti mua, edhe unë të trajtoj ty drejt!

Kështu edhe kurora e Sulejmanit u shtrembërua! Dita e ndritshme u bë pothuaj natë për të!

Sulejmani tha: "O kurorë, pse më shtrembërohesh mbi kokë? O diell, mos më përjashto mua nga lindja jote!"

O trim, sa ta rregullonte ai kurorën me dorë, kurora shtrembërohej prapë!

Plot tetë herë e rregulloi dhe të tetë herët ajo u shtrembërua. Dhe ai i tha: "O kurorë, ç'është kjo? Mos u shtrembëro më!"

Kurora i tha: "Edhe sikur njëqind herë të më drejtosh, prapë kam për t'u shtrembëruar, sepse, o njeri i besueshëm, ti vetë shtrembohesh!"

Pas kësaj, Sulejmani drejtoi zemrën, u ftoh nga epshi në zemër!

Atëherë, edhe kurora iu drejtua menjëherë dhe i qëndroi në kokë siç deshte ai!

Pastaj Sulejmani e shtrembëronte enkas, kurse kurora, për inat të tij, drejtohej.

Ai pejgamber i madh e shtrembëroi tetë herë kurorën, kurse ajo, çdo radhë, të tetë herët, u drejtua!

Kurora u bë me gojë dhe i tha Sulejmanit: "O sovran, përkëdhelu pak; meqë e shkunde pluhurin e dheun nga flatrat, fluturo!

Sepse unë nuk kam leje për të kaluar më tej, për t'i grisur perdet e padukshme të kësaj të fshehte!

Vëma pëllëmbën në gojë dhe mbyllma gojën që ajo të mos thotë gjëra të papëlqyera!"

Shkurt, po të erdhi e keqja, mos bëj fajtor të tjerët, por shih veten!

O mik, mos pandeh se kjo punë u bë nga të tjerët! Mos u përpiq kot siç përpiqej ai skllavi!

Skllavi herë merrej e grindej me përgjegjësin e kuzhinës, herë nxehej me padishahun bujar!

Krejt si Faraoni! Ai e pati lënë Musain dhe priste kryet e foshnjave të popullit!

Kurse armikun e kishte mu në shtëpi! Kurse ai ua priste kokat të tjerëve!

Edhe ti, bëhesh i keq me të tjerët në botën e jashtme ndërkohë që në botën tënde të brendshme pajtohesh me nefsin tënd!

Ai është armiku yt, kurse ti i jep sheqer atij! Kurse të gjithë të tjerët jashtë i vë nën dyshim!

Ti je i verbër si Faraoni, e ke zemrën të verbër. Je i mirë me armikun kurse të pafajshmit i poshtëron!

O faraon, gjer kur do t'i vrasësh të pafajshmit dhe do ta përkëdhelësh nefsin tënd që është fajtori i vërtetë?

Mendja e Faraonit ishte më e lartë se mendja e padishahëve, por vendimi i Zotit e kishte bërë pa mend dhe të verbër!

Po t'ia mbyllë Zoti dikujt syrin dhe veshin e zemrës, ai njeri bëhet kafshë edhe sikur të jetë Platoni vetë!

Shkurt, ashtu siç qe shfaqur vendimi i fshehtë për Bajazitin, ashtu shfaqet pashmangërisht vendimi i Zotit mbi tabelë!

Shejh Ebulhasani (r.a.) dëgjon se Ebujezidi ka folur për të dhe për gjendjen e tij.

Ndodhi siç pati thënë Bajazidi; Ebulhasani e dëgjoi këtë nga njerëzit e tij:

"Hasani do të bëhet ummeti dhe myridi im. Çdo mëngjes ka për të marrë mësim te varri im!"

Edhe vetë tha: "Edhe unë e pashë shehun tim në ëndërr. E dëgjova këtë fjalë nga shpirti i tij!"

Çdo mëngjes ai drejtohej për te varri i tij dhe i qëndronte pranë gjer në kohën e sillës.

Ose shkonte në krye të atij varri si të shkonte pranë një shehu, ose i kryheshin vështirësitë pa fjalë.

Më në fund, një ditë, shkoi prapë me bekime te kryet e atij varri. Sapo kishte rënë borë dhe varret ishin mbuluar me borë.

Ai u shqetësua kur pa se bora po lartësohej shtresë-shtresë mbi varr, po grumbullohej si kube mbi varr!

Nga varri i atij shehu të gjallë erdhi një zë: "Unë jam këtu dhe po të thërres vazhdimisht të vish tek unë!

Eja në vete dhe vrapo pas zërit tim, drejtohu nga kjo anë. Mos u largo nga unë edhe sikur e gjithë bota të mbushet me borëra!

Atë ditë, gjendja e Ebulhasanit u rregullua. Gjërat e çuditshme që i pati dëgjuar më parë, iu shfaqën atë ditë atij vetë!

Pasi nuk i vjen përgjigje për letrën e parë, skllavi i shkruan padishahut një letër tjetër.

Skllavi me pandehma të këqija shkroi një letër tjetër plot me qortime dhe ankime.

Dhe tha me vete: "I shkrova një letër tjetër më parë padishahut, por nuk e di, a i ra në dorë?"

Padishahu fytyrëbukur e lexoi edhe atë letër, por nuk i dha përgjigje, nuk i bëri zë.

Padishahu s'po ia vinte veshin. Edhe ai i shkroi plot pesë herë letër!

Më në fund, shambellani i tha: "Edhe ai është robi juaj... E vlen t'i jepni përgjigje.

Po t'i jepni përgjigje, po ta shihni me të mirë një rob, një skllav, ç'ju pakësohet nga padishallëku?"

Padishahu i tha: "Kjo është e lehtë, por ky skllav është i hutuar. Ky njeri kokëtrashë është i shëmtuar, është i ndyri i Zotit!

Ia fal gabimin, fajin, por sëmundja e tij më ngjitet edhe mua pastaj!"

Një zgjebarak i bën zgjebarakë njëqind të tjerë. Sidomos zgjebaraku i ndyrë që nuk e pëlqente qëndrimin e padishahut, ishte më i keq!

As qafirit të mos i ngjitet zgjebja e kokëtrashësisë, ndryshe, e keqja e tij i than edhe retë!

Atëherë, nga retë nuk pikon pikë shiu, qyteti kthehet në gërmadhë për shkak të atij bufi!

Për shkak të zgjebarakërisë së atyre kokëtrashëve, përmbytja e Nuhut e shembi një botë të tërë!

Pejgamberi ka thënë: "Kush është kokëtrashë, është armiku ynë, është lugat që të pret rrugën!

Po qe i mençur, e kemi zemër; flladi i freskët që vjen prej tij, era që vjen prej tij, madje, është mbarësi!

Jam dakord sikur të më shajë mendja, sepse zotëron një frymëzim nga frymëzimshmëria ime.

Sharja e tij s'është pa dobi. Ai nuk të vjen për vizitë me duar bosh!

Edhe sikur kokëtrashi të më fusë hallvë në gojë, sëmurem nga ajo hallvë, më hipën nxehtësia!

Në qofsh i mprehtë, n'e paç zemrën të ndriçuar, dije mirë këtë: Nuk është ndonjë kënaqësi t'ia puthësh bythën gomarit!

T'u lë erë të keqe mustaqeve kot më kot. Të fëlliqen rrobat me tenxheren e tij edhe pa ngrënë gjellë prej saj!

Gjella për të cilën po flas, është mendja, jo buka dhe qebapi! O bir, ushqimi i shpirtit është drita e mendjes!

Për njeriun nuk ka ushqim tjetër veç dritës. Njeriu nuk ushqehet e nuk rritet me gjë tjetër veç atij shpirti!

Këto ushqime pakësoji dalngadalë, sepse këto janë ushqim gomari, jo ushqimi i njeriut të lirë!

Pakësoji këto dhe le të aftësohesh për të marrë ushqimin e vërtetë, për të ngrënë kafshata prej drite!

Kjo bukë është bukë me reflektimin e asaj drite! Ky shpirt është shpirt me begatinë e atij shpirti!

Sapo të hash një herë bukën e dritës, i hedh dhé sipër edhe bukës, edhe furrës!

Mendja është dy mendje: Njëra, mendja e fituar. Ti e mëson atë siç e mëson fëmija në shkollë.

Nga libri, mësuesi, mendimi, kujtesa, idetë, dijenitë e bukura e të paprekura!

Mendja të shtohet, bëhesh më i mençur se të tjerët. Por edhe rëndohesh e mërzitesh nga mësimi përmendësh!

Duke shëtitur e u përsjellur, pothuaj bëhesh tabelë përsëritjeje përmendësh. Mirëpo ai që kalon nëpër këto, bëhet tabelë kujtese!

Mendja tjetër është e dhënë e Zotit. Burimi i saj është te shpirti.

Kur lumi i dijes të shpërthejë nga zemra, as merr erë, as vjetërohet, as zverdhet!

Punë e madhe nëse rruga e burimit është e mbyllur, sepse ai gurgullon çdo çast brenda në shtëpi!

Mendja e fituar me mësim u ngjan lumenjve. Ata dalin prej këtu apo aty dhe shkojnë nëpër shtëpi!

Po iu zu rruga, mbetet i pashpresë, nuk rrjedh! Ti kërkoje çezmën në zemër!

Një njeri takohet me një njeri tjetër dhe i kërkon këshillë,
kurse ai i thotë se është armiku i tij,
prandaj të kërkojë këshillë nga dikush tjetër.

Një njeri këshillohet me dikë; ai kërkonte të shpëtonte nga lëkundja, të lirohej nga burgu!

Ai tjetri i tha: "Mirë e ke, por kërko dikë tjetër dhe këshillohu me të!

Se unë jam armiku yt, pra, mos u kap pas meje! Masa e armikut nuk bëhet e ndritshme!

Shko dhe kërko dikë që të të bëhet mik. S'ka dyshim se miku ia do të mirën mikut!

Unë të jam armik, nga dikush si unë nuk gjen zgjidhje. Shkoj shtrembër dhe të bëj keq.

S'është diçka me vend të kërkosh nga ujku të të bëjë roje! Të kërkosh diçka atje ku nuk ndodhet, do të thotë të mos e kërkosh!

Mos ki aspak dyshim se unë jam armiku yt! Unë jam ai që ta pres rrugën, si mund të ndodhë që të të tregoj rrugë?

Kush rri e ngrihet me miqtë, edhe sikur në vatër të hirit të ndodhet, është në trëndafilishte!

Por ai që rri e ngrihet me armikun e kohës, edhe sikur të ndodhet në trëndafilishte, është te vatra e hirit!

Askush mos t'u bëftë armik që e ngacmon mikun duke parë interesin e vet!

Bëju të mira njerëzve për hir të Zotit ose bëji mirë kujtdo për shpirtin tënd,

Në mënyrë që gjithmonë të të duket mik, që në zemër, për shkak të urrejtjes, të të mos vijnë fytyra të shëmtuara!

Por nëse dikujt i bën armiqësi, ruhu prej tij! Takohu me një mik që të do dhe këshillohu me të për çfarë kërkon të këshillohesh!"

Njeriu i tha: "O njeri i mirë, të njoh, ti je armiku im i vjetër!

Por je njeri i mençur e shpirtëror; mendja s'ta pranon të shkosh shtrembër!"

Natyra kërkon ta nxjerrë inatin nga armiku, por mendja është zinxhir hekuri për nefsin!

E pengon atë nga e keqja, e tërheq pas. Mendja është si një pushtetar kontrollues për veprimet e tij të mira e të këqija!

Mendja besimtare i ngjan një pushtetari të drejtë; është roja dhe gjykatësi i qytetit të zemrës!

Ai e ka mendjen të zgjuar si të maces. Hajduti shtanget në vend si miu në vrimë!

Atje ku del miu dhe prek diçka, ose atje s'ka mace, ose ka, por vetëm sa për formë!

Ç'është macja? Luani që shemb luanë! Mendja besimtare e trupit!

Vështrimi i saj sundon mbi kafshët grabitqare. Bërtitja e saj i pengon kafshët që kullosin bar!

Qyteti është i mbushur plot me vjedhës, me grabitës veshjesh... Thuaj, le të ketë pushtetar, le të mos ketë!

Në një luftë, megjithëse në ushtri ndodheshin njerëz të moshuar dhe me përvojë lufte, i Dërguari i Allahut (a.s.) cakton si komandant një djalë të ri nga fisi Huzejl.

Pejgamberi dërgonte një ushtri për të luftuar me qafirët, për t'i fshirë gjërat e kota!

Ai zgjodhi një djalë të ri nga fisi Huzejl dhe e caktoi komandant të ushtrisë.

Komandanti është baza e ushtrisë. Fisi pa komandant është si trupi pa kokë!

Kjo vdekja jote, kjo zbehja dhe ky mbarimi yt janë për shkak se ti e braktis komandantin!

Janë për shkak të mërzitjes, të kurrnacërisë, të tërheqjes në egoizëm, të faktit që e quan veten komandant!

Krejt si mushka që ikën prej barrës. Edhe ajo e vë kokën para dhe merr malet!

I zoti, po, i hutuar! Në çdo anë ka nga një ujk të fshehur për të gjuajtur gomerë!

Tani, po të më humbesh nga sytë, çdo çast mund të të dalë një ujk i fuqishëm!

T'i shtyp e t'i thërrmon kockat si sheqer dhe kurrë më s'ke për ta parë dot të ngrihesh në këmbë!

Edhe sikur ta lëmë ujkun mënjanë; a mbetesh pa zjarr? Po s'pati dru, zjarri shuhet e mbaron!

Eja në vete dhe mos ik nga zotërimi im, mos u druaj nga barra! Shpirti yt vrapon pas meje ku e gjen veten!

Edhe ti je një mushkë, sepse të sundon nefsi, egoja! O ti që i falesh vetes, sundimi është i atij që është lart!

Por Zoti, epiqendra e madhështisë, nuk të tha gomar, të tha kalë! Arabi i thotë "taal" kalit arab.

Mustafai është, nga Zoti, përmirësuesi i mushkave të nefsit përz t'u kujdesur dhe për t'i vënë në rrugë ato.

Me tërheqjen prej bujari, u tha: "Ejani... ejani t'ju zbus dhe edukoj se unë jam edukator!"

Sa e sa shqelma hëngra nga këto mushka gjersa i bëra nefset të heqin dorë nga kokëfortësia dhe teprimi!

Ku të ketë një burrë që t'i zbusë të tërbuarit, ai s'ka mundësi të shpëtojë nga shqelmat e tyre!

Shkurt, shumica e ngatërresave dhe kokëçarjeve u vijnë pejgamberëve, sepse t'i sjellësh në rrugë njerëzit e pagdhendur është ngatërresë dhe kokëçarje!

Ju ecni pa rregull; bëni siç ju them unë dhe shkoni revan. Në këtë mënyrë, ejani në gjendje të rregullt dhe bëhuni kuaj që t'jua shalojë padishahu!

Zoti tha: "Thuaju atyre ejani, ejani, o mushka të pamësuara!

Por po të mos vijnë, mos u shqetëso... Mos u zemëro për ata dy të pabindur!"

Veshët e disave janë të shurdhër ndaj fjalës "ejani". Çdo kafshë ka stallën e vet!

Disa frikësohen nga ky zë, ikin. Stalla e çdo kali është e veçantë!

Kurse disa të tjerëve u mërzitet shpirti nga këto rrëfime, sepse kafazi i çdo zogu është tjetër!

Edhe engjëjt, madje, nuk janë të një gjinie; prandaj rrinë në qiell radhë-radhë!

Fëmijët shkojnë në të njëjtën shkollë, por secili qëndron më lart se tjetri për sa i përket mësimit!

Edhe ai që i përket lindjes ka ndjenjat e veta, edhe ai që i përket perëndimit! Por shikimi i është mundësuar syrit, atij i është dhënë mbështetje!

Edhe sikur qindramijëra veshë të radhiten radhë-radhë, prapë janë që të gjithë nevojtarë për një sy të ndriçuar.

Pastaj, edhe veshët kanë një mbështetje për t'i dëgjuar zërin e shpirtit, lajmet e Zotit, urdhrat e pejgamberëve.

Qindramijëra syve nuk u është dhënë aftësia për të ndjerë zë; asnjë sy s'di të dëgjojë!

Kështu, çdo ndijim quaje më vete. Asnjëri nuk e kryen dot punën e tjetrit!

Pesë ndijime të jashtme, pesë, të brendshme! Të gjitha bashkë, dhjetë copë, kanë bërë radhë në këmbë!

Ai që largohet nga radha e fesë, ikën dhe futet në radhën e fundit!

Ti mos e braktis fjalën e trëndafilit, por përsërite vazhdimisht, se ajo është një kimi e madhe!

Po qe se një bakër ka neveri nga fjala jote dhe niset të ikë, ti prapë mos ia kurse kiminë!

Po qe se nefsi, egoja e magjistarit nuk ta dëgjon fjalën tani, ndoshta fjala jote ndikon mbi të në fund dhe sjell dobi!

"Thuaju ejani, o bij, ejani, se Zoti po ju thërret në vendin e shpëtimit!"

O mësues, lëre egon dhe hiq dorë nga sevdaja për t'u bërë komandant! Kërko një komandant dhe bëj siç të thotë ai! Mos vër shumë merak për t'u bërë komandant!

Dikush e kundërshton Pejgamberin pse bëri komandant të riun prej fisit Huzejl.

Kur Pejgamberi e bëri kryekomandant të ushtrisë së tij, e cila meritonte ndihmën e Zotit, atë të riun nga fisi Huzejl,

Një llafazan nuk duroi dot nga zilia dhe u ngrit të kundërshtonte, të ngrinte flamurin e mospranimit të të riut.

Pa shihi njerëzit! Këta janë në botën e errësirës! Për një interes të përkohshëm, ku e lëshojnë veten, si ngrihen të kundërshtojnë!

Për t'u dukur, të gjithë janë përçarë, kanë dhënë shpirtin, janë bërë si të vdekur, kurse në luftë e në kundërshtim janë të gjallë!

Gjë për t'u çuditur është kjo: Çelësi i burgut është në dorë të këtij njeriu, megjithëkëtë, ai është i mbyllur në burg!

I riu është zhytur kokë e këmbë në pisllëk, por ujëvara rrjedh duke ia prekur fundin e rrobës.

Eshtë vazhdimisht pranë e pranë me gjënë e dëshiruar, megjithatë, s'ka as durim, as vendosmëri në kërkesën për të qenë pranë dikujt te i cili do të mbështetej e do të gjente qetësi!

Drita shpirtërore është e fshehtë. Pyetja dhe kërkimi i saj janë dëshmitarë të fshehtësisë së saj. Por zemra nuk lut shpëtim nga fjalët pa kuptim!

Ndërkaq, po qe se në burgun e kësaj bote nuk do të kishte një vend shpëtimi, zemra as do të mërzitej, as do ta kërkonte dhe dëshironte shpëtimin!

Mërzitja dhe dëshpërimi yt, si një nëpunës, të shtyjnë duke të thënë: "Eja, o mëkatar, o i paudhë, kërko një rrugë të drejtë!"

Ka rrugë të drejtë, por është e fshehur në pusi. Për ta gjetur, duhet ta kërkosh si i marrë, pa qëndruar, pa pushuar! E gjen ai që e kërkon kështu!

Përçarja kërkon bashkimin në pusi, prandaj ti, te ky kërkues, shih fytyrën e asaj që kërkohet!

Prodhimi jo i gjallë në arë, kopsht e vreshtë është nisur nga rrënja dhe është rritur... Kuptoje se kush u jep jetë atyre!

Po të mos ishte dikush që të jepte sihariq, a do të nguleshin e mbeteshin në derë syte e atyre që jetojnë në këtë burg?

Po të mos kishte lumenj, a do të kishte kush të futej e të lagej në qindramijëra lumenj?

Nuk mund të shtrihesh, nuk mund të gjesh prehje përtokë... Dije se në shtëpi ke shtrat e mbulesa!

Po të mos ketë një vend ku të gjendet qetësi, nuk ka njeri të paqetë; po të mos gjendet një gjë që e heq hutimin, nuk gjendet hutim!

Ai njeriu tha: "Jo, jo, o i dërguari i Zotit, bëj një të moshuar kryekomandant të ushtrisë!

O i dërguari i Zotit, edhe sikur i riu të jetë luan e bir luani, nuk mund të bëhet komandant ushtrie dikush tjetër veç një të moshuari!

Fundja, ti ke thënë, jam dëshmitar se është fjala jote: "Personi që do t'i shkohet pas, duhet të jetë plak!"

O i dërguari i Zotit, shihe këtë ushtar! Ka shumë vetë më të moshuar e më të parë se ai!

Mos e shih gjethen e verdhë të kësaj peme, por mblidh mollët e pjekura të saj!

Si mund të jenë pa gjë gjethet e saj të verdha? Zverdhja e gjethes është shenjë pjekurie!

Zverdhja e fytyrës, zbardhja e flokëve dhe mjekrës tregojnë për mendjen e pjekur!

Kurse gjethja e porsadalë, e porsagjelbëruar provon papjekurinë e frutit!

Ushqyerja pa ushqim është shenjë e heqjes dorë nga gjithçka, shenjë e pjekurisë shpirtërore. E verdha e floririt ia skuq fytyrën sarrafit, i sjell gjak fytyrës!

I riu faqetrëndafil e mjekërpadirsur është ende duke mësuar në shkollë të shkruajë e të këndojë!

Shkronjat dhe shkrimin i ka të shtrembra... Edhe sikur të jetë i mbushur në trup, mendjen e ka të pakët!

Edhe sikur plakut të mos i punojë këmba, mendja i ka krahë me të cilat fluturon në lartësira!

Po deshe shembull, shihe Xhaferin! Në vend të duarve e këmbëve, Zoti i dha krahë!"

Lëre floririn... Kjo fjalë është e mbuluar, zemra më ra në vuajtje si zhvë!

Qindra heshtje me fjalë e zë të bukur brenda vetes sime vënë dorën në gojë, thonë "mjaft më!"

Heshtja është det, e folura i përngjet lumit... Deti të kërkon ty, ti mos e kërko lumin!

Mos e kthe kryet mënjanë nga shenjat e detit... Mbaroje fjalën, Zoti e di se ç'është më e drejtë!

Ai njeri i paedukatë nxirrte fjalë nga buzët e ftohta në prani të Pejgamberit dhe, kështu, vazhdonte të fliste.

Ai njeri i pamarrëvesh kishte gjetur rastin për të folur dhe s'kishte të pushuar. Fundja, dija është gjë e kotë në krahasim me shikimin!

Këto lajme kalojnë gjithmonë në vendin e shikimit. Kur nuk shihet gjë, i jepet rëndësi lajmit. Nuk jepet lajm për atë që e ke para syve, por për até që mungon!

Kur dikush të arrijë në pozitën e shikimit, atëherë për të nuk kanë asnjë vlerë lajmet!

Kur të jesh takuar me njeriun e dashur e të fillosh të rrish me të, jepu leje kallauzëve!

Personit që e kalon fëmijërinë dhe bëhet burrë, i vjen e ftohtë edhe letra, edhe gruaja që bëhet kallauze!

Edhe sikur ta lexojë letrën, e lexon për t'ua mësuar atyre që s'dinë. Edhe sikur të flasë, flet për të treguar!

Eshtë gabim të flasësh për lajme para atyre që kanë sy për të parë, sepse kjo e folur është provë e padijes dhe mangësisë sonë.

Heshtja para atij që ka sy për të parë, të jep dobi ty! Prandaj ka ardhur urdhri: "Kur të këndohet Kur'an, heshtni dhe dëgjoni!"

Po qe se njeriu i pjekur e syçelur të thotë të flasësh, fol mirë e me edukatë, pak dhe pa e zgjatur fjalën!

Po të të urdhërojë ta zgjatësh, prapë zbatoje urdhrin, fol duke u turpëruar!

Me të vërtetë, edhe unë tani, duke e shkruar këtë Mesnevi të bukur, kështu po bëj, o dritë e Zotit, Husameddin!

Po të dua të sillem me mend dhe ta pres shkurt, ai më kërkon të flas me njëqind lloj pretekstesh!

O Husameddin, dritë e Zotit që është qendër e arsyes, meqë sheh, ç'kërkon nga fjalët?

Kjo duhet të jetë nga oreksi i tepërt! Si ka thënë poeti? "Edhe më sill verë, edhe më thuaj se kjo është verë!"

Këtë çast, kupa e saj është në buzët e tua, por edhe veshi thotë që t'i japësh pjesën që i përket!

O vesh, pjesa jote po nxehet! Ja, ç'është nxehtësia, ja ç'është dehja! Por veshi thotë se do më shumë se kaq sepse është i pangopur!

Mustafai (a.s.) i jep përgjigje kundërshtuesit.

Kur ai arabi e kaloi masën e fjalëve në prani të Mustafait me sjellje të ëmbla,

Ai të cilit i drejtoheshin fjalët e Kur'anit, duke kafshuar buzën, i tha arabit: "Mjaft fole!"

Vuri dorën në gojë që të mos flasë... Pse duhet të flasësh pranë atij që i di të fshehtat?

Ke çuar bajgën e tharë para burrit syçelë dhe i thua që ta blejë në vend të miskut!

O truqelbur, e ke vënë bajgën e devesë nën hundë dhe bën "oh, oh" tërë kënaqësi!

O syvëngër i shastisur! Për të t'u pëlqyer basma e keqe, lëshon klithma kënaqësie!

Në këtë mënyrë, kërkon ta gënjesh atë hundë të pastër, ta mashtrosh atë burrë të shtrirë në trëndafilishtet e qiejve!

Butësia e tregon atë sikur s'kupton, por edhe ti duhet ta njohësh pak veten!

Nëse këtë natë tenxherja ka mbetur e zbuluar, edhe macja duhet të ketë pak turp!

Arifi dritëkulluar e tregon veten sikur po fle, por është krejt i zgjuar, prandaj mos tento t'ia rrëmbesh çallmën!

O inatçi i fëlliqur, pse duhet të vazhdosh ta tregosh këtë përrallë djallëzore në prani të Mustafait?

Këta kanë qindramijëra butësi... Edhe një butësi e vetme e tyre, madje, vlen sa qindra male!

Butësia e tyre e budallalleps edhe burrin e zgjuar, e huton njeriun e mençur që ka qindra sy, e bën ta humbë rrugën, të prapësohet!

Si një verë e ëmbël dhe e kulluar, butësia e tyre shkon gjer në majë të truve, përhapet në të gjithë trupin!

Shihe atë të dehurin nga vera e fortë! Si Ferzini i dehur, filloi të ecë shtrembër!

Nën ndikimin e verës që e merr shpejt njeriun, i riu mbetet e shtrihet në rrugë si të ishte plak!

Pa le vera e shtambës "Belá, po, ti je Zoti ynë"! Kjo nuk është verë me dehje një nate!

Shokët e Shpellës e pinë atë verë dhe e humbën mendjen plot treqind e nëntë vjet pa zgjatur dorën në meze e pa lëvizur vendit!

Gratë e Egjiptit pinë një kupë të vogël nga kjo verë dhe i prenë gishtat!

Edhe magjistarët ranë në dehjen e Musait dhe e pandehën lakun ku do të vareshin, për të dashur!

Xhafer Tajjari u deh nga ajo verë dhe i flijoi duar e këmbë!

Ebujezidi - Zoti ia shenjtëroftë të fshehtën - thotë për vete:
"E deklaroj veten të pastër! Sa e lartë është fama dhe shfaqja ime!"
Dervishët e kundërshtojnë. Bajaziti u jep përgjigje atyre jo me fjalë, por duke treguar të vërtetën.

Ai i varfri i shkëlqyer, Bajazit, u tha dervishëve të vet: "Unë jam Zoti!"

Ai burrë që i zotëronte shkencat, u tha hapur, si i dehur: "Nuk ka Zot tjetër veç meje... Dijeni këtë dhe falmuni mua!"

Pasi i kaloi ajo gjendje, në mëngjes, i thanë: "Ti the kështu... Kjo nuk është e drejtë!"

Ai u tha: "Po ta them edhe një herë tjetër këtë, menjëherë të ma ngulni thikën!

Zoti është i pastër nga trupi, kurse unë kam trup. Kur të flas kështu, duhet të ekzekutohem!"

Pasi ai njeri me vullnet të lirë la këtë porosi, çdo dervish përgatiti një thikë!

Bajaziti e griti parë atë kupë të madhe dhe u deh... Porositë i dolën nga mendja!

I erdhi mezja, mendja i mori malet; erdhi mëngjesi, qiriri i mbeti pa shpresë!

Mendja i ngjet rojes... Kur vjen sulltani, roja i shkretë tërhiqet në një qoshe!

Mendja është hija e Zotit, kurse Zoti, dielli... A mund të durojë, a mund të qëndrojë hija ndaj diellit?

Po qe se peritë dhe xhindët bëhen eprorë ndaj njeriut, cilësia njerëzore te njeriu humbet!

Ç'të thotë njeriu, janë fjalë të perisë. Njeriu që e kanë zënë xhindet, flet, por, në të vërtetë, ato fjalë janë të xhindve, të perive!

Po qe se edhe peria është kaq e aftë, po Zoti i asaj perie si duhet të jetë?

Qenia i ikën, njeriu bëhet peri... Turku që s'merr frymëzim, fillon të flasë arabisht!

Por kur vjen në vete, nuk di asnjë fjalë! Kur peria ta ketë një qenie e një cilësi të tillë,

Si mund të ndodhë që Zoti i njeriut dhe perisë të jetë më poshtë se peria?

Po qe se personi që dehet e bëhet aq trim sa ta kapë luanin, ngrihet për ta mjelë luanin duke e pandehur për luaneshë, atëherë ti thua se këtë punë s4e bëri ai njeri, por vera që piu!

Po qe se vargëzon fjalë të mrekullueshme nga florinjtë e vjetër, ti prapë thua se ato fjalë i ka thënë vera!

Nëse kjo fuqi ndodhet edhe te vera, a s'ndodhet në dritën e Zotit?

Drita e Zotit të merr plotësisht ty nga vetja jote dhe ti bie poshtë, kurse fjala e tij lartësohet!

Kur'ani del nga buzët e Pejgamberit, por kush thotë se nuk e ka thënë Zoti, është qafir!

Kur filloi të fluturonte ethja e humbjes së vetëdijes, Bajaziti filloi të fliste përsëri ashtu!

Mendjen ia rrëmbeu rrebeshi i hutimit. Ai foli më keq se ç'pati folur më parë!

Dhe tha: "Në pelerinën time, në qenien time nuk ka gjë tjetër veç Zotit! Pse kërkoni në qiej e në tokë?"

Dervishët u marrosën... Ia ngulën thikat në trupin e pastër!

Secili, si myridët e Girdekuhit, ia ngulte pa mëshirë thikën pirit të vet!

Mirëpo thika kthehej në të kundërt dhe e plagoste atë vetë!

Kurse në trupin e atij shehu të bekuar nuk dukej shenjë thike ndërkaq që dervishët u mbuluan në gjak!

Kush ia pati ngulur thikën shehut në fyt, preu fytin e vet dhe u shemb i vdekur në vend!

Kush ia pati plagosur gjoksin, u ça vetë në gjoks dhe ngordhi e iku përjetësisht!

Kurse kush ia njihte gradën shpirtërore shehut, nuk tentoi fare për ta plagosur, nuk shfaqi asnjë dëshirë për këtë!

Gjysmëmendja ia lidhi duart dhe, kështu, e shpëtoi veten, ndryshe, edhe ai do të kishte ikur!

U bë mëngjes, kurse dervishët ishin pakësuar... Nga shtëpitë e tyre u ngrit lart një kujë e një vajtim!

Te Bajazidi u mblodhën mijëra burra e gra dhe i thanë: "O njeri që i fut dy botë në një këmishë!

Po qe se trupi yt do të ishte trup njeriu, edhe ai, si trupat e njerëzve të tjerë, do të kishte marrë fund nga plagët e hanxharëve!

Ai që ishte në vete, ra në përhumbje, kurse ata që mbetën në vete, ia ngulën gjembat syve të vet!"

O ti që i godet me shpatën Zylfikar ata që s'janë në vete! Mblidhi mendtë në kokë, se po ia ngul atë shpatë vetes!

Sepse ai që e ka humbur veten është i vdekshëm, ka shpëtuar... Ai është duke ndenjur përjetësisht në këndin e sigurisë!

Pamjen e ka të vdekshme, është bërë pasqyrë dhe në atë pasqyrë nuk shihen gjë tjetër veç fytyrat e të tjerëve!

Nëse pështyn, pështyn në fytyrën tënde; nëse e godet pasyrën, godet veten tënde!

Nëse sheh aty një surrat të shëmtuar, je ti. Edhe nëse sheh Isain dhe Merjemen, prapë ato që sheh janë ti!

Ajo nuk është as kjo, as ajo! Ajo është e pastër nga çdo gjë! Para teje vë vetëm veten tënde!

Kur fjala erdhi këtu, buzët u mblodhën. Kur kalemi arriti këtu, u thye dhe qëndroi!

Shprehia të dha mundësi, por ti mblidhi buzët dhe hesht; Zoti e di më mirë se ç'është e drejtë!

O sarhosh i përhershëm, ti je mu në skaj të ballkonit... Ose ulu aty, ose zbrit poshtë! Të fala me shëndet!

Në atë kohë që të të plotësohet qëllimi, dije se ajo kohë e këndshme është ardhja jote në skaj të ballkonit! Kështu dije këtë!

Frikësohu në kohë të mira... Atë kohë fshihe si thesar, mos e nxirr në shesh!

Mos e nxirr në dukje që dashurisë të mos i bjerë ndonjë e keqe papritmas! Eja në vete dhe në atë vend fshehtësie ec duke u frikësuar!

Në kohë gëzimi ke frikë nga ikja e atij gëzimi! Ja kjo është fluturimi dhe ikja e shpirtit tënd nga ai ballkon i fshehtë!

Po qe ti s'e sheh anën e ballkonit të fshehtësisë, shpirti e sheh dhe dridhet si ndër ethe!

Çdo e keqe që bie papritmas, ka rënë në skajin e frikshëm të ballkonit të gëzimit!

Njeriu s'rrëzohet për sa kohë që s'ndodhet në anë të ballkonit. Shih fiset e Nuhut dhe Lutit dhe merr mësim!

Shkaku që ai llafazani, në prani të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), thotë fjalë oratorike dhe flet shumë.

Nga dehja e pakufi e Pejgamberit, atij kokëtrashit i kishte rënë një rreze drite, e kishte mbushur me hare dhe e kishte dehur!

Nga gëzimi dhe hareja, filloi të fliste shumë. I dehuri e lë edukatën dhe bie kokëposhtë!

Por ai që e kapërcen vetveten në çdo vend, nuk bën të keqe. Vera e turpëron të paturpshmin!

Kurse i mençuri që pi verë, bëhet më i mençur... Kurse njeriu me vese të këqija bëhet i keq fund e krye!

Por meqë shumica e njerëzve janë të këqinj dhe imoralë, e bënë verën haram, të ndaluar!

Shkaku që i Dërguari i Allahut e vlerëson të riun e fisit Huzejl më lart se të moshuarit dhe personat me përvojë luftarake dhe e bën kryekomandant.

Vendimi është i atij që është epror. Shumica e njerëzve janë të këqinj, prandaj grabitësve ua morën shpatën nga duart.

Pejgamberi tha: "O ti që sheh fytyrën e jashtme të punës! Mos e shih atë të ri dhe të paaftë!

Sa e sa pleq mjekërzinj ka dhe sa e sa mjekërbardhë me zemrën të zezë si zift ka!

Mendjen e tij e provova shumë herë me radhë. Ai djalë i ri tregoi maturi plaku në punë!

Plaku është plak mençurie, o bir! Njeriu nuk bëhet njeri me zbardhjen e flokëve dhe mjekrës!

Kush është më plak se Iblisi? Por a s'ka mend? Atëherë s'vlen për kurrgjë!

Po qe se dikush është fëmijë, por me frymë Isai, i pastruar nga krenaria dhe pasioni, si mund ta quash fëmijë?

Zbardhja e flokut është shenjë pjekurie vetëm për atë që i ka syte të lidhur dhe është dritëshkurtër.

Meqë ai imitues nuk di gjë tjetër si shenjë përveç argumentit, gjithmonë kërkon rrugë për këtë.

Prandaj thamë që, në qoftë se ke për t'ia hyrë një pune, këshillohu me një të parë.

Sepse ai ka dalë nga perdja e imitimit, ka shpëtuar dhe çdo gjë e sheh me dritën e Zotit!

Drita e tij e pastër e shqyen lëkurën pa argument, pa deklaratë dhe e nxjerr të brendshmen në shesh!

Ç'është zemra, ç'është floriri i i vërtetë për atë që sheh vetëm të jashtmen? Ç'ka në shportën e hurmave? Ai e di!

Sa e sa florinj i kanë nxirë me tym për t'i shpëtuar nga hajdutët smirëzinj!

Sa e sa copa bakri i kanë larë me ujë floriri, i kanë veshur me flori me qëllim për t'ua shitur mendjeshkurtëve!

Ne jemi ata që e shohin fytyrën e brendshme të të gjitha vendeve, që e shohin zemrën; ne nuk shohim fytyrën e jashtme!

Kadinjtë që përsillen rreth të dukshmes, vendosin sipas pamjes së jashtme!

Sapo që dikush të thotë Fjalën e Dëshmisë, të bëjë diçka që tregon besimin, këta konkludojnë menjëherë se ai njeri është besimtar!

Në këtë mënyrë, sa e sa hipokritë janë strehuar pas pamjes së jashtme dhe, në këtë mënyrë, kanë derdhur fshehurazi gjakun e qindra besimtarëve!

Puno e purpiqu dhe bëhu i parë i mendjes dhe fesë dhe, në këtë mënyrë, si Arsyeja e Përgjithshme, shih botën e brendshme!

Kur ajo mendje e bukur u shfaqet nga mosqenia, Zoti i veshi një rrobë dhe i vuri mijëra emra!

Më i thjeshti i atyre emrave të bukur është ky: Ai nuk është nevojëtar për askënd!

Sapo mendja ta tregojë fytyrën një herë, t'ia shfaqë trajtën kësaj bote, përballë dritës së tij edhe dita mbetet e errët!

Edhe kokëtrashësia, po të dalë në shesh, errësira e natës mbetet e ndritshme pranë saj!

Sepse ajo është më e errët se nata, më e zezë! Por ç'dobi ka? Lakuriqi i keq i natës i blen errësirat!

Mësohu ngadalë-ngadalë me dritën e ditës, ndryshe, ashtu si lakuriqi, nuk del dot në dritë, por mbetesh në errësirë!

Lakuriqi do atë vend ku ka ndonjë vështirësi dhe bëhet armik i vendit ku ndriçon drita e një të lumturi!

Zemra i kërkon gjithmonë vështirësi me qëllim që dituria dhe aftësia t'i duken më mirë!

Me çdo vështirësi ai të vonon, të pengon ty, të zhyt në indiferentizëm dhe pakujdesi ndaj natyrës së tij të keqe!

Shenjat e të mençurit të plotë me gjysmë të mençurin,
e burrit të vërtetë me gjysmë burrin,
si dhe të personit krenar
që ishte i keq dhe s'kishte asnjë vlerë.

I mençur i thonë atij që ka në dorë pishtar. Ai ecën në krye të karvanit dhe u bëhet kallauz atyre.

Ai që ecën në krye i është nënshtruar dritës së tij, është vënë pas saj. Ai është i lidhuri pas saj i cili është nisur në udhë duke e kapërcyer vetveten!

Ai i ka besuar asaj. Edhe ju besojini dritës ku është shtrirë shpirti i tij, asaj bote drite!

Edhe njeriu me gjysmë mendje ia ka vënë syrin një të mençuri, të cilin e ka njohur si sy.

Ia ka hedhur dorën atij siç kapet qorri pas atij që i jep dorën. Në këtë mënyrë është bërë me sy, është bërë i shkathët dhe i shquar.

Sa për gomarin që s'ka mend as sa një kokërr elbi, ai edhe mendje s'ka, edhe të mençurin e ka braktisur!

Nuk di pak a shumë edhe ndonjë rrugë. Megjithëkëtë, mërzitet të vihet në rrugë pas një kallauzi, i vjen turp!

Dhe, në shkretëtirat pa anë e pa fund, ecën herë duke çaluar i pashpresë, herë vrapon i pafuqishëm!

Nuk ka ndonjë kandil që ta mbajë e të shohë se ç'ka para. Madje nuk gjen dot as një gjysmë drite që të lypë dritë prej saj!

Nuk ka mend në mënyrë që tregohet i gjallë; nuk ka gjysmë mendje, madje, që të vdesë, ta dijë veten të vdekur!

Të bëhet plotësisht i vdekur para të mençurit, në mënyrë që ta ngrerë vazhdimisht veten lart nga vendi i ulët ku ndodhet!

Po s'pate mendje të plotë, bëje veten si të vdekur dhe strehohu te një i mençur me fjalën të gjallë!

Njeriu që s'është i tillë, s'është i gjallë që të të bëhet bashkëkohës me Isain... S'është i vdekur që të përfitojë nga fryma e Isait që ngjall të vdekurit!

Njeriu me shpirtin të vdekur hedh hapa nga çdo anë, por kurrsesi s'shpëton dot!

Liqeni; ata që gjuajnë peshq në liqen; tre peshqit,
nga të cilët, njëri i mençur, tjetri gjysmë i mençur,
kurse i treti krenar, kokëtrashë, i shkujdesur dhe i
pavlerë;
fundi i tyre.

O inatçi, kjo i ngjet historisë së liqenit ku ndodheshin tre peshq të mëdhenj.

E ke lexuar te "Kelile" por ajo është cipa, kurse kjo që po tregojmë ne, është përmbajtja!

Disa peshkatarë kaluan anës së atij liqeni dhe i panë peshqit.

Dhe menjëherë shkuan me vrap për të sjellë rrjetë. Peshqit e kuptuan këtë.

I mençuri prej tyre u nis për rrugë; u nis në rrugën e vështirë që nuk pëlqehej aspak.

Mendoi që të mos kështillohej me ta sepse thoshin mendime të ndryshme që e thyenin vendosmërinë.

Meqë kapeshin nga dashuria për vendin, padituria dhe përtacia e tyre i ngjitej edhe atij.

Duhet një njeri i mirë e i gjallë për t'u këshilluar, që të të ngjallë edhe ty; por ku është ai?

O udhëtar, këshillohu me udhëtarë e jo me gra, sepse opinioni i gruas të bën topall!

Mos i jep shumë vlerë dashurisë për vatanin, por ecë, se vatani është atje, jo këtu!

Po deshe vatan, kalo në bregun tjetër të lumit dhe mos e lexo shtrembër e gabim këtë hadith (rrëfim) të drejtë!

Sekreti i këndimit të lutjes që këndon
ai që merr abdest gjatë larjes së gjymtyrëve.

Në hadith është përcjellë një lutje për çdo gjymtyrë që lahet duke marrë abdest.

Kur të tërheqësh ujë me hundë, kur të lash hundët, kërko nga Zoti aromë xhenneti!

Kërko që ajo aromë të të tërheqë dhe çojë në xhennet, sepse aroma e trëndafilit është provë e trëndafilishtes!

Dhe lutja që do të këndohet duke u larë pas kryerjes së nevojës, është kështu: "O Zot, pastromë nga kjo ndyrësi!

Gjer këtu më arriti dora, këtë vend e pastroi. Dora ime është e paaftë të ma pastrojë shpirtin!

Shpirtrat e atyre që s'janë njerëz, janë bërë njerëz me mirësinë tënde! Ajo që arrin te shpirtrat është dora jote e favorit dhe bujarisë!

Unë jam njeri i pavlerë, mua më erdhi në ndihmë fuqia jote! O Zot bujar, pastroma ti ndyrësinë e brendshme që s'kam fuqi ta pastroj unë!

Zoti im, unë e lava dhe e pastrova lëkurën nga papastërtitë, kurse botën time të brendshme lama dhe pastroma ti prej papastërtive!

Dikush, gjatë pastrimit, pasi kryen nevojën,
në vend që të këndojë lutjen përkatëse të këtij rasti,
"O Zot, më bëj mua nga ata që pendohen dhe pastrohen",
këndon lutjen "O Zot, bëmë të nuhas aromën e xhennetit",
e cila bëhet kur i jepet ujë hundës duke marrë abdest.
Një njeri i shquar që e dëgjon, nuk e duron dot.

Dikush, duke u pastruar pasi kishte kryer nevojën, u lut kështu: "O Zot, më mbush mua me aromë xhenneti!"

Dikush tjetër që e dëgjoi, i tha: "Bëre lutje të bukur, por ngatërrove vrimën!"

Kjo lutje këndohet gjatë abdestit duke i dhënë ujë hundës, kurse ti e këndove lutjen e hundës duke larë vendin e jashtëqitjes!

Njeriu i lirë e ndjen aromën e xhennetit me hundë! A vjen aromë xhenneti nga vrima e jashtëqitjes?

O ti që, duke treguar përulësi ndaj njerëzve të ulët, mbahesh më të madh ndaj sovranëve,

Mbajtja më të madh është e mirë dhe e bukur po të bëhet ndaj njerëzve të ulët... Pra, eja në vete dhe mos vepro në të kundërt, se kjo ta zë rrugën!

Trëndafili i bë dhe u rrit për hundën... O njeri i turbulluar, nuhatja është punë e hundës!

O trim, aroma e trëndafilit është për hundën. Ajo vrima poshtë nuk është vendi i asaj arome!

A të vjen prej saj ty aromë xhenneti? Po t'u desh aromë, kërkoje në vendin e vet!

Si kjo, edhe hadithi "dashuria për vatanin rrjedh nga besimi" është i drejtë, mirëpo, o mësues, më parë njihe vatanin!

Peshku i mençur tha: "Të gjej një rrugë dhe ta kthej zemrën pa u këshilluar me këta, pa bërë sipas mendimit të tyre!"

Eja në vete, tani s'është koha për këshillim; vihu në rrugë dhe, si Aliu, rënko pusin!

Të afërmit e këtij rënkimi janë të pakët... Ec netëve dhe fshehtas, si roje!

Shko nga ky liqen, për në det... Kërkoje detin, lëre vorbullën e ujit!

E bëri gjoksin këmbë dhe u vu në rrugë. Peshku i drojtur eci nga ai vend i rrezikshëm gjer te deti i dritës!

Dreri që i ka rënë pas qeni, vrapon edhe sikur t'i mbetet një damar nga jeta! Ja, ashtu vraponte!

Është gabim të biesh në gjumin e lepurit duke patur qentë pas. Se mos i hyn sy në gjumë njeriut që ka frikë!

Peshku iku dhe zuri rrugën e detit. Ai u vu në atë rrugë mjaft të gjatë!

Hoqi shumë mundime, por, në fund, arriti në pozitën e sigurisë dhe shëndetit.

E hodhi veten në detin që s'i dukej fundi e ana!

Ndërkaq, peshkatarët sollën rrjetën... Gëzimi i gjysmë të mençurit u prish, i iku shija e jetës!

Dhe tha: "Mjerë unë! E humba rastin! Si ndodhi që nuk iu bëra shok udhërrëfyesit?

Ai shkoi papritmas... Ai shkoi, por unë duhej t'i vihesha pas me nxitim!

Por është gabim të të vijë keq për atë që ka ikur! Po të ketë ikur, ka ikur; ta kërkosh, nuk ka asnjë dobi!

Këshillat e zogut të zënë në lak: "Mos u pendo për kohën e ikur por dija vlerën kohës që jeton, përpiqu të përfitosh prej saj dhe mos e kalo kohën duke u penduar."

Dikush zuri në lak një zog. Zogu i tha: "O mësues i shquar,

Ti ke ngrënë shumë lopë e dele, ke bërë kurban shumë deve.

Dhe nuk u ngope as me to, jo të ngopesh me mua!

Lërmë të lirë dhe unë do të të jap tri këshilla dhe shihe, atëherë, a jam budalla, apo i mençur!

Këshillën e parë të ta jap sa më ke në dorë, të dytën, mbi çatinë e bërë prej balte të përzjerë me kashtë!

Kurse të tretën të ta jap mbi pemë. Me këto tri këshilla të përmirësohet fati!

Këshilla që do të të jap sa më ke në dorë, është kjo: Fjalës së paqenë mos i beso pavarësisht se kush ta thotë!

Pas kësaj këshille të lartë, mori lirinë, u ngjit mbi çati

Dhe prej atje i tha: "Mos vuaj për atë që ka ikur! Pasi ta kesh hedhur poshtë rastin, mos u dëshpëro më!"

Pastaj i tha: "Në këtë trupin tim të vogël ka një margaritar me peshë dhjetë dërhem, por me vlerë të pamatshme.

Ju bënte të lumtur edhe ty, edhe djemtë e tu! Ai margaritar ishte haku yt!

Por s'paska qenë kësmeti yt, e le të të ikë dore! Një margaritar i tillë nuk gjendet në botë!"

Njeriu nisi të klithë si gruaja shtatzënë në të lindur.

Zogu i tha: "A nuk të thashë të mos vuash për atë që ka ikur?

Meqë ka ikur, pse po vuan? Ti ose s'ma kuptove këshillën, ose je shurdh!

Veç kësaj, a nuk të thashë të mos biesh në të shtrembër, të mos e dëgjosh kurrsesi fjalën e paqenë? A s'ishte kjo këshilla ime e dytë?

Unë vetë nuk vij tre dërhemë, ore trim, si mund të kem brenda në trup një margaritar dhjetë dërhemësh?"

Pas këtyre fjalëve, njeriu erdhi në vete dhe i tha zogut: "Ma jep atë këshillën e tretë të bukur ta shohim!"

Zogu i tha: "Për Zotin, i mbajte mirë ato dy këshillat e para dhe do të ta thënkam të tretën badjava!"

T'i japësh këshillë njeriut të paditur që ka rënë në gjumë, është të hedhësh farë në tokë djerr ku s'mbin gjë!

E grisura e kokëtrashësisë dhe paditurisë nuk pranon arnë. O këshillues, mos i hidh atij farë urtësie!

Peshku gjysmë i mençur mendon një zgjidhje për të shpëtuar dhe e tregon veten të ngordhur.

Në atë kohë ngatërrese e shqetësimi, peshku tjetër mbeti veç hijes së peshkut të mençur dhe tha:

"Ai arriti në det dhe u çlirua nga vuajtja... Unë u ndava nga një shok i tillë i mirë...

Por tani le të mos mendoj për të, por t'i gjej shpëtim vetes... Ta tregoj veten të ngordhur...

Të dal mbi ujë, të kthehem me barkun sipër dhe ta lëshoj veten ku të më çojë uji!

Dhe të zvarrisem mbi ujë jo si notar por si fije kashte!

Ta përngjasoj veten me një të ngordhur dhe t'ia lë ujit... Të vdesësh para se të të vijë vdekja, është shpëtim nga mundimi!"

O trim, vdekja para vdekjes është siguri... Kështu na ka porositur Mustafai!

Na ka thënë: "Vdisni para se t'ju vijë vdekja me prova!"

Peshku u kthye me barkun lart sikur të kishte ngordhur me të vërtetë dhe uji e çonte herë nga kjo anë, herë nga ana tjetër!

Të gjithë peshkatarët u mjeruan dhe thanë: "Eh, sa keq, ngordhi peshku më i miré!"

Peshku u gëzua me keqardhjen dhe mjerimin e tyre dhe mendoi me vete se, me këtë lojë, shpëtoi nga thika!

Njëri nga peshkatarët e kapi dhe, duke sharë, e hodhi në tokë.

Duke u përpëlitur fshehurazi, dalngadalë, peshku u fut sërish në ujë. Kurse i treti, ai kokëtrashi, mbeti në vuajtje.

Ai vazhdoi të përpëlitej majtas e djathtas për të shpëtuar.

Por gjuetarët e hodhën rrjetën dhe ai mbeti në të; kokëtrashësia e hodhi në zjarr!

Së bashku me kokëtrashësinë e vet, përfundoi në tiganin mbi zjarr!

Ndërsa po skuqej në vajin i nxehtë, mendja i thoshte: "A nuk të erdhi ndonjë person që të të frikësonte?"

Kurse ai, mes asaj të keqeje dhe torture, si shpirtrat e qafirëve, i thoshte: "Po, erdhi!"

Pastaj vazhdoi të thoshte: "Po qe se këtë radhë shpëtoj nga mundimi që ta thyen qafën,

Nuk kam për të zënë vend tjetër përveçse në det. S'do të rri më në liqen!

Do të gjej një ujë pa anë e pa fund që të ndodhem në siguri dhe të vazhdoj të jetoj përjetësisht në siguri dhe shëndet!"

Nuk mund t'i besohet betimit të kokëtrashit i cili pendohet pasi ka pësuar një të keqe. "Sikur të ktheheshin prapë në botë, ata do të fillonin përsëri t'i bënin ato gjëra për të cilat qenë ndaluar t'i bënin. Ata janë gënjeshtarë!" Zbardhja e parë e agimit është e pabesë.

Mendja i thoshte: A s'është budallallëku me ty bashkë? Me të nuk mund të qëndrohet në fjalë!

Besa në marrëveshjet bëhet me mendje, kurse ti s'ke mendje, o gomar!

Mendja ta kujton fjalën e dhënë, mendja e gris perden e harresës!

Kur s'ke mend, të sundon harresa, të bëhet armike, ta prish rregullin!

Flutura e natës, ngaqë s'ka mend, e hedh veten në zjarr pa i shkuar ndërmend se zjarri të djeg!

Kur i digjen krahët, pendohet, por prapë, ambicja dhe harresa e hedhin në zjarr!

Ta kuptosh një gjë, ta ngulisësh në mendje dhe ta kujtosh kur të të duhet, është punë e mendjes. Mendja e rrit gradën e këtyre.

Po të mos ketë margaritar, si mund të ketë shkëlqim margaritari dhe si mund të gjendet ai? Po të mos jetë dikush që t'ia kujtojë, si do të ikë njeriu nga ajo punë?

Kjo dëshirë e pakohë është për shkak të pamençurisë së njeriut. Ç'ves ka kokëtrashësia? Ajo nuk sheh!

Ai pendim është pasojë e mundimit, s'është pasojë e mendjes e cila është thesar!

Pasi të harrohet mundimi, edhe pendimi harrohet. Ky lloj pendimi s'vlen as sa dheu i thatë!

Ky pendim, për shkak të errësirës së dhimbjes dhe vuajtjes, e lidhi barrën, por, sapo të vijë dita, e prish fjalën e natës!

Kur ikën errësira e vuajtjes dhe vjen koha e kënaqësisë, edhe nga zemra ikën pasoja e saj, pendimi i lindur nga vuajtja!

Njeriu bën pendesë, por prijësi mendje vazhdon duke thënë me të bërtitur: "Sikur të kthehen prapë në botë, prapë ngatërrohen me punë për të cilat u thuhet "mos i bëni", dhe i bëjnë!"

Fantazia është e kundërta e arsyes, e cila lufton me të. I ngjet asaj, por nuk është ajo. Pyetje-përgjigjet mes Musait (a.s.) të arsyeshëm dhe Faraonit fantazist.

O trim, mendja është e kundërta e epshit. Mos i thuaj mendje mendjes që end epshin!

Asaj që i nënshtrohet epshit, thuaji fantazi. Fantazia është forma kallpe e floririt të mendjeve të vërteta.

Pa gur prove, fantazia dhe mendja nuk zbulohen. Që të dyja vëri menjëherë në gurin e provës.

Dhe ky gur prove është Kur'ani, është gjendja e pejgamberëve. Guri i provës i thotë gjësë kallpe "eja,

Eja dhe shihe se në ç'hall ke rënë për shkakun tim... Sepse ti s'je kompetenti as i zbritjes, as i ngjitjes sime!

Edhe sikur sharra ta ndajë më dysh mendjen, ajo prapë buzëqesh si floriri në zjarr!

Fantazia është Faraoni që djeg botët; mendja është e Musait i cili i ndriçon dhe i shkëlqen shpirtrat!

Musai iku në rrugën e mosqenies... Faraoni i tha: "Kush je ti?"

Musai iu përgjigj: "Unë jam mendja, jam përfaqësuesi i Zotit i cili është epiqendra e hyjnitetit! Jam provë e lartë e Zotit, personi që i jep siguri njeriut në mbrojtjen ndaj teprimit!"

Faraoni i tha: "Pusho, lëri fjalët e kota dhe ma thuaj emrin tënd të vjetër!

Musai i tha: "Përkatësia ime është në vendin e kësaj toke të Zotit, kurse emri i im i vërtetë është më i ulti i robve të tij!

Unë jam biri i robit të atij Zoti; kam lindur nga skllavja e robit të tij me të!

Origjina ime e vërtetë është dheu; balta dhe uji... Zoti u ka dhënë ujit dhe dheut zemër dhe shpirt.

Vendi ku ka për t'u kthyer e për të shkuar ky trupi im prej dheu, është prapë dheu! Edhe vendi ku do të shkosh ti, është dheu, o krenar!

Dheu është origjina edhe e jona, edhe e të gjithë të paudhëve, që të gjithë jemi prej dheu dhe, për këtë, ka njëqind lloj shenjash!

Trupit tënd i vjen ndihma nga dheu! Qafa jote rregullohet e trashet me ushqime që mbijnë nga toka!

Sa të të ikë shpirti, trupi bëhet dhé e mbaron në atë varr të frikshëm!

Edhe ti, edhe ne, edhe ata që të ngjajnë ty, që të gjithë, bëhen dhé. Nuk mbeten as posti dhe pozita jote!"

Faraoni i tha: "Veç kësaj, ti ke edhe një emër... Ai emër të ka hije ende ty:

Robi i Faraonit, robi i robve, robi, trupi dhe shpirti i të cilit është ushqyer dhe rritur më parë me të mirat e tij!

Robi i ulët, azgan dhe shumë mizor... Robi që ikën nga vendi për shkak të punës së keqe që ka bërë!

Robi katil, gjakatar, i egër, që s'e njeh të drejtën... Shihi tani këto cilësi dhe bëj krahasim, kush je?

Një rob i ulët, i varfër, i zhveshur që as na e njeh të drejtën, as na falenderon!"

Musai iu përgjigj kështu: "Na ruajttë Zoti, askush nuk mund t'i bëhet shok në sovranitet atij sovrani!

Në pasuri dhe pushtet është i vetëm i pashoq! Nuk ka për robtë e tij kryekomandant tjetër veç tij!

Askush veç tij nuk e ka në dorë popullin e vet. Askush veç atij që ka rënë në shkatërrim nuk mund të ngrihet në pretendimin për ortakëri me të!

Ai është që më ka përvijuar që ma ka dhënë këtë trajtë mua; ai është vizatuesi im! Po të ngrihet tjetërkush për këtë pretendim, është i padrejtë dhe mizor!

Ti nuk je i aftë për të ma krijuar as vetullën time; atëherë, si mund të thuash se ti më ke krijuar mua?

Ti je azgani, i tërbuari i vërtetë që ke rënë në pretendimin për t'iu bërë shok Zotit!

Po qe se unë e kam vrarë gabimisht një njeri të keq, s'e kam vrarë as për ego, as për dëfrim!

Unë i rashë vetëm një grusht, kurse ai vdiq në vend! Siç duket nuk kishte shpirt që ngordhi ashtu, menjëherë!

Unë vrava një qen, kurse ti vrave bijtë e pejgamberëve, qindramijëra fëmijë të pafajshëm e të padëmshëm!

I vrave ata dhe gjaku i të gjithëve rëndon në qafën tënde! Të shohim ç'do të të bien mbi kokë nga ky gjak!

E vrave sojin e Jakubit... Qëllimi yt ishte të më vrisje mua, këtë shpresoje, këtë doje ti!

Zoti të verboi ty dhe më zgjodhi mua. Dredhia që sajoi nefsi yt u përmbys!"

Faraoni i tha: "Lëri këto! Pa dyshim, e drejta ime paska qenë bukë me kripë, ë?

Të më turpërosh mua në sy të popullit! Ta errësosh ditën e ndritshme në zemrën time! A kjo është që duhet të bësh ti si shpërblim të të drejtës sime që kam tek ti?

Musa, poshtërimi i ditës së kiametit është më i vështirë. Po s'më respektove mua në të mirë e në të keq, gjendja jote në kiamet do të bëhet më e keqe se kjo!

Ti s'e duron dot dhimbjen e një pleshti, si do ta durosh dhimbjen e gjarpërit?

Në dukje, unë po e shemb punën tënde, por po e shndërroj një gjemb në trëndafilishte!

Ndërtimi është te shembja; bashkimi është te shpërndarja; rregullimi është te thyerja; qëllimi është te paqëllimi;
qenia është te mosqenia. Çdo gjë i ngjet kësaj.
Edhe të kundërtët dhe të ngjashmit e tjerë janë po si këta.

Erdhi dikush dhe nisi ta lërojë e ta kthejë tokën. Një kokëtrashë nuk duroi dot dhe klithi.

Dhe tha: "Pse e shemb këtë vend? Pse e çan dhe e shpërndan?"

Njeriu i tha: "O kokëtrashë, ik tutje e mos u merr me mua! Dije se ndërtimi është te shembja!

Pa u bërë ky vend i shembur e i shëmtuar, si mund të ndodhë që të kthehet në trëndafilishte, në arë gruri?

Pa u përmbysur rregulli i vjetër, si mund të bëhet bostan e arë të lashtash, si mund të japë prodhim e fruta?

Pa e çarë plagën me bisturi, a mjekohet, a shërohet?

Po s'tu la vendi i sëmurë me ilaç, si të kalon sëmundja, si gjen shërim?

Rrobaqepësi e bën basmën copë-copë... A del kush t'i thotë rrobaqepësit që e njeh atë art,

Pse e solli atllasin në atë gjendje? Pse e preu? T'i thotë se ç'ta bëjë tani atë atllas?

A nuk e shembin ndërtesën e vjetër për ta bërë të re?

Po kështu, marangozi, kovaçi dhe kasapi, kur duan të bëjnë një gjë të re, a nuk e prishin më parë?

Rrahja e hekurit e bën copën e hekurit vegël për përdorim!

Po të mos e shtypnim dhe thërrmonim grurin në mulli, pra, po të mos e bluanim, a do të mund të bënim bukë e t'i zbukuronim sofrat?

Musai i jep përgjigje Faraonit
që qoftë i mallkuar!

O peshk, buka me kripë që hëngra më mundon kaq shumë për të të shpëtuar ty nga rrjeta, apo jo!

Po ta pranosh këshillën e Musait, shpëton nga një grep i tillë me fund të keq!

Ka shumë kohë që e ke bërë veten rob të dëshirave dhe pasioneve! Mjaft më! Një krimb të vogël e shndërrove në kuçedër!

Edhe unë solla një kuçedër kundër kuçedrës tënde dhe kam për qëllim që me anë të saj të të përmirësoj ty çast pas çasti!

Fryma e saj të zihet me frymën e kësaj; kuçedra ime ta shkatërrojë kuçedrën tënde!

Po të të pëlqejë, shpëton nga të dyja kuçedrat, përndryshe, kjo kuçedër ta shkul e ta fshin nga rrënjët shpirtin tënd!

Faraoni tha: "Je një magjistar shumë i madh. U fute në këtë qytet pa një pa dy!

Popullin me zemër të bashkuar në një, e përçave në dysh... Ashtu është! Magjia vepron edhe mbi gurin dhe malin! Edhe ata, madje, i çan e i shemb!"

Musai iu përgjigj kështu: "Unë u jam nënshtruar plotësisht urdhrave të Zotit! A është parë që të bëhet magji me emrin e Zotit?

Themeli i magjisë është padija, mohimi. Mirëpo shpirti i Musait është pishtar feje!

O i shëmtuar, a u ngjaj unë përçarësve? Frymës sime ia ka zilinë edhe Mesihu!

O i ndyrë, ç'gjë e imja u përngjet magjistarëve? Librat ndriçohen e zbukurohen nga shpirti im!

Por ti, meqë ke fluturuar me flatrat e dëshirave dhe pasioneve, bie në dyshim për mua!

Kush bën punën e mashtruesve dhe kriminelëve, sigurisht që ka për të rënë në dyshim për bujarët!

Ti je një copë e gjithësisë. Çfarëdo që të jesh, patjetër që ke për ta parë të tërën e kësaj gjithësie në cilësitë e tua, o njeri i tërbuar!"

Po u rrotullove dhe t'u muarën mendtë, të duket se edhe shtëpia rrotullohet!

Kur të hipësh në anije dhe anija të niset, të duket sikur bregu ecën!

Po qe se zemra të ngushtohet nga një konflikt a nga një luftë, e gjithë bota të duket e ngushtë!

Po të arrish kënaqësinë siç e dëshirojnë miqtë dhe po qe se zemra të bëhet e kënaqur, kjo botë të duket trëndafilishte!

Sa e sa vetë shkuan gjer në Siri e Irak dhe atje nuk panë asgjë tjetër veç hipokrizisë dhe mohimit!

Sa e sa vetë arritën gjer në Indi e gjer në qytetin Herat, dhe atje nuk gjetën gjë tjetër veç shitblerjes!

Sa e sa vetë arritën në Turkestan e në Kinë dhe atje nuk panë gjë tjetër veç lakut e kurthit!

Po qe se ai që shkon në udhëtim dhe nuk sheh dot gjë tjetër veç aromës dhe ngjyrës, thuaji atij: Përsillu në të gjitha klimat dhe vetëm këto ke për të parë!

Kau shkon në Bagdad dhe e shëtit qytetin nga një skaj në tjetrin...

Dhe nga gjithë ajo jetë që bëhet atje, nga ato bukuri e kënaqësi, sheh nëpër sokakë vetëm lëkura shalqinjsh!

Gjëja e denjë për vëzhgimin e kaut ose gomarit janë kashta e hedhur nëpër sokakë dhe bari i mbirë nëpër rrugë!

Shpirti i personit të mbetur varur si copë mishi i tharë në natyrë është lidhur me shkaqet... Ai nuk sheh dot gjë tjetër përtej kësaj!

O njeri i madh që rri ulur në krye të vendit, fusha ku janë zhdukur shkaqet, është faqja e gjerë e tokës së Zotit!

Atje shpirti ndërron pamje çdo çast. Çdo çast sheh një botë krejt të re dhe në mënyrë të qartë!

Por njeriut të kapur pas një cilësie, të mbetur ngrirë me atë cilësi, edhe sikur të jetë në xhennet, në breg të lumenjve të xhennetit, edhe ai vend i duket i keq dhe i shëmtuar!

Çdo ndijim i njeriut ndjen (përcepton) gjëra të tjera dhe është i painformuar për përceptimet e ndijimeve të tjera.
Po kështu, edhe çdo usta zanatçi është i paformuar në zanatin e një ustai tjetër, nuk e njeh atë zanat.
Ndërkaq, fakti që një ndijim nuk di gjë për detyrën e ndijimeve të tjera, nuk është argument për mosqenien
e ndijimeve të tjera. Kështu, përsa i përket përbërjes dhe gjendjes, çdo ndijim e mohon detyrën e ndijimeve
të tjera dhe çdo zanatçi e mohon artin e zanatçinjve të tjerë. Themi e mohon, por me këtë nuk duam të themi
se nuk e di ekzistencën e atij ndijimi ose atij arti.

Korniza e shikimit tënd të botës është sipas mendësisë sate. Fakti që, sipas teje, njerëzit e pastër ndodhen pas perdes dhe ti nuk i sheh, është pasojë e ndjenjës sate të fëlliqur!

Dikur laje ndjenjën me ujin e vështrimit... Kjo është, kështu është larja e ndërresave nga sofitë! Kështu dije këtë!

Po të pastrohesh, perdja griset dhe shpirtrat e personave të pastër nisin të të duken!

Sikur e gjithë bota të mbushet me dritëra dhe trajta, vetëm syri bëhet i njohur me atë bukuri.

Po qe se e mbyll syrin dhe e hap veshin për të parë cullufet dhe fytyrën e një të bukure,

Veshi të thotë: "Unë nuk e shoh dot fytyrën. Vetëm po qe se fytyra jep një zë, e dëgjoj atë zë!"

Di, di, por di gjërat që më përkasin mua... Dhe gjëja që më përket mua është jo gjë tjetër veç tingullit dhe zërit!

O hundë, eja në vete! Po i the hundës shihe këtë bukuri, nuk ka mundësi, se hunda nuk e ka këtë aftësi!

Dhe të thotë ty: "Po të jetë misk ose esencë trëndafili, e nuhas. Kjo është puna ime, kaq është dija ime!

Si mund ta shohë unë atë bukuri që i shembëllen copës së argjendit? Mblidh mendtë në kokë dhe mos ma propozo gjënë që s'mund ta bëj!

Edhe ndjenja e shtrembër nuk sheh dot gjë tjetër veç së shtrembrës; në daç vëri para një gjë të shtrembër, në daç të drejtë!

O mësues! syri i vëngërt nuk sheh dot tek!

Edhe ti je faraon! Je mashtrim dhe hipokrizi nga maja e kokës te thoi! Prandaj nuk më sheh dot mua të ndryshëm prej vetes tënde!

O vështrimshtrembër, mos më shih mua me syrin tënd, por me syrin tim që të mos më shohësh dy!

Shihmë mua qoftë edhe për një çast me syrin tim që të shohësh një shesh përtej ekzistencës!

Shpëto edhe nga ngushtica, edhe nga emri, edhe nga fama! Shih ashkun, pasionin hyjnor, mes pasionit hyjnor! Të fala me shëndet!

Dije se, po shpëtove nga korniza e trupit, edhe veshi të bëhet sy, edhe hunda!

Ai sovran fjalëmbël ka thënë drejt: Çdo qime e arifëve, e njerëzve të pajisur me kulturën shpirtërore, bëhet sy!

Në fillim, syri nuk ishte sy... Në mitrën amësore ai ishte një copë mishi!

Copa e dhjamit nuk bëhet shkak për të parë, o bir! Po të ishte ashtu, askush nuk do t'i shihte dot gjërat që shihen në ëndërr!

Për shembull, edhe shejtani dhe peria shohin, por në sy të të dyve nuk ka ndonjë gjë që t'i ngjasë copës së dhjamit!

Ç'lidhje ka drita me dhjamin? Mirëpo, ja që Zoti krijues dhe dashuridhurues e ka bërë këtë lidhje!

Njeriu është krijuar nga dheu por nuk i përngjet dheut. Xhindët nuk kanë ndonjë lidhje me zjarrin, por edhe ata janë krijuar nga zjarri!

Origjina e perisë është zjarri, por, po të bësh kujdes, nuk i përngjet fare zjarrit!

Megjithëse zogu është krijuar nga ajri, ku i përngjet ajrit? Zoti u ka dhënë lidhjeve gjërave pa lidhje!

Këto gjëra të dyta kanë lidhje me origjinën e tyre. Zoti ua ka dhënë këtë lidhje, por mendja nuk e kupton dot këtë lidhje, cilësia e saj nuk njihet!

Njeriu është formuar nga dheu pa asnjë vlerë... Por ç'lidhje ka ky bir me të atin?

Edhe nëse ka ndonjë lidhje, është e fshehtë nga mendja, mendja nuk e kupton dot cilësinë e saj! Nga do ta gjurmojë e do ta gjejë mendja këtë lidhje?

Po qe se nuk do t'i kishte dhënë sy erës, si do ta dallonte popullin e Adit?

Si e dallon dot besimtarin nga armiku i tij? Si do të ndodhte që ta dallonte verën nga shtamba?

Po qe se te zjarri që e digjte Nemrudin nuk do të kishte sy, si do të ndodhte që ta vinte veten në mundim e të tregonte respekt ndaj tij?

Po qe se Nili nuk do të kishte sy e nuk do të shihte, si do të mund t'i dallonte nga njëri-tjetri kiptinjtë me izraelitët?

Mali e guri s'kishin shikim e si iu bënë të dashur Daudit?

Kjo tokë nuk kishte sy shpirtëror, pse, atëherë, e gëlltiti ashtu Karunin?

Po qe se trau Hannane nuk do të kishte sy zemre, a do të mund ta shihte ndarjen e atij personi të vetëm, e atij njeriu të pashoq?

Po qe se copërat e gurëve nuk do të shihnin, si do të dëshmonin brenda grushtit?

O mendje, hapi flatrat dhe këndoje suren "Kur toka të tronditet me një lëkundje të fuqishme..."!

Po qe se kjo tokë nuk do të shohë ditën e kiametit, si do të dëshmojë për të keqin?

Kurse ajo do ta thotë gjendjen ku ndodhet, gjërat që di! Toka do të na i hapë sekretet!

Edhe dërgimi im te një sovran si ti, është një provë e kësaj... Ai që e dërgon, e di se

Një sëmundje e tillë ka nevojë për një ilaç të tillë që, sigurisht, do ta shërojë lehtë atë plagë të padurueshme!

Para kësaj ke parë ëndrra dhe e ke kuptuar se Zoti do të më zgjedhë e do të më dërgojë mua...

Unë do të merrja në dorë shkopin dhe dritën dhe do t'ia thyeja zverkun një njeriu të paturpshëm si ti!

Prandaj Zoti, zotëruesi i ditës së kiametit, të tregonte ty ëndrra të llojllojshme!

Ato ishin ëndrra të denja për zemrën tënde të keqe, për tërbimin tënd, ato donin të ta tregonin ty se ishin plotësisht në përshtatje me gjendjen tënde!

Zoti t'i tregonte këto që ta dije se Ai ishte një Zot i urtë dhe i ditur për çdo gjë dhe, në të njëjtën kohë, i cili dhuronte shpëtim për vuajtjet e pashpëtim!

Por ti u ngrite t'i interpretosh këto ëndrra... Ti u bëre qorr dhe shurdh dhe the se ato ishin fantazira të ardhura nga gjumi i rëndë!

Edhe mjekët me astrologët, me shkëndijat e dritës që kishin, e panë kuptimin e ëndrrave, por, për shkak të lakmisë, nuk e thanë të vërtetën!

Ata të thanë: "Dëshpërimi, tronditja e pushtetit janë larg pushtetit dhe sovranitetit tënd...

Njeriu sheh gjithmonë ëndrra të tilla ose nga ushqimet e ndryshme, ose nga gjellët!"

Sepse e panë se ti nuk do këshillë, je i ashpër e i pasjellshëm, je gjakatar!..

Sovranët derdhin gjak për një punë, por mëshira e tyre qëndron mbi zemërimin e tyre!

Padishahu duhet të pajiset me shprehitë e Zotit. Mëshira e Zotit e kapërcen ndëshkimin e tij!

Nuk duhet që ndëshkimi të jetë epror si te shejtani! Po të ndodhë ashtu, derdh gjak pa qenë e nevojshme!

Nuk është e drejtë as butësia si butësia e njerëzve të pandershëm e të padenjë, sepse edhe gruaja i bëhet orospi, edhe shërbëtorja!

Mirëpo ti e bëre zemrën shtëpi shejtani; e bëre urrejtjen orientim për veten!

Brirët e tu të mprehtë shpuan sa e sa zemra... Ja, pra, ky shkopi im ta theu zverkun tënd të ndyrë!

Sulmimi i banorëve të kësaj bote kundër banorëve të asaj bote, sulmi gjer te brezat që janë kufiri i botës së fshehtë,
rënia në shkujdesje e padije për shkak të qenies së tyre në pusi... Fundja, edhe gaziu, po të mos shkojë në luftë,
qafirët hyjnë në vendin musliman dhe grabisin.

Ushtarët fizikë sulmojnë kalatë e shpirtërorëve...

E sulmojnë kalanë që mbron rrugëkalimin e botës së fshehtë me qëllim që të mos vijë nga ajo anë dikush krejt e pastër!

Po nuk shkuan gazinjtë në luftë, qafirët ecin e sulmojnë.

Gazinjtë e botës së fshehtë nuk të sulmojnë ty ngaqë janë të ditur, o keqvajtës!

I sulmove kalatë e rrugëkalimeve të botës së fshehtë; nuk deshe që burrat e së fshehtës të vijnë këtej!

Ua hodhe kthetrat belit të etërve, mitrës së nënave; deshe ta presësh udhën me të keqe!

Si mund ta mbyllësh ti rrugën e madhe të hapur nga Zoti, epiqendra e hyjnitetit, për të rritur njerëz fisnikë?

O kryeneç, ti i zure kalatë e rrugëkalimeve, por, kundër verbërisë tënde, ja që doli një burrë!

Ja, unë jam ai burrë që doli! Unë ta djeg e ta shemb synimin tënd! Me emrin e Zotit, t'i asgjësoj emrin dhe famën!

Ti mbaji kalatë e rrugëkalimeve... Gjer kur do të vazhdosh t'u qeshësh mjekrës dhe mustaqeve të tua?

Kaderi t'i shkul një e nga një mjekrën e mustaqet dhe më në fund e kupton se kundërshtimi i kaderit s'ka dobi!

Mjekra dhe mustaqet e tua janë më të fuqishme, apo ato të Ad-it? Nga fryma e tyre dridheshin qytetet!

Ti je më kryeneç, apo Themudi? Si ata s'ka ardhur tjetër në këtë botë!

Edhe njëqind shembuj të tjerë si këta të të jap, nuk ka dobi, sepse ti je i shurdhër. Ti dëgjon, por bën sikur s'dëgjon!

Bëra pendesë për fjalën që thashë dhe e bëra pikërisht ilaçin tënd...

Do ta lyej këtë ilaç mbi mjekrën tënde të trashë dhe ajo ose do të piqet, ose do të digjet, kurse ti do të mbetesh përjetësisht me plagë!

Dhe në këtë mënyrë e di se Zoti di gjithçka! Çdo gjëje ia jep ilaçin e duhur, o dushman!

Kur bëre një punë të shtrembër, kur bëre një punë të keqe dhe nuk e gjete menjëherë pas saj atë që meritoje?

Kur dërgove në qiell një frymë e një lutje dhe pas saj s'të erdhi një e mirë e ngjashme me të?

Po të kesh kujdes, po të jesh i zgjuar, çdo çast ke për ta gjetur përgjigjen e punës që ke bërë!

Po të kesh kujdes e të kapesh pas litarit të shpëtimit, nuk është nevoja që për ty të vijë kiameti!

A është nevoja t'i thuhet fjalë e hapur atij që i njeh mirë shenjat dhe simbolet?

Kjo kokëçarje të vjen nga kokëtrashësia, ngaqë s'i kupton idetë dhe simbolet!

Kur zemra të të nxihet për shkak të së keqes, kuptoje se këtu nuk është nevoja e hutimit!

Ajo nxirje të bëhet ty një shigjetë dhe atëherë të arrin ndëshkimi i hutimit!

Po s'të arriti shigjeta, s'të arrin nga favori dhe bujaria, jo se e keqja jote s'duket!

Eja në vete dhe, nëse të duhet zemër, ki kujdes! Sepse pas çdo pune del në shesh diçka për ty!

Po të bësh më shumë përpjekje, puna jote e kujdesshme lartësohet më shumë!

Trupi i njeriut të krijuar prej dheu, i ngjet hekurit prej minerali të mirë, ka kapacitet për t'u bërë pasqyrë;
te ai, edhe në këtë botë duken xhenneti, xhehennemi, etj.,
dhe duken hapur e drejt, jo me rrugën e imagjinatës!

Edhe ti, në pamje, i ngjet një cope hekuri të ndryshkur, prandaj fërkoje e jepi shkëlqim vetes!

Dhe, në këtë mënyrë, zemra të të bëhet një pasqyrë plot trajta dhe në të, çdo çast të pasqyrohet nga çdo anë një bukuri me trup të argjendtë!

Ç'është e vërteta, hekuri është i zi, i shëmtuar, por fërkimi dhe shkëlqimi ia heqin të zezën.

Hekuri shkëlqehet dhe e zbukuron fytyrën dhe, në këtë mënyrë, në të mund të shihen trajta!

Trupi i krijuar nga dheu është trashanik, i zi, por pranon pastrim dhe shkëlqim, prandaj pastroje dhe shkëlqeje!

Jepi shkëlqim në mënyrë që te ai të nisin të duken trajtat e së fshehtës, të duken reflektimet e hyrive dhe engjëjve!

Dije se Zoti të ka dhënë shkëlqim të mendjes, me të cilën pastrohet dhe ndriçohet gjethja e zemrës!

O i panamaz, e ke lënë shkëlqimin dhe i ke hapur të dy duart e dëshirave dhe pasioneve!

Po të mbyllen dashirat dhe pasionet, hapet dora e shkëlqyesit.

Në hekurin që është pasqyrë e së fshehtës, duken të gjitha trajtat.

E ndryshke dhe e nxive botën tënde të brendshme dhe ja, ky është kuptimi i ajetit "përpiqen të shkaktojnë intriga mbi tokë"!

Kështu veprove gjer tani, pra, mos vepro më kështu këtej e tutje! E nxive ujin, mos e nxi më shumë!

Mos e turbullo, që ky ujë të kthjellohet dhe shihe atëherë në atë ujë se hëna dhe yjet bëjnë tavaf!

Sepse njeriu i përngjet ujit të lumit; po u turbullua, nuk ia sheh dot fundin!

Fundi i lumit është i mbushur plot me inxhi dhe merxhane... Kurrë mos e turbullo se ai është i thjeshtë e i kthjellët!

Shpirti i njerëzve i përngjet ajrit; po u përzje me pluhur, bëhet perde në qiell, nuk e tregon qiellin!

Bëhet pengesë për dukjen e diellit. Por po t'i ikë pluhuri, bëhet e thjeshtë dhe e ndritshme!

Megjithëse zemrën e ke sterrë të zezë, Zoti të ka treguar ëndrra që ta gjesh rrugën e shpëtimit!

Musai (a.s.) ia tregon Faraonit të fshehtat si dhe, duke i dhënë lajm nga bota e fshehtë, ia tregon se ç'ëndrra ka parë, me qëllim që Faraoni të besojë se Zoti di gjithçka ose, të paktën, të dyshojë për këtë.

Me fuqinë e tij, Zoti i tregoi te hekuri i zi sterrë se ç'ka për të ndodhur në fund...

Në këtë mënyrë, dëshiroi që ti të bësh më pak të këqija; mirëpo ti, megjithëse i shihje vazhdimisht këto, bëheshe më i keq!

Të tregoi gjëra të këqija në ëndërr... Ti u trembe prej tyre, por ato gjëra të këqija ishin trajta jote!

Si puna e atij zezakut që u pa në pasqyrë dhe, kur e pa fytyrën e vet të shëmtuar, e ndyu pasqyrën!

E pështyu dhe i tha: "Ti je e shëmtuar, prandaj e meriton këtë!" Kurse pasqyra iu përgjigj: "Shëmtia që sheh ti këtu është shëmtia jote, o njeri i verbër dhe i ulët!

Edhe këtë pështymë ia hodhe fytyrës tënde, jo mua, sepse unë jam krejt e ndritshme!"

Ti herë e pe rrobën të djegur, herë gojën të zënë, syrin të qorruar!

Herë një lugat ta piu gjakun, herë një kafshë e egër ta kafshoi kokën!

Herë e pe veten duke rënë kokëposhtë në llagëm, herë duke u mbytur në rrebeshe të përgjakura!

Herë, në ëndërr, nga ky qiell i pastër të erdhi një zë: "I keq je, i keq, i keq!"

Disa herë dëgjove qartë këtë zë nga malet: "Ik, ore ti... Ti je nga të xhehennemit!"

Herë, nga çdo gjë e pashpirt dëgjove thirrjen: "Faraoni ra përjetësisht në xhehennem!"

Pe ëndrra më të këqija se këto, por më vjen turp të t'i them, në mënyrë që të mos zemërohesh dhe natyra jote e mbrapshtë të mos mbrapshtohet më shumë!

O ti që s'pranon këshillë, po të them më të paktën dhe dëgjoje këtë dhi dje se unë e di!

E bëre veten të verbër e të vdekur me qëllim për të mos i menduar ëndrrat që shihje dhe gjërat që kishin për të të rënë mbi kokë!

Gjer kur do të ikësh? Ja ku të doli para verbëria e mendësisë sate të mashtrimeve!

Porta e pendesës është e hapur.

Eja në vete dhe largohu prej kësaj këtej e tutje, sepse, me bujarinë e Zotit, porta e pendesës është e hapur!

Pendesa ka një portë të hapur nga perëndimi; ajo është e hapur gjer në kiamet!

Ajo portë do të mbetet hapur gjersa dielli të lindë nga ana e perëndimit, pra, mos ia kthe shpinën asaj porte!

Me mëshirën e Zotit, xhenneti ka tetë porta... O bir, njëra nga ato tetë porta është porta e pendesës!

Të gjitha të tjerat herë hapen e herë mbyllen, kurse porta e pendesës është gjithmonë e hapur!

Këtë dije si pasuri... Porta është e hapur, pra, përkundër verbërisë së ziliqarit, hiqja shulin!

Musai (a.s.) i thotë Faraonit: "Prano një këshillë prej meje dhe, si shpërblim, fito katër virtyte!"

Eja në vete, prano një këshillë prej meje dhe, si shpërblim, merr katër gjëra!

Faraoni i tha: "Ç'këshillë është ajo? Ma trego pak atë këshillë!"

Musai i tha: "Ajo këshillë e vetme është kjo: Thuaje hapur: "Zoti është një, nuk ka Zot tjetër veç tij!"

Ai është krijuesi i lartë i qiejve dhe yjeve, njerëzve dhe shejtanëve, xhindve, perive dhe zogjve!

Ai është krijuesi i detit, fushës, malit dhe shkretëtirës. Vendi i tij s'ka kufi, ai vetë s'ka të ngjashëm!"

Faraoni i tha: "O Musa, ç'janë ato katër gjëra që do të më japësh si shpërblim të kësaj?

M'i thuaj dhe, me favorin e atij premtimi të bukur, kryqi i mohimit tim të më lirohet!

Ndoshta për shkak të atyre premtimeve të këndshme që do të marr si shpërblim, më hapet dryni i rëndë i mohimit!

Ndoshta nën ndikimin e lumit të mjaltit, helmi i urrejtjes që kam në trup më zbutet dhe ëmbëlsohet...

Ose me reflektimin e atij lumi prej qumështi krejt të pastër, mendja ime e robëruar ushqehet qoftë edhe për një çast!

Ose me reflektimin e atyre lumenjve të verës, dehem dhe e nuhas pak kënaqësinë e urdhrit të Zotit!

Ose nga kthjelltësia e lumenjve, trupi im shterp dhe i shembur rinohet...

Në trupin tim djerr mbin gjelbërim dhe gjembat më kthehen në parajsë!

Ndoshta, me reflektimin e xhennetit dhe katër lumenjve, shpirti më meriton ndihmën e Zotit dhe vihet ta kërkojë të dashurin!

Me të vërtetë, me reflektimin e xhehennemit, jam bërë zjarr... jam përzjerë me ndëshkimin e Zotit!

Me reflektimin e gjarprit të xhehennemit, jam kthyer në gjarpër. Jam duke u hedhur helm njerëzve të xhennetit, jam duke i qëlluar ata!

Nën ndikimin e vlimit të ujit të vluar të xhehennemit, këtu, nën ndikimin e shkumëzimit të tij, atje, uji im i mizorisë e shuan popullin!

Me reflektimin e mesdimrit jam bërë mesdimër... Ose, me reflektimin e xhehennemit, i kam ngjarë xhehennemit!

Tani jam xhehennem për të varfërit dhe viktimat... Mjerë ata në i shtifsha në dorë!

Si shpërblim për besimin, Musai (a.s.) ia tregon Faraonit katër virtytet.

Musai i tha: "I pari ndër ata të katër, trupi të mbetet i shëndoshë përjetësisht!

O njeri i mençur, sëmundjet e treguara në mjekësi, të largohen nga trupi!

I dyti, jeta të bëhet e gjatë... Vdekja i druhet jetëgjatësisë sate!

Pasi të kalosh një jetë të mirë, nuk ikën nga kjo botë pa arritur qëllimin!

Madje e kërkon vdekjen siç kërkon qumësht foshnja në gji, jo për shkak të ndonjë mundimi ose vuajtjeje që të robëton!

E kërkon vdekjen, por jo se ke rënë në një mundim dhe ke mbetur i paaftë, por se e ke parë thesarin në gërmadhën e shtëpisë tënde!

Atëherë e merr kazmën dhe, pa u menduar fare, fillon ta shembësh shtëpinë!

Sepse e sheh shtëpinë si mbulesë të thesarit; e kupton se kjo, e vetme, bëhet pengesë për qindra të vjela!

Atëherë, këtë e hedh në zjarr, fiton cilësi burrërore, bëhesh burrë!

O ti që e humb vreshtën për një gjethe! Ti i ngjet krimbit që kapet e humbet pas një gjetheje dhe, kështu, mbetet pa rrush!

Por nëse favori dhe bujaria e Zotit e zgjojnë këtë krimb, kuçedra e padijes të ha e të fshin ty!

Krimbi kthehet në kopësht plot pemë e fruta... Ja, pra, fatmirët, një ndryshim të tillë meritojnë!

Komenti i hadithit të shenjtë: "Unë isha një thesar i fshehtë dhe desha të njihesha!"

Shembe shtëpinë... Me këtë kristal Jemeni bëhen qindramijëra shtëpi!

Thesari ndodhet nën shtëpi; është e pamundur të shtihet në dorë pa u shembur shtëpia! Mos u druaj nga shembja e shtëpisë, mos rri!

Sepse me paranë që do të nxirret nga ky thesar, mund të ndërtohen mijëra shtëpi pa vështirësi e pa mundim!

Fundja kjo shtëpi, në fund fare, do të bëhet gërmadhë dhe, atëherë, edhe thesari nën të do të dalë sheshit!

Mirëpo atëherë thesari nuk do të jetë më yti, sepse pasuria që do të të binte në dorë, do të ishte pagesa për shpirtin për shembjen e shtëpisë!

"Njeriu fiton vetëm atë për të cilën është përpjekur!" Kur të mos marrësh asnjë pagesë për atë punë,

Do të rrish duke thënë: "Mjerë unë! Një hënë e tillë paska qenë nën re dhe unë nuk e pashë!

Nuk i mbajta fjalët që m'u thanë si mirësi. Tashmë thesari shkoi, mbeta duarbosh!"

Për shembull, ti zë me qira një shtëpi të tillë që, edhe sikur ta blesh, prapë nuk bëhet prona jote!

Periudha e qirasë në këtë shtëpi, me qëllim që të bësh punë, është gjer në vdekje!

Në këtë dyqan merresh me arnim vjetërsirash, por nën dyqan janë të groposura dy metale!

Ky dyqan është me qira... Shpejtohu, merre kazmën dhe gërmoja fundin!

Të të hasë menjëherë kazma në metal e të shpëtosh edhe nga dyqani, edhe nga arnimi i vjetërsirave!

Ç'është ky arnimi i vjetërsirave? Të hash bukë, të pish ujë... Me këto arna e arnon pa pushim pelerinën tënde të vjetër!

Kjo pelerinë e trupit griset vazhdimisht, kurse ti e arnon duke ngrënë bukë e duke pirë ujë!

O ti me fatin të ardhur nga fisnikëria, eja në vete dhe turpërohu nga arnimi!

Gërmoje pak fundin e këtij dyqani që ato dy metalet të ta ngrenë lart kokën!

Eja në vete para se të mbarojë afati i qirasë i kësaj shtëpie, përndryshe, edhe afati i qirasë mbaron, edhe ti mbetesh pa nxjerrë ndonjë dobi prej saj!

Atëherë, pronari i dyqanit të nxjerr nga dyqani të cilin e shemb për të shtënë në dorë thesarin!

Kurse ti herë i bie kokës, herë shkul mjekrën e trashë!

Dhe thua: "Mjerë për mua! Ky dyqan ishte imi... A mos isha i verbër që nuk nxora ndonjë dobi prej tij?

Sa keq! Kjo ishte jona, por na e mori era, kurse neve, robve, na mbeti të mjerohemi përjetësisht!"

Duke u mashtruar nga zgjuarsia e tij e bashkëlindur dhe mendimet, njeriu nuk e kërkon dituriné e fshehtë që është dituria e pejgamberëve.

Unë pashë në shtëpi, një stoli, një qëndisje dhe, me dashurinë për atë shtëpi, u bëra i pavendosur.

As që dita gjë për thesarin, ndryshe, kazma më bëhej lule në dorë!

Ah, po t'ia kisha dhënë atë kohë hakun kazmës, tani kisha shpëtuar nga ankthi!

Ia kisha ngulur sytë qëndisjes, si fëmijët, kisha mbetur i zhytur pas lojërave të dashurisë!

Ai gjykatësi i shenjtë më pati thënë: "Ti je një fëmijë. Edhe shtëpia e mbushur me qëndisma, vizatime e figura, s'është as e drejtë, as e bukur!"

Në "Ilahiname" më pati dhënë shumë këshilla, më pati thënë t'ia gërryej rrënjën qenies e ta bëj tym e pluhur.

Faraoni tha: "O Musa, mjaft, zemra m'u tret nga vuajtja; më në fund, thuaje premtimin e tretë!"

Musa i tha: "I treti është kështu: pushteti të dyfishohet dhe bëhesh zotërues i pushtetit dhe salltanetit të pastruar nga armiqtë e të dy botëve!

Bëhesh zotërues i pushtetit, i të mirave dhe i vendeve më të shumta se këto që ke tani! Pushteti i tanishëm është në luftë, kurse ai pushtet është në paqe e qetësi!

Pa shih atë që të fal një pushtet dhe vend të tillë në botën e luftës, si të shtron një sofër për vendin tënd në paqe!

Vështro e shih se ai që t'i jep ato me bujari në kohë mundimi, si kujdeset për ty në kohë shpërblimi!"

Faraoni tha: "O Musa, kush është i katërti? Thuaje shpejt, sepse durimi m'u mbarua, ambicja m'u shtua!"

Musai i tha: "Do të mbetesh i ri gjithmonë, flokët dhe mjekra do të jenë gjithmonë të zeza, kurse fytyra e kuqe si mollë!

Për ne, ngjyra dhe aroma nuk kanë vlerë, por ti je i ulët, prandaj po flas për botën e ulët!

Krenimi me ngjyrë, aromë, pozitë i gëzon fëmijët, i gënjen ata!

Hadithi: "Popullit folini jo sa ju mban mendja juaj, por sa mban mendja e tij, në mënyrë që të mos i thonë gënjeni Zotit dhe pejgamberit të tij!

Puna më ra me fëmijët... Duhet ta përdor gojën e fëmijëve të tjerë!

T'i them: "Shko në shkollë, pa të të marr një zog ose të të sjell rrush të thatë dhe arra!"

Ti nuk di gjë tjetër veç rinisë së trupit, prandaj merre këtë rini... O gomar, na elb!

Fytyra nuk të rrudhet fare, nuk të zbehet. Rinia jote e bekuar mbetet po në këtë gjendje!

Atij s'i vjen as rrudhje pleqërie, as shtati i bëhet dy kat si selvi!

As fuqia e rinisë tek ti pakësohet, as dhëmbët të zverdhen e të lëvizin!

Nuk e sheh as pasivitetin që bëhet shkak për neverinë e grave ndaj burrave, as paaftësinë dhe vuajtjen ngaqë s'bie dot me gruan!

Shkëlqimi i kohës së rinisë të çel e të gëzon në atë mënyrë siç e pati çelur dhe gëzuar Ukashen myzhdeja e Pejgamberit!

"Kush më lajmëron se ka dalë Saferi, do t'i jap lajmin e mirë të xhennetit!"

Ahmedi, pejgamberi i kohës së fundit, mërgoi në muajin Rebiulevvel. për këtë nuk ka aspak kundërshtim!

Kur zemra ia mori vesh këtë kohë mërgimi, u bë i dashuruari me shpirt dhe zemër i asaj kohe!

Kur erdhi Saferi e mbaroi, u gëzua se do të udhëtonte.

Çdo natë, me dëshirën për këtë takim, thoshte gjer afër mëngjesit: "O shok, i larti i të lartëve!"

Dhe vazhdonte: "Kush më jep myzhden se doli muaji Safer...

Kush më gëzon me lajmin se doli Saferi dhe hyri Rebiulevveli, edhe unë do ta gëzoj me xhennetin, do t'i bëhem shefaatçi, ndërmjetësues!"

Ukashe shkoi dhe i tha: "Myzhde! Saferi doli e shkoi!" Dhe Pejgamberi i tha: "O luan, xhenneti është yti!"

I shkoi edhe dikush tjetër e i tha se Saferi doli... Pejgamberi i tha se myzhden e mori Ukashe!

E shikon se si burrat e vërtetë gëzohen nga mërgimi prej kësaj bote? Kurse fëmijët i gëzohen mbetjes në këtë botë!

Zogut qorr që nuk e ka shijuar ujin e mirë, uji i hidhur i duket eliksir!

Edhe Musai numëronte e derdhte parashikime të tilla që të mos bjerë hidhërim në lumturinë tënde!

Faraoni i tha: "Mirë fort! Mirë fole, por unë po piqem e këshillohem edhe me një mik të mirë!"

Faraoni këshillohet me Asijen në lidhje me besimin ndaj Musait (a.s.).

Faraoni ia hapi këtë fjalë Asijes Asija i tha: "O ti që të është nxirë zemra, jepua zemrën këtyre premtimeve!

Në këto fjalë ka mirësira të mëdha... O sovran me shprehi të mira, mos rri, menjëherë fitoji këto!

Erdhi koha e të mbjellave dhe çfarë të mbjellash të dobishme!" Këto fjalë i tha dhe, nga dëshira, nisi të qajë!

U hodh përpjetë nga vendi dhe i tha: "Ç'lumturi për ty! O qeros i mjerë, dielli t'u bë kurorë në kokë!

Qylafi e mbulon turpin e qerosës, pa le sikur ai qylaf të jetë dielli dhe hëna!

Pse nuk i the "po", pse nuk i the "qindra herë qoftë i falenderuar" qysh kur i dëgjove këto në atë kuvend?

Po qe se kjo fjalë do të binte në vesh të diellit, do të zbriste kokëposhtë me shpresë për t'i merituar këto!

A e kupton se ç'premtim, ç'favor është ky? Sikur Zoti ta kërkonte e ta pyeste Iblisin!

Ai bujar të ftoi ty për një favor dhe mirësi të tillë dhe si durove? për t'u çuditur!

Si s'ta treti zemrën kjo? Po të ta kishte tretur, do të merrje pjesë nga të dy botët!

Po të tretej zemra e njeriut për hir të Zotit, do të meritonte favore e të mira në të dy botët si dëshmorët!

Edhe indiferentizmi është urtësi, edhe kjo verbëria jote e ka një urtësi, po pse të jetë gjer në këtë gradë?

Që kapitali të mos fluturojë dore shpejt e shpejt, indiferentizmi është edhe urtësi, edhe dhunti!

Por nuk duhet të bëhet një plagë e pashërueshme! Nuk duhet të bëhet helmi i mendjes dhe shpirtit, nuk duhet ta mundojë njeriun!"

Kush mund ta arrijë një dhënie-marrje të tillë? Po e blen trëndafilishten për një trëndafil!

Si shpërblim për një farë, qindra drurë... Si shpërblim për një kokërr drithi, qindra monedha!

Të thuash "Kush e bën çdo gjë për hir të Zotit dhe bëhet i sinqertë ndaj Zotit", do të thotë ta japësh atë kokërr. Në këtë mënyrë fitohet e vërteta e fjalës "Edhe Zoti bëhet i tiji dhe ia jep çdo gjë që dëshiron!"

Sepse kjo qenie e mangët dhe e pavendosur është krijuar nga qenia e paperënd ueshme e Zotit!

Po qe se qenia e vdekshme ia jep veten atij, bëhet e përjetshme, kurrë nuk vdes!

Si pika e ujit që ka frikë nga era dhe dheu ohe, për shkak të tyre, prishet!

Sapo që pika e ujit të bashkohet me detin që është origjina e saj, shpëton edhe nga nxehtësia e diellit, edhe nga era, edhe nga dheu!

Pamja i humbet në det, por individualiteti i saj nuk humbet, përkundrazi, përjetësohet, përmirësohet!

Eja në vete, o pikë uji dhe jepe qenien pa u penduar; jepe dhe, si shpërblim për një pikë, gjeje detin pa anë e pa fund!

Eja në vete, o pikë uji, dhe gjeje këtë nder, bjer në pëllgmbë të detit dhe bëhu e sigurtë në atë pëllëmbë se nuk ke për t'u prishur!

Kujt i ka rënë në dorë një fat i tillë? Një det e dëshiron dhe e kërkon pikën!

Për hir të Zotit, për hir të Zotit, shite shpejt dhe blej! Jepe pikën dhe fitoje detin plot margaritarë!

Për hir të Zotit, për hir të Zotit, mos e vono fare... Kjo fjalë vjen nga deti i favoreve!

Edhe favori, madje, humbet mes favoreve... Njeriu i ulët e i pavlerë ngjitet në qiellin e shtatë!

Eja në vete, askush nuk e gjen dot këtë me të kërkuar... U bë si u bë, rastise në një lojë të çuditshme!

Faraoni tha: "Po e bisedoj këtë edhe me Hamanin; padishahu duhet ta marrë mendimin e vezirit!"

Asija i tha: "Mos ia thuaj këtë të fshehtë Hamanit! Ku e di vlerën e skifterit plaka qorre?"

Skifteri i padishahut dhe gruaja plakë.

Po ia dhe skifterin një plake, ajo ia pret thonjtë e kthetrave për t'i bërë mirë!

Mirëpo gjymtyra me të cilën bën punë, gjuan skifteri, janë kthetrat me thonjtë e gjatë... kurse plaka e shkretë e verbër ia pret thonjtë verbërisht aty për aty!

Dhe i thotë: "Ku e paske tët ëmë, o bir që të janë rritur thonjtë kështu?"

Dhe plaka e keqe ia pret skifterit thonjtë, krahët, sqepin...

Pastaj i vë para një supë me thela brumi dhe, kur ai ha pak, nxehet dhe e lë mënjanë dashurinë!

Dhe i thotë: "Gatova për ty një supë të tillë të shijshme me copa brumi të pjekur, kurse ti s'e njeh të mirën, tregohesh i pasjellshëm!

Ti je i denjë për mundime e kokëçarje! Ku do ta dish se ç'është fati i mirë?

Po s'i hëngre thelat, të paktën pi nga lëngu!" Dhe i jep nga lëngu i supës!

Por skifterit nuk i pëlqen as lëngu i supës! Atëherë, gruaja plakë zemërohet krejt!

Nga zemërimi, ia hedh mbi krye skifterit supën e nxehtë, ia përvëlon kokën dhe e bën qeros fare!

Skifterit i përvëlon zemra dhe, duke kujtuar favoret e padishahut i cili u jepte shkëlqim zemrave, fillon të qajë!

Nga ato sy lozonjarë e të përkëdhelur nga vështrimet bujare të padishahut, i derdhen lotë si rrëke!

Sytë e tij të mprehtë u mbushën me plagë të hapura nga ajo sorrë plakë. Kështu ndodh që e bukura, syri i bukur, të bjerë në mjerim nga syri i keq!

Kurse syri i tij ishte një sy i tillë që të dy botët i dukeshin si një fije floku!

Edhe sikur në sy t'i binin mijëra qiej, do të humbisnin siç humbet një burim uji pranë detit!

Sapo që ai sy të largohet nga gjërat e kësaj bote ndjesore, sheh botën e fshehtë dhe për shkak të kësaj aftësie, puthet e përkëdhelet!

Nuk gjej dot një vesh që të mbaj një ligjëratë për atë sy të bukur!

Po të dilnin jot të bekuar nga ai sy, Xhebraili ia kapte çdo pikë...

Po qe se ai dilber i bukur do t'i jepte lejë, do t'ia lyente pikën në flatra e në sqep.

Skifteri thoshte: "Zemërimi i plakës mori flakë, por nuk m'i dogji dot fuqinë, bukurinë, durimin dhe diturinë!"

Skifteri im i shpirtit end qindra trajta... E plagos devenë, jo Salihun!

Sapo që Salihu të marrë një frymë, të bëjë një lutje, nga mali lindin qindra deve të atij lloji!

Zemra thotë: "Hesht, mblidhe mendjen, ndryshe, zelli ta heq e ta gris endjen e qenies!"

Por ç'ti bësh! Krenaria prej sovrani nuk detyronte dot dëgjimin e këshillës dhe, më në fund, e shkuli këshillën nga zemra dhe e hodhi tutje!

Zelli i Zotit është tejet i butë, ndryshe, brenda një çasti qindra botë do të digjte!

Faraoni tha: "Duhet të takohem e të këshillohem me Hamanin. Tek ai mbështetet vendi, tek ai gjej unë forcë e fuqi!"

Personi me të cilin këshillohej Mustafai, ishte Besniku i Zotit. Ai që i jepte mendim Ebuxhehlit, ishte Ebulehebi!

Kështu e tërhoqi lloji atë, që asnjë këshillë s'i hyri në vesh!

Çdo gjë fluturon me qindra krahë për të shkuar te lloji i vet; i këput të gjitha lidhjet me fantazinë për t'u bashkuar me të!

Gruaja që i kishte shkarë fëmija mbi ulluk dhe i kishte rënë në rrezik, shkon te Aliu (k.s.) për t'i kërkuar zgjidhje.

Te Murtezai shkoi një grua dhe i tha: "Fëmija më ka shkarë mbi ulluk.

Po ta thërras, s'e kap dot; po ta lë, kam frikë se do të rrëzohet e do të vritet!

Nuk ka mend që t'i them të shpëtojë nga rreziku, të vijë tek unë, e të më kuptojë!

Po t'i bëj shenjë me dorë, prapë s'kupton! Edhe po të më kuptojë, e keqja është se s'më dëgjon!

Ia tregova gjirin dhe qumështin, por e kthen fytyrën mënjanë!

Për hir të Zotit, o njerëz të mëdhenj, ju jeni edhe në këtë botë ata që ua japin dorën të dobtëve, edhe në botën tjetër!

Gjemi një zgjidhje të shpejtë hallit tim se zemra më dridhet se mos e humb frytin e zemrës!

Aliu i tha: "Gjithmonë del një fëmijë... Me ta parë fëmija llojin e vet,

Menjëherë kalon nga ulluku në çati... Lloji është përjetësisht i pasionuar pas llojit të vet!"

Gruaja ashtu bëri... me ta parë fëmija i saj fëmijën tjetër, u kthye nga ai

Dhe kaloi nga ulluku në çati. Dije se çdo lloj tërheq llojin e vet!

Fëmija shkoi duke u zvarritur në atë anë ku ndodhej fëmija tjetër dhe shpëtoi nga rreziku i rrëzimit.

Edhe pejgamberët janë dërguar si njerëz me qëllim për t'i shpëtuar njerëzit nga ulluku!

Pejgamberi thoshte: "Edhe unë jam njeri si ju... Ejani te lloji juaj dhe mos humbni!"

Sepse lloji ka një tërheqje të çuditshme. Eshtë lloji që e bën këdo që të kërkojë dikë tjetër.

Isai dhe Idrisi qenë të të njëjtit lloj me engjëjt, prandaj u ngjitën në qiell!

Kurse Haruti me Marutin qenë nga lloji i trupit, prandaj zbritën nga lartësitë, në ultësira!

Mohuesit, qafirët, janë të të njëjtit lloj me xhindët... Shpirtrat u janë bërë çirakë të shejtanëve!

Kanë mësuar qindramijëra vese të këqija nga shejtanët, e kanë mbyllur syrin e mendjes dhe zemrës!

Vesi më pa rëndësi i veseve të tyre të këqija është zilia, zilia që i ra qafës Iblisit!

Ata qenër u kanë mësuar këtyre mendjemadhësinë dhe zilinë. Ata s'duan që populli të meritojë një pronë dhe pushtet të përjetshëm!

Po të shohin te dikush ndonjë cilësi të lartë djathtas a majtas, dëshpërohen nga zilia!

Sepse i pafati që i është djegur lëmi, do që askujt të mos i ndizet qiriri!

Eja në vete dhe fito edhe ti një vlerë të lartë dhe mos vuaj për vlerat e larta të të tjerëve!

Lutiu Zotit të ta largojë zilinë, në mënyrë që Zoti të të shpëtojë prej kufomës tënde!

Të të japë ty një preokupim të brendshëm që të mos e ngresh dot kokën!

Zoti i ka dhënë një gllënjke verë një ndjeshmëri të tillë që e deh njeriun duke e shpëtuar nga të dy botët!

I ka dhënë një grushti bime droge një ndjeshmëri të tillë që e rrëmben njeriun prej vetes qoftë edhe për një farë kohe!

Zoti i ka dhënë gjumit një gjendje të tillë që e ndërpret mendimin nga të dy botët!

E ka sjellë Mexhnunin, për shkak të dashurisë për një copë lëkurë, në atë gjendje që të mos e dallojë dot mikun nga armiku!

Ai ka qindra verëra si kjo që do t'i binin më qafë kuptimit tënd!

Nefsi, egoja, ka verëra të këqija, me të cilat e nxjerr njeriun e keq nga udha!

Mendja ka verëra bekimi me gëzimin e të cilave njeriu gjen një konak pa perëndim!

I dehur, e shkul që andej çadrën e kupës qiellore dhe niset për udhë!

Eja në vete, o zemër dhe mos u bëj krenare... Isai është i dehur pas Zotit, kurse gomari, i dehur pas elbit!

Nga këta qypa kërko ato lloj verërash që dehja jote të mos marrë fund!

Sepse çdo dashnor i ngjan një qypi të mbushur plot... Ai është i turbulluar, kurse ky, i kthjellët si inxhi!

O burrë që e kupton dhe e njeh verën, shijo me maturi që të gjesh një verë të papërzjerë e të kthjellët!

Që të dy llojet e verërave të dehin, por dehja e kësaj e tërheq dhe e çon njeriun gjer te Zoti!

Pije këtë dhe shpëto nga mendimet, lëkundjet, dredhitë dhe mashtrimet dhe vrapo e kërce si deve e çliruar nga kapistra!

Pejgamberët janë nga lloji i shpirtit dhe engjëllit, prandaj e tërheqin engjëllin që është në qiell!

Era është nga lloji i zjarrit, është miku i tij... Që të dy lartësohen, ngjiten në lartësi!

A ia mbylle grykën shtambës së zbrazët dhe e hodhe në hauz apo lumë?

Nuk fundoset gjer në kiamet! Sepse brenda është bosh dhe në atë boshllëk ka ajër.

Prirja e ajrit është për në lartësi... Edhe enën ku ndodhet, e ngre lart!

Edhe shpirtrat që janë nga lloji i pejgamberëve, duke u tërhequr zvarrë shkojnë pranë tyre!

Sepse mendja e personit të këtij lloji është e lartë. S'ka dyshim se, përsa i përket krijimit, edhe mendja është e të njëjtit lloj me engjëjt!

Ajri i nefsit, egos, është më i lartë se armiku, por nefsi është nga lloji i ulët, prandaj shkon në botën e ulët!

Kiptiu ishte nga lloji i Faraonit kurse pjesëtarët e fiseve izraelite, nga lloji i Musait, bashkëbiseduesit të Zotit!

Hamani ishte krejtësisht nga lloji i Faraonit, prandaj e pati zgjedhur Faraoni atë, e kishte vënë në krye të vendit, e kishte bërë vezir!

Përfundimisht, edhe Hamani e tërhoqi atë nga kryevendi gjer në fundin e xhehennemit, sepse ata dy burra të ndyrë ishin nga lloji i xhehennemit!

Që të dy ishin përvëlues si xhehenemi; që të dy ishin e kundërta e dritës! Që të dy ishin persona që, si xhehennemi, druheshin nga drita e zemrës dhe e kishin neveri atë!

Sepse xhehennemi thotë: "O besimtar, kalo shpejt nëpër sirat sepse drita dhe bukuria jote do të ma shuajnë zjarrin!

O besimtar, po të ma prekë fundi i rrobës tënde zjarrin, do të ma shuajë, prandaj kalo menjëherë!"

Edhe njeriu i xhehennemit frikësohet dhe ikën prej drite, sepse, o i bukuri im, ai ka natyrë xhehennemi!

Ashtu siç ikën besimtari me tërë dëshirën nga xhehennemi, ashtu dhe xhehennemi ikën prej besimtarit!

Sepse drita dhe bukuria e besimtarit nuk janë nga lloji i zjarrit. Kush kërkon dritën dhe bukurinë, është, në të vërtetë, e kundërta e zjarrit.

Ka ardhur në hadith: Besimtari i lutet Zotit ta shpëtojë prej xhehennemit...

Edhe xhehennemi i lutet atij me gjithë dëshirë: "O Zot, mbamë mua larg prej filanit!.."

Shihe tani tërheqjen e llojit dhe kuptoje se nga ç'lloj je ti, nga i mohimit, apo nga i besimit?

Në paç prirje ndaj Hamanit, je nga lloji i Hamanit; në paç prirje ndaj Musait, je nga lloji i të Madhit!

Në paç prirje ndaj të dyve, ke përzjerje nga të dy llojet. Tek ti, mendja dhe nefsi janë të përzjerë!

Që të dy në luftë me njëri-tjetrin! Eja në vete dhe përpiqu që kuptimet të kenë epërsi ndaj trajtave!

Që ta shohësh armikun çdo çast në disfatë, të mundur... Në botën e luftës, ky gëzim është i mjaftueshëm!

Faraoni me surrat inatçiu, më në fund, ia tha këto fjalë Hamanit në mënyrë të trashë!

Ia tregoi premtimet e Musait, bashkëbiseduesit të Zotit... E bëri atë të mbrapshtë konfidentin e vet!

Faraoni kështillohet me vezirin e vet Haman në lidhje me besimin ndaj Musait (a.s.)

Me ta gjetur vetë Hamanin, Faraoni ia tregoi këto. Hamani u hodh përpjetë dhe çorri rrobën.

I mallkuari, klithi e vajtoi; i hoqi çallmën dhe pelerinën dhe i hodhi përdhe!

Dhe i tha Faraonit: "Si ndodhi që ia tha këto fjalë të paturpshme e të kota sovranit në fytyrë?

Ti e ke vënë tërë botën nën sundim dhe punën tënde, me ndihmën e fatit, e ke kthyer në flori!

Mbretërit të sjellin taksa ty pa këmbënguljen dhe kërcënimin tënd edhe nga lindja, edhe nga perëndimi!

O padishah i madh, të gjithë padishahët ta puthin me gëzim pragun e portës tënde!

Kur kali i armikut e sheh kalin tonë, kthehet mbrapsht pa ia treguar thuprën!

Gjer tani ishe ti të cilit i falej bota; a mos ke për t'u bërë tani njeriu më i ulët?

Eshtë më e këndshme që zotëria të hidhet në zjarr, sesa t'i përkulet e t'i falet shërbëtorit të vet!

Jo, kjo s'ka mundësi! O sovrani im që ke vënë nën sundim edhe Kinën, më parë vritmë mua që mos të të shohnë atë gjendje!

Sovrani im, më parë bjeri qafës sime që të mos ma shohin sytë këtë poshtërim!

S'ka ndodhur ndonjëherë një gjë e tillë, por edhe s'duhet të ndodhë! Si? Të bëhet qielli tokë e toka, qiell, ë?

Shërbëtorët tanë do të bëhen shokë porte me ne; robërit do të na i plagosin zemrat, ë?

Sytë e armiqve do të ndrisin, kurse sytë e miqve do të verbohen... Pastaj, neve, fundi i varrit do të na bëhet trëndafilishte!

Poshtërsia e fjalëve të Hamanit - Zoti e mallkoftë!

Hamani nuk i njihte mikun me armikun, tavllën e luante përsëmbrapthi!

O i mallkuar, armiku yt s'është tjetërkush veç teje. Mos iu nënshtro urrejtjes e mos u thuaj armik të pafajshmëve!

Sipas teje, kjo gjendje është lumturi, ë? Në fillim vrapo, pastaj ha dru!

Po s'ike duke u zvarritur nga kjo lumturi, kjo pranvera jote ka për të t'u bërë vjeshtë e ashtu ka për të të ikur!

Sa e sa njerëz si ti kanë parë lindja dhe perëndimi! Në fund fare të gjithëve u është prerë koka nga trupi!

Kur as lindja me perëndimin nuk janë të përjetshme, si mund ta përjetësojnë një njeri?

Populli t'u la e t'u lye për pak ditë nga frika, nga droja e hyrjes në burg kurse ti krenohesh me të!

Por kujt t'i bëjë sexhde populli, do të thotë se ia helmon shpirtin atij.

Sapo t'i kthehet një herë fati, sapo të mirat t'ia kthejnë shpinën, e kupton edhe ai se e kanë helmuar, edhe njeriu që di!

Ç'lumturi për atë që e ka poshtëruar nefsin e vet! Mjerë për atë që, me mendjemadhësi, ka ngritur krye si mal!

Dije se të mbajturit më të madh është verë e helmuar. Me atë verë, kokëtrashi bëhet i dehur.

Nëse një i paqenë e pi verën e helmuar, e tund kokën nga gëzimi për një farë kohe,

Por një çast më vonë helmi i vepron në zemër dhe fillon të bjerë në agoni!

Po qe se s'beson që është i helmuar, shih se ç'i bëri ajo verë e helmuar popullit të Adit!

Sapo që një padishah ta kapë një padishah tjetër, ose e vret, ose e mbyll në një qeli të errët!

Por sapo një i vuajtur ta shohë një të vuajtur tjetër, i gjen melhem për vuajtjen, i bën të mira!

Nëse e mbajtura më të madh nuk është helm, pse e vret padishahu atë pa faj e pa gabim?

Dhe pse e lavdëron tjetrin kur ai nuk i ka bërë nderime të veçanta? Po t'i shohësh këto dy veprime, mund ta kuptosh helmimin.

Pirati që zë rrugën, kurrë nuk e rreh e nuk e vret të varfërin! Ujku kurrë nuk e kafshon ujkun e ngordhur!

Hizri e shpoi dhe e theu gjeminë për ta shpëtuar nga duart e njerëzve të këqinj!

Meqë gjemia e thyer shpëton, theu dhe ti! Siguria është te varfëria; ec bëhu dhe ti i varfër!

Mali që kishte minerale dhe para, u bë copë-copë nga plagët e kazmave dhe varéve!

Shpata pret qafën e atij që ka qafë. Hija është shtrirë përtokë; ajo nuk plagoset fare!

Madhështia, tepria janë zjarr, o azgan... O vëlla, si po e hedh veten në zjarr?

Shih, ai që është shtrirë dhe bërë njësh me tokën, a bëhet shenjë për shigjetat?

Por sapo ta ngrejë kokën nga toka, atëherë, si shenjat, plagoset pa një pa dy!

Ky pretendim për "ne" dhe "unë" është shkallë e njerëzve. Më në fund, njeriu rrëzohet nga kjo shkallë.

Kush ngjitet më lart, ai është më i trashë, sepse, kur të rrëzohet, i thyhen kockat më keq!

Këto janë gjëra të dyta... Thelbësore është kjo: madhështia është politeizëm, është t'i bësh shok Zotit!

Po vdiqe dhe s'u ngjalle me të, je armik që lufton për t'u bërë ortak me të, për të fituar prona dhe pushtet!

Por po u ringjalle me të, që ringjallja me të bëhet, kjo është unitet i plotë, këtu s'ka politeizëm!

Por këtë shihe në pasqyrën e punëve, sepse s'e kupton dot këtë me fjalë, me thashetheme!

Po ta them atë që kam përbrenda, shumë vetëve u pikon zemra gjak!

Prandaj kaq gjë po e quaj të mjaftueshme; fundja, kjo u mjafton atyre që kuptojnë. Kush të jetë në fshat, ja ku u bëra zë dy herë!

Shkurt, Hamani, me ato fjalë ia preu Faraonit këtë lloj rruge!

Kafshata e lumturisë i kishte ardhur gjer në fyt kurse Hamani ia preu qafën Faraonit!

Lëmin e shirë të Faraonit ia lëshoi erës! Asnjë padishah mos pastë një vezir të tillë!

Musai (a.s.) e pret shpresën se Faraoni i ndodhur nën ndikimin e fjalëve të Hamanit, do të besojë!

Musai tha: "Unë të tregova favore, të bëra bujarira, por ç'të bëj? Zoti s'ta paska bërë kësmet!

Padishahllëkun e pavërtetë mos e di as dorë, as mëngë!

Padishahllëku me të vjedhur e me të vrarë është pa shpirt, pa zemër e pa sy!

Po qe se padishahllëkun ta ka dhënë populli, e merr përsëri prej teje sikur ta merrte borxhin!

Padishahllëkun hua jepja Zotit dhe Zotit të të japë një padishahllëk që ta pranojë gjithëkush!

Feudalët arabë i drejtohen Mustafait (a.s.) me propozimin për ta ndarë mes tyre vendin dhe shtetin në mënyrë që të mos mbetet grindje dhe rrëmujë. Mustafa (a.s.) u përgjigjet: "Unë jam i ngarkuar me detyrë për ta drejtuar shtetin". Të dy palët hyjnë në bast.

Bejlerët arabë u mblodhën, shkuan te Pejgamberi dhe nisën të grinden.

Ata i thanë: "Ti je një bej, edhe secili nga ne është një bej! Ta përpjesëtojmë këtë bejllëk dhe ti merre pjesën që të takon nga vendi!

Secili ta pranojë pjesën që i bie; edhe ti laji duart, më në fund, nga pjesa jonë!"

Pejgamberi u tha: "Bejllëkun mua ma dha Zoti. Ai më dhuroi pushtet absolut!"

Ai urdhëroi: "Kjo kohë është koha e Ahmedit, kjo periudhë është periudha e Ahmedit... Ejani në vete dhe zbatojeni urdhrin e tij!"

Fisi i tha: "Edhe ne sundojmë me pëlqimin e Zotit! Edhe neve Zoti na e ka dhënë bejllëkun!"

Pejgamberi tha: "Por mua Zoti ma dha bejllëkun si pronë, kurse juve jua huajti si një pretekst!

Bejllëku im është i qëndrueshëm gjer në kiamet, kurse bejllëku hua ikën shpejt e shpejt!"

Fisi i tha: "O urdhërues,mos fol shumë! Ti thua se je epron ndaj nesh; ku e ke provën?"

Menjëherë, me urdhrin persekutues të Zotit, në qiell u shtri një re, shpërtheu rrebeshi që e përmbyti vendin përreth!

Ai rrebesh i frikshëm u drejtua nga qyteti. Duke klithur nga tmerri, qytetarët filluan të ikin me vrap!

Kishte ardhur koha e provës! Ishte koha kur dyshimi do të fshihej, kurse e vërteta do të dilte sheshit!

Pejgamberi u tha: "Çdo bej ta hedhë heshtën që ky rrebesh të qëndrojë! Edhe sëmundja shkaktohet nga ushqimi i mirë, edhe fuqia! Le ta provojmë bejllëkun tonë!" Të gjithë i hodhën heshtat!

Edhe Mustafai e hodhi shkopin që kishte në dorë, atë shkop që i linte të pafuqishëm mosbesimtarët që sundonin!

Dhe rrebeshi i tërbuar, kryeneç dhe i fuqishëm i mori me vete si fije kashte të gjitha heshtat!

Të gjitha heshtat u humbën, kurse shkopi, si një vëzhgues, qëndronte mbi ujë!

Me ndihmën e atij shkopi, rrebeshi i fuqishëm e ktheu rrugën nga qyteti dhe u drejtua për në një vend tjetër.

Bejlerët arabë që e panë një punë të tillë të madhe, nga frika e miratuan të gjithë pushtetin e Mustafait.

Vetëm tre vetë me smirë të madhe nuk besuan. Nga inati thanë magjistar dhe orakull.

Pushteti i marrë hua bëhet kështu, i dobët. Kurse pushteti që është e dhënë e Zotit, është ja, kështu, i lartë!

O person me sojin dhe sorollopin të njohur, po s'i pate parë ato heshtat dhe shkopin, shih emrat e atyre bejlerëve dhe emrin e Pejgamberit!

Emrat e tyre i fshiu rrebeshi i vdekjes, kurse emri dhe pushteti i Ahmedit vazhdon të ekzistojë!

Emri i tij thirret pesë herë në ditë dhe kështu do të vazhdojë gjer në kiamet!

Po të kesh mend, të bëra favore; po të jesh gomar, kam sjellë një shkop për gomar!

Dhe të nxjerr nga kjo stallë në atë mënyrë që me këtë shkop t'i përgjak kokë e veshë!

Atëherë, as gomarët e tjerë të kësaj stalle e durojnë vuajtjen tënde, as njerëzit!

Ja, pra, kam sjellë një shkop për ta sjellë në rrugë e për ta edukuar çdo gomar të padëshiruar!

Për të të ndëshkuar ty, ky shkop bëhet kuçedër, sepse edhe ti je bërë si kuçedër në shprehitë dhe veprimet e tua!

Ti je një kuçedër mali e pamëshirshme, por pa shihe kuçedrën e qiellit!

Në këtë shkop ka pjesë nga xhehennemi! Eja në vete dhe ik në dritë!

Ndryshe, mbetesh mes dhëmbëve të mia dhe askush s'të shpëton dot nga unë! Kështu të thotë ajo!

Ky shkop është bërë tani kuçedër në mënyrë që të mos thuash ku është xhehennemi i Zotit!

Kush e njeh fuqinë e Zotit, nuk pyet se ku janë xhenneti me xhehennemin!

Zoti e bën xhehennemin ku të dëshirojë. Lartësitë e qiellit i kthen në kurthe për zogjtë dhe shpendët!

Dhëmbëve u jep një dhimbje të tillë që thua se kjo dhimbje dhëmbi është xhehennem, është kuçedër!

Ose e bën pështymën mjaltë. Ti thua se këto janë xhennet dhe rroba xhenneti,

Nga rrënjët e dhëmbëve nxjerr sheqer. Në këtë mënyrë, e kupton vendimin e kaderit!

Atëherë, mos i kafsho me dhëmbë të pafajshmit; mendo gjendjen nga e cila nuk do të shmangesh, nuk do të shpëtosh dot!

Zoti e ktheu Nilin në gjak për kiptët, kurse izraelitët i shpëtoi nga belaja!

Shihe këtë dhe kupto se i dalloi personin me mend në kokë që ecën në rrugë të Zotit, nga i dehuri!

Këtë dallim, Nili e mësoi nga Zoti dhe këtij i bëri të mira, kurse tjetrin e shtrëngoi fort!

Favori i Zotit i dha mend Nilit, kurse persekutimi i tij e hutoi Kabilin!

Me bujarinë e tij, Zoti krijoi aftësi mendore te gjërat pa shpirt, kurse me persekutimin e tij, ia mori mendjen të mençurit!

Me favorin e tij, te gjëja pa shpirt shtroi mendje, kurse me persekutimin e tij, dija iku nga njerëzit me mend!

Me urdhrin e tij, reshoi aty mendje si shi, kurse mendja e këtij e pa zemërimin e Zotit dhe iku!

Reja, shiu, hëna dhe yjet në lartësira..., të gjithë vijnë e shkojnë sipas një rregulli.

Secili vjen vetëm në kohën e vet dhe as vonohet, as vjen më herët!

Si ndodhi që këtë të mos e mësosh nga pejgamberët ti? Ata i dhuruan dije gurit e drurit!

Shihi këto dhe gjërat e tjera pa shpirt krahasoji pa dyshim me gurin e drurin!

Bindja e gurit dhe e drurit del në shesh dhe tregon edhe për gjendjen e gjërave të tjera pa shpirt në dukje.

Ato thonë: "Ne e njohim Zotin dhe i bindemi atij dhe të gjithë ne s'jemi gjëra të kota të krijuara rastësisht!"

Shihe ujin e Nilit dhe kupto... A nuk bëri dallim mes dy bashkësive?

Ashtu siç e di se si e gëlltiti toka Karunin, dije edhe se Nili ka njohuri!

Edhe hëna, po kështu! Me ta dëgjuar urdhrin, u nda në mes! Apo jo!

Kudo ku të kishte një gur apo dru, i dha haptazi selam Mustafait, apo jo! Ja, pra, kështu njihi të gjitha gjërat e pashpirt!

Përgjigje Dehriut, materialistit, që e mohon ekzistencën e Zotit dhe thotë se bota nuk ka fillim.

Dje njëri thoshte se bota u krijua më pas, se ky qiell është i përkohshëm, trashëgimtari i tij është Zoti!

Një filozof tha: "Si e di që u krijua më pas? Si e di shiu se reja u krijua më pas?

Ti nuk je as një molekulë e kësaj gjithësie që është në ndryshim të vazhdueshëm, atëherë, si e di se dielli është krijuar më pas?

Ku do ta dijë krimbi i zhytur në pisllëk fillimin dhe fundin e tokës?

Ti e dëgjove këtë fjalë nga yt atë dhe, me kokëtrashësi, e imitove dhe u kape pas saj!

Cili është argumenti se u krijua më pas? Thuaje, përndryshe, hesht dhe mos tento të flasësh tepër!

Njeriu tha: "Në këtë det të thellë, një ditë pashë se dy grupe njerëzish kishin hyrë në bast.

Ndërsa ata flisnin dhe haheshin me njëri-tjetrin, populli u mblodh rreth tyre.

Edhe unë u futa mes turmës dhe prita të kuptoj se ç'thoshin.

Një pjesë thoshin se bota është e përkohshme; nuk ka dyshim se kjo ndërtesë e ka një ndërtues.

Pjesa tjetër thoshte se kjo botë është e përhershme, nuk ka fillim, nuk ka krijues apo ndërtues; edhe në pastë, është vetë ajo.

Ai që i besonte Zotit, i tha tjetrit: "E mohove krijuesin, u bëre mohues i Zotit që rrotullon natën me ditën dhe ushqen!"

Filozofi tha: "Unë nuk e dëgjoj fjalën pa argument dhe provë. Vetëm kokëtrashi kapet pas imitimit!

Eja, tregoje argumentin tënd, ndryshe unë s'dëgjoj fjalëpa argument në këtë botë!"

Besimtari i tha: "Argumenti dhe prova janë në shpirtin tim! Në shpirt kam një provë të fshehtë!

Ti e ke syrin të dobët, nuk e sheh dot hënën e re, por unë e shoh, pra, mos u nxeh me mua!"

Fjala u zgjat, kurse dëgjuesit mbetën të mahnitur pas kreut dhe fundit të kësaj bote të stolisur!

Besimtari tha: "O mik, në zemër kam një provë... Për mua, është një shenjë se bota është krijuar më pas!

E kam besuar fort dhe shenja e besimit tim është kjo: Ai që beson fort, edhe sikur të hyjë në zjarr,

Ashtu si enigma e ashkut te ashikët, nuk dëmtohet, nuk digjet, nuk shkatërrohet!

E fshehta e fjalëve të mia kuptohet vetëm nga e verdha, nga dobësia e fytyrës sime!

Lotët e nxehtë që rrjedhin në faqe, janë argument dhe provë e bukurisë së të dashurës!"

Filozofi tha: "Unë nuk u jap rëndësi këtyre gjërave që s'përbëjnë provë për të gjithë njerëzit, nuk i quaj provë këto!"

Besimtari tha: "Sikur akçeja kallpe me akçen e vërtetë të hyjnë në bast, sikur akçeja e vërtetë t'i thotë kallpes "ti je kallpe, kurse unë, e vërtetë",

Prova e fundit është zjarri! Kur këto dy motra të bien në zjarr, gjendjen e tyre e kuptojnë edhe parësia, edhe njerëzit e thjeshtë! Të gjithë shpëtojnë nga dyshimi se e kuptojnë mirë se ç'janë ato!

O shpirt, edhe uji dhe zjarri janë krijuar për të vënë në provë akçen e vërtetë me akçen kallpe.

Ti dhe unë, le të hyjmë në zjarr! Le të bëhemi provë e qëndrueshme për ata që habiten pas kësaj pune!

Unë dhe ti, le të zhytemi përnjëherësh në det, sepse edhe unë jam një provë për këta njerëz, edhe ti!"

Dhe ashtu bënë! U futën në zjarr. Të dy e hodhën veten në zjarrin e përvëluar!

Ai që pretendonte se ka Zot, shpëtoi, kurse tjetri, i keqi, u dogj e u shkatërrua!

Këtë lajm dëgjoje nga muezini... E shton edhe një herë aq verbërinë e shpirtit të paditur!

Emri i Mustafait nuk u dogj nga vdekja, sepse bartësi i atij emri qëndronte përtej vdekjes!

Qindramijërat që hyjnë në bast në këtë periudhë, kanë grisur perdet e mohuesve!

Besimtari me filozofin e vendosën këtë punë. Ndodhi ajo që pati ndodhur gjithmonë me mrekullitë: i drejti doli fitues!

Dhe nga kjo përgjigje e kuptova se, ai që thotë se bota, gjithësia, kanë fillim, se ky qiell është krijuar më pas, ka të drejtë!

Fytyra e provës së sjellë nga mohuesi është gjithmonë e verdhë. Ku është prova mbi drejtësinë e atij mohimi?

Ku ka minare prej nga të lavdërohen mohuesit? Më trego ndonjë minare të tillë në botë dhe le të jetë ajo provë e drejtësisë së tyre!

Ku ka një katedër ku të ngjitet dikush dhe të përmendë kohën e një mohuesi?

Emrat e pejgamberëve të shtypura mbi paratë, janë shenjë e drejtësisë së tyre gjer në kiamet!

Paratë e mbretërve ndryshojnë, kurse paraja e Ahmedit vazhdon gjer në kiamet!

Le të jetë flori apo argjend... Tregoje emrin e një mohuesi mbi një para!

Eja, mos e quaj mrekulli këtë! Shih edhe Kur'anin me njëqind gjuhë që është i qartë si drita e diellit dhe quhet Libri i Përgjithshëm!

Askush s'ka as fuqinë, as kurajën për të vjedhur një shkronjë prej tij apo për të shtuarnjë fjalë në të!

Bëhu mik me të epërmin që të bëhesh i epërm! Eja në vete, o azgan, mos u bëj mik me të humburit!

Prova e mohuesit është vetëm e vetëm kjo: "Unë nuk shoh vend tjetër veç këtij vendi që shihet!"

Ai s'mendon aspak se kudo që ka një gjë që shihet, ajo lajmëron për urtësitë e fshehta!

Dobia e çdo gjëje që shihet, ashtu si dobia e ilaçeve e fshehur në to, është e fshehur brenda asaj gjëje!

Komenti i ajetit "Qiejt dhe tokën dhe ato që ndodhen mes tyre i krijova me të drejtë", pra, jo vetëm që t'i shihni ju, por i krijova për kuptimin që nuk e shihni ju dhe për një urtësi të përjetshme!

A ka ndonjë piktor që ta bëjë pikturën pa ndjekur ndonjë interes, thjesht për të pikturuar?

Edhe për të pikturuar e bën, edhe dëshiron që, me këtë pretekst, njerëzit të shpëtojnë nga vuajtjet.

Me pikturën dëshiron që fëmijët të gëzohen, që miqtë e vdekur të kujtohen nga miqtë!

Nuk ka asnjë shtambar që ta bëjë shtambën thjesht për të bërë shtambë, pa menduar që brenda saj të futet ujë!

Nuk ka asnjë poçar që ta bëjë poçen thjesht për të bërë poçe, pa pasur për qëllim që në të të futet gjellë!

Nuk ka asnjë kaligraf që ta bëjë bukurshkrimin vetëm për ta treguar bukurinë e shkrimit të tij dhe jo edhe që njerëzit ta lexojnë!

Trajta e dukshme provon trajtën në botën e fshehtë e cila, nga ana e saj, është bërë e qenë nga një trajtë tjetër e botës së fshehtë!

Dhe, kështu, mund të vazhdohet duke numëruar shumë e shumë trajta njëra pas tjetrës!

O bir, këto u përngjasin varianteve të pafundme të lojës së shahut. Dobinë (përvojën) e çdo loje shihe në lojën tjetër!

Këtë lojë e luajnë për ta luajtur lojën e fshehtë dhe atë, për një lojë tjetër... Më në fund, edhe atë e luajnë për një lojë tjetër!

Ktheji sytë, kështu, nga të gjitha anët dhe shihi të gjitha lojërat që luhen për të bërë mat e për ta fituar në këtë lojë!

Për t'u ngjitur në shkallë, në fillim do të shkelësh mbi shkallaren e parë, pastaj në të dytën.

Dhe dije se shkallarja e dytë është bërë për t'u ngjitur në të tretën dhe, kështu, duke u ngjitur shkallare pas shkallareje, arrin në çati!

Ushqimi është për të prodhuar spermë dhe sperma, për të prodhuar soj e sorrollop, për t'i ndriçuar sytë dhe zemrën!

Po njeriu pamjeshkurtër nuk sheh gjë tjetër veç punës së parë. Mendja e tij u ngjet barërave të mbira në tokë, ai është i burgosur në vend, nuk shëtit, nuk përsillet dot tjetërkund!

Edhe barin, n'daç thirre, n'daç mos e thirr... I ka ngecur këmba në tokë, s'të vjen dot!

Edhe nëse e tund kokën nën veprimin e erës, mos u gënje nga ajo tundje koke!

Koka i thotë flladit të mëngjesit, "të dëgjuam, o fllad", kurse këmbët kundërshtojnë: "lërna të qetë tani!"

Edhe pamjeshkurtëri, meqë nuk di të shëtisë, ashtu si njerëzit e ulët, hiqet zvarrë, si qorrat, e hedh hapin duke u mbështetur te Zoti!

Ç'dobi ka të mbështetesh te Zoti në luftë? Kjo i përngjet mbështetjes te Zoti nga fillestarët që luajnë tavëll!

Kurse vështrimet e mprehta që s'kanë mbetur të ngrira në një vend, shkojnë duke depërtuar para, i grisin perdet dhe shikojnë!

Ata që kanë vështrime të tilla, që tani dhe me sytë e tyre, i shohin ngjarjet që kanë për të ndodhur dhjetë vjet më vonë!

Kështu, çdokush e sheh edhe të fshehtën, edhe të ardhmen me aq sa ç'e ka depërtues vështrimin. Edhe të mirën e sheh, edhe të keqen!

Kur para e pas syve të mos mbetet ndonjë halë, e gjithë bota bëhet e sheshtë dhe sytë e lexojnë edhe tabelën e të fshehtës!

Kur ta kthejë vështrimin pas, para syve i del e gjithë aventura dhe krijimi i gjithësisë duke filluar qysh në çastin e parë të ekzistences!

Dëgjon dhe sheh se si engjëjt e tokës me Zotin e lartë vënë bast për çështjen e atit tonë si zëvendës i Zotit mbi tokë!

Dhe kur ta hedhë vështrimin para, të gjitha ç'kanë për të ndodhur gjer në ringjallje i dalin të gjalla para syve!

Kështu, pra, kur të shohë pas, i shfaqet çdo gjë gjer në origjinë dhe kur të shohë para, çdo gjë gjer në kiamet!

Çdo njeri sheh në raport me ndriçimin dhe shkëlqimin e zemrës!

Kush t'i ketë dhënë shkëlqim më tepër zemrës, sheh më shumë! Atij i duken më shumë trajta!

Po qe se thua që kjo tejdukshmëri është favor i Zotit, edhe suksesi në pastrimin dhe tejdukshmërinë e zemrës është e dhënë e Zotit, është favor i tij!

Edhe ajo punë, edhe ajo lutje, është në raport me përpjekjen... "Njeriu fiton vetëm atë për të cilën është përpjekur!"

Eshtë vetëm Zoti që e jep përpjekjen! Asnjë fije kashte nuk e zotëron përpjekjen e sovranit!

Fakti që Zoti e cakton dikë për një punë të caktuar,që e vë në atë punë, nuk do të thotë se e pengon dëshirën, parapëlqimin dhe vullnetin!

Por sapo që një njeriu të pafat t'i japë ndonjë mundim, ai i mbledh ç'ka e nuk ka dhe i tërheq në anë të mohimit dhe kundërshtimit!

Po t'i japë mundim një fatmiri, ai i tërheq më pranë ç'ka u nuk ka!

Njerëzit zemërkëqinj, ngaqë kanë frikë, kapen pas shkaqeve të dezertimit nga lufta!

Kurse burrat trima sulmojnë radhët e armiqve përsëri nga frika e shpirtit!

Frika dhe shqetësimi i çon para Rustem-ët. Kurse frikacaku zemërkeq vdes në vend nga frika!

Kokëçarja dhe frika e shpirtit janë gur prove! Kështu ndodh që trimat dallohen nga frikacakët në çast rreziku!

Zoti i dërgon Musait (a.s.) mesazhin: "O Musa, unë, Zoti krijues, të dua ty!"

Zoti i dërgoi Musait një mesazh të frymëzuar në zemër: "O njeri i zgjedhur, unë të dua!"

Musai i tha: "O bujar, thuaje shkakun që, çfarëdo që të jetë, ta shtoj!"

Zoti i tha: "Edhe sikur të zemërohet e ëma me të, fëmija prapë i hidhet në qafë s'ëmës!

Nuk njeh qenien e tjetërkujt veç saj! Eshtë i shtënë pas saj, i dehur pas saj!

Edhe sikur e ëma t'i japë një shuplakë, prapë te ajo shkon, hyn në prehër të saj!

S'kërkon ndihmë prej askujt tjetër veç saj! Ajo është gjithë e keqja dhe gjithë e mira!

Edhe në kujtesën tënde, në të mirë e në të keqe, nuk ka tjetërkënd veç meje! Ti as që e kthen kokën për të parë tjetërkund!

Për ty, çdo gjë tjetër veç meje është gur e dhé. S'të interesón askush, le të jetë fëmijë, i ri apo plak!

Kësaj i ngjet ajo që thuhet në namaz: "Ijjake neabudu", vetëm ty të adhurojmë; dhe, në kohë kokëçarjeje, "s'kërkojmë ndihmë prej tjetërkujt veç teje!"

"Ijjake neabudu" është përjashtim dhe e posaçme vetëm për ta eliminuar dëmin.

Edhe "Ijjake nesteain" është përjashtim dhe kërkesën për ndihmë e bën të posaçme vetëm për Zotin.

Domethënë, kuptimi i këtij ajeti është kështu: Vetëm ty të adhurojmë dhe ndihmën vetëm prej teje e kërkojmë!

Padishahu zemërohet me nedimin, shokun e bisedës; dikush ndërhyn dhe i lutet padishahut ta falë; padishahu e pranon ndërhyrjen, kurse nedimi zemërohet me personin që ndërhyn dhe e qorton për ndërhyrjen.

Një padishah u nxeh me njërin prej nedimëve, shokëve të tij të kohës së lirë dhe bisedës dhe deshte ta bënte hi e pluhur!

E hoqi shpatën prej milli për t'ia prerë kokën nedimit, për ta ndëshkuar për veprimin e gabuar.

Ndërkaq, askush s'ishte në gjendje të thoshte diçka ose të ndërhynte te padishahu me lutje për ta falur.

Vetëm një nga të afërmit e padishahut, me emrin Imadylmylk, tentoi të bënte një ndërhyrje prej Mustafai.

U hodh nga vendi dhe ra në sexhde. Atëherë, edhe padishahu e lëshoi menjëherë shpatën prej dore.

Dhe tha: "Edhe sikur të jetë djall, e fala, ia mbulova fajin!

A e hodhe këmbën? Edhe sikur të më ketë bërë qindra dëme, po e pranoj.

Mund të heq dorë nga qindramijëra nxehje. Në atë gradë është vlera jote tek unë!

Nuk mund të rri indiferent ndaj lutjes tënde... Lutja jote do të thotë lutja ime!

Nuk do ta kisha falur këtë njeri sikur qielli me tokën të bashkoheshin!

Edhe sikur çdo qelizë e trupit të tij të më lutej veç e veç, nuk do t'ia shpëtonte dot kokën nga shpata!

Por duke e falur, nuk dua të të lë ty nën detyrimin e mirënjohjes, vetëm dua të të tregoj ç'vlerë ke ti tek unë, o nedimi im i mirë!

Nuk e bëre ti këtë, e bëra unë! O nedim, cilësitë e të cilit janë groposur në cilësitë tona, o nedim që na e ke lënë neve qenien tënde!

Ti nuk e bëre këtë punë me dashje, por se ashtu të erdhi përbrenda! Unë jam ai që të shtyu ty për këtë! Sepse nuk jam unë që ta kam dhënë veten ty, por ti ma ke dhënë mua qenien tënde!

Je bërë i merituari i ajetit "Ti nuk i hodhe ato gurë; në të vërtetë, Zoti i hodhi!" Ia ke lëshuar dhe lënë veten si shkumë dallgëve!"

Meqë u bëre "la", ngrije shtëpinë pranë "il'lallah"-ut. Eshtë e çuditshme se je edhe rob, edhe zotëri!

Ç'të ketë dhënë, padishahu e ka dhënë, jo ti... Të drejtën Zoti e di më mirë; vetëm ai është që ekziston!

Nedimi shpëtoi nga kokëçarja dhe mundimi, por aq u prek nga ky ndërmjetësuesi, sa u bë që të mos i jepte selam!

E preu miqësinë me atë njeri të sinqertë. Po ta haste në rrugë, e kthente kokën nga muri dhe nuk i jepte selam, nuk e përshëndeste!

Ishte bërë pothuajse i huaj për shokun që e kishte shpëtuar... Populli u çudit, kjo punë u muar nëpër gojë dhe nisi të tregohej si ngjarje.

Çdokush thoshte: "Nëse s'është i marrë, pse e la miqësinë me shokun që ia shpëtoi jetën?

Ia shpëtoi kokën, ia bleu sërish shpirtin, prandaj ky duhej të bëhej dhé ku i shkelte këmba!

Mirëpo ky po vepron në të kundërt, filloi të ushqejë urrejtje për një mik të tillë!"

Dikush që donte t'i afronte, e dënoi qëndrimin e këtij dhe i tha: "Pse sillesh kështu keq me një mik këshilltar si ky?

Ai mik i vërtetë i padishahut ta shpëtoi jetën, nuk të iku koka, shpëtove, por ai të shpëtoi!

Edhe sikur të të bënte një të keqe, nuk duhej t'i largoheshe, kurse ai mik i mirë dhe i pastër të bëri një të mirë!

Nedimi tha: "Unë do ta bëja fli jetën për padishahun; ai pse hyri në mes dhe ndërhyri për faljen time?

Në atë çast unë me Zotin ndodhesha në një afrim të tillë që në mes nuk mund të na hynte as dhe një pejgamber i zgjedhur!

S'dua mëshirë përveçse ndëshkimin e padishahut, nuk mbështetem tek tjetërkush veç tij!..

Unë e kisha kthyer fytyrën nga padishahu, e kisha dashur atë, kurse tjetërkënd e kisha vlerësuar me zero! Për mua s'ekzistonte tjetërkush veç tij!

Edhe sikur të ma presë kokën për ndëshkim, më fal gjashtëdhjetë jetë!

Puna ime është të luaj me kokën time, të heq dorë nga qenia, kurse puna e padishahut ti është të falë kokat!.."

Ç'lumturi për kokën e prerë me dorën e padishahut... Mjerë për kokën që përkulet para dikujt tjetër!

Po qe se padishahu ndëshkon dhe e kthen natën në errësirë si zift, nata arrin në një gradë të tillë të lartë që kthjellohet pa pasur mijëra ditë feste!

Rrotullimi rreth padishahut i atij që e sheh padishahun, është edhe mbi ndëshkimin, edhe mbi favorin, edhe mbi mohimin, edhe mbi besimin!

Nuk ka në botë një fjalë për ta shprehur këtë... Eshtë e fshehtë, e fshehtë, e fshehtë!

Sepse fjalët me këta emra të bukur e të pastër u shfaqën te Ademi.

"Emrat e gjithësisë" ishin prijës për Ademin, por në një veshje të posaçme!

Kur Ademi vuri në kokë një qylaf prej uji dhe dheu, fytyra e atyre emrave që i përkisnin shpirtit, u nxi.

Me qëllim që të shfaqet kuptim prej uji dhe dheu, emrat e shpirtit e mbuluan fytyrën me perçen e frymës.

Ç'është e vërteta, në një aspekt, fjala e hap kuptimin, por, në dhjetë aspekte, e mbulon, e fsheh!

Xhebraili (a.s.) e pyet Halilin nëse kishte ndonjë nevojë.
Halili i përgjigjet: "Kam, por jo prej teje!"

Unë jam Halili i kohës, kurse ai është Xhebraili. Unë s'e dua udhëzimin e tij në kohë kokëçarjeje!

A nuk e mësoi ai edukatën nga Xhebraili i cili ndërhyri për Halilin? Kur Xhebraili i tha Halilit të Zotit:

"Ke ndonjë dëshirë? Më thuaj, të të ndihmoj! Përndryshe, të iki menjëherë!"

Ibrahimi i tha: "Jo, ti hiqu nga mesi! Pasi e vërteta të ketë dalë në shesh, mjeti është mundim!"

Për këtë botë, pejgamberi është një lidhje që i afron robë te Zoti. Sepse ai është mjet mes besimtarëve dhe Zotit!

Por nëse çdo zemër do ta dëgjonte dhe ndjente mesazhin e fshehtë të Zotit, ç'do të kishte nevojë në botë për tinguj dhe zëra?

Ç'është e vërteta, ai është asgjësuar në Zotin, është pa kokë, por puna ime është më e hollë se e tij!

Puna e bërë prej tij është punë Zoti, unë jam i dobët në krahasim me të... E drejtë, por kjo punë, prapë më duket e keqe mua!

Gjëja që është vetë favori për popullin, është persekutimi i burrave të lartë e të përkëdhelur.

Prandaj populli duhet të heqë mundime e kokëçarje në mënyrë që ta shohë dhe kuptojë ndryshimin në mes!

O mik i vërtetë, këta tinguj që janë mjet për ta kuptuar kuptimin, sipas njeriut që ia ka arritur kuptimit, janë gjemba, janë të ulët e të poshtër!

Prandaj, që shpirti i kulluar të shpëtojë prej tingujve, duhet që të heqë shumë kokëçarje dhe të ketë shumë mirëkuptim!

Mirëpo disa bëhen krejt të shurdhër nga këta tinguj, kurse disa të tjerë që janë më të lartë, bëhen më eprorë!

Kjo kokëçarje i përngjet lumit Nil, është ujë për të mirët dhe gjak për të këqinjtë!

Kush e sheh më shumë fundin, është më i bekuar, kapet pas pune me më seriozitet, mbjell të lashta dhe mbledh më shumë fruta!

Sepse e di se kjo botë mbjelljeje është krijuar për t'u përgatitur për ringjalljen, për ta vjelë e për ta mbledhur këtu të mbjellën për jetën e pasme, ahiret.

Nuk ka asnjë lidhje që të lidhet për atë lidhje. Ajo lidhje është për të shtënë në dorë një tregti, për të fituar një fitim!

Po ta vësh re me kujdes, sheh se mohimi i asnjë mohuesi nuk është thjesht për mohim...

Persekutimi i armikut për zili ose dëshirimi i epërsisë është për ta treguar veten.

Edhe dëshira për epërsi është me anë të një lakmie tjetër. Shkurt, në mungesë të kuptimeve, trajtat nuk kanë ndonjë shije!

Ja, prandaj, ti pyet: "Pse e bën këtë?" Sepse trajtat janë vaj ulliri, kurse kuptimi, dritë!

Në s'qoftë, fjala "pse" pse? Sepse po qe se ajo trajtë do të ishte vetëm për trajtë, ti nuk do të pyesje "Pse e bën këtë?"

Pyetja "pse" është për të mësuar diçka. Është keq të pyesësh pse me një trajtë tjetër veç kësaj.

O njeri i sigurt, nëse dobia dhe e fshehta e kësaj është kjo, pse e kërkon urtësinë e kësaj?

Nëse trajtat e banorëve të qiellit e të tokës janë krijuar vetëm për këto trajta, këtu nuk ka ndonjë urtësi!

Nëse s'ka ndonjë zotërues urtësie, ky sistem ç'është? Nëse ka një zotërues urtësie, si mund të jetë boshe dhe e kotë puna e tij?

Pa menduar një gjë të drejtë a të gabuar, as dikush bën një pikturë për hamamin, as bojatis ndonjë vend!

Musai e pyet Zotin: "Pse i krijove njerëzit dhe pastaj i shkatërron ata?" Përgjigjja e Zotit.

Musai tha: "O Zoti i ditës së llogarisë, bëre e rregullove, pse e prish dhe e rrënon përsëri?

Krijon meshkuj e femra që i shtojnë jetët, pastaj i shkatërron këta; pse?"

Zoti i tha: "E di se këtë pyetje nuk ma bën për shkak të mohimit ose nga indiferentizmi dhe përshtatja ndaj nefsit, egos tënde.

Përndryshe, nuk do ta shihja me pëlqim, do të të ndëshkoja e do të të prekja për këtë pyetje.

Por heton urtësitë në punët tona, të fshehtën e ekzistencës!

Dhe, pasi t'i mësosh këto, dëshiron t'ua bësh të ditura njerëzve dhe, në këtë mënyrë t'i japësh pjekuri çdo njeriu të zakonshëm.

Ti i di këto, por pyet për t'ia bërë të ditura edhe njerëzve.

Sepse kjo pyetje është gjysmë dije. Ai që nuk di asgjë, ai që është jashtë kësaj dijeje, nuk e bën dot këtë pyetje!"

Edhe pyetja lind nga dija, edhe përgjigjja... Po kështu, edhe gjembi mbin nga dheu dhe uji, edhe trëndafili!

Edhe shmangia nga rruga e drejtë ndodh nga dija, edhe gjetja e rrugës së drejtë! Po kështu, edhe e hidhura bëhet nga lagështira, edhe e ëmbla!

Urrejtja dhe dashuria vijnë nga njohja... Ushqimi i mirë jep edhe shëndet, edhe sëmundje!

Bashkëbiseduesi i Zotit e bëri veten naiv për t'ua mësuar këtë të fshehtë naivëve, për t'i bërë ata që të përfitojnë!

Edhe ne ta bëjmë veten më naivë se ai dhe le ta dëgjojmë përgjigjen sikur nuk e dimë!

Ata që shesin gomarë, zihen me njëri-tjetrin, pothuajse bëhen armiq vetëm e vetëm për ta shtënë në dorë çelësin e shitjes!

Zoti urdhëroi: "O Musa i mençur! Meqë pyete, eja e dëgjoje përgjigjen!

O Musa, mbill në tokë farë dhe kuptoje të fshehtën e kësaj dhe bëhu i matur!"

Musai mbolli farë, fara mbiu, nxori kallinj e u poq, u rrit mirë e bukur...

Pastaj ai mori drapërin dhe nisi ta korrte. Nga e panjohura i erdhi në vesh një zë:

"Pse mbjell, ushqen dhe, kur të jetë bërë, e pret dhe e kosit?"

Musai tha: "O Zot, këtu ka edhe kokrra, edhe kashtë, prandaj po e pres!

Sepse kokrrat nuk duhen futur në depon e kashtës... Edhe kashta, në u futtë në depon e drithit, bëhet keq!

Nuk ka kuptim që këto të përzihen. Patjetër duhen shoshitur e ndarë!"

Zoti tha: "Nga kush e more këtë njohuri që formon një lëmë?"

Musai i tha: "O Zot, këtë aftësi ndarjeje ma dhe ti!" Zoti i tha: "Atëherë pse tek unë të mos ketë ndarje?"

Mes popullit ka edhe shpirtra të pastër, edhe shpirtra të përzjerë me dhé.

Këto guaska sedefi nuk janë të gjitha njëlloj. Në njërën ka margaritar, në tjetrën, kockë!

Nëse duhet ndarë gruri nga kashta, edhe gjëja e mirë duhet ndarë nga e keqja!

Njerëzit e kësaj bote janë krijuar që thesarët e urtësisë të mos mbeten të fshehtë, por të dalin sheshit!

"Unë isha një thesar - tha Zoti - thesar i fshehtë... Dëgjoje këtë dhe mos e humb margaritarin, por nxirre në shesh!

Fryma shtazore dhe arsyeja e pjesshme i përngjasin dhallit të imagjinatës dhe fantazisë, kurse fryma e përjetshme i përngjet gjalpit që ndodhet i fshehur në këtë dhallë.

Siç është i fshehur gjalpi në dhallë, është e fshehur edhe gënjeshtra në elementin e të vërtetës!

Gënjeshtra jote është ky trup i vdekshëm, kurse e vërteta, shpirti që i përket Zotit!

Ka vite që dhalli i trupit është në shesh, kurse gjalpi i shpirtit është bërë i pavlerë brenda tij!

Më në fund, Zoti dërgon një rob si përfaqësuesin e tij, një njeri që ta rrahë dhallin në mutí.

Dhe ai e rreh dhallin me mjeshtëri me cilësinë e zbuluesit të një uni të fshehtë brenda unit.

Ose zbulon fjalën e një robi i cili është pothuaj pjesë e vetvetes dhe ajo fjalë shkon në veshin e personit që kërkon vahjin, mesazhin hyjnor!

Veshi i besimtarit e rrok dhe e ngulit në mendje mesazhin... Veshi i tillë është shoku, bashkudhëtari i njeriut që fton tek Zoti!

I ngjan pothuaj veshit të fëmijës: mbushet me fjalët e s'ëmës dhe pastaj fillon të flasë.

Po të mos ketë tek fëmija një vesh që kupton, nuk e dëgjon dot fjalën e nënës, mbetet i pagojë.

Shurdhi i lindur nëne është gjithmonë edhe memec... Personi që flet e ka dëgjuar fjalën në fillim prej s'ëmës.

Dije se veshi i shurdhmemecit është fatkeqësi ndër fatkeqësitë. As aftësi për të dëgjuar fjalë ka, as aftësi për ta ngulitur në mendje!

Ai që flet pa i pasë ngulitur më parë ato që do të thotë, është Zoti, sepse cilësitë e tij ekzistojnë pavarësisht nga shkaqet.

Ose, ashtu si Ademi, flet me anë të sugjerimit të Zotit në mungesë të pengesës së nënës dhe dados.

Ose, duke i pasur të ngulitura që më parë nga ana e Zotit, flet sapo të lindë!

Kundërshtimi dhe hedhja poshtë e dyshimit mbi legjitimitetin dhe rregullsinë e lindjes diskutohen për të treguar se nuk ka lindur me rrugë ilegjitime.

Në veprim duhet një lëvizje e tillë që dhalli të ndahet nga gjalpi në zemër.

Duket sikur në dhallë nuk ka gjalpë prandaj dhalli ka ngritur flamur në botën e ekzistencës!

Ajo që duket ekzistente tek ti, përbëhet nga cipa ose lëkura. Po ajo që duket e vdekur ose sikur s'është? Ja, pikërisht ajo është, ajo ekziston!

Po të kesh dhallë që s'ka nxjerrë gjalpë, që s'është vjetëruar, kurrsesi mos e shpenzo pa e tundur dhe pa ia nxjerrë gjalpin!

Merre menjëherë në dorë dhe, duke e rrotulluar, ta nxjerrë atë që e fsheh.

Sepse gjëja e përkohshme është provë e gjësë së përhershme. Po kështu, lutjet e të dehurve janë provë e ekzistencës së sakiut, servirësit të verës!

Një shembull tjetër mbi këtë.

Lëvizja e luanëve te flamurët tregon për ekzistencën e një flladi të fshehtë.

Po të mos frynte flladi apo era, si do të bënte lëvizje në ajër luani i vdekur?

Nga lëvizja e luanit e kupton se po fryn flladi i mëngjesit ose era e perëndimit. Kjo lëvizje tregon për atë erë të fshehtë.

Edhe ky trup i përngjet luanit te flamuri. Mendimi e lëviz atë çdo çast e vazhdimisht!

Mendimi që vjen nga lindja, është era e mëngjesit. Ajo që vjen nga perëndimi, është era me kundërmim të qelbur e perëndimit!

Lindja e flladit të mendimit është lindje tjetër. Perëndimi i flladit të mendimit është nga ajo anë!

Hëna është pa shpirt, edhe lindja e saj është pa shpirt. Kurse lindja e zemrës është shpirti i shpirtit të shpirtrave!

Dielli i ditës që lind nga lindja është lëkurë e lindjes së diellit që ndriçon botën e brendshme, është vetëm një reflektim i tij!

Sepse pa përcjellshmëri shpirti, trupi vdes e shkon; atëherë, për të nuk ka as ditë e as natë!

Por shpirti pa trup është i përjetshëm e i rregullt edhe nëse s'ka ditë dhe natë!

Po kështu, në ëndërr, syri e sheh edhe diellin, edhe hënën edhe në mungesë të tyre!

O shok, gjumi ynë është vëlla me vdekjen. Shihe njërin e kuptoje tjetrin!

Po të të thonë se ëndrra është një lloj vdekjeje, mos e dëgjo këtë fjalë pa ia kuptuar të vërtetën!

Shpirti yt sheh në ëndërr gjëra të tilla që ti s'i sheh dot edhe sikur të rrish zgjuar njëzet vjet!

Për ta interpretuar ëndrrën, vrapon një kohë të gjatë pas të diturve

Dhe i pyet se ç'është kuptimi i ëndrrës tënde. T'i thuash vdekje e dytë kësaj të fshehte është qenëri!

Kjo ëndërr për të cilën po flasim, është ëndërr që shohin njerëzit e thjeshtë. Kurse ëndrra e njerëzve që i janë afruar Zotit, është vetë afërsia ndaj Zotit!

Duhet elefanti që, kur të zgjohet, ta shohë në ëndërr Indinë!

Gomari nuk e sheh Indinë në ëndërr, sepse nuk është larguar nga India, nuk ndodhet në kurbet!

Duhet një shpirt mjaft i madh si elefanti që në gjumë të shkojë me dëshirë të madhe në Indi!

Elefanti e dëshiron dhe e kërkon Indinë, prandaj kjo dëshirë, ky përkujtim merr natën trajtë dhe i shfaqet atij!

Zbatimi i urdhrit "përmendeni Zotin" s'është punë e çdo llafazani! Zbatimi i urdhrit "kthehu te Zoti yt" nuk është diçka që mund ta bëjë këmba e çdo kaleshi!

Por ti mos u bëj i pashpresë, por ngjaji elefantit! Edhe në s'je elefant, përpiqu t'i ngjash elefantit!

Shihi kimistët në botë, dëgjoji zërat e atyre që bëjnë çdo çast piktura mbi xham!

Ata radhisin figura në boshllëkun e qiellit. Bëjnë punë për mua e për ty!

O njeri që je përlyer me glasat e pulave! Në s'i sheh dot burrat që u kundërmon parfum këmisha a re, të paktën shihi këto gjëra që të prekin ty!

Nga dheu i tyre mbijnë çdo çast barëra të reja; ato shihi... Çdo çast, kuptimin e tyre e prek diçka; ato shihi!

Edhe Ibrahim Et'hemi pa në ëndërr pa mbulesë të gjithë Indinë e zemrës

Dhe i këputi zinxhirët, ua la vendin të tjerëve dhe u humb nga sytë!

Kjo punë është shenjë e shikimit të Indisë... Njeriu hidhet përpjetë nga gjumi dhe zgjohet dhe pastaj bëhet si i marrë!

E lë çdo lloj maturie, i këput hallkat e zinxhirit dhe kalon tutje!

Siç tregoi Pejgamberi për shenjën e zemrave duke përshkruar nurin, dritën e tyre!

Ai tha: Po të hyjë drita në zemër, shenja e saj është kjo: Njeriu largohet nga ky vendbanim i rremë, e kalon edhe ahiretin që është vendbanimi i gëzimeve!

O mik i pastër, për ta shpjeguar këtë hadith të Mustafait, do të tregojmë një ngjarje! Dëgjoje!

Historia e shehzadesë, birit të padishahut, që i tregohet padishahllëku i vërtetë dhe ajeti "Âtë ditë njeriu ikën nga vëllai, nëna dhe babai". Padishahllëku ose sundimi mbi këtë grumbull dheu është i personave me natyrë fëminore; kësaj ata i thonë "ta marrësh kalanë"; njëri nga fëmijët del më i fortë se të tjerët, ngjitet mbi grumbullin e dheut dhe thotë: "Kalaja është imja!" Fëmijët e tjerë e kanë zili sepse toka është pranvera e fëmijëve. Pasi shehzadeja shpëtoi nga vartësia e ngjyrave, tha: "Unë këtyre dherave me ngjyra u them "tokë e poshtër". Nuk i them flori, atllas dhe mëndafsh i zi. Unë shpëtova nga ky mëndafsh i zi dhe u hoqa mënjanë. Sipas ajetit "Ne i dhamë atij urtësi qysh kur ishte fëmijë", orientimi hyjnor mund të bëhet në çdo kohë pa pasur nevojë për kalimin e viteve. Përballë fuqisë së Zotit i cili e zbaton në çast dëshirën e tij, askush nuk mund të pretendojë diçka!

Një padishah kishte një djalë trim. Edhe pamjen e kishte të stolisur me cilësi të bukura, edhe zemrën!

Një natë, padishahu pa në ëndërr se i biri i vdiq papritmas! Padishahut iu nxi bota!

Zemra iu dogj e iu përvëlua, lotët iu thanë, as të qante s'kishte më fuqi!

Aq u hidhërua, aq u dëshpërua, sa s'i mbeti më fuqi as për të rënkuar!

Duke e dashur vdekjen, trupi iu mpi dhe e humbi çdo aftësi veprimi! Por mirë që s'i kishte ardhur ende vdekja, pra, u zgjua nga gjumi!

Dhe, kur u zgjua, aq u gëzua, sa s'ishte gëzuar kurrë në jetë!

I dukej sikur do të vdiste nga gëzimi! Shpirti dhe trupi sikur i ishte shtrënguar mes vdekjes dhe jetës!

Kjo dritë shuhet edhe me frymën e dëshpërimit, edhe me frymën e gëzimit! Ja për ty diçka për të qeshur e për t'u tallur!

Ai është i gjallë mes këtyre dy vdekjeve. Megjithëse i shtrënguar në këtë gjendje, gjë për të qeshur!

Padishahu tha me vete: "Kjo ishte shkak për gëzim, ajo, për dëshpërim! Zoti më fali një shkak për gëzim dhe unë u gëzova!"

Ç'gjë e çuditshme! E njëjta ngjarje, nga njëra anë vdekje, nga ana tjetër ngjallje dhe gëzim!

Nga njëra anë është e ëmbël, kënaqësidhënëse! Kurse nga ana tjetër, ndëshkuese, vrasëse!

Gëzimi trupor është gjë e lartë për atë që i përket kësaj bote, por, sipas ditës së ahiretit, ringjalljes dhe jetës tjetër, është e mangët dhe humbje!

Interpretuesi i ëndrrës e interpreton të qeshurën në ëndërr si qarje, hidhërim, dëshpërim!

Kurse qarjen, si gëzim, hare!

Padishahu ra në mendime se kjo vuajtje kaloi, por shpirti bie në dyshime të këqija nga këto gjëra!

Dhe tha me vete: "Nëse trëndafili shkon dhe në këmbë më ngulet një gjemb i tillë, të paktën të më mbetet një kujtim prej tij!"

Ka shkaqe të panumërta për mosqenien... Cilën rrugë të mbyll?

Ka qindra dritare për vdekjen kafshuese, qindra dyer... Duke u hapur, secila bën gër-gër...

Veshi i lakmitarit nuk i dëgjon kërcitjet e dyerve të vdekjes për shkak të ambicjes për mall e pasuri!

Nga njëra anë, dhimbjet e trupit, zhurma e dyerve... Nga ana tjetër, mundimi i armiqve, zhurma e dyerve!

Imzot i dashur, pa lexoje përmbajtjen e një libri mjekësie dhe shih zjarrin me breshëri të sëmundjeve.

Nga të gjitha ato anë ka rrugë për në këtë shtëpi... Në çdo dy hapa ka një pus plot me akrepë!

Era është e fortë, drita ime, në të shuar... Të veproj shpejt dhe të ndez një dritë tjetër nga drita e tij.

Të paktën të më mbetet njëra nga këto të dyja, kështu që, nëse era ma shuan njërën, të dëfrehem me tjetrën!

Si arifët; edhe arifi, për të shpëtuar nga vetja e trupit të metë, ndez kandilin e zemrës

Duke menduar se, nëse një ditë i shuhet papritmas ky kandil, të vërë në vend të tij kandilin e shpirtit!

Mirëpo padishahu nuk e kuptoi këtë dhe u gënjye. Në vend të kandilit të vdekshëm u kap pas një kandili tjetër të vdekshëm!

Duke pasur frikë se mos i ndërpritet soji, padishahu i merr të birit një vajzë.

Pas kësaj, padishahu deshi t'i zinte një vajzë për nuse të birit me qëllim që ta martonte dhe t'i shtohej soji e sorrollopi!

Nëse ky i linduri do të nisej për në botën tjetër, vendin e tij ta zinte një i lindur tjetër!

Dhe mendoi që, nëse i biri vdiste, kujtimi i tij të mbetej i përhershëm te fëmijët e tij!

Prandaj ai padishahu i zgjuar, Mustafai, pati thënë: "Fëmija është e fshehta e të atit!"

Prandaj të gjithë njerëzit, nga dashuria që kanë për fëmijët, u mësojnë atyre arte dhe zanate

Duke menduar se, kur kallëpi i tyre të fshihet nga sytë, kuptimi i tyre të mbetet i përjetshëm.

Me urtësinë e tij, Zoti i ka dhënë seriozitet ambicjes së çdo fëmije që lind me aftësi, me qëllim që ta gjejë rrugën e tij në jetë!

Kështu, pashai mendoi me vete: "Edhe unë, për vazhdimin e sojit tim, do t'i marr djalit një vajzë me prejardhje, natyrë dhe karakter të mirë.

Por dua që vajza të jetë jo nga soji i një padishahu të keq, por nga soji i një personi të pastër!"

Fundja, padishahu është person i pastër. Eshtë edhe i lirë! Nuk është robi as i epshit, as i grykës!

Por njerëzit, në kundërshtim me këtë, i quajtën robërit dhe skllevërit padishah... Siç iu vu zezakut emri Kafur!

A s'i thonë "vend shpëtimi" shkretëtirës që pi gjak? A s'i thonë "i bekuar" njeriut të ulët, kurrnac e të pabekuar?

Ose robin e epshit, zemërimit dhe dëshirës e quajtën "zotëri"!

Në qytete, njerëzit ua vunë robërve të vdekjes titullin "zotëri që urdhëron vdekjen!"

Atë që kishte rënë në radhën e mballomarëve, domethënë, që ishte dhënë pas interesave të vogla materiale, e quajtën me titullin "zotëri i madh" dhe "vezir i kryevendit"!

Kështu, pasi padishahu zgjodhi një zahid, një njeri të thjeshtë e të devotshëm për krushqi, ky lajm ra në vesh të grave!

Pjesëtaret e haremit e kundërshtojnë zgjedhjen nga padishahu të vajzës së një zahidi të varfër për të birin dhe turpërohen nga kjo krushqi.

Duke kundërshtuar për shkak të mendjeshkurtësisë, e ëma e shehzadesë, birit të padishahut, i tha të shoqit: "Si mendja, si tradita, kanë vënë si kusht që, në martesë, çifti duhet të jetë i barabartë.

Mirëpo ti, nga koprracia, po e bën birin tonë krushk me një të varfër!"

Padishahu i tha: "Eshtë gabim t'i thuhet i varfër një njeriu të pastër! Sepse zemra e tij është e ngopur, e pasur dhe kjo është e dhënë e Zotit!

Një njeri i tillë bëhet i ngopur dhe i kënaqur me atë që ka nga devocioni, jo si të varfërit, nga kurrnacëria dhe përtacia!

Përkorësia që krijohet nga të kënaqurit me pak, është nga devocioni. Kjo është një gjë krejt e ndryshme nga zemërngushtësia e njerëzve të ulët!

Dorështrënguari, po të gjejë një kokërr drithi, jep edhe kokën e vet, kurse njeriu i pastër nuk ia hedh sytë as thesarit me florinj!

Njerëzit e shquar i thonë "i varfër" padishahut i cili synon çdo gjë të ndaluar e të pabekuar për shkak të ambicjes!"

Gruaja i tha: "Ku i ka ai qytetet dhe kalatë që ka për t'i dhënë si pajë? Po margaritarët dhe paratë që ka për t'i hedhur si dorovi?"

"Ik, moj ti! - I tha padishahu. - Kujt shqetësohet për fenë, Zoti ia heq të gjitha shqetësimet e tjera!"

Më në fund, padishahu doli fitues dhe i mori të birit një vajzë me natyrë të bukur dhe nga soji i një njeriu të pastër!

Vajza s'kishte shoqe në bukuri! Fytyrën e kishte më të ndritshme se dielli i paradites!

Kjo ishte bukuria e vajzës; edhe shprehitë dhe sjelljet i kishte si bukurinë! Shkurt, morali i saj ishte aq i mirë që s'mund të përshkruhet!

Vajzës shihi besimin që, bashkë me të, bukuria, pasuria dhe pozita si dhe fati që të sjell dobi, të jenë të tutë!

Dije se jeta e pasme, ahireti, është tufë devesh, kurse malli dhe pasuria e kësaj bote është leshi i deveve. Po ta kesh tufën, të vjen edhe leshi bashkë me të!

Por po ia more leshin, deveja s'bëhet e jotja... po të bëhet e jotja, ç'vlerë i mbetet leshit?

Padishahu i vuri kurorë të birit me atë vajzë që vinte nga një soj i pastër e i sinqertë.

Mirëpo, ja që kazaja dhe kaderi e bëjnë punën e tyre! Edhe një magjistare plakë ishte dashuruar keqas pas atij djali të bukur!

Ajo plakë e djallëzuar i bëri shehzadesë një magji të tillë që do t'ia kishin zili edhe magjistarët e Babilonit!

Atëherë, edhe shehzadeja u dashurua keqas pas asaj plake të shëmtuar duke lënë edhe nusen, edhe dhëndërinë.

Ja, një djall i tillë i zi, një plakë e tillë e djallëzuar ia preu rrugën djalit të padishahut!

Ajo grua nëntëdhjetëshe që i kishte marrë erë kurmi, nuk i la djalit as mend, as gojë; i shkreti nuk kishte më fuqi as për të folur!

Plot një vit, djali u bë rob pas asaj gruaje. Plot një vit ia puthi këmbët asaj gruaje të qelbur!

Biseda e plakës e shkrinte djalin, e bënte gjysmënjeri!

Ndërsa të tjerët vuanin për shkak të dobësisë së tij, ai vetë, nën efektin e magjisë, nuk dinte gjë për vete!

Bota iu padishahut burg. Kurse i biri qeshte kur ai dhe të afërmit qanin!

Padishahu mbeti pa shpresë. ditë e natë therte kurbane dhe jepte lëmosha!

Përdori të gjitha mundësitë, por djali e dashuronte plakën gjithnjë e më shumë!

Padishahu e kuptoi mirë se në këtë ngjarje kishte patjetër një të fshehtë, një urtësi dhe se zgjidhja e kësaj mund të bëhej vetëm me lutje e përgjërime!

Dhe, duke rënë në sexhde, nisi të lutej: "O Zot, fermani yt zbatohet! Në pronën e Zotit, fjala e kujt shkon përveç fjalës së tij?

Mirëpo ky djalë i mjerë po digjet si dru i thatë... O Zot i mëshirshëm, mos e lër të digjet!"

Më në fund, lutjet dhe përgjërimet e tij drejtuar Zotit u pranuan dhe nga rruga doli një magjistar i mjeshtëruar!

Padishahut i pranohet lutja për shpëtimin e të birit nga magjistarja e djallëzuar.

Magjistari kishte dëgjuar nga larg që djali ishte robëruar nga një grua plakë.

Kishte dëgjuar se kjo grua ishte e pashoqe në magji, se s'kishte të dytë si ajo!

O trim, ka trim mbi trima. Edhe në aftësi, edhe në fuqi, ka të zotë mbi të zotë gjer në qiell!

Më në krye është Zoti vetë... Pa dyshim, deti është vendi ku përfundojnë rrebeshet dhe ujërat!

Retë e marrin ujin nga deti, pastaj e derdhin poshtë dhe ai ujë arrin përsëri në det!

Padishahu mendoi se djali i iku dore. Kurse njeriu i ardhur i tha: "Ja ku erdha për një shpëtim të madh!

Asnjë nga magjistarët e këtushëm nuk matet dot me atë plakë, por unë kam ardhur nga larg dhe njohuritë e mia janë të shumta! Vetëm unë ia dal asaj!

Si dora e Musait, me leje të Zotit, e shkul magjinë e saj nga rrënjët!

Sepse kjo njohuri më është dhënë nga Zoti. Nuk e mësova duke u bërë çirak i magjistarëve të zakonshëm e pa vlerë!

Unë erdha për t'ia prishur magjinë, për t'ia hequr shehzadesë të verdhët e fytyrës!

Kur të zbardhë, shko në varrezë; atje, pranë murit, ka një varrezë të lyer me gëlqere të bardhë...

Gërmo atje në drejtim të kibles dhe shihe fuqinë e Zotit!

Kjo histori është mjaft e gjatë dhe ti u mërzite... Po i lë tepricat dhe po të tregoj shkurtimisht se ç'ndodhi.

Ai i zgjidhi nyjet e lidhura fort dhe e shpëtoi shehzadenë nga mundimi.

Kur erdhi në vete, djali vrapoi për tek froni i të atit

Dhe me qindra mirënjohje ra në gjunjë dhe e fërkoi ballin në tokë! Nën sqetull kishte një shpatë e një qefin.

Padishahu organizoi festa, populli i qytetit u gëzua; edhe nusja që e kishte prerë shpresën, ia arriti qëllimit!

Bota u ngjall përsëpari, u ndriçua! Ç'është e drejta, habitem! Edhe ajo ditë ishte ditë si të tjerat, si dita e sotme!

Dhe padishahu i bëri djalit një dasmë të tillë që edhe qenve u vunë para sherbet trëndafili!

Magjistarja plakë ngordhi nga dëshpërimi duke ia dorëzuar pronarit të xhehennemit edhe fytyrën e shëmtuar, edhe veset e shëmtuara!

Shehzadeja po habitej se si ia kishte prishur mendjen ajo grua plakë!

Me ta parë nusen që i ngjante hënës dhe që ua kalonte të gjitha të bukurave,

I iku mendja nga koka, u mpak e ra përtokë! Plot tri ditë s'u përmend!

E humbi mendjen tri ditë e tri net, kurse populli u shqetësua për mpakjen e tij.

Më në fund, me anë të lëngjeve prej trëndafili, me anë të ilaçeve, erdhi në vete... U hap dalngadalë duke filluar të kuptonte të mirën e të keqen.

Një vit më vonë, mes fjalëve të tjera, i ati i tha: "O bir, pa kujtoje atë të dashurën e vjetër!

Kujtoje atë që pati fjetur me ty, atë shtrat dhe mos u bëj kaq i pabesë e i ashpër në fjalë!

Shehzadeja i tha: "Lëre, o baba... Unë e gjeta gëzimin dhe lumturinë, shpëtova nga gropa e mashtrimit!"

Ja, kështu ndodh kur besimtari e gjen rrugën dhe e kthen kokën nga errësira, për në anën ku ndodhet drita e Zotit, drita e së Vërtetës!

Shehzadeja është njeriu, përfaqësuesi i Zotit mbi tokë,
kurse i ati, zëvendësi i Zotit, Ademi, të cilit i bënë sexhde engjëjt.
Plaka e djallëzuar është kjo botë; ajo e ndau me magji të birin
nga i ati. Pejgamberët dhe velinjtë, të urtët, janë ai mjeku që i gjeti shpëtim kësaj.

O vëlla,dije se shehzadeja je ti... Ke lindur përsëpari në këtë botë të vjetër!

Magjistarja e djallëzuar është kjo botë e cila i ka bërë robër të ngjyrës dhe kundërmimit të saj edhe burrat!

Sapo të biesh në këtë lumë të turbullt, këndo çdo çast lutjen "kul eudhu, mbështetem te...", fryeje veten

Dhe shpëto nga kjo magji, nga kjo vuajtje, mbështetu te Zoti i agimit dhe kërko ndihmë prej tij!

Bota u ka bërë njerëzve magji dhe i ka hedhur në gropë, prandaj pejgamberët i kanë thënë botës magjistare!

Eja në vete dhe ruaju nga magjitë e fuqishme të kësaj plake të qelbur, fryma e nxehtë e së cilës i bën rob edhe sovranët!

Në zemër janë magjitë e saj që lëshojnë frymëra me pështymëra dhe ajo është që i lidh këto nyje!

Magjistarja botë është një plakë e çuditshme! Zgjidhja e perit të magjisë së saj nuk është gjë që mund ta bëjë kushdo!

Po qe se mendjet do të mund ta zgjidhnin nyjen e lidhur prej saj, a do të dërgonte Zoti pejgamberë?

Eja në vete dhe kërkoje dikë i cili e ka nefsin të bekuar, zgjidh nyje dhe e di të fshehtën sipas së cilës Zoti bën atë që dëshiron!

Bota të ka zënë edhe ty në grep si peshk. Shehzadeja mbeti në atë grep një vit, kurse ti ndodhesh në atë grep plot gjashtëdhjetë vjet!

Plot gjashtëdhjetë vjet po heq mundime në atë grep... As ndonjë kënaqësi ke, as ndonjë sunnet, traditë profetike po zbaton!

Je një mëkatar i pafat! As botën shpirtërore s'e ke të mirë e të bukur, as nga mëkati s'ke shpëtuar!

Fryrja e kësaj bote i lidhi fort këto nyje. Më në fund, ti kërkoje fryrjen e krijuesit të vetëm!

Kërkoje dhe fryrja "Unë i fryva Ademit nga shpirti im" të të shpëtojë nga kjo dhe të të thotë lartësohu!

Fryrjen e magjistarit nuk mund ta prishë gjë tjetër veç fryrjes së Zotit. Fryrja e magjistarit është fryrje persekutimi, fryrja e Zotit është fryrje mëshirimi!

Mëshira e Zotit e kalon ndëshkimin dhe persekutimin e tij, ndodhet para. Edhe ti, nëse kërkon të ndodhesh para, ec dhe kërko një burrë që ka ecur para!

Në këtë mënyrë, arri në gradën e personave të lartësuar me aktet e tyre ose të martuar me hyri! O sovran i magjepsur, ja shpëtimi për ty!

Përsa kohë që plaka-botë të jetë pranë teje dhe ti të mbetesh nën efektin e ledheve të saj, as rrjeta e saj nuk zgjidhet, as nyjet e magjisë së saj!

A nuk u tha Pejgamberi, drita e bashkësive njerëzore, kësaj dhe asaj bote, ortakë?

Atëherë, bashkimi me këtë është ndarja prej saj. Shëndeti i këtij trupi është sëmundje e shpirtit.

Ndarja nga ky kalim është e vështirë, por dije se ndarja nga ai vendqëndrim është më e vështirë!

Edhe ndarja nga piktura të vjen ty e vështirë, por sa e vështirë është ndarja nga piktori!

O mik që nuk e duron dot ndarjen nga kjo botë e ulët! Si do ta durosh ndarjen nga Zoti?

Nuk ndahesh dot nga ky ujë i zi; po si, atëherë, si e pranon të ndahesh nga burimi i Zotit?

Pa pirë nga ky ujë i zi, nuk e ndjen dot veten mirë... Por ç'të ndodh kur ndahesh nga njerëzit e mirë dhe burimi i ujit që pijnë ata?

Po ta shihje një frymë bukurinë e Zotit, edhe shpirti do të të përfshihej nga zjarri, edhe trupi!

Pastaj këtë ujë e sheh të neveritshëm... Pasi ta shohësh tronditjen që të jep afërsia me Zotin,

Ashtu si shehzadeja, bashkohesh me të dashurin! E nxjerr gjembin që të ka hyrë në këmbë!

Përpiqu ta kapërcesh veten dhe gjeje veten menjëherë... Zoti e di se ç'është më e drejtë!

Mblidhi mendtë në kokë dhe mos u bëj gjithmonë bashkëshoqërues i vetes! Mos bjer çdo çast në baltë si gomari!

Kjo rrëshqitje është ngase sytë s'të shohin mirë! Si qorri, nuk e sheh të përpjetën e të tatëpjetën!

Kundërmimin e këmishës së Jusufit bëje vërtetim për veten, sepse kundërmimi i saj i hap sytë!

Ajo trajta e fshehtë dhe ajo dritë e ballit i ka bërë sytë e pejgamberëve që të shohin larg!

Drita e asaj fytyre e shpëton njeriun prej zjarri. Eja në vete dhe mos e prano dritën hua!

Kjo dritë i tregon njeriut vetëm kohën ku ndodhet; ajo i mahis trupin, mendjen dhe shpirtin!

Pamjen e ka dritë, por, në të vërtetë, është zjarr. Nëse do dritë të vërtetë, hiqi të dy duart nga kjo dritë!

Syri dhe shpirti që shohin vetëm kohën dhe situatën ku ndodhen, kudo që të shkojnë, kanë për të rënë me hundë përtokë!

Edhe sikur mes këtyre njerëzve të ketë nga ata që shohin larg, janë të paaftë. E shohin të largtën, por e shohin si në ëndërr!

Në breg të përroit, buzët i ke të thara dhe ashtu bie të flesh dhe, për të kërkuar ujë, vrapon pas një pamjeje iluzive si pas mirazhit në shkretëtirë!

E sheh mirazhin e largët, vrapon pas tij, bëshesh i dashuruar pas dukjes!

Në gjumë unë jam me zemër e sy të hapur ndaj shokëve, i shpoj perdet dhe e shoh çdo gjë...

Ja, shih, pashë ujë në atë anë, ejani të shkojmë me vrap ta arrijmë! Kurse ajo na qenkësh mirazhi që ke parë ti!

Në çdo hap largohesh edhe ca më shumë nga ky ujë i mirë. Vrapon për ta aritur mirazhin, por largohesh nga uji i vërtetë!

Vendosmëria jote është pengesë e vërtetë për ujin e vërtetë që të ka arritur ty!

Sa e sa vetë ka që nisen të arrijnë atje ku duan të arrijnë, që vihen rrugëve për këtë!

As ajo çka sheh, as ajo çka thotë njeriu që fle nuk vlen për gjë! Edhe gjëja që sheh, edhe fjala që thotë, janë fantazira, pra, hiq dorë prej tyre!

Po të të ketë ardhur gjumi, fli në udhë... Për hir të Zotit, shtrihu e fli vetëm në udhë të Zotit!

Mund të ndodhë që të të rastisë një udhëtar e të të shpëtojë nga gjumi e nga fantazitë!

Edhe sikur mendja e njeriut që fle, ta ndajë qimen në dyzet pjesë, nuk vlen për gjë. Me të nuk mund ta gjejë as rrugën e fshatit!

Edhe sikur mendja e njeriut që fle të jetë dyfish a trefish, prapë është në gabim, prapë në gabim!

Atë e godasin dallgët e ujit pa pushim, kurse ai vazhdon të vrapojë nëpër shkretëtirë për të gjetur ujë!

Ujin e ka më pranë se damari i qafës që i rreh, kurse ai digjet për ujë!

Historia e zahidit të varfër dhe me familje të madhe i cili,
në një vit zije, ndërsa populli vdiste nga uria,
tregohej i gëzuar dhe i hareshëm. Njerëzit i thanë:
"Nuk është koha për gëzim, por për të vajtur në qindra ngushëllime!" Kurse ai iu përgjigj: "Ç'më duhet mua?"

Në një vit zije, ndërsa gjithë fisi qante e vajtonte, zahidi qeshte.

I thanë: "S'është vendi për të qeshur... Mungesa e ushqimit po ua than rrënjën besimtarëve!

Mëshira e Zotit i mbylli sytë ndaj nesh, fusha u dogj e u zhurit nën diellin përvëlues!

Vreshtat e rrushtë u nxinë; s'ka lagështirë as poshtë e as lart!

Nga kjo zi e nga kjo vuajtje, njerëzit po vdesin si peshku pa ujë nga dhjetë e nga dhjetë, nga njëqind e nga njëqind!

A nuk të dhimbsen muslimanët? Besimtarët janë vëllezër! Janë të gjithë si një trup i vetëm!

Po të dhembë një gjymtyrë e trupit, dhemb i gjithë trupi dhe kjo ndodh edhe në paqe, edhe në luftë!"

Zahidi tha: "Kjo duket si zi buke në sytë tuaj, por faqja e dheut është si xhennet, unë kështu e shoh!

Në çdo fushë e në çdo vend jam duke parë kallinjtë që kanë lëshuar shtat sa një shkak njeriu!

Kallinjtë valëviten nga flladi i mëngjesit. Fusha është plot me presh!

Dhe unë i prek të gjitha këto me duar, i lëmoj për të kuptuar në është e vërtetë ajo që shoh... Atëherë, si mund ta pres dorën e ta nxjerr syrin?

O njerëz të ulët, ju jeni miq të faraonit trup, prandaj Nili ju duket gjak!

Sapo të bëheni menjëherë miq të Musait të mendjes, nuk do të shihni gjak, por ujin e lumit!"

Sapo që të ndodhë diçka mes teje e tët eti, e sheh atë si qen, ashtu të duket ai në sytë e tu!

Yt atë nuk është qen por ashtu të duket ty nën efektin e zemërimit; ashtu të duket edhe njeriu më i mëshirshëm!

Vëllezërit e kishin zili Jusufin, nxeheshin me të, prandaj iu duk si ujk.

Por sapo të pajtohesh me tët atë dhe të të ikë zemërimi, qeni zhduket dhe yt atë të bëhet një mik i zjarrtë!

E gjithë bota është trajtë e arsyes së përgjithshme.
Po të veprosh në kundërshtim me arsyen e përgjithshme,
po të krijosh shqetësime, bota ta shton ty shqetësimin;
po kështu, po të prishesh shumë herë me tët atë,
kur ta shohësh atë, dëshpërohesh, nuk do t'ia shohësh fytyrën, kurse më parë ai ishte drita e syve të tu, qetësia jote!

E gjithë bota është trajtë e arsyes së përgjithshme... Ajo është ati i tërë njerëzve.

Nëse dikush e shton mohimin ndaj arsyes së përgjithshme, e gjithë bota i duket si qen!

Pajtohu me këtë baba, lëre kundërshtimin dhe uji me dheun do të të duken shtroje floriri.

Po s'u pajtove me të, gjendja dhe koha ku ndodhesh të bëhen pothuaj si kiamet; në sytë e tu, edhe qielli ndërron, edhe toka!

Unë ndodhem vazhdimisht në pajtim me këtë baba, prandaj kjo botë më duket si xhennet!

Çdo kohë shoh një trajtë të re, çdo çast shoh një bukuri të re dhe duke parë të reja, as dhimbje dhe mërzitje mbetet, as gëzimi shuhet! Njeriu mbushet me hare përsëpari!

Unë e shoh botën të mbushur plot me të mira e dhunti... Ujërat rrjedhin me entuziazëm nga burimet!

Kur zhurma e këtyre ujërave më vjen në vesh, ma deh mendjen dhe zemrën!

Degët tunden si dervishë pendestarë, gjethet përplasin pëllëmbët si muzikantë dhe këngëtarë!

Pasqyra shkëlqen si vetëtimë brenda këllëfit prej leshi; po sikur të dalë jashtë, si do të shkëlqejë?

Unë nuk them as një të mijtën e kësaj, sepse çdo vesh është plot dyshime!

Sipas pandehmës, kjo fjalë është myzhde... Por arsyeja thotë: "Ç'dometheně myzhde? Unë e tillë jam!"

Fëmijët e Uzejrit (a.s.) e pyesin atë për gjendjen e të atit dhe ai u thotë "e pashë". Disa e njohën dhe i humbën ndjenjat, kurse disa të tjerë që s'e njohën, thanë: "Ky na dha neve myzhde, ç'është kjo humbje ndjenjash?"

A nuk pyesnin fëmijët e Uzejrit në rrugë për gjendjen e babait të tyre?

Ata ishin plakur, kurse i ati ishte i ri. Ndërkaq, i ati u doli papritmas përpara!

Ata e pyetën: "O udhëtar, a ka ndonjë lajm, vallë, nga ati ynë i shtrenjtë?

Dikush na tha se sot ka për të ardhur, se, pasi na la pa shpresë për shumë kohë, sot do të arrijë!"

Uzejri u tha: "Po, do të vijë pas meje!.." Njëri nga djemtë, kur e dëgjoi këtë myzhde, u gëzua.

Dhe thirri: "O ti që na dhe këtë myzhde, qofsh i gëzuar!" Kurse një tjetër e njohu Uzejrin.

Dhe i tha të vëllait: "O i hutuar, a mos është vendi për myzhde? Ke rënë mu në mes të minierës së sheqerit!" Pas këtyre fjalëve, e humbi vetëdijen dhe u shemb përdhe!

Kjo është myzhde për pandehmën, por, sipas arsyes, është vetë bashkimi... Sepse syri i pandehmës është me perde, nuk e sheh dot të vërtetën!

Për qafirët, mohuesit, është vuajtje, për besimtarët, lajmëtar i gëzimit. Por sipas syrit që e sheh fytyrën e brendshme të punës, është vetë bashkimi!

Sepse ashiku është çdo çast e gjithmonë i dehur. Shkurt, është edhe mbi mohimin, edhe mbi besimin!

Mohimi është lëkura e sipërme e thatë, kurse besimi, lëkura e brendshme e shijshme!

Edhe mohimi, edhe besimi janë portierët e tij, sepse ai është përmbajtja, kurse mohimi me besimin, cipa, lëkura.

Vendi i lëkurës së thatë është zjarri, kurse lëkura e ngjitur pas përmbajtjes është e shijshme dhe e këndshme!

Sa për përmbajtjen: Ajo është më e lartë se grada e shijes dhe ëndjes... Është vetë ajo që jep shijet!

Kjo fjalë s'ka fund, pra, kthehu pas dhe Musai im le të ngrejë pluhur nga fundi i detit!

Këto fjalë u thanë sipas mendjes së njerëzve të thjeshtë, kurse pjesa e mbetur është fshehur!

O person nën dyshim, floriri i mendjes sate është copë-copë. Si mund t'i vë vulë një floriri të tillë?

Mendja jote është shpërndarë në qindra punë të rëndësishme, është pjesëtuar në mijëra dëshira, mallra dhe pasurira!

Këto copëra duhen mbledhur bashkë me dashuri në mënyrë që ti të vish në një gjendje të këndshme si Samarkandi dhe Damasku!

Nëse i mbledh ato gjer në copën më të vogël dhe pastrohesh nga dyshimi, ty mund të të shtypet monedha e padishahut!

O person i pagdhendur, nëse në peshë e kalon një miskal (pesë gram), padishahu bën prej teje një kupë të artë.

Në atë kupë shënohen edhe emri, edhe llagapet, edhe portreti i padishahut, o ti që kërkon bashkim!

Më në fund, e dashura të bëhet edhe bukë, edhe ujë; të kthehet edhe në dritë, edhe në bukuri, edhe në meze, edhe në verë!

Mblidhe veten se e mbledhura është mëshirë. Mblidhe veten që të të mund të them ç'të ketë!

Sepse e folura është për vërtetim... Shpirti që i bën shok Zotit, nuk beson te e drejta dhe e vërteta!

Shpirti i përpjesëtuar në gjërat e kota të fatit, është shndërruar në gjendje përbashkësie në mes gjashtëdhjetë sevdash!

Më në fund, një njeriu të tillë nuk i thuhet gjë, është më mirë që para tij të heshtet, sepse përgjigjja që u duhet dhënë kokëtrashëve është heshtja!

Këtë e di unë! E di, por dehja trupore ma hap gojën edhe nëse nuk dua unë! A nuk hapet goja pa dashje në teshtitje dhe përgjumje? Ja, ashtu!

Komenti i hadithit: "Unë çdo ditë i shfaq shtatëdhjetë herë pendesë Zotit".

Si Profeti që ka thënë: "Çdo ditë bëj shtatëdhjetë herë pendesë për shkak se flas dhe i përhap të vërtetat.

Por ajo dehje ma prish pendesën. Dehja trupore që zhvesh rroba, më bën ta harroj pendesën!"

Për ta sqaruar gjendjen e kohëve shumë të vjetra, urtësia e Zotit i jep harresë personit që di të fshehtë.

Enigmat e fshehta bëhen një lumë që shpërthen nga burimi "e shkruara u shkrua, kalemi u tha" dhe dalin në shesh me flamurë!

O njerëz, mëshira e pafundme rrjedh çdo çast, por ju jeni në gjumë, nuk e kuptoni!

Rroba e personit në gjumë pi ujin e lumit, kurse personi në gjumë vrapon pas mirazhit!

Ai vrapon me shpresën për të gjetur ujë atje dhe, me këtë mendim, e humb vetë rrugën që të çon te uji!

Sepse thotë "atje" dhe largohet prej këtu; jepet pas një fantazie dhe largohet nga e vërteta!

Këta gjoja shohin larg, por shpirtin e kanë në gjumë... O udhëtarë, t'ju vijë keq për ta!

Unë s'kam parë etje që t'i sjellë njeriut gjumë... Vetëm etja e njeriut pa mend sjell gjumë!

Fundja, mendje i thonë asaj që është shtrirë në bjeshkën e Zotit dhe ha nga të mirat e Zotit. Mendjes që vjen nga Mërkuri nuk i thonë mendje!

Arsyeja e pjesshme sheh gjërat gjer në varr... Në gjërat e tjera imiton pejgamberët dhe velinjtë, të urtët.

Vështrimi para i kësaj arsyeje është gjer në varr, kurse arsyeja e njeriut të zemrës i sheh gjërat gjer në çastin kur të fryjë Briri!

Kjo arsye nuk kalon dot përtej varrit, dheut. Kjo këmbë nuk shkon dot në fushën ku ndodhen gjërat e çuditshme!

Mërzitu nga kjo arsye e kjo këmbë dhe ec para, kërko për vete një sy që ta shohë të fshehtën dhe bëhu i njoftuar!

Personi i lidhur pas mësuesit, nxënësi i kufizuar pas librit ku do ta gjejë dritën që t'i shkëlqejë nga duart e nga rroba?

Ky vështrim, kjo mendje i jep njeriut vetëm marrje mendsh. Lëre vështrimin dhe prit!

Mos kërkoni lartësim nga të folurit. Eshtë më mirë të dëgjosh se të flasësh!

Edhe niveli i ngulitjes në kujtesë është një lloj epshi dhe çdo lloj epshi është një idhull në rrugë.

Po qe se çdo person i pavlerë do të arrinte virtytin dhe mirësinë e Zotit, a do të dërgonte Zoti kaq pejgamberë!

Arsyeja e pjesshme është si vetëtima dhe ndriçimi i saj. A mund të arrish ta marrësh mesazhin hyjnor me ndriçimin e dhënë nga vetëtima?

Drita e vetëtimës nuk vlen për ta treguar rrugën. Ajo është një urdhër për renë që të qajë!

Edhe vetëtima e arsyes sonë është për të qarë, vlen për vajtimin e mosqenies me dëshirën e qenies.

Arsyeja e fëmijës i thotë atij të përsillet rreth atyre që shkruajnë, por njeriu nuk ngulit dot gjë vetvetiu.

Arsyeja e të sëmurit e tërheq atë tek mjeku, kurse vetë nuk mjekohet e nuk shërohet dot!

Ja, shih, shejtanët dëshirojnë të ngjiten në qiell dhe i ngrehin veshët drejt të fshehtave të botës sipër.

Duke vjedhur një pjesë të vogël nga ato të fshehta, nga qielli vijnë kometa dhe i fshijnë...

"Ikni, ikni" - u thonë atyre, - "se mbi tokë ka ardhur një pejgamber, prandaj, çfarë të doni, kërkojani atij, merreni prej tij!"

Po deshët margaritarë të paçmuar, "hyni nëpër shtëpi nga dyert"!

Bjerini rrethit të hekurt të derës dhe prisni. Për ju s'ka rrugë nga çatia e qiellit!

S'mund ta plotësoni nevojën nga kjo rrugë e gjatë... Ne ia dhamë të fshehtën e të fshehtave robit tonë që e krijuam nga dheu!

Në s'qofshi tradhtarë, shkoni pranë tij. Edhe sikur të jeni kallam bosh, me ndihmën e tij bëhuni kallam sheqeri!

Ai kallauz nxjerr gjelbërim nga toka jote. Kjo s'është një punë larg potkoit të kalit të Xhebrailit!

Po u bëre tokë për këmbën e kalit të Xhebrailit, kthehesh në gjelbërim, rinohesh, freskohesh!

Samiriu i vuri brumit të viçit gjelbërimin që fal jetë dhe ai gjelbërim u shndërrua në margaritar për atë viç të bërë prej floriri dhe viçi pothuaj u bë i gjallë!

U bë i gjallë dhe ai gjelbërim brenda tij dha një zë të tillë që u bë provë për armiqtë!

Po të vini me bindje të plotë tek njeriu i të fshehtës, shpëtoni nga qylafi i vënë mbi kokë si skifterit!

Skufja që ia mbulon skifterit sytë e veshët duke e bërë të paaftë e të pavlerë,

Është për t'ia lidhur sytë e për t'ia fshehur llojin skifterit i cili priret nga lloji i vet!

Por kur skifteri të heqë dorë nga lloji i vet e të bëhet mik me padishahun, i zoti ia heq skufjen nga koka e ia hap sytë!

Mos pretendo shumë për kryekomandë nga vendi ku Zoti i vëzhgon shejtanët, nga opinioni i pavarur i arsyes së pjesshme...

Ti nuk je i pavarur në opinionin tënd, je vetëm nxënësi i zemrës tënde dhe ecën duke menduar se ke aftësi!

Pra, shko te zemra, sepse ti je pjesë e zemrës; eja në vete se ti je rob i padishahut të drejtë!

T'i shërbesh si rob dhe shërbëtor atij është më e mirë se mbretërimi, sepse thënia "unë jam më i dobishëm se ai" është thënie e shejtanit!

Ore njeri i ulët, vështro përulësinë e Ademit dhe krenarinë e Iblisit, dalloje ndryshimin mes tyre dhe zgjidh përulësinë e Ademit!

Edhe Pejgamberi që është diell i rrugës, ka thënë: "Ç'lumturi për personin që e përul nefsin!"

Shihe hijen e Tuba-s dhe fli mirë e bukur... Vër kokën në atë hije dhe kridhu në gjumë pa bërë prapësi!

Hija e përuljes së nefsit është vend për të fjetur mirë. Për atë që ka aftësi për atë pastrim, është një vend i këndshëm gjumi!

Po qe se e lë këtë hije dhe shkon nga ana e egoizmit, bëhesh shpejt kundërshtues, prapësohesh dhe e humb rrugën!

Ajeti "O ju që keni besuar, mos flisni dhe mos vendosni para se të flasin dhe vendosin Allahu dhe i Dërguari!" Meqë s'je pejgamber, bëhu nga ummeti, bashkësia e tij; meqë s'je mbret, bëhu nënshtetas!

Prandaj, ec, shko nën hijen e urdhrit të shehut, mësuesit, dhe hesht, zbato urdhrin!

Po s'bëre kështu, edhe sikur të kesh aftësi dhe kapacitet, meqë do të ngrihesh të pretendosh për përkryerje, do të ndryshosh, do të goditesh dhe do t'i humbësh aftësitë dhe kapacitetet!

Po të sillesh prapë me mësuesin që njeh dhe di të fshehta, i humb edhe aftësitë!

Tani për tani kënaqu me këpucari, duro... Ndryshe, po të mos durosh, bëhesh mballomar, vjetërsirandreqës dhe ashtu mbetesh!

Po qe se tek mballomarët dhe ata që mbledhin e shesin vjetërsira, do të kishte durim dhe butësi, ata do të bëheshin të gjithë këpucëbërës!

Po qe se punon e përpiqesh shumë, më në fund, do të mërzitesh dhe vetë do të thuash se mendja paska qenë një lidhëse, një pengesë!

Si njeriu që jepet pas filozofisë... Edhe ai, në ditën e vdekjes, e pa mendjen pa krahë e pa flatra

Dhe e pohoi pa të keq, atëherë, duke thënë: "Me anë të zgjuarsisë, e ngamë kalin në vende të kota e pa bazë!

U bëmë krenarë, u gënjyem dhe u larguam nga burrat e vërtetë... Vazhduam të notonim në detin e fantazisë!

Mirëpo notimi në detin e shpirtit s'paska qenë asgjë! Aty s'paska zgjidhje tetër veç hyrjes në gjeminë e Nuhut!"

Edhe ai sovrani i pejgamberëve kështu tha: "Në këtë det të përgjithshëm, në këtë oqean, unë jam gjemi!

Ose është trashëgimtari i syrit tim shpirtëror, zëvendësi im që zë vendin tim me drejtësi!"

O trim, nuk duhet t'ia kthesh shpinën gjemisë! Ja, pra, ne jemi gjemia e Nuhut në det!

Mos shko si Kenani në çdo mal dhe dëgjoje nga Kur'ani ajetin "Sot s'ka shpëtim!"

E ke syrin të lidhur, prandaj kjo gjemi të duket ulët, kurse mali i mendimit tënd, shumë lart!

Aman, mos e shih me përbuzje këtë gjemi të ulët! Shih mirësinë e Zotit që vjen e qëndron këtu!

As lartësinë e malit të mendimit mos e shih fort, sepse atë mund ta shembë në çast një dallgë!

Nëse je Kenan, edhe sikur të të jap njëqind këshilla si kjo, prapë nuk më beson mua!

Si do ta pranojë këtë fjalë veshi i Kenanit? Atë e ka vulosur Zoti!

A hyn këshillë në veshin e vulosur prej Zotit? Gjëja e krijuar më pas, si mund ta ndryshojë vendimin e pafillimtë?

Prapë, me shpresën se nuk je Kenan, po të them një fjalë të këndshme:

Më në fund, këtë do ta pohosh, pra, të paktën, eja në vete, shihe ditën e parë që të shohësh ditën e fundit!

Ti mund ta shohësh ditën e fundit! Vetëm syrin që sheh ditën e fundit mos e dëmto, mos e qorro!

Kush e sheh me bekim fundin e punës, kurrë nuk rrëshqet nga rruga!

Nëse nuk e do këtë rrëzim dhe ngritje për çdo çast, tërhiqe në sy tokën ku shkel një burrë i vërtetë!

Dheun ku shkel këmba e tij bëje syrme për syrin dhe hidhe tej nga koka këtë punë prej punëtori të vatrës së zjarrit!

Sepse duke u bërë një nxënës i tillë, edhe sikur të jesh gjilpërë, bëhesh shpatë!

Fërkoje syrin me dheun ku shkel këmba e çdo burri të zgjedhur, si të ish syrme ai dhé, sepse ai dhé edhe ta djeg syrin, edhe ta ndriçon!

Deveja ha gjemba meqë ato i japin dritë syrit, prandaj syri i saj shpërndan dritë!

Mushka e pyet devenë: "Unë rrëzohem shpesh në rrugë, kurse ti, rrallë; pse ndodh kjo?" Përgjigjja e devesë.

Një ditë, një mushkë u takua me një deve... që të dyja ranë në një stallë.

Mushka tha: "Unë rrëzohem shumë herë në të përpjetë, në vend të rrafshtë, në pazar e në fshat.

Sidomos kur zbres nga e përpjeta e malit poshtë, gjithmonë rrokullisem nga frika!

Kurse ti rrëzohesh rrallë... Pse kështu? Apo mos shpirti yt i pastër është me fat?

Unë gjithmonë zë në thumb dhe më përgjaken fytyra e gjunjët!

Samari dhe barra më rrëzohen dhe ha dru gjithmonë prej qiraxhiut!

Si njeriu me pak mend! Edhe ai, për shkak të mendjes së pakët, pendohet për mëkatin, por e prish pendesën çdo çast!

Për shkak të mefshtësisë së opinionit dhe vendosmërisë e cila e bën ta prishë pendesën, me kohë turpërohet si Iblisi!

Si kali topall me barrë të rëndë që lufton të ecë në rrugën gurore e që çdo çast rrëzohet në hundë!

Ngaqë ai i prapi e prish pendesën, ha pa pushim shuplaka kokës nga e padukshmja!

Pastaj, prapë, me vendosmërinë e tij të mefshtë, bën pendesë. Por sapo ta qortojë shejtani, e prish pendesën!

Eshtë shumë i dobët... Mirëpo aq të lartë e sheh veten, aq mbahet më të madh, saqë edhe ata që i afrohen Zotit, i sheh me nënvleftësim!

O deve, kurse ti i ngjet besimtarit, rrëzohesh pak në hundë, e vret pak hundën!

Çfarë ka tek ti që nuk pëson fatkeqësi? Që nuk rrëshqet, që nuk rrëzohesh?"

Deveja i tha: "Çdo bekim është nga Zoti, por mes meje dhe teje ka shumë ndryshime!

Koka ime ndodhet lart, sytë e mi shohin lartësitë... Largpamësia e mbron njeriun nga dëmi!

Ndërsa ndodhem në krye të malit, unë ia shoh fundin. Çdo gropë, çdo rrafshinë i shoh me hollësi!

Po kështu, edhe ai burrë i lartë i pa të gjitha se ç'kishin për t'i rënë në kokë gjer në vdekje!

Ç'do të ndodhë njëzet vjet më pas? Ai njeri me shprehi të mira i sheh të gjitha këto qysh sot!

Madje, ai njeri i devotshëm nuk e sheh vetëm gjendjen e vet. Ai e sheh edhe gjendjen e atyre në perëndim, edhe të atyre në lindje!

Drita zë vend nësytë dhe zemrën e tij. Pse, do të thuash? Nga dashuria për vatanin!

Si Jusufi! Edhe ai e pa në fillim në ëndërr që dielli dhe hëna i bënë sexhde.

Ato që pa dhjetë vjet më parë, ndoshta dhe më parë, më në fund, i pësoi!

Fjala që thotë se "besimtari sheh me dritën e Zotit", nuk është e kotë! Drita e Zotit shpon dhe përshkon edhe qiejt!

Ajo dritë mungon në sytë e tu... Ec tutje, se ti je shtënë pas ndjenjave shtazore!

Për shkak të dobësisë së syve, ti sheh majat e këmbëve... Je e dobët; edhe kallauzi yt është i dobët!

Eshtë syri që u shërben si kallauz duarve e këmbëve. Ai e sheh edhe vendin ku duhet mbajtur e duhet shkelur, edhe vendin ku s'duhet mbajtur e shkelur!

Pastaj, edhe syri im është mjaft i ndriçuar; gjithashtu, krijimi im është krejt i pastër!

Sepse unë jam bir i hallallit, nuk jam nga të kurvërisë dhe të mëkatit!

Kurse ti, nuk ka dyshim se je nga të kurvërisë. Po qe harku i shtrembër, edhe shigjeta shkon shtrembër!

Mushka e miraton përgjigjen e devesë dhe e pohon epërsinë e saj, kërkon ndihmë prej saj dhe mbështetet me zemër të pastër te ajo; deveja i shfaq konsideratë mushkës, e udhëzon dhe e ndihmon prindërisht dhe mbretërisht.

Mushka tha: "Fole drejt, o deve!" Dhe sapo e tha këtë fjalë, iu mbushën sytë me lot!

Qau për një farë kohe dhe i ra devesë nën këmbë dhe i tha: "O ti e zgjedhur mes robve të Zotit!

Ç'humbje ke po të kesh mirësinë që të më pranosh edhe mua në radhët e robve të Zotit?

Deveja i tha: "Meqë e pohove para meje, ec para, shpëtove nga fatkeqësitë e kohës!

U maturove, u çlirove nga kokëçarjet; ishe armik, u fute mes njerëzve të dashurisë!

Fundja, në origjinën tënde nuk pati vese të këqija. Nga ai me origjinë të keqe, nuk vjen gjë tjetër veç inatit dhe të këqijave!

Kurse ai që s'ka të këqija në origjinë dhe që ka vese të këqija të përkohshme, e pohon të keqen dhe dëshiron të bëjë pendesë!

Si pegamberi Adem! Edhe faji iparëndësishëm që bëri ai, ishte i përkohshëm dhe ai bëri pendesë menjëherë!

Por faji i Iblisit, meqë ishte i origjinës, te ai nuk kishte rrugë për pendesë!

Ec para, shpëtove edhe nga vetja, edhe nga veset e këqija. U çlirove edhe nga flaka e xhehennemit, edhe nga dhembët e kafshëve të egra!

Ec para! Tani për tani e fitove lumturinë, e hodhe veten në një bekim të përjetshëm!

Arrite lumturinë e shprehjes "futu mes robve të mi"! Ende copën "hyr në xhennetim tim"!

Gjete rrugë për të hyrë mes robve të Zotit, nga një rrugë e fshehtë u fute në xhennetin e përjetshëm!

The "na trego rrugën e drejtë"! Dhe rruga e drejtë të kapi prej dore e të çoi gjer në xhennet!

O njeri i vyer, ishe zjarr, u bëre dritë! Ishe trung, u bëre rrush i freskët e i thatë!

Zoti e di më mirë se ç'është e drejtë, apo jo! U bëre yll e diell, gëzohu tani!

O dritë e Zotit, Husameddin, mbaja mjaltin, hidhja në hauzin e qumështit

Që ai qumësht të shpëtojë pa u prishur... Në detin e shijes, t'i shtohet shija!

Të arrijë në detin Elest. Po të bëhet det, do të thotë se ka shpëtuar nga çdo lloj prishjeje!

Po qe se qumështi gjen një rrugë për të rrjedhur në detin e mjaltit, kurrë nuk prishet, nuk thartohet e nuk pritet!

O luan i Zotit! Bulëro si luan dhe ai bulërim të ngjitet gjer në qiellin e shtatë!

Ç'di shpirti i mërzitur e i hidhëruar? Nga ta dijë miu bulërimën e luanit?

Shkruaje gjendjen tënde me ujë floriri që të përfitojnë ata me zemrën të gjerë si det dhe natyrë të mirë!

Fjala që i shton shpirt shpirtit, është uji i Nilit! O Zot, tregoje atë si gjak në sytë e kiptiut!

Kiptiu i lutet një burri nga fiset izraelite:
"Për hatër të vëllazërisë dhe miqësisë,
mbush nga Nili një shtambë ujë me qëllim për vete,
ma vër në buzë dhe të pi, sepse kur ju izraelitët
i mbushni enët për veten tuaj, uji kthjellohet,
kurse kur i mbushim ne, kiptinjtë, turbullohet!"

Dëgjova se një kipti, i turbulluar nga etja, shkoi në shtëpinë e një izraeliti

Dhe i tha: "Jam shok e mik me ty. Sot kam një nevojë, prandaj erdha ta kërkoj prej teje!

Sepse Musai na bëri magji dhe, më në fund, Nili u bë gjak për ne!

Kur mbushin izraelitët, bëhet ujë dhe e pijnë, kurse sytë e kiptinjve janë lidhur, atyre u duket gjak!

Dhe, kështu, fisi kipti po vdes nga etja. Kjo, ose nga fati i keq, ose nga e keqja e vetes!

Mbush një tas me ujë për vete dhe ky mik të pijë nga uji yt!

Sepse po e mbushe për vete, nuk bëhet gjak, por mbetet ujë i pastër e i kulluar!

Edhe unë të pi në sajë teje. Njeriu i lidhur pas dikujt, shpëton nga vuajtja me favorin e atij pas të cilit është lidhur!

Izraeliti i tha: "Mirë, more zotëri i dashur, po të shërbej ty, po e bëj atë që dëshiron ti, o dritë e syve!

Të bëj sipas dëshirës sate, të të gëzoj ty... Të të bëhem rob e skllav por ty të të jap liri!"

E mbushi tasin nga Nili, e afroi te goja dhe e piu gjysmën.

Pastaj e drejtoi tasin tek ai që i kërkoi ujë dhe i tha: "Pi edhe ti!" Uji u bë menjëherë gjak i zi!

E ktheu prapë nga ana e vet, gjaku u bë ujë. Kiptiu u nxeh, mori flakë!

Dhe u ul pak. Pasi i kaloi furia, i tha: "O shpatë e lartë,

O vëlla, si mund të zgjidhet kjo nyje?" Izraeliti i tha: "Këtë e pi njeriu i devotshëm!

Dhe njeri i devotshëm është ai që është mërzitur nga rruga e Faraonit, prandaj është kthyer nga Musai dhe është bërë si ai!

Shko pas Musait, bëhu bashkësi e Musait dhe pije këtë ujë. Pajtohu me hënën dhe shihja dritën!"

Në sytë e tu ka qindramijëra errësira për shkak të zemërimit ndaj robve të Zotit!

Tulate zemërimin, pastaj hape syrin dhe gëzohu... Merr shembull nga miqtë dhe bëhu mësues!

Ndërsa tek ti ka mohim sa mali i përrallave, si mund të lidhesh pas meje për të marrë ujë në pëllëmbë nga Nili?

A mund të kalojë mali nga vrima e gjilpërës? Kalon, por vetëm nëse bëhet një fill peri i vetëm!

Me anë të pendesës tënde shndërroje malin në fije kashte, merre mirë e bukur kupën e atyre që falin fajet dhe ngrije!

Mirëpo si mund ta pish atë me këtë lloj hileje kur Zoti ua ka ndaluar qafirëve, mohuesve?

O shpifës që ka pësuar shpifje, si mund të ndodhë që Zoti i cili i ka krijuar hilen dhe mashtrimin, të gënjehet nga hileja dhe mashtrimi yt?

Bëhu nga bashkësia e Musait, se hileja nuk ka dobi! Hileja jote është matje e erës!

A mos e ka atë të drejtë uji që të braktisë urdhrin e Zotit dhe të bëhet ujë për qafirët?

A mos pandeh ti se ha bukë? Ti ha helm gjarpëri, ha veten tënde!

Si mund t'i bëjë dobi buka personit që e ka braktisur urdhrin e të dashurit?

A mos pandeh se do t'i lexosh fjalët e Mesnevisë e do t'i kuptosh lirë, badjava?

Apo se fjalët e urta dhe enigmat e fshehta do të të hyjnë lehtësisht në vesh, do të të vijnë në gojë?

Dëgjon, dëgjon, por të vijnë si përrallë... Dëgjon faqen e jashtme, jo të brendshmen!

Një e bukur ka hedhur çarçaf sipër dhe e ka fshehur fytyrën prej teje!

Ashtu siç të vjen Kur'ani nga inati, ashtu të vjen edhe Sehnameja apo Kelile dhe Dimne!

Po qe se syrmeja e mirësisë ta hap e ta ndriçon syrin, atëherë e kupton dhe e dallon të drejtën nga ajo me nënkuptim!

Kurse për njeriun që s'nuhat dot, si misku, si jashtëqitja, njëlloj janë... A s'nuhat dot?

Qëllimi për të cilin lexohet fjala e Zotit të lartë, është shpëtimi i vetes nga mërzitja dhe dhimbja!

Sepse zjarri i lëkundjes dhe dyshimit me këtë fjalë shuhet. Kjo fjalë bëhet shërim për vuajtjen e njeriut.

Për shuarjen e një zjarri kaq të madh, sipas mendjes, si uji i pastër e i kulluar, si shurra, një janë!

Zjarrin e lëkundjes dhe dyshimit e shuan edhe uji, edhe shurra. Që të dyja e shuajnë siç shuan gjumi zjarrin e vuajtjes dhe dëshpërimit!

Por po ta dish se ky ujë i pastër që është fjala shpirtërore e Zotit, i shuan plotësisht nga zemra të gjitha lëkundjet dhe dyshimet,

Zemra e gjen rrugën e trëndafilishtes dhe arrin atje!

Sepse ai që merr një aromë nga të fshehtat e librave të Zotit, fluturon nëpër kopshte e vreshta, nëpër brigjet e përronjve!

A mos e pandeh ti fytyrën e velinjve, të urtëve, siç e shohim ne?

Edhe Pejgamberi u habit duke thënë se "si ndodh që besimtarët të mos ma shohin fytyrën mua?"

Ai thoshte: "Si ndodh që njerëzit nuk e shohin dritën e fytyrës sime? Mirëpo ajo dritë e kaloi edhe dritën e diellit të lindjes!..

Por, nëse e shohin, ç'është kjo habi?" Më në fund, erdhi mesazhi që thoshte se ajo fytyrë është në botën e fshehtësive!

Që fytyrën të mos ta shohin qafirët, hëna për ty është re për popullin e verbër!

Që nga kjo verë të mos pijnëparësia dhe populli, kokrra e drithit për ty është lak për popullin e verbër!

Zoti tha: "Ata të shohin ty por të përngjasojnë me figurat në muret e hamamit..." "Të vështrojnë, por nuk të shohin!"

O ti që adhuron figurat! Edhe portreti në pikturë të sheh ty me ata sy të shuar, ashtu duket se të sheh!"

Pranë tij qëndron me edukatë, por, kur e sheh se nuk ta var fare, të vjen çudi se pse nuk po të respekton!

Pse piktura e bukur s'më jep përgjigje për pyetjet? Pse nuk ma kthen përshëndetjen?

Megjithëse i bëra qindra sexhde, pse ajo s'ka mirësinë ta lëvizë kokën dhe mjekrën?

Edhe Zoti nuk duket në botën e jashtme, nuk e lëviz kokën, por të jep brenda në shpirt një kënaqësi të tillë,

Që ajo kënaqësi e vlen sa për dyqind tundje koke! Ja, kështu e tundin kokën mendja dhe shpirti!

Po qe se punon e përpiqesh dhe i shërben mendjes, ajo çka bën mendja për ty është të të fusë në rrugë të drejtë, të t'i shtojë pretekstet për të hyjrë në rrugë të drejtë!

Zoti nuk ta tund kokën hapur ty, por të bën krye të kryeve!

Zoti të jep fshehurazi një gjë të tillë, që të gjithë banorët e botës të të bien në sexhde!

Po kështu, kur i jep vlerë një guri, ai gur, domethënë, floriri, merr në sytë e popullit një vlerë të lartë!

Kur një pikë ujë meriton favorin e Zotit dhe bëhet margaritar, e kalon edhe floririn!

Trupi është dhé, por kur Zoti i jep atij një dritë, bëhet si hëna që e mbështjell dhe e ndriçon tokën!

Eja në vete!.. Këta sundimtarë s'janë gjë tjetër veç magji, pikturë e vdekur! Por duket sikur shohin dhe ua presin rrugën kokëtrashëve!

Duken si sy që sheh e që pulitet dhe kokëtrashët u japin ekzistencë, i bëjnë argument dhe provë!

Kiptiu kërkon nga izraeliti të lutet për të për të mirë dhe izraeliti bën lutje për kiptiun për të mirë; lutja e tij pranohet nga Zoti, më bujari i bujarëve dhe më mëshiruesi i mëshiruesve.

Kiptiu tha: "Bëj një lutje për mua..., sepse zemra ime është e zezë sterrë, prandaj unë nuk e kam atë gojë!

Lutu se, ndoshta, hapet dryni i kësaj zemre dhe i shëmtuari zë vend në kuvendin e të bukurve!

Personi i shëmtuar, me begatinë e lutjes, zbukurohet. Ose një shejtan bëhet engjëll përsëpari.

Ose një degë e thatë, me fuqinë në dorën e Merjemes, kundërmon aromë të mirë, bëhet e njomë, jep fruta!

Izraeliti ra atë çast në sexhde dhe tha: "O Zot që i di punët e dukshme e të fshehta!

Para kujt tjetër veç teje i bashkon robi duart? Edhe lutja, prej teje, edhe pranimi i lutjes, prej teje!

Ti je, gjithashtu, ai që në fillim i jep prirje lutjes dhe, pastaj, je prapë ti që e pranon!

Ti je edhe i parmë, edhe i mbramë, kurse ne, një hiç i hiçit për të cilin as që mund të bëhet fjalë!"

Ndërsa po thoshte kështu, më në fund, legeni ra nga çatia... Ai ra në dalldi.

Duke bërë lutje, erdhi përsëri në vete... "Njeriu merr vetëm atë që ka bërë!"

Ndërsa po thoshte këtë lutje, zemra e kiptiut u entuziazmua. Papritmas lëshoi një të bërtitur.

Dhe tha: "Mos rri, por menjëherë më mëso se ç'do të thuash duke shprehur besimin dhe menjëherë ta prej brezin e vjetër!

Në shpirt më lëshuan një zjarr... një shejtani i bënë një kompliment nga zemra.

Jam miku yt, nuk mund të rri pa të parë ty... Lavdi Zotit, kjo miqësi, më në fund, ma zuri dorën.

Bisedat e tua ishin një alkimi, siç duket. Mos t'u largoftë këmba nga shtëpia e zemrës!

Ti ishe një degë nga fidani i xhennetit... iu ngjita asaj dhe më çoi gjer në xhennet!

Ishte një rrebesh që ma rrëmbeu trupin... Ky rrebesh më shtyu gjer në breg të detit të favorit dhe mirësisë!

Me shpresën e ujit, shkova drejt rrebeshit, por pashë detin dhe fitova margaritarë me grushta!"

Izraeliti i solli një tas dhe i tha të merrte ujë me të. Kiptiu i tha: "Ec tutje, shko, në sytë e mi, ujërat u shëmtuan.

Piva një sherbet nga e fshehta "Zoti i bleu besimtarët", që s'kam për t'u etur gjer në kiamet!

Brenda kam një burim që ka marrë vrull, i cili u dhuron ujë burimeve dhe lumenjve.

Zemra më digjej nga etja, kërkonte ujë.... Tani meritoi një ndihmë të tillë që uji i duket i keq!

Si argument i drejtësisë në linjën "kaf, ha, ajn, sad", emri Kafi i Zotit u bë Kef:

Jam Kafi (i mjaftueshëm), t'i jap të gjitha të mirat ty pa shkaqe, pa përdorur ndihmën e tjetërkujt si ndërmjetës!

Jam Kafi, të mbaj ty pa bukë... të dhuroj ty zotnillëk, padishahllëk pa ushtarë e pa ushtri...

Megjithëse s'është pranverë, të jap ty narcize e manushaqe, të ngulis në kujtesë njohuri pa libër e pa mësues mjeshtër!

Jam Kafi, të jap shëndet pa ilaçe; varrin dhe gropën i bëj shesh...

Musait i jap një shkop të lëshojë shpata mbi kokë të të gjithë botës, i fal fuqi e forcë...

Në dorë të Musait vë një dritë, një shkëlqim që ta sfidojë edhe diellin!

Shkopin e bëj kuçedër me shtatë kokë, një kuçedër të tillë që të mos ketë rrjedhur prej ndonjë babe kuçedër e të mos ketë dalë prej ndonjë nëne kuçedër!

Nuk përzjej gjak në ujin e Nilit, por, me fuqinë time, ujin e tij e kthej në gjak!

Gëzimin tënd si uji i Nilit e kthej në shqetësim që të mos gjesh më mundësi për t'u gëzuar!

Dhe kur ta rinosh sërish besimin, neveritesh prej Faraonit.

Dhe sheh se ka ardhur Musai i mëshirës... Nili i dukur si gjak, është bërë ujë për shkak të tij!

Po qe se fillin e perit e fsheh në zemër, Nili yt i kënaqësisë nuk bëhet kurrë gjak.

Dhe thosha me vete të besoja dhe të dilja nga ky tufan gjaku.

Ku ta dija unë se Zoti do të më ndërronte, se zemrën do të ma sillte në gjendje tjetër dhe do të më bënte Nil!

Në sytë e të tjerëve jam si më parë, por në sytë e mi duket një Nil që rrjedh.

Po kështu, edhe kjo botë, në syrin e pejgamberit duket e zhytur në tesbih, në madhërimin e Zotit, kurse sipas nesh, rri ashtu, pa kuptim...

Në syrin e tij kjo botë duket e mbushur me pasion dhe mirësi hyjnore, kurse në syrin e tjetërkujt, e vdekur, pa jetë!

Lart apo poshtë, çdo vend ecën me nxitim; ai dëgjon fjalime prej dheu e prej gurësh!

Mirëpo të gjitha këto janë të mbyllura për popullin, çdo gjë duket e vdekur... Unë nuk kam parë ndonjë perde për t'u çuditur më shumë se kjo!

Sipas nesh, të gjitha varret janë njëlloj. Por në sytë e velinjve, të urtëve, dikush është kopësht xhenneti, dikush gropë xhehennemi!

Populli thoshte se Pejgamberi është fytyrëthartë; pse kështu, pse nuk ka kënaqësi?

Kurse parësia thoshin: Në sytë tuaj ashtu duket ai...

Vështroni një herë me syrin tonë dhe shihni buzëqeshjet te "njeriu"!

Ajo gjëja e prapë ashtu duket nga sipër drurit të dardhës... O djalë i ri, zbrit nga pema dhe shih!

Ajo pemë dardhe është pemë ekzistence... Sa të jesh ti aty, gjëja e vjetër do të të duket e re!

Sa të ndodhesh mbi atë pemë, bota do të të duket një gjembishte e fëlliqur, një vend plot akrepë të zemëruar, plot gjarpërinj!

Por po të zbresësh nga pema, menjëherë e sheh botën me bukuroshe faqetrëndafile, me dado e taja!

Gruaja e keqe i thotë të shoqit: "Ato fantazma të duken ty
nga maja e drurit të dardhës, sepse, nga maja e dardhës, të tilla gjëra i bien njeriut në sy! Zbrit poshtë dhe ato fantazma ikin!"
Po të na thoshte dikush se ajo që ka parë burri, s'ka qenë fantazmë, do t'i jepnim këtë përgjigje: "Ky është shembull, jo çështje.
Kaq shembull është i mjaftueshëm. Po të mos ngjitej në drurin e dardhës, nuk do të shihte as fantazmë, as gjë tjetër!"

Një grua donte të takohej e përkëdhelej me mikun e vet mu në sy të të shoqit kokëtrashë.

Ajo i tha të shoqit: O fatbardhë, dëshiroj të ngjitem në pemë e të mbledh fruta.

Me t'u ngjitur në pemë, e vështroi të shoqin nga lart dhe nisi të qajë.

Dhe i tha: O i pamoralshëm i ndyrë, kush është ai bukurosh që ke sipër?

Ti je shtrirë nën të si grua... Ti paske qenë homoseksual!

I shoqi i tha: Ty t'u muarën mendtë, më duket... Këtu nuk ka askush përveç meje!

Por gruaja i tha edhe disa herë të tjera të shoqit t'i tregonte se kush ishte ai mashkull që i kishte hipur sipër.

Atëherë, burri i tha: O grua, zbrit nga pema! Ty të janë marrë mendtë, me të vërtetë je turbulluar!

Gruaja zbriti nga pema dhe kësaj radhe u ngjit i shoqi. Dhe gruaja e mori mikun në gjoks!

I shoqi i bërtiti: Hë, moj orospi, kush është ai burrë që të ka hipur sipër si majmun?

Gruaja i tha: Këtu s'ka kush veç meje! Eja në vete, ty t'u muarën mendtë, më duket, mos fol përçart!

Sadoqë burri i përsëriti fjalët, gruaja vazhdoi t'i thoshte se kjo ndodhte prej drurit të dardhës!

Gruaja i tha: Edhe unë pashë gjëra të tilla kur ndodhesha mbi pemë, o i poshtër!

Zbrit poshtë dhe shih, veç meje s'ka njeri tjetër. Të gjitha këto fantazma, prej drurit të dardhës!

Shakaja dhe humori vlejnë për të ngulitur diçka. Dëgjoji ato si gjëra serioze dhe mos u kap nga ana e jashtme e tyre.

Çdo gjë serioze, sipas maskarenjve, është maskarallëk, shaka, kurse sipas të mençurve, edhe shakatë dhe humori janë serioze!

Mendjeshkurtërit kërkojnë drurin e dardhës, por nga ky dru dardhe në atë dru dardhe ka një rrugë të gjatë!

Zbrit nga druri i dardhës dhe vihu në rrugë. Ty të është turbulluar edhe syri, edhe fytyra!

Kjo pemë është egoizëm, është ekzistenca e mëparshme. Për sa të mbetet me këtë ekzistencë, sytë i çakërisen, sheh gjëra të paqena!

Por po të zbresësh nga pema e dardhës, as në mendim s'mbetet shtrembërim e mbrapështi, as në sy, as në fjalë!

Atëherë, këtë pemë e sheh t'i jenë ngjitur degët gjer në qiellin e shtatë dhe të jetë bërë një pemë shteti të madh!

Kur të zbresësh dhe të largohesh prej tij, Zoti me mëshirën e vet, e ndryshon atë pemë.

Për shkak të kësaj zbritjeje poshtë, të kësaj thjeshtësie e modestie, Zoti t'i jep syrit aftësi shikimi të drejtë.

Po qe se shikimi i drejtë do të ishte i lehtë dhe badjava, a do ta luste Mustafai Zotin t'ia jepte atë?

Ai i tha: "O Zot, qoftë lart, qoftë poshtë, çdo gjë ma trego siç është!"

Pasi të kesh zbritur poshtë, ngjitu prapë në atë pemë, sepse tashmë ajo pemë, me urdhrin e Zotit "Bëhu!", është ndryshuar, ka gjelbëruar.

Ajo pemë është shndërruar në pemën e Musait. Po t'ia tërheqësh ngarkesën në vendin ku ndodhet Musai,

E sheh se këtë pemë zjarri e gjelbëron, e bën të gëzuar; dega e saj thotë: "Pa dyshim, unë jam Zoti!"

Nën hijen e tij plotësohen të gjitha nevojat... Ja, e tillë është alkimia hyjnore!

Më në fund, ai egoizëm, ajo ekzistencë bëhet hallall për ty sepse në të sheh atributet e Zotit të madhërishëm!

Pema e shtrembër drejtohet dhe e tregon Zotin... "Rrënjët i ka në tokë, kurse degët e gjethet, në qiell!" Pjesa e mbetur e historisë së Musait.

Me një komunikim serioz, Musait i erdhi ky mesazh nga Zoti: Lëre shtrembërinë dhe bëhu i drejtë tani!

Kjo pemë e trupit është shkopi i Musait. Erdhi urdhri i Zotit: Hidhe atë prej dore!

Hidhe dhe shihja të mirën e të keqen. Pastaj merre përsëri atë në dorë me urdhrin e Zotit.

Para se ta hidhte, ai s'ishte diçka tjetër përveç një shkopi, por me t'u marrë në dorë me urdhrin e Zotit, u përmirësua, u zbukurua.

Më parë me të ai u shkundte gjethe qengjave, por për atë fis krenar u bë mrekulli.

U bë gjykatës në kokë të atyre që ndiqnin Faraonin, ujërat ua bëri gjak, u bë shkak t'i binin kokës me grushta!

Në arat e tyre ranë karkalecat, hëngrën ç'kishte, e fshinë. Të mbjellat e tyre dhanë prodhime krize dhe vdekjeje.

Më në fund, duke parë përfundimin e punës, Musai ra në dalldi dhe filloi të lutej.

Ai tha: "O Zot, pse gjithë këto mrekulli, këto përpjekje? Sepse ky popull nuk ka për të ardhur në rrugë të drejtë!

Nga Zoti erdhi urdhër: Bëj si Nuhu dhe lëre shikimin e përfundimit në fjalë!

Bëj sikur s'e sheh atë, sepse ti je ftues në udhë. Është dhënë urdhri "Kumtoje urdhrin e Zotit!" Kjo nuk është kot!

Urtësia më e parëndësishme e thirrjes tënde me kaq këmbëngulje e tyre për në rrugë të drejtë është ky: Inati dhe këmbëngulja e tyre del në shesh

Dhe nga të gjitha fraksionet njihet se Zoti orienton dhe çorienton.

Me ekzistencën është fjala për të nxjerrë në dukje përsosmërinë e Zotit. Në këto kushte, populli duhet vënë në provë me këshillë dhe me nxitje për të keq.

Shejtani këmbëngul për t'i çuar njerëzit në rrugën e teprimit dhe mbrapshtisë. Kurse shehu këmbëngul për t'i çuar në rrugë të drejtë.

Kur ato punë dëshpëruese ndiqnin njëra-tjetrën, Nili kthehej krejtësisht në gjak.

Më në fund, Faraoni shkon te Musai dhe, i përkulur më dysh, fillon t'i lutet:

Sovrani im, ne e bëmë, ti mos e bëj... mos thuaj gjë se ne s'kemi fytyrë!

Vdeksha për ty, u bëfsha copë-copë, pranoma lutjen. Unë jam mësuar me madhështi, mos më godit rëndë!

Ki mirësinë, o njeri i besueshmërisë, lëvize buzën me mëshirë që kjo gojë e zjarrtë të mbyllet!

Musai tha: "Zoti im, Faraoni më gënjen, ai kërkon të gënjejë atë që është gënjyer pas teje!

Ta dëgjojmë, apo edhe unë t'i bëj hile dhe ai ta kuptojë origjinalin e hiles së ngjitur pas nënhiles?

Sepse origjina e çdo hileje, e çdo rrengu është tek ne... origjina e çdo gjëje që ndodhet në tokë, është në qiell.

Zoti tha: Ai qen nuk e vlen as për kaq. Qenit hidhi një kockë nga larg!

Eja, lëvize atë shkop dhe tokat të bëjnë të mbijnë edhe një herë atë që prishën karkalecat.

Ata karkaleca të digjen menjëherë, të përcëllohen, të bëhen sterrë të zeza dhe populli ta shohë se si Zoti e ndryshon çdo gjë!

Për ta bërë një punë, nuk kam nevojë për shkak; ai shkak është për ta mbuluar e fshehur të vërtetën!"

Ai që i beson natyrës në këtë mënyrë, mbahet pas ilaçit... astrologu ua ngul sytë yjeve!

Nga ambicja, hipokriti shkon në pazar në errësirën e mëngjesit me frikën se mos malli i zhvlerësohet!

Edhe personi i cili s'e ka larë fytyrën dhe s'ka bërë adhurim por që vrapon pas rizkut dhe kërkon ushqim, bëhet kafshatë për në xhehennem e mbaron.

Si qengji që shpërndahet dhe kullot, edhe shpirti i populllit edhe ha, edhe hahet.

Kur qengji shpërndahet dhe kullot, kasapi gëzohet me mendimin se ai po ha gjethin që kërkon ai, po majmet për të!

Në të ngrënë e në të pirë bën lakmi si xhehennem dhe majmesh për xhehennem!

Vihu në punën tënde, qoftë edhe një ditë hapu në bjeshkën e urtësisë, kullot dhe ajo zemër mbretërore të ngjallet!

Ngrënia-pirja e trupit është pengesë për këtë të ngrënë. Shpirti i ngjet tregtarit, kurse trupi, grabitësit e piratit!

Po qe se hajduti që pret rrugën digjet si dru, qiriri i tregtarit digjet e shkëlqen!

Sepse ti përbëhesh prej mendjes; çdo gjë tjetër që ke, vetëm mendja e mbulon, e fsheh... mos e humb veten dhe mos u merr me gjëra të marrëzishme.

Dije se çdo epsh, si vera dhe opiumi, është perde për mendjen. të mençurit mbeten të habitur me këto!

Por nuk është vetëm vera që e shuan mendjen, që e deh njeriun... çdo gjë që i përket epshit i i lidh e i mbulon syrin, veshin.

Sa larg ishte shejtani nga pirja e verës... Ishte i dehur, por ishte bërë i dehur me madhështi, kryeneçësi dhe kundërshtim!

I dehuri është personi që sheh gjënë që s'është.... Për shembull, bakrin dhe hekurin i sheh flori!

Kjo fjalë s'ka fund! O Musa, lëvizi menjëherë buzët që nga arat të na mbijnë të mbjellat!

Musai e zbatoi urdhrin; menjëherë faqja e tokës u blerua, u mbush me zymbyla e me kallinj plot kokrra të mëdha!

Kiptinjtë, menjëherë, si njerëz që kishin kaluar zi buke, që kishin ardhur në prag të vdekjes, filluan t'i hanin ato.

Besimtarët, njerëzit, kafshët, me mirësinë e Zotit, hëngrën e u ngopën disa ditë me radhë!

Por kur e mbushën barkun, filluan ta mohojnë të mirën... pasi iku nevoja, përsëri u tërbuan, ngritën krye!

Nefsi, egoja është faraon, kurrsesi mos e ngop që të mos i vijë ndërmend mohimi i vjetër!

Nefsi nuk zbukurohet po s'ra në nxehtësinë e zjarrit. Kurrsesi mos tento ta rrahësh hekurin pa u skuqur si prush!

Trupi nuk lëviz pa mbetur i uritur. Të tentosh ta përmirësosh trupin e ngopur, dije se është si të tentosh ta rrahësh hekurin e ftohtë!

Edhe sikur të qajë me ngashërime, mblidhi mendtë se ky nef nuk do që të bëhet musliman!

Ai i ngjet Faraonit. Si Faraoni në krizën e bukës, bie në gjunjë para Musait, i përgjërohet!

Por kur t'i kryhet puna, tërbohet. Krejt si gomari që kur e hedh barrën, fillon të hedhë shqelma!

Po t'i shkojë puna mirë, po t4i plotësohet qëllimi, i harron krejt ato qarjet me ngashërime!

Po qe se një njeri qëndron për shumë vite në një qytet dhe për një çast i mbyll sytë, e zë gjumi dhe fillon të shohë ëndërr,

E gjen veten të mbushur plot me gjëra të mira e të këqija dhe qytetin e vet as që e kujton!

Nuk thotë, madje: Unë isha atje. Ky qytet i ri nuk është qyteti im, unë s'bëhem i këtushëm, sidoqoftë, jam i ardhur!

Jo vetëm që s'thotë kështu, por e pandeh veten se aty ka ardhur në botë, aty është mësuar!

Sa e çuditshme është që edhe shpirti nuk i sjell as ndërmend vendet, banesat ku ka ndenjur, ku është lindur dhe rritur;

Nuk mendon se, si reja që e mbulon yllin, kjo botë e rrënuar ia ka mbuluar sytë!

Sidomos shpirti ka shkelur shumë qytete, ka shëtitur shumë qytete. Për shkak të mirëkuptimit, pluhurat e atyre qyteteve ende s'janë shkundur!

Njeriu nuk ia ka hyrë me vendosmëri punës dhe nuk e ka pastruar zemrën me qëllim që gjërat që ka parë e i ka kaluar, t'i shohë e t'i mësojë!

Zemra e njeriut duhet të jetë e pastër dhe të ngrejë kokë si e merituar e të fshehtave. Duhet t'i hapet syri dhe të shohë fillimin dhe mbarimin!

Gjendjet dhe mjediset që ndërroi njeriu qysh nga fillimi.

Në fillim ka ardhur në vendin e jogjallesave, pastaj, nga bota e jogjallesave, ka rënë në botën e bimëve.

Për vite ka qenë bimësi, ka kaluar jetën si bimë dhe megjithëse bima është e kundërta e gjërave pa shpirt, nuk i ka shkuar ndërmend se një kohë është ndodhur në vendin e gjërave pa shpirt.

Dhe pasi ka rënë nga bimësia në shtazëri, nuk e kujton fare gjendjen e vet në kohën kur ka qenë bimësi.

Vetëm ka një prirje ndaj gjelbërimit. Sidomos kur vjen pranvera dhe çelin lulet.

Edhe fëmijët kanë prirje ndaj nënave. Por fëmija nuk e di sekretin pse priret ndaj nënës dhe qumështit të saj.

A nuk ka prirje të fuqishme edhe dervishi fillestar ndaj pirit të ri, ndaj atij fati të lartë?

Sepse pjesa e kësaj mendjeje është prej asaj mendjeje të përgjithshme... Lëvizja e kësaj hijeje është nga lëvizja e asaj dege trëndafili.

Më në fund, hija asgjësohet në të dhe e kupton të fshehtën e kësaj prirjeje dhe vartësie!

O njeri fatmirë, po s'lëvizi kjo pemë, si do të lëvizë hija e saj?

Krijuesi që njeh, e kthen dhe e vërtit atë sërish nga shtazëria në njerëzi....

Kështu, duke shkuar nga klima në klimë, më në fund, në botën e njeriut merr një gjendje të mençur, të ditur dhe të lartë.

Por ashtu siç nuk i kujton mendjet e mëparshme, as nuk e çon ndërmend se do të kalojë nga kjo mendje dhe do të ndryshojë!

Më në fund, pasi të shpëtojë edhe nga kjo mendje plot me këtë ambicje dhe këtë dëshirë, do të shohë qindramijëra mendje për t'u çuditur!

Ç'është e vërteta, ka fjetur, e ka harruar gjendjen e mëparshme... Po a e lënë atë në këtë botë harrese?

Prapë e zgjojnë nga ai gjumë dhe me t'u zgjuar, fillon të qeshë me gjendjen e vet...

Dhe thotë: Ç'ishte ai shqetësim, ai dëshpërim që pësova në gjumë? Si u bë që i harrova ato gjendjen e drejta e të rregullta?

Si u bë që nuk e dita se ai shqetësim dhe dëshpërim ishin ëndërr, mashtrim, fantazim?

Edhe bota i ngjet kësaj... përbëhet pothuaj prej atyre ëndrrave dhe fantazive që pa njeriu që flinte. Ai që fle pandeh se ato ëndrra dhe fantazira janë të vërteta dhe do të vazhdojnë.

Por kur papritmas vjen mëngjesi i paracaktuar, shpëton nga errësira e pandehmave dhe mashtrimeve.

Dhe kur sheh vendin e banesën, fillon të qeshë për shqetësimin dhe ankthin.

Gjërat e mira e të këqija që pe në gjumë, ditën e ringjalljes shfaqen një e nga një.

Ç'të kesh bërë në gjumin e kësaj bote, kur të zgjohesh ke për t'i parë sheshit të gjitha dhe

Do ta kuptosh se i bëre këto punë të këqija në gjumë, por ato nuk ikën; që të gjitha e kanë një shpjegim!

O ti që e ke qortuar dhe munduar edhe robin, në këtë ditë të shpjegimit të qeshjes dhe ëndrrës duhet të qash me të madhe.

Dije se vuajtja, dhimbja dhe vajtimi në ëndërr provojnë se kur të zgjohesh do të gëzohesh.

O ti që shqyen lëkurën e Jusufëve, kur të zgjohesh nga ky gjumë i thellë, do të ngrihesh si ujk.

Veset të bëhen një nga një ujk dhe t'i copëtojnë gjymtyrët me egërsi.

Pas ndëshkimit ekuivalent ti vdes, por edhe pas vdekjes ai gjak nuk fle. Mos thuaj se, po vdiqa, shpëtoj.

Ekuivalenca e tanishme është një regjim për rregullsinë e kësaj bote; në raport me ekuivalencën e atjeshme është lojë.

Prandaj Zoti e ka quajtur këtë botë lojë. Sepse ky ndëshkim është një lojë në krahasim me atë ndëshkim!

Ky ndëshkim është për të qetësuar luftën dhe intrigën. Ajo është për ta tredhur burrin, kurse kjo, si për ta bërë synet!

Njerëzit e xhehennemit janë të uritur.
Ata i luten Zotit: "O Zot, na i shto furnizimet tona dhe na i dërgo menjëherë se nuk na mbeti më durim!"

O Musa, kjo fjalë s'ka fund... Eja në vete dhe lëri ato gomerë të kullosin bar!

Të kullosin bar dhe të shëndoshen e majmen nga ato barëra të mira. Sepse, mblidhi mendtë, ne kemi ujqër të egër!

Ne i dimë qarjet e ujqërve tanë... Këta gomerë ua japim atyre që t'i hanë!

Përbërja e e asaj fryme të mirë të dalë nga buzët e tua, deshi t'i bënte njerëz këta gomerë!

Ti u bëre favor e mirësi dhe i thirre shumë ata, por ata gomerë s'kanë fat e jo kësmet!

Tashmë hidhe mbi ta jorganin e dhuntive dhe të kridhen menjëherë në gjumin e shkijdesjes dhe padijes.

Të kridhen dhe kur të zgjohen e të ngrihen nga ky gjumë shkujdesjeje e padijeje, të shohin se qiriri është shuar dhe sakiu ka ikur!

Teprimet e tyre të çuditën ty, por ata do ta pijnë verën e mallit edhe në ahiret!

Në këtë mënyrë, drejtësia jonë shkel këmbë jashtë, e tregon veten dhe në kiamet, për çdo punë të keqe, jep një ndëshkim plotësisht të merituar!

Sovrani që nuk e shohin hapur, vazhdimisht është me ta si i fshehtë.

Si mendja...Ti atë s'e sheh dot, por ajo është bashkë me ty!

Ti atë s'e sheh dot, por ajo të mban në provë ty, ta sheh qëndrimin dhe veprimin!

Sa gjë e çuditshme është që kjo, ndërsa është kështu, ti nuk e sheh me vend që krijuesi i mendjes të jetë me ty!

Njeriu tregohet indiferent ndaj mendjes, bën punë të këqija, pastaj mendja fillon ta qortojë njeriun.

Ti je indiferent ndaj mendjes, por a nuk është ai qortim prej ekzistencës së mendjes?

Po të mos ishte mendja jote, po të qëndronte ajo indiferente ndaj teje, si do të ndodhte që të të qortonte ty, të të jepte shpulla?

Ndërkaq, po qe se nefsi yt nuk do të ishte indiferent ndaj mendjes, a do të bëje këto marrëzira, a do t'u hyje këtyre punëve të ndyra?

Prandaj, mendja jote i ngjet një astrolabi... Me atë e gjen afërsinë e diellit.

Afërsia e mendjes sate ndaj teje nuk ka tregues cilësorë; nuk është as djathtas, as majtas, as prapa, as para teje!

Ndërsa afërsia e mendjes sate ndaj teje, ekzistenca e mendjes sate tek ti është pa tregues cilësorë dhe në një gjendje të papërshkrueshme, për pasojë, nuk je në gjendje të flasësh për këto gjëra, pse afërsia e Zotit ndaj teje të mos jetë pa tregues cilësorë?

Lëvizja e gishtit tënd nuk është ap para gishtit, as pas, as djathtas, as majtas ti!

Në gjendje gjumi dhe vdekjeje, ajo lëvizje ikën nga gishti... Në gjendje zgjimi, vjen.

Pa atë lëvizje, nga gishti s'vjen ndonjë dobi. Mirë, po me ç'rrugë vjen ajo lëvizje?

Drita e syve, drita në beben e syrit nuk vijnë as nga gjashtë drejtimet. Por me ç'rrugë vijnë?

Ana dhe drejtimi janë në botën e krijimit. Botën e urdhrit dhe atributit diji pa anë e pa drejtim.

I miri im, dije se në botën e urdhrit nuk ka anë e drejtim. Zoti që urdhëron, sigurisht që është krejtësisht i lirë, i pakufizuar nga anët dhe drejtimet!

As mendja nuk ka anë e drejtim. Sigurisht, Zoti që e njeh shprehjen mirë, është mendje mbi mendje, shpirt mbi shpirt!

Nuk ka asnjë krijesë që të mos ketë lidhje me të! Por, or babë, kjo lidhje nuk përshkruhet, ajo është e pacilësueshme!

Sepse në shpirt nuk ka as afrim, as ndarje. Mirëpo pandehma (supozimi) nuk mund të mendojë gjë tjetër veç ndarjes dhe bashkimit.

Gjeje gjurmën e një prove tjetër veç këtij bashkimi, njësimi dhe ndarjeje... Mirëpo ndjekja e gjurmës nuk e bind të eturin!

Nëse je larg nga origjina, ndiqe plotësisht gjurmën që damari yt burrëror të të çojë në bashkim!

Si mund t'i gjejë mendja rrugë kësaj lidhjeje, si ta kuptojë këtë lidhje? Kjo mendje është në vartësi të lidhjeve ndarje dhe bashkim.

Prandaj Mustafai na ka porositur ne: "Mos flisni shumë për personin e Zotit!"

Fundja, të mendosh personin e Zotit, nuk është të mendosh me të vërtetë personin e Zotit!

Sepse pandehma dhe mendimi i atij që mendon ka të bëjë vetëm me rrugën. Kurse mes asaj pandehme dhe mendimi dhe Zotit, ka qindramijëra perde!

Çdokush është mbyllur me një perde, ka pandehur se ka arritur te Zoti, por ai që pandeh ai për Zot, është vetëm fantazia e tij!

Ja, prandaj Pejgamberi ia ka fshirë iluzionin atij personi në mënyrë që të mos bjerë në gabim duke u kapur pas fantazirave.

Sepse në iluzionin e tij kishte braktisje të etikës dhe edukatës. Zoti e poshtëron të paedukatin.

Dhe poshtërimi është i tillë që njeriu bie poshtë, por e pandeh veten lart!

Kjo është edhe puna që bën i dehuri: ai nuk e dallon qiellin nga toka ku qëndron!

Mendoni veprat e habitshme të Zotit... Shihni madhërinë dhe madhështinë e tij dhe humbeni veten!

Po qe se njeriu kridhet në artin e Zotit dhe i humb mjekrën dhe mustaqet, e njeh veten, e njeh se gjer ku e ka kufirin, heq dorë nga mendimi mbi Artistin, madje as e nxjerr zërin!

Dhe me gjithë zemër e shpirt, nuk thotë dot gjë tjetër veçse "unë ty s'të lavdëroj dot"! Sepse ajo e thënë, madje, është përtej shifrave dhe kufijve!

Dhulkarnejni shkon në Malin e Përrallave dhe i thotë:
"O Mali i Përrallave, na fol për madhështinë e Zotit!"
Mali i Përrallave i përgjigjet: "Madhështia e tij s'tregohet
me fjalë... Përballë asaj madhështie, kuptimet asgjësohen!" Dhulkarnejni i lutet: "Të paktën na fol për atë që mban mend
dhe për artet e Zotit të cilat mund të thuhen lehtë!"

Dhulkarnejni shkoi në Malin e Përrallave. Ai pa se ai mal ishte prej smeraldi të kulluar.

E kishte rrethuar gjithësinë si hallkë nga të gjitha anët. Dhulkarnejni e pa malin dhe u habit.

Dhe i tha: Nëse mali je ti, malet e tjerë ç'duan? Pranë teje ata janë pothuaj si lodër!

Mali i Përrallave i tha: Ato male janë damarët e mi. Ato nuk mund të jenë të barabartë me mua në bukuri dhe tërheqje!

Në çdo qytet unë kam një damar. Anët e botës janë të lidhura me damarët e mi.

Po deshi Zoti të bëjë lëkundje toke në një qytet, më thotë mua dhe unë e lëviz damarin që arrin atje.

Po e lëviza me të keq damarin që arrin në atë qytet, atje toka lëkundet.

Me të thënë Zoti mjaft, damari im shtrohet. Unë dukem i qetë, por jam vazhdimisht në kërkesë.

Qëndroj si melhem, por bëj mjaft punë; si mendja! Edhe mendja rri, por fjala prej tij lind, lëviz.

Por sipas atij që s'ia rrok mendja këtë, lëkundja e tokës shkaktohet nga avujt në tokë!

Një milingonë që po ecte mbi letër,
pa kalemin që po shkruante e vizatonte dhe filloi ta lavdëronte.
Një milingonë tjetër me sy më të mprehtë i tha se ajo e shihte
se mjeshtëria ishte te gishtat, prandaj t'i lavdëronte gishtat.
Kurse një milingonë tjetër që shihte më mirë se të dyja,
u tha: "Unë lavdëroj krahun
sepse gishtat janë pjesë të krahut!" Etj.

Një milingonë e vogël pa kalemin mbi letër dhe këtë të fshehtë ia tregoi një milingone tjetër.

Dhe i tha: Ai kalemi e zbukuroi dhe e shndërroi letrën në trëndafilishte. Figura të çuditshme bëri.

Milingona e dytë i tha: Janë gishtat që e bëjnë atë art. Në këtë punë, kalemi varet nga gishtat, është mjeti i gishtave!

Milingona e tretë tha: Jo, jo... Ato i ka bërë krahu. Me fuqinë e tij i bënë gishtat ato vizatime!

Kështu, secili shkoi më tej. Më në fund, një milingonë që kuptonte pak dhe mbahej si më e shquara ndër milingonat,

Tha: Mos pandehni se këtë mjeshtëri e bën pamja, mos e shihni ashtu! Në gjumë dhe në vdekje, pamja s'di gjë për këtë!

Pamja është si rroba dhe shkopi... Këto vizatime nuk mund t'i bëjë gjë tjetër veç mendjes dhe shpirtit!

Mirëpo as ajo nuk e dinte se mendja me shpirtin janë gjëra jo të gjalla po qe se nuk i vë në lëvizje Zoti!

Po e preu Zoti mirësinë një çast prej mendjes, mendja që zotëron zgjuarsi, bën budallallëqe!

Me të parë se Mali i Përrallave foli dhe se i shpoi inxhitë e fjalëve, Dhulkarnejni tha:

O mal që i di të fshehtat, ke njohuri për çdo gjë dhe thua fjalë, më fol mua për artet e Zotit!

Mali i Përrallave i tha: Ik tutje! Artet e Zotit janë aq të larta sa për to nuk mund të flitet, ato nuk mund të shprehen me fjalë!

Ose ku mund ta shkruajë kalemi nga vetja shenjën e atyre arteve në ato faqe letre!

Dhulkarnejni i tha malit që t'i tregonte qoftë edhe një rrëfim të vogël mbi të... Ai iu shpreh kështu: O dijetar me shprehi të mira, fol për fuqinë e çuditshme të Zotit!

Mali i Përrallave i tha: "Ja, pra, për ty, kjo fushë që është një rrugë treqind vjeçare. Sovrani e ka mbushur atë me male dëbore!

Janë grumbulluar mal mbi mal në mënyrë të panumërt. Dhe vazhdon të bjerë botë mbi ta!

Mbi një mal dëbore shtrohet një mal dëbore tjetër. Ftohtësia e borës ndjehet gjer në fund të tokës!

Nga një hambar i panjohur, mbi malin e borës shtresohet çdo çast një mal tjetër bore.

Sovrani im, po të mos ishte një fushë e tillë, nxehtësia e xhehennemit do të më shkatërronte mua!

Indiferentët dhe të paditurit diji si male bore! Zoti i ka krijuar ata kështu, të ftohtë, me qëllim që të mos digjen perdet e të mençurve!

Po të mos ishte e kundërta e paditurisë që i lëshon ato borëra, Mali i përrallave do të digjej dhe shkrihej me zjarrin e dëshirës së madhe!

Edhe zjarri është një thërrime nga persekutimi i Zotit. Është si një kamxhik për t'i frikësuar njerëzit e poshtër!

Por me gjithë persekutimin e tij kaq të madh e të lartë, shih: ftohtësia e favorit të Zotit e kalon atë!

Kjo është një përparësi shpirtërore e pacilësueshme me shifra. Si atë, ashtu dhe këtë, shihi të padyfishtë.

Po s'i pe dot, kjo është nga aftësia kuptuese e ulët... Fundja, mendjet e popullit janë vetëm një kokërr elbi nga ajo esencë!

Në këto kushte, mos i shaj shenjat e fesë, të metën gjeje te vetja! Zogu i krijuar nga dheu, si mund ta kapërcejë qiellin e të shkojë tutje?

Vendi më i lartë ku mund të vërtitet zogu, është ajri.... sepse formimi i tij është prej epshi, ajri dhe dëshira!

Prandaj ti bëhu i mahnitur pa thënë po e jo dhe nga mëshira e Zotit të të vijë para një kalë me shalë!

Në se je i paaftë për t'i kuptuar këto gjëra të çuditshme, po të thuash "po" bie në veprim për t'u dukur.

Po të mos thuash po e të thuash jo, vret ballin në atë fjalë, për shkak të fjalës jo, persekutimi i Zotit ta mbyll dritaren!

Në këto kushte vetëm bëhu i mahnitur! Mahnitu që të të vijë ndihma e Zotit nga para e nga prapa!

Po qe se mahnitesh, shtangesh dhe e kapërcen qenien tënde, thuaj me gjuhën e gjendjes tënde: "O Zot, na ço në rrugë të drejtë!"

Kjo punë është shumë e madhe, shumë e madhe! Por po fillove të dridhesh, ajo gjë e madhe zbutet për ty, bëhet krejt e rrafshtë!

Sepse kjo madhëri është sipas mohuesit. Po u bëre i dobët e i përulur, është favor, është mirësi!

Xhebraili (a.s.) ia tregoi veten Mustafait (s.a.s.) në trajtën e vërtetë. Atëherë, kur u duk njëra prej shtatëqind flatrave, ajo e zuri tërë horizontin dhe dielli u mbulua me të gjitha rrezet.

Mustafai i tha Xhebrailit: "O mik, si e ke pamjen?

Shfaqmu hapur që të të shoh e të të vështroj!"

Xhebraili i tha: "Nuk ke fuqi, nuk mund të më shohësh... Ndijimi është i dobët, shumë i brishtë!"

Pejgamberi i tha: "Duku të të shoh dhe ta kuptosh se sa i dobët dhe i pafuqishëm është ndijimi në këtë trup!"

Ndijimi fizik i trupit të njeriut është i mangët. Por brenda tij ka një shprehi të madhe e të bukur.

Trupi dhe shpirti i njeriut i ngjajnë gurit dhe hekurit. Por sipas punës që bëjnë, ky gur dhe hekur janë një çakmak.

Zjarri lind nga guri dhe hekuri. Lind, por këtyre dy baballarëve u sjell shumë persekutime.

Zjarri është një atribut që i përket trupit, por e persekuton trupin, i nxjerr flakë!

Megjithëkëtë, në trup ka një dritë të tillë që, si Ibrahimi, e persekuton yjësinë e zjarrit.

Shkurt, Pejgamberi, zotëruesi i dijeve, ka thënë alegorinë: "Ne jemi ata që u shkojnë pas atyre që ecin përpara."

Në dukje, të dy anët i nënshtrohen një kudhre, por përsa i përket atributit dhe efektit, është më i lartë se mineralet hekurore.

Ja, pra, edhe njeriu, në pamje është pjesë e botës, por nga atributi, dije se është esencë e botës!

Në dukje, njeriu sëmuret nga efekti i një mushkonje, por fytyra e tij e brendshme ka mbuluar shtatë kat qiell!

Pasi Pejgamberi nguli këmbë që Xhebraili të shfaqej me pamjen e tij të vërtetë, Xhebraili u duk pak. Por ishte aq impresionues, saqë mali ta shihte, bëhej copë-copë!

Njëri krah ishte lindja, por e mbuloi në çast perëndimin. Me ta parë, Mustafai u mpak nga impresionimi!

Kur e pa Mustafain të mpakur nga frika, Xhebraili e përqafoi, e mori në gji.

Ai impresionim është për të huajt, kurse ky favor, për miqtë!

Kur mbretërit ulen në fron, përreth tyre ndodhen çaushë impresionues me shpata në duar.

Tek këta çaushë ka çomange, heshta, shpata. Edhe luanët sikur t'i shohin, dridhen nga pamja e tyre!

Nga zërat dhe britmat e çaushëve zemrat rrëqethen. Nga pamja e tyre e frikshme, çdo njeri frikësohet.

Por kjo është për ta lajmëruar popullin e thjeshtë ose fisnikët se po kalon sovrani.

Ky impresionim bëhet që populli të mos e ngrejë kokën lart, që askush të mos e verë mbi kokë qylafin e madhështisë, është shfaqje për popullin.

Me këtë mënyrë kërkohet që të thyhet egoizmi i tyre, që nefsi ose egoja e tyre, së cilës i pëlqen vetja, të bëjë pak intriga e të këqija.

Në këtë mënyrë, popullit i bëhet e njohur fuqia ndëshkuese e padishahut dhe qyteti mbetet në siguri.

Në nefse të tillë, dëshirat për keq vdesin. Fuqia impresionuese e sovranit bëhet pengesë për ta.

Por kur padishahu futet në kuvendin e ngushtë e të afërt, atje s'mbetet më madhështi e impresionim.

Aty padishahu është shumë i butë, mëshira e tij merr vrull. Në atë botë dëgjon vetëm entuziazmin e fyellit dhe tamburit.

Në kohën e luftës bien daulle dhe vegla të tjera gjëmuese e tronditëse, kurse në kohë dëfrimi zhvillohen biseda me parësinë, dëgjohet tamburi.

Për popullin, divani i pyetjeve dhe llogarive. Për bukuroshët me fytyrë perie, kupa me verë!

Parzmoret dhe shpatat janë për luftë, kurse veshjet prej mëndafshi dhe veglat muzikore, për kohën e dëfrimit.

O bujar! Kjo fjalë s'ka fund! Zoti e di më mirë se ç'është e drejtë, apo jo! Mbaroje, atëherë, këtë fjalë!

Ajo ndjenjë e fundosur te Hazreti Ahmedi, tani po fle nën tokën e Medines...

Kurse ajo shprehi e lartë që çan radhë luftarake, nuk ka ndryshuar fare... Në postin e drejtësisë!

Ato që ndryshojnë, janë atribute të trupit. Kurse shpirti që është i përjetshëm, është një diell krejt i ndritshëm!

Ai nuk ndryshon fare, nuk shndërrohet fare në gjendje tjetër, sepse nuk është as nga lindja, as nga perëndimi!

A e humb veten dielli nga molekula? A e sheh drita fluturën dhe i humb ndjenjat?

Trupi i Hazreti Ahmedit kishte lidhje me atë shpirt të lartë. Dije se ky ndryshim është një gjendje që i përket trupit.

Si sëmundja, gjumi dhe dhimbja. Shpirti është i pastër nga këto cilësi.

Nuk mund ta përshkruaj. Përndryshe, po t'u hy vetive të shpirtit, bie tërmet edhe në këtë botë, edhe në botën e bërjes!

Po qe se dhelpra e tij është prishur një çast, luani i shpirtit gjithsesi duhet të jetë në gjumë atë çast!

Ai luan i pastër nga gjumi, ishte në gjumë. Ja, pra, për ty, edhe një luan të butë, edhe një luan të ashpër e të frikshëm!

Luani e bën veten sikur po fle. Të gjithë qentë pandehin se me të vërtetë po fle, ndoshta ka vdekur!

Ndryshe, kush do të kishte fuqi në këtë botë që prej një të dobëti të vidhte gjënë më të parëndësishme!

Hazreti Ahmedi pa nga Xhebraili por vetëm shkuma iu plagos. Deti i tij u entuziazmua me dëshirën për shkumëzim!

Hëna është fund e krye dorë, pëllëmbë, grusht, dhënës, shpërndan dritëra. Ç'dëm ka sikur hëna të mos ketë duar e pëllëmbë? Le të mos ketë!

Po qe se Xhebraili e hap atë flatrën e tij të madhe, Hazreti Ahmedi i humb ndjenjat dhe bie në dalldi përjetësisht!

Kur Ahmedi e kaloi Xhebrailin në sidre, në vendin e vëzhgimit, në postin e tij, në kufi,

I tha Xhebrailit: "Eja, fluturo pas meje!" Kurse Xhebraili i tha: "Ec, ec, unë s'jam i barabartë me ty!"

Hazreti Ahmedi i tha përsëri: "O ti që i djeg perdet, eja... Unë akoma s'kam shkuar në postin tim të lartë!"

Xhebraili i tha: "O shoku im i bukur e i nurshëm, sikur të rrah një krah e të kaloj prej këtu, më tej, krahu më digjet!"

Këto rrëfime janë mahnitje mes mahnitjesh. Personat e veçantë të Zotit, duke parë gjendjen e personave të tjerë më të veçantë, mbeten të mahnitur, bien në dalldi!

Të gjitha dallditë këtu janë lojë. Sa shpirtra ke ti? Ky vend është pozita e dhënies së shpirtit!

O Xhebrail, n'daç të jesh i madh, n'daç të jesh i lartë! Ti nuk je as flutur që fluturon rreth qiririt, as qiri!

Pasi qiriri të ndizet e ta thërresë fluturën, ajo nuk tërhiqet pa iu djegur shpirti.

Ktheje këtë fjalë nga e kundërta dhe bëje luanin gjah të gomarit të egër.

Mbyllja gojën tullumbit prej nga shpërndave fjalë nëpër botë. Mos e hap torbën e fjalëve përçart!

Për personin që sytë nuk i kanë kaluar, që nuk i janë lartësuar dot përtej faqes së qiellit, këto fjalë mund t'i vijnë si pa kuptim e si përçartje!

Mos u sill ashpër me ta, përpiqu të kalosh mirë me ta, o ti që je vendosur në shtëpitë e tyre si njeri i vetëm!

Jepua gjërat që luten e kërkojnë, kënaqi ata, o ti mik që je vendosur në vendbanimet e tyre, që e ke bërë atë vend vendbanimin tënd!

Gjersa të arrijë padishahu, gjersa t'i shihni pamjet dhe trillet e tij të bukura, o rejlinj, kaloni mirë me maragalinjtë!

O Musa, në derë të faraonit të kohës duhen thënë fjalë të buta!

Po të hedhësh ujë mbi vajin që zjen, edhe oxhakun e djeg, edhe tenxherenë!

Thuaj fjalë të buta, por kurrsesi gjë tjetër veç të drejtës! Mos tento që me fjalë të buta të shesësh dyshnime e lëkundje!

U bë iqindi, pra, preje fjalën shkurt, o ti i iqindisë që e zgjon kohën!

Njeriut që e ka bërë zakon të hajë dhé, mos i jep dhé duke treguar një butësi të parregullt; sheqeri është më i mirë!

Ti nuk ke dhënë e marrë me tinguj e shkronja, por, prapë, ti je bahçe shpirti për fjalët e shpirtit!

Ky kryegomar që ka mbetur i varur në kallamishten e sheqerit, sa e sa vetë i la në një hall për t'u qarë!

Ai që e shihte atë nga larg, pandehu se atje ndodhej vetëm ai... Dashi i mundur nga përleshja, largohet pas duke u zbythur e duke u zbythur; edhe ai ashtu shkoi pas.

Trajtën e shkronjës dije kryegomar që vendoset në kopshtin e kuptimit, në bahçen e bukur e të lartë!

O dritë e së vërtetës, Hysameddin, këtë kryegomar sille në bostanin e pjeprit dhe shalqinit!

Sille dhe, ashtu siç ngordhi kryegomari në kasaphane, vendi ku ky burrë i papjekur u poq, t'i japë atij një jetë tjetër!

Ja, pra, prej nesh radhitje trajtash, prej teje dhënie shpirti... Jo, e thashë gabim; edhe ajo prej teje, edhe kjo!

O diell që e ndriçon qartë botën, ti je lavdëruar në qiell... Të të njohë edhe toka ty dhe të lavdërohesh përjetësisht mbi tokë!

Lavdërohu dhe ata të tokës t'i kenë një me ata të qiellit edhe zemrat, edhe kiblet, edhe shprehitë!

Të zhduket ndarja, të mos mbetet politeizëm dhe dyzim! Zaten, në qenien shpirtërore ka vetën njësi, unitet!

Kur shpirti im ta njohë shpirtin tënd, e kujtojnë se gjërat që kanë parë e kaluar janë të njëjta!

Dhe bëhen mbi tokë si Musai me Harunin. Si qumështi me mjaltin, përzihen bukur me njëri-tjetrin dhe shkrihen.

Por po ta njohë pak dhe ta mohojë, edhe ky mohim është si një perde që e mbulon unitetin.

Sa e sa të njohur u kthyen pastaj. Ja, pra, ai fytyrëhënë u nxeh me mosfalenderimin e këtij lloj njeriu!

Prandaj, shpirti i keq nuk e njohu shpirtin e Pejgamberit, por nuk e shqelmoi!

Të gjitha këto i këndove e i mësove... Tani këndoje edhe suren "Lem jekun" dhe njihe inatin dhe këmbënguljen e këtij qafiri të vjetër!

Para se trajta e Hazreti Ahmedit t'i lëshonte dritë kësaj bote, vetitë e tij ishin nuska për çdo qafir!

Dhe thonin: Eshtë një person i tillë që do të vijë... Me imagjinatën e fytyrës së tij u rrihnin zemrat!

Bënin sexhde dhe luteshin: O Zoti i njerëzve, sa të jetë e mundur, nxirre shpejt në shesh atë!

Me emrin e Hazreti Ahmedit luteshin për fitore. Prandaj armiqtë e tyre përmbyseshin!

Ku të kishte një luftë të vështirë, sulmi i përsëritur i Hazreti Ademit u jepte ndihmë atyre!

Kurdo që të kapeshin nga ndonjë sëmundje e rëndë, e kujtonin atë dhe, në këtë mënyrë, gjenin shërim.

Trajta e tij ishte në zemrat e tyre, në veshët e tyre, në gojët e tyre dhe në rrugët e tyre!

Por trajtën e tij të vërtetë a mund ta gjente çdo çakall? Ajo trajtë ishte vetëm produkti i tij, pra, imagjinatë!

Po të reflektohej trajta e tij në mur, nga zemra e murit pikonte gjak.

Trajta e tij i vinte murit aq e bekuar, sa muri shpëtonte menjëherë nga dyfytyrësia!

Në krahasim me pastërtinë e personave të pastër, ajo dyfytyrësi ishte turp për murin, ç'është e vërteta!

Por, më në fund, pasi e panë atë, të gjithë këtë madhërim, të gjithë këtë lartësim, të gjithë këtë dashuri pothuajse e mori era dhe e çoi tutje!

Sapo akçeja kallpe e pa zjarrin, u nxi menjëherë. A mund të gjejë gjëja kallpe rrugë për në zemër?

Njeriu kallp ia thotë pa pushim dëshirën gurit të provës dhe kështu i fut në dyshime ata që i shkojnë pas.

Kush s'është njeri, kapet pas hiles së tij e shkon. Fundja, ky dyshim shfaqet te çdo njeri i rëndomtë.

Dhe thotë: Po të mos jetë akçe me karat të plotë, a e kërkon gurin e provës?

Ajo kërkon gur prove, por jo gur prove që t'ia nxjerrë në shesh falsitetin!

Guri i provës që fsheh vetinë e gjësë kallpe, që nuk e nxjerr atë në shesh, s'është as gur prove, as dritë dijeje!

Pasqyra që e fsheh dhe nuk e tregon të metën e fytyrës për hatër të çdo kalltabani,

Nuk është pasqyrë, por hipokrit... Në paç mundësi, mos kërko pasqyrë të tillë ti!